

IMPLIKIMET E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE TERRORIZMIT NË QASJET MBI SIGURINË. RAST ANALIZE SHQIPËRIA

VILMA SPAHIU

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Marrëdhënie Ndërkombëtare për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: PROF. DR. PËRPARIM FUGA

Numri i fjalëve: 54,926

Tiranë, Maj 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj se punimi me temë “Implikimet e krimit të organizuar dhe terrorizmit në qasjet mbi sigurinë. Rast analize Shqipëria”, për marrjen e gradës “Doktor” në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe Edukimit, departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, është punimi im origjinal. Deklaroj gjithashtu se burimet në të cilat u mbështeta për zhvillimin e këtij punimi, janë paraqitur në mënyrë të hollësishme duke paraqitur autorët, titujt e librave ose revistave dhe faqet përkatëse. Gjithashtu është paraqitur në mënyrë të hollësishme çdo site në internet, në të cilin është marrë informacioni.

DEDIKIMI

Landit.....

Abstrakt: Sfidat bashkëkohore ndaj mjedisit të sigurisë sa vijnë e shtohen dhe bëhen më komplekse por niveli më i lartë i pasigurisë kombëtare dhe globale vjen si pasojë e operimit të krimit të organizuar dhe terrorizmit (aktorë jo-shtetëror transnacional), shoqëruar kjo edhe me krizën ekonomike. Të dy këto fenomene përbëjnë kërcënimin më të madh ndaj sigurisë sot, sepse veç e veç apo së bashku këto veprimtari kriminale (a) përdorin dhunën në një shkallë të gjerë, (b) korrupsionin si mjet për të korrptuar zyrtarët shtetëror, (c) arritjen e përfitimeve sa më të mëdha si dhe (d) realizimin e objektivave specifik të kauzave të tyre, fetare, ideologjike apo politike.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e këtyre kërcënimeve ndaj sigurisë, qëllimi i këtij punimi është të analizojë implikimet e krimit të organizuar dhe terrorizmit në nivelin e sigurisë në Shqipëri si rast studimor, sikurse dhe të rekomandojë zgjidhjet e mundshme për trajtimin e këtyre kërcënimeve. Kur flasim për implikimet e krimit të organizuar dhe terrorizmit në sigurinë e aktorëve, nënkuptojmë qasjet mbi sigurinë në *aspektin teorik*, e cila lidhet me ndikimet/ implikimet e tyre mbi evoluimin e konceptit të Sigurisë, si dhe qasjet mbi sigurinë në *aspektin aplikativ* e cila nënkupton procesin e vendimmarrjes dhe politik bërjes.

Hipoteza e këtij punimi është: *”Krimi i organizuar dhe Terrorizmi në realitetin shqiptar përbëjnë kërcënim ekzistencial sigurie duke vënë në pikëpyetje ekzistencën e shtetit, sepse dobësojnë organizmat shtetëror si dhe pengojnë konsolidimin dhe zhvillimin e shoqërisë”*. Kuadri konceptual/teorik i këtij punimi do të jetë Shkolla e Kopenhagës, procesi i sigurizimit. Faktorët që kanë lehtësuar lindjen dhe zhvillimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit në Shqipëri kanë qenë përmbysja e sistemit komunist, ekonomia e dobët, de stabiliteti politik, kriza/kolapsi ekonomik i vitit 1997-të dhe konfliktet në rajon. Deri më sot këto dy fenomene janë përcaktuar thjeshtë si prioritete kryesore të sigurisë jo si kërcënime ekzistenciale sigurie, kjo tregon që asnjëherë nuk ka ndodhur një proces i mirëfilltë sigurizimi, e për pasojë situata gjithnjë e më tepër paraqitet e vështirë dhe rezultatet kanë rezultuar negative. Problematika lidhet jo me mungesën e një strategjie kombëtare në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, por me nevojën për tu ri konceptuar duke u përshtatur me mjedisin e ri të sigurisë si dhe nevoja për aplikueshmërinë e saj.

Të dhënat e përdorura për këtë punim do të përfshijnë burime parësore që përfshijnë Dokumentet Strategjik- Bazën ligjore-Deklarata të aktorëve të ndryshëm mbi fenomenin e krimit të organizuar dhe terrorizmit. Si dhe burime dytësore, si literaturën teorike mbi fenomenin e krimit të organizuar dhe terrorizmit, studime të mëparshme mbi këto fenomene, literatura specifike që trajton këto aspekte në kontekstin shqiptar, si në aspektin teorik ashtu dhe në atë aplikativ.

Fjalë kyçe: Siguri; krim i organizuar; terrorizmi; rast analize Shqipëria.

Abstract: From an overall assessment of the challenges to the security environment and contemporary developments, the highest level of national and global security comes up as a result of the operation of organized crime and terrorism (non-state transnational actors). In this context, a role also plays the economic crisis. Today both these criminal activities pose the biggest threat to security, because separately or together they (a) employ violence on a large scale, (b) use corruption as a tool to corrupt government officials, (c) achieve large benefits from their operations and (d) realize specific objectives of their causes, which might be religious, ideological or political ones.

Taking into account the significance of these threats to security, the purpose of this study is to analyze the implications of organized crime and terrorism at the security level in Albania – as a case study, as well as recommend possible solutions for handling these threats. While talking about the implications of organized crime and terrorism for the actors' security, we consider approaches on security from the *theoretical aspect*; such approaches are closely related to their impacts / implications regarding the evolution of the concept of Security, and security-related approaches in terms of *applicative aspect*, meaning decision-making and policy-making processes.

The hypothesis of this study is: *“Organized crime and terrorism in the Albanian reality are an existential threat to the security, endangering the existence of the state, because they weaken the state institutions and negatively affect the consolidation and development of our society.”* The conceptual / theoretical framework of this study will be the Copenhagen School, namely securitization process. Factors that have facilitated the emergence and the development of terrorism and organized crime in Albania are the collapse of the communist system, a weak economy, political instability, crisis/economic collapse in 1997, and regional conflicts. To date these two phenomena are simply defined as the major priorities of security – not as existential threats to security; this means that there has never been a genuine process of securitization, and therefore the situation becomes increasingly difficult and the results have proved to be negative. This problematic situation is related not only to the lack of a national strategy in the fight against organized crime and terrorism, but also to the need to reformulate a new strategy, which should be well-suited to the new security environment, as well as to the need for its applicability.

The data used for this study include primary sources, mainly legal strategic documents, legal basis, declarations of various actors on the phenomena of terrorism and organized crime. The data used for this study also include secondary sources, such as theoretical literature on the phenomena of terrorism and organized crime, previous studies on these activities, specific materials addressing these issues in the Albanian context – from the theoretical and applicative aspects.

Key words: Security; organized crime; terrorism; case analysis - Albania.

Falenderime

Një falënderim i veçantë shkon për profesorin tim udhëheqës Prof. Dr. Përparim Fuga për mbështetjen, inkurajimin, besimin, këshillat dhe sugjerimet e tij të vlefshme për punimin tim doktoral. I jam mirënjohëse që në çdo moment të punës sime është treguar i gatshëm dhe jam ndjerë shumë komode për të ndarë me të të gjitha problematikat që kam hasur gjatë punës dhe së bashku kemi arritur të gjejmë zgjidhjet e duhura.

Gjithashtu falënderoj të gjithë stafin akademik të Universitetit Europian të Tiranës. Kam pasur kënaqësinë dhe fatin të marr dije prej tyre. Në veçanti u jam mirënjohëse Prof. Dr. Romeo Gurakuqit dhe Prof. Ass. Tomi Treskës, sepse të dy kanë kontribuar jo vetëm në formimin tim akademik, por edhe në atë njerëzor. Të dy kanë përforcuar tek unë ndjenjën e korrektësisë, përgjegjësisë dhe drejtësisë. Gjithashtu dua të falënderoj edhe Prof. Dr. Kristaq Xharon që edhe pse i është bashkuar stafit akademik të Universitetit Europian të Tiranës vitin e fundit, ka qenë një ndihmesë dhe mbështetje e madhe për mua me ekspertizën e tij.

Nuk mund ti mungojë pjesës sime të falënderimeve Dr. Luan Hoxha, një njeri shumë i rëndësishëm gjatë viteve të studimeve të mia Master. Ai ka qenë një ndër mbështetësit kryesorë të pasionit tim mbi çështjet e sigurisë, kryesisht për trajtimin dhe analizimin e implikimeve të krimit të organizuar dhe terrorizmit në sigurinë kombëtare/ndërkombëtare. E konsideroj vetën me shumë fat dhe të privilegjuar që kam marrë dije nga një person në radhë të parë human dhe pastaj një profesionist i fushës. Ka qenë një ndër njerëzit, i cili ka mbështetur filozofinë time se: *“Nuk mund të bëhesh kurrë një akademik dhe profesionist i fushës, nuk mund të japësh kurrë një kontribut pozitiv për vendin tënd, por edhe më gjerë, nëse nuk je në radhë të parë një njeri me vlera*

humane, i cili nuk cenon lirinë e askujt dhe vepron gjithmonë me drejtësi, kjo është pasuria më e madhe për një njeri”.

Një falënderim i veçantë shkon për kolegun tim Dr. Fatri Morina, për orët e gjata të diskutimeve, të cilat kalonin pa u ndjerë për shkak të pasionit tonë të përbashkët mbi studimet e sigurisë. Koleg, bisedat tona kanë qenë jo vetëm të vlefshme për punën time kërkimore por më kanë dhënë një kënaqësi të madhe, sepse i vlerësoj shumë njohuritë dhe ekspertizën tënde.

Miqtë janë një ndër pasuritë e mia më të mëdha në këtë jetë, i falënderoj pa fund që ata janë të pranishëm në çdo moment të jetës sime. Faleminderit, Goncela, Miranda, Ema, Visi, Elda, Armela, Alida, Suadela, Hamilton, Megi, Gleni, Ody, Ardi, Koli për të gjithë besimin, dashurinë e pakushtëzuar që më keni dhënë e vazhdoni të më jepni, ju kërkoj ndjesë për ditët që unë nuk kam qenë e pranishme për shkak të kohës dhe orëve të mia të gjatë të punës, për mbylljen e telefonit etj. Veçanërisht dua të falënderoj miken time Eneda Xhorin, për mbështetjen, besimin, forcën, diskutimet e gjata, për buzëqeshjet dhe qetësinë që ajo më ka dhënë në momentet e stresit gjatë punës. Mike kemi ndarë dhe do të ndajmë gjithçka bashkë si edhe këtë moment gëzimi në jetën time.

Së fundi dua të falënderoj familjen time, prindërit, dy vëllezërit; Rolandin dhe Neritanin, si edhe Edlirën. Ju falënderoj pa fund që më keni mësuar të jem një njeri i lirë në të gjitha kuptimet, një njeri i cili bën gjithmonë ato gjëra që e bëjnë të lumtur, një njeri gjithmonë të buzëqeshur. Sekret i forcës sime të përditshme jeni ju! Ju falënderoj për dashurinë e madhe dhe mbështetjen që më jepni në çdo ditë të jetës sime! Ju dua pafund!

LISTA E SHKURTIMEVE

A3	Karta e Adriatikut
AII	Nisma Adriatik- Jon
ASHM	Armë të Shkatërrimit në Masë
BE	Bashkimi European
BS	Bashkimi Sovjetik
BSEC	Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi
CEI	Nisma e Europës Qendrore
CEPOL	Kolegji European i Policisë
ETA	Organizata Separatiste Baske
EUROJUST	Agjencia për Bashkëpunimin Gjyqësor në BE
EUROPOL	Zyra Policore Europiane
FA	Forcat e Armatosura
FARC	Forcat e Armatosura Revolucionare të Kolumbisë
FBI	Federal Bureau of Investigation
IRA	The Irish Republican Army

ISIL	Shteti Islamik i Irakut dhe Leventit
ISIS	Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit
NATO	North Atlantic Treaty Organization
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PLO	Organizata për Çlirimin e Palestinës
RCC	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
RSH	Republika e Shqipërisë
SAP	Procesi i Stabilizim Asocimit
SECI	South East Cooperation Initiative
SEECF	Procesi i Bashkëpunimit midis shteteve të Europës Juglindore
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SK	Siguri Kombëtare
SSK	Strategjia e Sigurisë Kombëtare
SU	Strategjia Ushtarake
PSK	Politika e Sigurisë Kombëtare

Përmbajtjes e Lëndës

Abstrakt.....	4
Abstract.....	6
Falenderimet.....	8
Lista e Shkurtimeve.....	10
KAPITULLI I: Hyrja.....	15
1.1.Qëllimi/Objektivat.....	17
1.2. Pyetja kërkimore, nën pyetjet specifike dhe hipoteza.....	17
1.3. Metodologjia e punimit.....	18
1.3.1. Modeli i hulumtimit.....	18
1.3.2. Metodatat e kërkimit, lloji i të dhënave dhe burimet.....	21
1.4. Risia dhe kufizimet.....	23
1.5. Struktura e punimit.....	25
KAPITULLI II: Rishikimi i literaturës dhe kuadri teorik.....	28
2.1.Një vështrim i përgjithshëm i literaturës mbi sigurinë.....	28
2.1.1.Trajtimi i rastit Shqiptar në literaturën ekzistuese.....	45
2.2.Evoluimi i konceptit të sigurisë si refleksion i mjedisit të sigurisë.....	52
2.3.Siguria në optikën e qasjeve teorike; Shkolla e Kopenhagës & Welsh.....	55

KAPITULLI III: Siguria Kombëtare dhe Ndërkombëtare.....61

3.1.Siguria Kombëtare, evoluimi, politika, institucione.....	61
3.2.Siguria Ndërkombëtare, evoluimi, politika, institucione.....	65
3.2.1. <i>Sfida të Mjedisit të Siguirsë</i>	69
3.2.2. <i>NATO dhe BE për menaxhimin e sigurisë</i>	76
3.3.Çështje të integritit të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare.....	79

KAPITULLI IV: Terrorizmi dhe Krimi i Organizuar, refleksione në konceptin dhe procesin e sigurisë.....84

4.1.Një vështrim historik i evoluimit të terrorizmit.....	85
4.2.Tipologjitë e terrorizmit.....	94
4.2.1. <i>Struktura e organizimit të organizatave terroriste</i>	98
4.3. Forma e terrorizmit në dhe pas sulmit të 11 Shtatorit 2001.....	99
4.4. Një vështrim historik i evoluimit të krimit të organizuar.....	106
4.4.1. <i>Karakteristika të Krimit të Organizuar Transnacional</i>	113
4.4.2. <i>Karakteristikat e operimit të krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor</i>	117
4.4.3. <i>Format kryesore të evoluimit të krimit të organizuar dhe transnacional</i>	123
4.5.Analizë mbi strategjitë e parandalimit të krimit të organizuar/ transnacional.....	126
4.6.Ndërthurja dhe ndikimet e krimit të organizuar dhe terrorizmit.....	130
4.6.1. <i>Organizata terroriste ISIS (Rast analize)</i>	133

4.7. Lidhja midis Shkollës së Kopenhages, fenomeneve (Krimi i organizuar & Terrorizmit) dhe Shqipërisë si rast studimor.....	142
--	-----

KAPITULLI V: Krimi i organizuar dhe terrorizmi - Analizë e mjedisit të sigurisë në vendin tonë144

5.1.Evolimi i konceptit të sigurisë në vendin tonë.....	146
5.1.1Analizë mbi dokumentet strategjik të sigurisë kombëtare.....	158
5.2.Krimi i Organizuar në Shqipëri.....	165
5.3.Lufta kundër krimit të organizuar si një parakusht i sigurië dhe integritetit.....	174
5.4.Veçori të operimit të terrorizmit.....	180
5.5.Procesi i Sigurizimit ndaj kërcënimit të krimit të organizuar dhe terrorizmit.....	191
5.6.Refleksion mbi SSK (2015) dhe SSU (2015) të Republikës së Shqipërisë.....	201

KAPITULLI VI: Përfundime dhe rekomandime.....210

BIBLIOGRAFIA.....216

Kapitulli I: Hyrja

Studimet e sigurisë qëndrojnë në thelb të disiplinës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Duke qenë se siguria është një çështje e politikave të larta, ajo është thelbësore dhe pjesë integrale e debateve qeveritare sikurse dhe debateve akademike. Siguria kombëtare është prioriteti themelor që duhet të realizojnë shtetet. Mbrojtja e qytetarëve, shoqërisë në tërësi dhe vetë shtetit, përbën në thelb arsyen e ekzistencës së shtetit. Çdo shtet, për të realizuar qëllimin e tij primar - atë të mbrojtjes së qytetarëve - harton strategji kombëtare të cilat në vetvete bazohen në vlerësimin e të gjithë komponentëve të fuqisë së tij. Pas vendosjes së prioritetit të parë, atë të sigurisë dhe mirëqenies së individëve, shtetet përcaktojnë dhe prioritetet e tjera të cilat janë në funksion të realizimit të prioritetit të parë. Në një logjikë të ngjashme, shtetet vendosin dhe prioritetet e tyre në politikën e jashtme, të cilat janë (ose së paku duhet të jenë) në koherencë të plotë me prioritetet e politikës së brendshme. Ndërthurja midis elementeve të politikës së brendshme dhe asaj të jashtme dëshmon më së miri pozicionin e shteteve në arenën ndërkombëtare, qoftë ky një pozicion qendror, i mesëm ose periferik.

Tradicionalisht objekti i cili duhej siguruar ka qenë shteti, çka njihej si objekt referues. Ai është përpjekur që të garantojë siguri përmes forcës ushtarake, megjithatë ekzistojnë edhe qasje të tjera të artikuluar në periudhën e pas Luftës së Ftohtë, të cilat përcaktojnë si objekte të tjera referuese (shoqëria, grupe etnike, sektorë të ndryshëm, individë, etj.) ashtu edhe mjete të tjera (diplomacia, ekonomia, kultura, etj.) për të përmbushur qëllimin primar të shtetit, sigurinë e tij. Qasje të tilla tregojnë se praktikatat e kaluara, në vend që të forconin sigurinë, kanë qenë shpeshherë shkak kryesor i pasigurisë. Bota në të cilën jetojmë sot, përballet me shumë probleme, të cilat pa diskutim që kërkojnë një zgjidhje nga ana e shteteve, sikurse dhe nga ana e aktorëve jo-shtetëror. Në periudhën bashkëkohore, mungesa e një bashkëpunimi midis aktorëve të ndryshëm do e bëjë të pa mundur përballjen me sfidat e reja të sigurisë të lidhura

me çështjet mjedisore, përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, luftërat apo konfliktet etnike në vendet në zhvillim, krimi i organizuar, terrorizmi, etj.

Mjedisi bashkëkohor i sigurisë karakterizohet nga një nivel i lartë kompleksiteti, i cili vjen si pasojë e:

- Ekzistencës së aktorëve të ndryshëm (si shtetëror ashtu edhe jo shtetëror);
- Shfaqjes së fenomeneve të reja të cilat përbëjnë kërcënim për sigurinë (kërcënimet tradicionale dhe jo tradicionale/ kërcënimet asimetrike);
- Ndërveprimit në nivele të ndryshme (i brendshëm, rajonal dhe ndërkombëtar);
- Globalizimit, tendencave integruese dhe intensifikimi i marrëdhënieve midis aktorëve;
- Zhvillimeve teknologjike;
- Pa parashikueshmërisë.

Të gjithë këto element janë tregues të qartë të kompleksitetit të mjedisit bashkëkohor të sigurisë, në të cilin si mundësitë ashtu edhe kërcënimet sa vijnë dhe rriten. Në listën e gjatë të kërcënimeve me të cilat mund të përballen aktorët e sistemit ndërkombëtar, ndër më kryesorët mund të përmendim krimin e organizuar dhe terrorizmin, të cilët përbëjnë një sfidë shumë të rëndësishme për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare të shteteve. Rëndësia në rritje e këtyre fenomeneve si kërcënime serioze për sigurinë, lidhet me aftësinë e tyre për të depërtuar në pikat më të dobëta të organizimit shtetëror. Prezenca e formave të ndryshme të veprimtarive të grupeve kriminale dhe infiltrimi i tyre në sfera të ndryshme, si në atë shoqërore, ekonomike dhe politike, po kthehet gjithnjë e më shumë në një faktor thelbësor destabilizues dhe frenues për konsolidimin dhe zhvillimin e shoqërive. Kjo nuk është karakteristikë vetëm në shtetet e dobëta, por është problematikë e cila mund të prekë çdo aktor të sistemit ndërkombëtar, pavarësisht pozitës së tij brenda këtij sistemi.

1.1.Qëllimi/Objektivat

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë implikimet e krimit të organizuar dhe terrorizmit në nivelin e sigurisë në Shqipëri si rast studimor, sikurse dhe të rekomandojë zgjidhjet e mundshme për trajtimin e këtyre kërcënimeve. Kur flasim për implikimet e krimit të organizuar dhe terrorizmit në sigurinë e aktorëve, nënkuptojmë qasjen mbi sigurinë në *aspektin teorik*, e cila lidhet me ndikimet/ implikimet e tyre mbi evoluimin e konceptit të Sigurisë, si dhe qasjen mbi sigurinë në *aspektin aplikativ*, e cila nënkupton procesin e vendimmarrjes dhe politik bërjes.

Për të përmbushur këtë qëllim, punimi përcakton një sërë objektivash, ku ndër më të rëndësishmit përmendim:

- Analizimi i situatës së sigurisë në Shqipëri dhe identifikimit të kërcënimeve kryesore ndaj saj;
- Identifikimi i tipareve/karakteristikave të krimit të organizuar dhe terrorizmit, dhe implikimet e tyre në mjedisin e sigurisë në Shqipëri;
- Analizimi i qasjeve të aktorëve ndaj këtyre kërcënimeve, si në aspektin e bashkëpunimit me aktorë të tjerë ashtu edhe në nivelin e sigurizimit të këtyre fenomeneve.

1.2.Pyetja kërkimore, nën pyetjet specifike dhe hipoteza/t

Në koherencë me qëllimin dhe objektivat e specifikuar me lart, pyetjet kryesore që ngrihen në këtë punim janë:

- Si ndikojnë krimi i organizuar dhe terrorizmi në mjedisin e sigurisë në rastin shqiptar?
 - o Cilat janë tiparet e mjedisit të sigurisë në Shqipëri dhe cilat janë kërcënimet kryesore ndaj saj?
 - o Cilat janë karakteristikat e krimit të organizuar dhe terrorizmit dhe cilat janë

implikimet e mundshme të tyre në nivelin e sigurisë?

- o Cila ka qenë qasja e aktorëve ndaj këtyre kërcënimeve dhe çfarë impakti ka sjellë ajo në politikën e brendshme dhe të jashtme të sigurisë?

Ndërsa hipoteza e këtij punimi është: ***“Krimi i organizuar dhe terrorizmi në realitetin shqiptar përbëjnë kërcënim ekzistencial sigurie duke vënë në pikëpyetje ekzistencën e shtetit, sepse dobësojnë organizmat shtetëror dhe pengojnë konsolidimin dhe zhvillimin e shoqërisë”.***

Niveli i kërcënimit ndaj sigurisë mund të jetë i ndryshëm, ai mund të shfaqet si i tërthortë ose si i drejtpërdrejtë. Kur flasim për kërcënim ekzistencial sigurie, nënkuptojmë nivelin më të lartë të pasigurisë të lidhur me mosrealizimin e prioritetit themelor të shtetit, i cili është garantimi i sigurisë dhe mirëqenia e qytetarëve të tij. Krimi i organizuar dhe Terrorizmi njihen si kërcënime për sigurinë e shteteve në sistemin ndërkombëtar por duhet të nënvizojmë faktin se lloji/niveli i kërcënimit nga këto dy fenomene është i ndryshëm si rezultat i politikave dhe masave të ndërmarra nga shtetet në parandalimin, ballafaqimin dhe minimizimin e këtyre dy fenomeneve. Në realitetin shqiptar, shteti dhe shoqëria shfaqen të dobëta për të reaguar ndaj këtyre dy dukurive, si rezultat i nivelit të lartë të fushave të operimit të këtyre dy veprimtarive dhe kombinimit të kufizimeve njerëzore dhe materiale.

1.3. Metodologjia e punimit

1.3.1. Modeli i hulumtimit

Modeli i hulumtimit i përzgjedhur për këtë punim është ai i rastit studimor, i fokusuar tek Shqipëria. Po përse rast studimor dhe përse Shqipëria? Për të argumentuar një përzgjedhje të tillë duhet fillimisht të evidentojmë elementët/karakteristikat e rastit studimor si model hulumtimi, të cilat janë:

- Përfshin një rast të vetëm, ose një numër të vogël rastesh, por secili prej tyre eksplorohet në thellësi;
- Në to mund të mblidhen një numër llojesh të ndryshme të të dhënave dhe mund të përfshihen edhe të dhëna afatgjata apo përfaqësimore;
- Subjekt i rastit të studimit mund të jetë një person, organizatë, situatë ose një vend por studimi duhet të lidhet me një aspekt të caktuar të rastit, të përcaktuar në pyetjen e hulumtimit;
- Rasti i studimit ka kufij, ai e bën të qartë çfarë do të studiohet dhe çfarë jo;
- Qasja e përdorur është holistike, sepse hulumtuesi është i interesuar si për marrëdhëniet që ekzistojnë midis pjesëve përbërëse të rastit, ashtu edhe për rastin si një i tërë (Matthws & Ross, 2010: 128).

Për të justifikuar përzgjedhjen e këtij modeli, është e nevojshme të fokusohemi tek qëllimi, pyetja kërkimore dhe hipoteza e punimit. Sikurse u evidentua dhe më lart, qëllimi i punimit është të identifikojë, analizojë dhe të rekomandojë zgjidhjet e mundshme për fenomenin e krimit të organizuar dhe terrorizmit dhe implikimet që ato kanë në sigurinë kombëtare/ rajonale/ ndërkombëtare apo qasjeve mbi sigurinë, në kontekstin e një rasti specifik i cili është Shqipëria. Pyetja kërkimore bazë është: Si ndikojnë krimi i organizuar dhe terrorizmi në mjedisin e sigurisë? (Rasti shqiptar). Ndërsa hipoteza: Krimi i organizuar dhe terrorizmi në realitetin shqiptar përbëjnë kërcënim ekzistencial sigurie, duke vënë në pikëpyetje ekzistencën e shtetit, sepse dobësojnë organizmat shtetërore si dhe pengojnë konsolidimin dhe zhvillimin e shoqërisë sonë.

Sikurse vihet re nga elementët e mësipërm, modeli i rastit studimor është i përshtatshëm për punimin sepse:

- Përfshin një rast të vetëm, i cili është Shqipëria, dhe studiohet në thellësi;

- Të dhënat që mund të mblidhen për të studiuar implikimet e krimit të organizuar dhe terrorizmit në sigurinë kombëtare janë të llojeve të ndryshme, ku mund të përfshihen si ato sasiore/cilësore dhe parësore/dytësore. Sikurse do të trajtohet dhe në vijim, punimi do të mbështetet kryesisht në të dhënat cilësore. Duke qenë se siguria dhe kërcënimet ndaj saj përveçse fenomene janë edhe procese, atëherë modeli i rastit studimor na lejon të mbledhim dhe të dhëna afatgjata.
- Subjekt i punimit do të jetë një rast specifik, që është Shqipëria dhe aspektet e sigurisë që do të trajtohen do të kufizohen vetëm në trajtimin e krimit të organizuar dhe terrorizmin dhe jo në tërësinë e kërcënimeve ndaj sigurisë në rastin Shqiptar, duke përcaktuar në këtë mënyrë dhe kufijtë e rastit studimor. Rëndësia e këtyre dy kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare është e evidentuar si nga studimet e zhvilluara në kontekste të tjera por të ngjashme me kontekstin Shqiptar, ashtu dhe nga dokumentet strategjik dhe diskuri politik i aktorëve kryesor në rastin tonë.
- Qasja holistike, tërësore, është e aplikueshme në rastin e përzgjedhur sepse interes përbëjnë si fenomenet e veçanta, bashkëveprimi midis tyre dhe implikimet që ato kanë në tërësi për rastin studimor, Shqipërinë.

Arsyet e përzgjedhjes së Shqipërisë si rast studimor, janë si subjektive ashtu edhe objektive:

- Arsyeja subjektive lidhet me faktin se i përkas këtij vendi, duke bërë që si interesi ashtu edhe njohja ime mbi të të jetë më e madhe në raport me vendet e tjera.
- Arsyet objektive lidhen me faktin se këto dy fenomene, krimi i organizuar dhe terrorizmi (kryesisht fenomeni i parë) përbëjnë kërcënime reale për subjektin e analizës. Si historia, ashtu edhe aktualiteti, të cilat do të trajtohen në mënyrë të detajuar gjatë punimit, dëshmojnë për një konstatim të tillë. Periudha e tranzicionit, karakteristikat e

vendit, treguesit socio – ekonomik e më gjerë, kanë prodhuar kontekstin e përshtatshëm për ekzistencën dhe implikimet e këtyre fenomeneve ndaj sigurisë kombëtare.

1.3.2 Metodat e kërkimit, lloji i të dhënave dhe burimet

Për përzgjedhjen e metodave që do të përdoren për hulumtimin, duhet të nisemi nga pyetja/et kërkimore, hipoteza e punimit dhe aspektet e temës hulumtuese që janë fokusi kryesor (Matthws & Ross, 2010: 141). Bazuar në këto element, qasja e përdorur do të jetë cilësore, sepse përshtatet me fokusin e punimit i cili përmban disa nga elementët e qasjes cilësore (Matthws & Ross, 2010: 142), si:

- Qasjet ontologjike dhe epistemologjike janë interpretuese – duke qenë se fenomenet që trajton punimi, të tilla si krimi i organizuar, terrorizmi dhe siguria trajtohen si konstrukte sociale (përdorimi i Shkollës së Kopenhagenit e cila ka tipare konstruktiviste), atëherë ky element përputhet me fokusin e punimit.
- Pyetjet e hulumtimit mund të hartohen përmes nën pyetjeve – sikurse evidentohet në seksionin e pyetje/ve kërkimore, punimi ngre një pyetje kërkimore bazë dhe disa nën/pyetje specifike të cilat janë në funksion të saj.
- Pyetja e hulumtimit mund të marrë përgjigje përmes përshkrimit dhe shpjegimit – këto element janë të pranishëm në procesin e këtij kërkimi shkencor, ndryshe nga ato kërkime të cilat përdorin qasjen sasiore ku pyetja e hulumtimit marrin përgjigje përmes numërimit të ngjarjeve dhe analizave statistikore.
- Të dhënat janë të formave të ndryshme, dhe jo të paraqitura me anë të kodeve numerike ose emërtuese. Sikurse do të shihet dhe përgjatë punimit, të dhënat e mbledhura janë cilësore dhe jo sasiore.

Metodat e mbledhjes së të dhënave dhe analizës së tyre, të cilat përputhen me qasjen

cilësore që përdoren në këtë punim janë:

- Dokumentet – përfshijnë si të dhëna cilësore (raportet dhe gjetjet e projekteve të hulumtimit) ashtu dhe politika (dokumente qeveritare dhe të tjera), të cilat specifikohen në nën/seksionin e mëposhtëm të burimeve.
 - o Deklaratat, komunikata, intervista të aktorëve të lidhur me sigurinë si në aspektin politik bërës ashtu edhe studimor.
- Analiza e ligjërimit – e cila përkufizohet si tekst i shkruar ashtu edhe i folur. Përdoret kryesisht në hulumtime cilësore dhe nga pikëpamja teorike mbështetet në teorinë e konstruktivizmit shoqëror.

Arsyeja e përzgjedhjes së këtyre metodave, si për mbledhjen e të dhënave ashtu edhe për analizimin e tyre është në funksion të përmbushjes së qëllimit të kërkimit, pyetje/ve kërkimore dhe hipotezës. Duke qenë se baza teorike e këtij punimi mbështetet në qasjen konstruktiviste, këto janë metodat më të përshtatshme, për arsyen se:

- o Shkolla e Kopenhagenit, e ngritur në premisat konstruktiviste, i shikon fenomenet si konstrukte sociale të aktorëve ndërveprues. Realitetet nuk janë ‘objektive’ por ndërtohen në bazë të ndërveprimit midis aktorëve.
- o Procesi i sigurizimit, i cili është elementi kryesor i kësaj qasje sikurse dhe i punimit, argumenton se një çështje apo fenomen i caktuar, për t’u bërë pjesë e sigurizimit dhe të trajtohet si kërcënim ekzistencial, duhet të artikullohet si i tillë nga aktori sigurizues nëpërmjet një akti ligjërimit, dhe të bindet audienca për nevojën e marrjes së masave të jashtëzakonshme.

Burimet e përdorura janë si parësore ashtu edhe dytësore.

- Burimet parësore përfshijnë:
 - o Dokumentet strategjik – si Strategjia e Sigurisë Kombëtare; Strategjia Ushtarake; Strategjia Ndër sektoriale në Luftën Kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve dhe Terrorizmit; Planet e Veprimit.
 - o Bazën ligjore – Kushtetuta, Ligje, Aktet të tjera.
 - o Deklarata të aktorëve të ndryshëm mbi fenomenin e krimit të organizuar dhe terrorizmit.
- Burimet dytësore përfshijnë:
 - o Literaturën teorike mbi fenomenin e krimit të organizuar dhe terrorizmit.
 - o Studime të mëparshme mbi këto fenomene.
 - o Literatura specifike që trajton këto aspekte në kontekstin shqiptar, si në aspektin teorik ashtu dhe në atë aplikativ.

1.4. Risia dhe kufizimet

Studimi i një problematike të lidhur me terrorizmin dhe krimin e organizuar, shoqërohet si me mundësi ashtu dhe me kufizime të ndryshme. Kur flasim për mundësi i referohemi faktit se implikimet që sjell krimi i organizuar dhe terrorizmi në sigurinë kombëtare të Shqipërisë është i studiuar relativisht pak si nga studiues shqiptar ashtu edhe të huaj. Përgjithësisht studimet e mëparshme janë fokusuar në analizimin e faktorëve në mënyrë të pavarur nga njëra – tjetra. Risia e këtij punimi konsiston në dhënien e rëndësisë së duhur këtyre dy fenomeneve, të cilat përbëjnë sot rrezikun/kërcënimin më të madh për sigurinë tonë kombëtare.

Ky studim mund të japë një ndihmesë/kontribut në formulimin e strategjive efektive dhe të aplikueshme si dhe mund të ndihmojë në rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të elitës politike dhe shoqërisë shqiptare mbi nivelin e lartë të pasigurisë ekzistenciale që këto dy fenomene shkaktajnë për sigurinë tonë. Gjithashtu risia që sjell ky punim, lidhet me

propozimin për ti sigurizuar këto dy fenomene dhe aplikueshmërinë e procesit të sigurizimit në realitetin shqiptar. Elita politike dhe institucionet shtetërore i kanë konsideruar krimin e organizuar dhe terrorizmin si prioritet të sigurisë kombëtare por asnjëherë si kërcënime ekzistenciale të sigurisë.

Kufizimet e punimit, kanë të bëjnë kryesisht me:

- Studimet e mëparshme – bazuar në rishikimin e literaturës ekzistuese, studimet të cilat fokusohen në fenomenet e krimit të organizuar dhe terrorizmit në rastin Shqiptar janë të kufizuara. Ato ose janë në nivelin e artikujve ose fokusohen vetëm tek njëri nga fenomenet. Kjo situatë ka dy pasoja. Së pari, ajo krijon terrenin e përshtatshëm për këtë fushë studimore, në të cilën ky punim mund të shërbejë për të mbushur këtë boshllëk. Së dyti, mund të jetë problematike pasi studimet referenciale për këtë temë janë relativisht të kufizuara.
- Aksesit në të dhëna – për shkak të natyrës së fenomeneve që merren në shqyrtim, aksesit në të dhëna është problematik. Të dhënat ekzistuese janë të paplota, nuk janë periodike, mbulojnë vetëm elementë të veçantë të këtyre fenomeneve, janë të shpërndara në burime të ndryshme, aksesit në të cilat jo gjithmonë është i mundur. Mungesa e një data-baze përbën kufizim për punimin.
- Mungesa e të dhënave reale – të dhënat e disponueshme dhe të aksesueshme i referohen vetëm të dhënave të evidentuara nga organet ligj zbatuese. Duke mos patur informacion të plotë mbi veprimtarinë e këtyre fenomeneve, kryesisht të krimit të organizuar i cili ka dhe një natyrë më të fshehtë, atëherë identifikimi dhe analizimi i impaktit konkret të këtyre fenomeneve në sigurinë kombëtare bëhet i vështirë.
- Shtrirja kohore e studimit – Fokusi kryesor i këtij punimi shtrihet që nga periudha post-komuniste deri në 2014-tën. Në terma sasiorë kjo periudhë është relativisht e gjatë për tu

përfshirë në një studim të vetëm, por duke qenë se analizimi i situatës aktuale nuk mund të jetë i plotë pa kuptuar evoluimin e këtyre fenomeneve atëherë periudha kohore e marrë në analizë është e përshtatshme dhe e nevojshme.

- Matja e implikimit që mund të vijë si pasojë e bashkëpunimit midis dy fenomeneve – Një ndër aspektet më interesante në rastin e trajtimit të fenomeneve të tilla është mundësia e bashkëpunimit midis tyre dhe impaktit që ato mund të kenë mbi sigurinë kombëtare, por duke qenë se masa e kërcënimit që secili prej tyre ka në sigurinë kombëtare është shumë i ndryshëm dhe të dhënat për një bashkëpunim të mundshëm midis tyre në rastin e Shqipërisë mungojnë atëherë punimi fokusohet në analizimin e kërcënimeve të ndara dhe jo të marra së bashku (në kuptimin e pasojave që mund të vijnë si rezultat i bashkëpunimit midis tyre).

1.5.Struktura e punimit

Struktura e këtij punimi përbëhet nga gjashtë kapituj. Secili nga kapitujt është trajtuar në mënyrë të atillë që të krijojë një rrjedhë logjike midis kalimeve nga njëri tek tjetri. Secili nga kapitujt është në funksion të së tërës. Pra, është si një mekanizëm zinxhir ku secili nga elementët jep kontributin e tij, për të vënë në punë të gjithë mekanizmin.

Kapitulli i parë është hyrja e punimit, në të cilën shpaloset një tablo e përgjithshme mbi atë së çfarë është siguria, shteti dhe prioriteti i tij themelor, kërcënimet/sfidat me të cilat përballlet siguria kombëtare/ndërkombëtare e shteteve. Pjesë e rëndësishme e këtij kapitulli është identifikimi i fokusit/qëllimit të punimit, objektivat, risia dhe kufizimet e kërkimit shkencor, pyetja kërkimore dhe nën pyetjet specifike dhe hipoteza qendrore e punimit. Metodologjia, e cila përfshin modelin dhe instrumentet e përdorur për këtë punim janë pjesë e këtij kapitulli.

Kapitulli i dytë, përmban rishikimin e literaturës dhe kuadrin teorik. Analiza kritike e literaturës ekzistuese mbi çështjet e sigurisë ka rëndësi teorike por edhe metodologjike për punimin. Fokusi do jetë si literatura bashkëkohore e cila trajton këto fenomene në aspektin teorik, ashtu edhe literatura mbi rastet e ngjashme studimore por edhe të rastit të Shqipërisë. Pjesë shumë e rëndësishme e këtij kapitulli do të jetë identifikimi dhe analizimi i tipareve/karakteristikave të evoluimit të konceptit të sigurisë si refleksion i mjedisit të sigurisë. Siguria në optikën e qasjeve teorike: Shkolla e Kopenhagën & Welsh do të përbëjë edhe fokusin e pjesës së fundit të këtij seksioni.

Kapitulli i tretë, fokusohet në shpjegimin e koncepteve të tilla si: siguri kombëtare dhe siguri ndërkombëtare, evoluimi, politikat dhe institucionet e tyre. Për të kaluar më tej tek identifikimi, analizimi i sfidave/kërcënimeve të mjedisit të sigurisë. Një pjesë shumë e rëndësishme e këtij kapitulli do të jetë analizimi i strategjive të dy aktorëve të rëndësishëm të sistemit ndërkombëtar - NATO dhe BE - mbi menaxhimin e rrezikut ndaj sigurisë kombëtare dhe asaj ndërkombëtare. Pjesa e fundit e këtij kapitulli paraqet një reflektim dhe një vështrim kritik mbi çështjet e integritetit të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kapitulli i katërt, fokusohet në analizimin e fenomeneve të terrorizmit dhe krimit të organizuar dhe implikimeve të tyre në nivelin e sigurisë së aktorëve. Në literaturën bashkëkohore debati fillon që me përkufizimin e fenomeneve, duke ndjekur më pas evolucionin e tij dhe për t'u ndalur në veçoritë e terrorizmit dhe krimit të organizuar. Një vend të rëndësishëm në këtë kapitull zë dhe trajtimi i ndërthurjes e ndikimit të krimit të organizuar dhe terrorizmit, të shfaqura në rastin e organizatës terroriste ISIS.

Kapitulli i pestë, fokusohet në analizimin e mjedisit të sigurisë të rastit studimor, Shqipërisë. Kapitulli nis me trajtimin dhe analizimin e konceptit të sigurisë në rastin e Shqipërisë, për të vazhduar më tej me analizimin e dokumenteve strategjik të sigurisë kombëtare të hartuara dhe implementura ndër vite. Një pjesë shumë e rëndësishme e këtij

kapitulli do të jetë identifikimi i elementëve/faktorëve të cilët kanë krijuar kushte të favorshme për lindjen dhe evoluimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit në realitetin shqiptar. Më tej do të ndalemi tek argumentimi i fakteve se lufta kundër krimit të organizuar shihet si parakusht i sigurisë dhe integritit tonë. Pjesët më të rëndësishme të këtij kapitulli do të jenë: Argumentimi për aplikimin e procesit të sigurizimit ndaj kërcënimit të krimit të organizuar dhe terrorizmit në realitetin shqiptar, si dhe refleksioni mbi Strategjinë e Sigurisë Kombëtare (SSK, 2015) dhe Siguria e Strategjisë Ushtarake (SSU, 2015) të Republikës së Shqipërisë. Këto dy çështje do të përbëjnë edhe dy pjesët e fundit të këtij kapitulli.

Kapitulli i gjashtë, përfshin konkluzionet dhe rekomandimet e punimit.

Kapitulli II: Rishikim literature dhe kuadri teorik

2.1. Një vështrim i përgjithshëm i literaturës mbi sigurinë

Termi ‘Siguri’ zë një vend shumë të rëndësishëm në disiplinën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Mungesa e një përkufizimi të gjithë pranuar, e lidhur me interesa të ndryshme dhe kompleksitetin, bën që ky term të shpjegohet me një sërë përcaktimesh të cilat marrin kuptim në varësi të kontekstit në të cilin aplikohen. Disa akademikë e kanë cilësuar termin ‘Siguri’ si një “koncept në thelb të kontestuar” (Buzan, 1991; Little, 1999; Gallie, 2008). Wolfers, i cili është një ndër teoricienët më të rëndësishëm në studimet e sigurisë, e përkufizon sigurinë si “mungesa e kërcënimit për vlerat e fituara” (Wolfers, 1962: 485). Thënë ndryshe, ‘Siguria’ është e kundërta e pasigurisë ose e kërcënimit.

Sikurse shprehet dhe Lippman, “një komb është i sigurt deri në pikën kur nuk ka në rrezik vlerat kyçe që mund të humbasë për t’i u shmangur një lufte, ose që është në atë nivel sa t’i mbrojtë ato vlera edhe nëse hyn në luftë”. Punimi i Wolfers (1952) do të përbënte bazën kryesore për studiuesit e tjerë të sigurisë, të cilët duke u nisur nga puna e tij i dhanë formë disiplinës së studimeve të sigurisë. Sipas Wolfers, për të përcaktuar termin siguri duhet paraprakisht t’i përgjigjemi disa pyetjeve:

- Siguri për kë? - Është e nevojshme të përcaktohet se cili është objekti referues i sigurisë, cili është ai aktor (shtet, grupe apo sektorë të caktuar), i cili rrezikohet nga kërcënimet ndaj sigurisë. Një identifikim i tillë është shumë i rëndësishëm pasi një fenomen i caktuar mund të jetë kërcënim për disa objekte, por mund të mos jetë i tillë për disa të tjerë.
- Siguri për cilat vlera? - Vlerat e aktorëve variojnë nga ato materiale, deri tek ato të lidhura me identitetin, kulturën dhe trashëgiminë. Në momentin që zhvillohet një analizë për sigurinë e aktorit, është e nevojshme të identifikohet dhe cila apo cilat nga

vlerat e tij janë të kërcënuara. Jo çdo kërcënim shfaqet me të njëjtin intensitet dhe ka të njëjtin efekt në tërësinë e vlerave materialo – ideore të aktorëve.

- Sa siguri? - A është e mundur të thuhet që ne kemi pak ose shumë siguri? Bernard Brodie, i cili ka shkruar pak a shumë në të njëjtën kohë me Wolfers, citon gjeneralin Jacob L. Devers, i cili shprehet se “Siguria kombëtare është një gjendje që nuk mund të kualifikohet. Ne ose do jemi të sigurtë, ose do jemi të pasigurtë. Ne nuk mund të kemi siguri të pjesshme. Nëse ne jemi gjysmë të sigurtë, ne nuk jemi fare të sigurtë.”(Brodie, 1950: 5).
- Siguri nga cilat kërcënime? - Gjatë Luftës së Ftohtë kërkohej siguri nga ‘kërcënimi komunist’ e më vonë, pas përfundim të kësaj lufte duket se ‘u shtua’ gama e kërcënimeve, e cila në fakt nuk u shtua por thjesht u pa nga një këndvështrim tjetër, duke përfshirë nën termin siguri edhe ato kërcënime që deri në atë kohë nuk konsideroheshin si të tilla, duke u etiketuar me termin kërcënime jo-tradicionale të sigurisë.
- Siguri në çfarë mënyre? - Specifikimi i këtij dimensionit të sigurisë është veçanërisht i rëndësishëm në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, pasi lidhet me përdorimin apo me ‘kërcënimin e përdorimit’ dhe ‘kontrollin e forcës’ ushtarake i cili mund të çojë në kufizim të mjeteve të përdorura për arritjen e sigurisë (Walt, 1991).
- Siguri me çfarë kosto? - Edhe përcaktimi i këtij dimensionit të Sigurisë është shumë i rëndësishëm, sepse lejon të nënkuptohet fakti që siguria duhet të arrihet pavarësisht faktorëve të tjerë, pa marrë parasysh këtu as kostot financiare. Kjo nënkupton se shpenzimet nuk kanë rëndësi kur bëhet fjalë për sigurinë, por në realitet të gjithë vlerësojnë se “kostot gjithmonë kanë rëndësi” (Baldwin, 1997: 16).

- Siguri afatshkurtër apo afatgjatë? - Politikat më racionale për sigurinë me shtrirje afatgjata, ndryshojnë nga ato afatshkurtra apo afatmesme. Në periudha afatshkurtra, mund të gjenden zgjidhje imediate, apo mund të krijohen grupe *ad hoc*, për zgjidhjen e problemeve që nuk mund të presin për t'u trajtuar, duke marrë masa të shpejta e të thjeshta si p.sh.: patrullimi më i rreptë i kufirit, vendosja e më shumë patrullave policore apo ushtarake etj, “por në periudha afatgjata, ndoshta do të jetë e preferueshme të bëheni miq me ‘armikun tuaj’” (Boulding, 1963: 424). Gjithashtu, mund të ndodhë që Siguria afatshkurtër mund të bie ndesh me sigurinë afatgjatë (Dahl & Lindblom, 1953: 50), sepse faktorët si koha, ndryshimet që mund të ndodhin në mjedisin e sigurisë apo në marrëdhënien midis shteteve, ndikojnë në rishikimin e çështjeve të sigurisë, duke bërë që strategjia afatgjatë të shihet me lente të tjera.

Deri në rënien e Murit të Berlinit, me termin "Siguri" nënkuptohej vetëm Siguria Ushtarake por konteksti i ndryshuar historik, si rezultat i përfundimit të Luftës së Ftohtë mes dy kampeve të Lindjes dhe Perëndimit (BS - SHBA) dhe ridimensionimi i rolit të NATO-s, ndikuan në zgjerimin e konceptit "Siguri", duke përfshirë në të edhe fusha të cilat më parë nuk trajtoheshin si objekte sigurie. Në periudhën bashkëkohore, kur flitet për "Siguri" nuk nënkuptohet vetëm Siguria Ushtarake dhe mbrojtja e shtetit nga kërcënimet e jashtme pasi siguria nuk është vetëm çështje e mungesës së kërcënimit ose të burimeve të kontrolluara të kërcënimit të nivelit të ulët në natyrë ose në shoqëri. Sot ajo duhet të kuptohet dhe si aktivitet dhe si sistem përmes të cilit mund të sigurohet praktikimi i funksioneve elementare të shoqërisë.

Barry Buzan, në librin e tij “People, States and Fear” ka shtruar një sërë pyetjesh, të tilla si: Siguri për kë? Siguri për shtetin apo siguri për individin? Siguri për cilat vlera? Siguri për territorin e shtetit, apo siguri për individin, mjedisin etj? Nisur nga këto pyetje ai

argumenton se në rast se ne nuk specifikojmë objektin referues, atëherë koncepti i Sigurisë ka pak kuptim (Buzan, 1991: 26). Koncepti i sigurisë në këtë kontekst të ri të shfaqur është shumë më i gjërë, brenda të cilit duhet të përfshihen edhe: Siguria politike, ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe padyshim edhe siguria ushtarake, të cilat Buzan i etiketon si sektorë të sigurisë dhe i studion nëpërmjet analizës sektoriale të sigurisë.

Pavarësisht veçantisë së termit "Siguri", përdorimi dhe studimi i tij nuk mund të shkëputet nga fusha të tjera të mendimit. Në fushën filozofike, kanë qenë të shumtë studiuesit (filozofët) që e kanë trajtuar dhe janë angazhuar të interpretojnë termin "Siguri". Në interes të kuptimit, të evoluimit si dhe të lidhjes së vetë konceptit siguri me aspektin filozofik, njihen disa autorë që i hapën rrugën studimeve të Sigurisë dhe qasjeve kryesore ndaj saj, të tillë si:

- *Thomas Hobbes* - e kuptonte sigurinë si vlerën më fundamentale dhe bazë mbi të cilën njerëzimi ndërton jetën individuale dhe kolektive. Sipas Hobsit, “pa siguri, jeta do të ishte e vetmuar, e dobët, e keqe, e vrazhdë dhe e shkurtër” (2008: 42). Kjo është një nga arsyt kryesore përse siguria shihet si një prioritet nga ai dhe nga akademikë të tjerë të mëvonshëm. Hobsi e përcaktonte rolin e shtetit, si mjetin për sigurimin e rendit dhe mbrojtjes së brendshme, kundër armiqve të jashtëm. Kjo pikëpamje e ktheu atë në një nga ithtarët e realizmit në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare.
- *Immanuel Kant* - dhe ideja e tij për krijimin e një federate të shteteve vullnetare botërore, vuri themelet e qasjes idealiste të sigurisë dhe paqes në botë.
- *Hugo de Grotius* - perceptoi jo vetëm konfliktet në marrëdhëniet ndërmjet shteteve por para së gjithash respektimin e rregullave të caktuara të mirësjelljes, duke mundësuar bashkëpunim në kuadër të bashkësisë ndërkombëtare.

Shumë studime dhe ide të rëndësishme të akademikëve të njohur, kanë kontribuar në zhvillimin e konceptit të sigurisë duke e pasuruar atë me nocione tashmë të njohura në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, e veçanërisht në fushën e Sigurisë. John Herz, me idenë e tij për dilemën e sigurisë, theksoi faktin se realizimi i nevojave të sigurisë të shtetit–komb individual, shpie në nivel më të lartë pasigurie të shteteve tjera. “Çdo shtet identifikon masat dhe aksionet e veta që të sigurojë siguri vetjake, si pjesë të interesave të veta vitale për ekzistencë, ngaqë ato janë domosdoshmëri dhe tërësisht janë mbrojtëse, ndërkaj aktiviteti i njëjtë, nga shtetet e tjera, perceptohet si kërcënim” (Herz, 1950: 42). Arnold Wolfers vuri themelet e analizës së konceptit shumë-shtresësor të sigurisë në botën bashkëkohore, me diskutimin e tij për sigurinë kombëtare. Robert Jervis, implementoi një ide interesante për regjimet e sigurisë, duke e zhvendosur fokusin e analistëve, nga analiza e shtetit në analizë të sistemit (Jervis, 1976).

Gert Krell, zhvilloi një kritikë gjithëpërfshirëse të koncepteve ushtarake të sigurisë, veçanërisht nga aspekti i studimeve paqësore (Krell, 1979). Stanley Hoffmann, synonte që siguria kombëtare, të analizohet në kontekstin e politikës botërore (Hoffmann, 1972). Hedley Bull, po ashtu bënte përpjekje për qasje më të gjerë në hulumtimin e sigurisë kombëtare, që do të tërhiqte vëmendje më të madhe të interesave të përbashkëta të të gjitha shteteve në fushën e sigurisë. Krause dhe Nye, në mënyrë kritike paralajmëruan se teoricienët ekonomikë dhe politikë, nuk i përkushtuan vëmendje të konsiderueshme themeleve gjithëpërfshirëse të sigurisë kombëtare, që luajnë rol aktiv në theksimin e vlerave të tjera shoqërore (Krause& Nye, 1975).

Në përpjekje për të kuptuar evoluimin e termit "Siguri", duhet të analizojmë edhe termin "Siguri Kombëtare". Ashtu sikurse nocioni i sigurisë, edhe për konceptin "Siguri Kombëtare" nuk ekziston një përkufizim i vetëm, i pranuar universalisht. Siguria Kombëtare si koncept është relativisht i ri, i shfaqur për herë të parë tek vepra "Politika e Jashtme

Amerikane" (1943) e Wolter Lippman. Megjithatë, edhe shumë autorë të tjerë amerikanë si Morgenthau, Kennan apo Kaplan, e kanë përdorur konceptin e "Sigurisë Kombëtare" e cila është e lidhur drejtpërsëdrejti me interesat kombëtare të një shteti. Përkufizimi i Lippman mbi Sigurinë Kombëtare tregon lidhjen e shtetit me luftën. “Një komb ka siguri kombëtare, kur nuk i duhet të përdorë luftën, ose kërcënimin për luftë, për të ruajtur interesat e tij legjitime” (Lippman, 1943: 37) . Ai pohon se shteti është i sigurt deri kur ai nuk është në rrezik që t’i viktimizojë vlerat e veta themelore, pa marrë parasysh se a bëhet kjo për qëllim të evitimit të luftës, apo detyrohet për t’i mbrojtur vlerat e tij në një luftë potenciale (Lippman, 1943).

Nga ana e tij, profesori i së drejtës ndërkombëtare, Vojin Dimitrijeviç, identifikon pesë karakteristika specifike, të cilat ai i konsideron si elemente themelore të sigurisë kombëtare:

- garantimi i ekzistencës së shtetit si bashkësi politike, ekzistenca e kombit (që nuk është identik me ekzistencën e shtetit të veçantë) dhe mbijetesa fizike e popullsisë së tij.
 - mbrojtja e integritetit territorial, si e drejtë themelore e shtetit;
 - ruajtja e pavarësisë politike, si atribut i statusit ndërkombëtarisht të njohur të shtetit;
 - sigurimi i cilësisë së jetës;
 - inkorporimi i “interesave vitale” të shtetit në politikën e sigurisë kombëtare.
- (Dimitrijeviç, 1973: 11).

Studiuesi Mario Nobilo, i cili trajton analizën e aspekteve të sigurisë të marrëdhënieve bashkëkohore ndërkombëtare, e përkufizon sigurinë kombëtare si: “interaksion kompleks ndërmjet faktorit politik, ekonomik, ushtarak, ideologjik, juridik, shoqëror dhe faktorëve të tjerë shoqërorë të brendshëm dhe të jashtëm, përmes të cilëve, shtetet në kontekst individual angazhohen të sigurojnë kërkesa të arsyeshme, për ta ruajtur sovranitetin

e tyre, integritetin territorial, mbijetesën fizike të popullsisë së vet, pavarësinë politike dhe mundësitë për zhvillim të balancuar dhe të shpejtë shoqëror në nivel të njëjtë” (Nobilo, 1988: 72).

Amin Hewedy, ekspert për Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe diplomat me përvojë, sigurinë kombëtare e përkufizon si “aktivitet të shteteve-kombe, me të cilin shtetet në kornizat e kapaciteteve të tyre shoqërore, në të tanishmen dhe të ardhmen, duke i pasur parasysh ndryshimet globale dhe zhvillimin, e mbrojnë identitetin e tyre, ekzistencën dhe interesat” (Hewedy, 1989: 16). Ky aktivitet përfshin:

- sigurimin e cilësisë së jetës;
- masa të veçanta (në tregti, ekonomi, kulturë etj.) që ta sigurojnë dhe mbrojnë vetveten nga çdo rrezik që mund të vijë nga mjedisi;
- masa sigurie të shoqërisë, të cilat me doemos duhet të jenë në përputhje me kapacitetet e shoqërisë (në të kundërtën ato do të mund të çojnë në pasiguri);
- këto masa me doemos duhet të jenë të planifikuara (afatgjata dhe afatshkurtra);
- të përshtatura me ndryshimet globale dhe rajonale në botë (Hewedy, 1989: 16).

Wolfers, sigurinë kombëtare e përkufizon nga aspekti objektiv dhe subjektiv. Ndryshe nga Hewedy, i cili preferon matjen e mungesës së kërcënimit ndaj vlerave themelore, Wolfers e vendos theksin në mungesën e frikës së shoqërisë për rrezikimin e vlerave të saj. Buzan është i bindur se siguria ndërlidhet me përpjekjet për liri nga frika, por edhe nga varfëria/ nevojat. Në kornizat ndërkombëtare, siguria përfshin kapacitetin e shoqërive dhe shteteve për t'u ruajtur identiteti i tyre i pavarur dhe integriteti funksional (Buzan, Weaver, Wilde, 1998: 214). Interesant paraqitet edhe ideja e Ken Booth, i cili pohon se siguri e qëndrueshme mund të arrihet vetëm nga ana e kombeve dhe shteteve, të cilët këtë nuk ua privojnë të tjerëve.

Megjithatë, kjo mund të arrihet vetëm në rastin kur siguria do të shqyrtohet si proces i çlirimit (Both, 1991: 313).

Termi Siguri Kombëtare përdoret shpesh edhe duke i'u referuar intensitetit të interesave, të cilat në këtë rast konsiderohen si interesa jetësorë (Scruton, 2007: 623), të cilat kanë një vlerë themelore për mbijetesën e kombit. Pas përcaktimit të interesave kombëtare, shtetet përpilojnë Strategjinë e Sigurisë Kombëtare. Strategjia e Sigurisë Kombëtare, në Fjalorin e termave Ushtarakë, përcaktohet si “arti dhe shkenca e zhvillimit dhe e përdorimit të fuqisë politike, ekonomike dhe psikologjike të një vendi, së bashku me forcat e saj të armatosura, në kohe paqe dhe lufte, për garantimin e objektivave kombëtare” (Departamenti i Mbrojtjes i SHBA-së, 1987: 232). Strategjia e Sigurisë Kombëtare përcakton interesat, objektivat, prioritetet e vendit, rrugët dhe programet kryesore për realizimin e tyre. Pra, Strategjia e Sigurisë Kombëtare është me të vërtetë përmbledhja e sigurisë, e strategjisë ekonomike dhe politike bazuar në supozimin se cila është mënyra më e mirë për zhvillimin e sigurisë kombëtare dhe ndërtimin e rregullit ndërkombëtar (Ikenberry, 2003: 132).

Konteksti i ri ndërkombëtar i shfaqur me përfundimin e Luftës së Ftohtë, rënien e regjimeve komuniste në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, ridimensionimi i rolit të NATO-s, solli ndryshime thelbësore në axhendën e çështjeve të sigurisë, duke e zgjeruar gamën e problematikës me të cilën përballej arena ndërkombëtare, e njëkohësisht çuan në evoluimin e konceptit tradicional të sigurisë. Sfidat e identifikuara si kërcënime/rreziqe kryesore për mjedisin global të sigurisë së pas viteve-90-të lidheshin me kërcënime të tilla si, ndryshimet klimaterike, konfliktet etnike, demografia, terrorizmi ndërkombëtar, krimi i organizuar, trafiket e paligjshme dhe korrupsioni si efekte anësore të globalizmit, destabiliteti dhe problematikat e shteteve të dobëta etj.

Sipas Fred Schreier, sfidat kryesore ndaj sigurisë ndërkombëtare mund ti klasifikojmë në tre kategori:

1. Në kategorinë e parë përfshihen çështjes si demografia, ekonomia, energjia, ushqimi, uji, ndryshimet klimaterike, konfliktet/lufta dhe e ardhmja e forcave të armatosura. Këto konsiderohen si çështjet apo sfidat e mëdha me të cilat do të përballemi, por që edhe për shumë vite me radhe në të ardhmen nuk do të mund ti zgjidhim;
2. Kategoria e dytë përfshin korrupsionin, terrorizmin, krimin e organizuar, piraterinë, migracionin, kontrollin dhe mbikëqyrjen parlamentare. Këto çështje/sfida duhej të ishin zgjidhur shumë kohë më përpara, por ato paraqesin vështirësi në përballjen me to për shkak të natyrës së tyre;
3. Ndërsa në kategorinë e tretë bëjnë pjesë çështjes si globalizmi, e ardhmja e kombeve-shtete në një botë të globalizuar, dështimet e shteteve të dobëta dhe impakti i tyre, të drejtat individuale përkundrejt sigurisë kolektive, hapësira kibernetike, efektiviteti i multilaterizmit në zhvillimin e bashkëpunimit, progresi teknologjik dhe inovacioni. Këto çështje do të bëhen në të ardhmen fokusi i analizave të studiuesve, por edhe të ekspertëve (Schreier, 2010).

Të gjitha kërcënimet përbëjnë rrezik, por fenomenet transnacionale si terrorizmi ndërkombëtar dhe krimi i organizuar transnacional vlerësohet se përbëjnë sot rrezikun më të madh të kërcënimit ndaj sigurisë globale si pasojë e natyrës së tyre asimetrike (NATO, 2010: 13). Në pamundësi për tu përballur me aktorë jo-shtetërorë, nëpërmjet goditjeve asimetrike, terroristsët kërkojnë të kenë impakt psikologjik mbi opinionin publik, duke shkaktuar klimë të madhe pasigurie dhe frike tek publiku. Asimetria vjen si rezultat i pabarazisë në interesa midis kundërshtarëve. Sulmet asimetrike karakterizohen si operacione taktike, pavarësisht se në

arritjen e objektivave ato marrin natyrë strategjike. Objektivat strategjike synojnë dobësimin e vullnetit të kundërshtarit. Sikurse shprehet dhe Svendsen, terrorizmi ndërkombëtar është kërcënimi më aktual i dukshëm i këtij lloji dhe qeveritë janë të ndërgjegjshme për vështirësitë e përballjes me një kundërshtar kaq të vështirë për t'u njohur, por edhe të organizuar që vepron përtej kufijve shtetëror, duke shfrytëzuar me mjeshtëri lirinë e lëvizjes, mundësitë e mëdha të komunikimit dhe kapacitetet e zgjeruara financiare të mundësuara nga procesi i globalizimit (Svendsen, 2012: 135).

Mbrojtja kundër sulmeve asimetrike përbën vështirësinë më të madhe për hartuesit e strategji kombëtare dhe ndërkombëtare, sepse një kundërshtar jo konvencional nuk mund të luftohet me mjete tradicionale (konvencionale). Fenomeni i terrorizmit në historinë e njerëzimit ka njohur një evoluim duke e pasuruar atë përgjatë periudhave të ndryshme me elemente të rëndësishëm dhe domethënës për mjedisin e sigurisë. Ekaterina Sparova në librin e saj me titull "Terrorizmi në konfliktet asimetrike-aspektet ideologjike dhe strukturore" dallon tre lloje terrorizmi:

1. Terrorizmi klasik në kohë paqeje (lëvizjet majtiste në vitet 1970-80);
2. Konfliktet e lidhura me terrorizmin, kjo nënkupton përdorimin e terrorizmit si një taktikë në konfliktet e armatosura asimetrike lokale dhe rajonale;
3. Super terrorizmin, si një fenomen relativisht të ri, i njohur ndryshe si terrorizëm global i shfaqur pas 11-Shtatorit (Stepanova, 2008: 9-11).

Gjithashtu Jeffry Bale, studiues në shkollën pasuniversitare të Politikave Ndërkombëtare dhe Menaxhimit në Institutin Middlebury të Studimeve Ndërkombëtare ka bërë një kategorizim të grupeve të cilat kanë përdorur terrorizmin. Sipas tij, kemi:

- grupe etno-nacionaliste separatiste, të cilat kërkojnë shkëputjen/pavarësinë e tyre;

- grupe të krahut të majtë, të cilat kërkojnë përmbysjen e sistemit kapitalist (marksist-leninist/anarkist);
- grupe revolucionare të krahut të djathtë, të cilët kërkojnë përmbysjen e regjimeve ekzistuese nëpërmjet revolucionit dhe krijimin e një rendi të ri;
- grupet fetare, të cilët luftojnë me armiqtë në emër të Zotit (Bale, The Monterey Terrorism Research and Education Program).

Mbi terrorizmin ekzistojnë shumë përkufizime. Sipas Jeffry Simon "ekzistojnë të paktën mbi 212 përkufizime të ndryshme mbi terrorizmin në të gjithë botën, por vetëm 90 prej tyre përdoren nga qeveritë apo institucionet e tjera ndërkombëtare" (Simon, 1994: 29). Përpyjekjet e para ndërkombëtare për një përkufizim mbi terrorizmin u bënë nën drejtimin e OKB-së nëpërmjet një Konvente për Ndalimin dhe Dënimin e Terrorizmit në vitin 1973, ku me terrorizëm u përkufizuan "Të gjitha aktet kriminale të drejtuara kundër një shteti me synimin për të krijuar një gjendje terrori në mendjen e personave, grupeve të veçanta ose të publikut të gjerë, por kjo mbeti thjeshtë një draft, sepse kjo konventë nuk hyri kurrë në fuqi" (KNDT, 1973).

Vihet re që në legjislacionet e shteteve, përkufizimet mbi terrorizmin janë të ndryshme, madje vihet re që departamente/agjenci të ndryshme brenda të njëjtit shtet i japin përcaktime të ndryshme termit të terrorizmit. P.sh.: Departamenti i Shtetit, përdor këtë përkufizim: Dhunë e paramenduar, e motivuar politikisht kundër objektivave jo luftuese, e ndërmarrë nga grupe apo individë klandestinë me qëllim për të influencuar mbi audiencën (U.S Department of State, 1996). Nga ana tjetër FBI (Byroja Federale e Hetimit), e përkufizon si përdorimi i paligjshëm i forcës apo dhunës kundër personave apo pronave për të ushtruar presion mbi qeverinë, popullsinë civile apo ndonjë segment tjetër me objektiva politike apo sociale. Ndërsa Departamenti i Mbrojtjes e përcakton si përdorim i paligjshëm dhe kërcënues i dhunës kundër

individëve apo pronës, me qëllim presionin ndaj qeverisë apo shoqërisë, për të realizuar objektiva politike, fetare apo ideologjike (Howard & Sawyer, 2006).

Pamundësia për të pasur një përkufizim të pranuar universalisht, vjen si rezultat i idesë së shteteve, që çdo njëri prej tyre duhet të zhvillojë një përkufizim mbi terrorizmit, sepse përkufizimi universal mund të kufizojë sovranitetin e tyre. Kjo mund të jetë një nga arsyet, por ekzistojnë edhe shumë të tjera, duke e kthyer pamundësinë e përkufizimit të terrorizmin në një debat midis studiuesve dhe ekspertëve të fushës, ku secili prej tyre përpiqet që ta përkufizojë apo edhe të japë arsyet e pamundësisë së përkufizimit të termit.

Bruce Hoffman e përkufizon terrorizmin si "krijimi i kushteve/klimës të qëllimshme të frikës dhe terrorit, nëpërmjet përdorimit ose kërcënimit të përdorimit të dhunës me qëllim sjelljen e ndryshimeve politike" (Hoffman, 2006: 41). Ky përkufizim i tij mbi terrorizmin paraqet disa kufizime, nga kush përdoret dhuna dhe për të realizuar këtë ndryshim thellësisht politike, kush bëhen objekti mbi të cilën përdoret kjo dhunë? Kufizime paraqet edhe përkufizimi i Jonah Alexander, ku me terrorizëm ai kupton "përdorimin e dhunës kundrejt civilëve rastësorë në mënyrë që të frikësojnë ose të krijojnë frikë të përgjithshme për të arritur disa objektiva/qëllime politike" (Alexander, 1976: 14). Një përkufizim pak më i qartë na vjen nga Walter Enders dhe Todd Sandles. Ata e përkufizojnë terrorizmin si "përdorimi ose kërcënim i përdorimit të dhunës së paramenduar nga grupe subnacionale për të realizuar një objektiv politik, fetar ose ideologjik, përmes frikësimit të audiencës së gjerë" (Enders & Sandles, 2002: 145). Megjithatë, edhe ky përkufizim paraqet disa mangësi, sepse në këtë rast është themelore për ta shkaktimi i panikut tek audienca, por ne kemi shumë raste ku grupet terroriste përpiqen maksimalisht dhe përdorin të gjitha mjetet në funksion të arritjes së influencës ndaj vendimeve qeveritare.

Një tjetër autor i cili është marrë shumë me problematikat e mos përkufizimit të këtij termi është Walter Laqueur, i cili mendon se "nuk ekziston dhe nuk ka për të patur një përkufizim gjithëpërfshirës dhe universal mbi terrorizmin" (Laqueur, 1997: 5). Pavarësisht kësaj, ai është përpjekur për të na dhënë një kuptim mbi terrorizmin. Sipas tij, me terrorizëm do të kuptojmë: "Përdorimin, ose kërcënimin për përdorimin e dhunës, një metodë luftimi, ose një strategji për të arritur disa objektiva të caktuara. Terrorizmi ka si qëllim të shkaktojë një gjendje frike te viktimat, në mënyrë të pamëshirshme dhe që nuk përputhet aspak me rregullat humanitare. Publiciteti është një faktor thelbësor i strategjisë terroriste" (Laqueur, 1987: 143).

Mos ekzistenca e një përkufizimi të qartë dhe të gjithë pranueshëm vjen si rezultat i faktit që nuk ekziston vetëm një lloj terrorizmi, por ne ndeshemi me forma të ndryshme të këtij fenomeni. Pamundësia e përkufizimit shkaktohet edhe nga një faktor tjetër, i cili lidhet me paqartësitë që ne kemi në lidhje me identifikimin e dallimeve ndërmjet terrorizmit, luftës guerrilase, luftës civile, luftës konvencionale apo edhe me veprimtaritë e tjera kriminale. Kjo për faktin se terroristët nuk janë të vetmit të cilët përdorin taktikat e terrorit dhe frikës, nëpërmjet përdorimit të dhunës apo akteve të dhunshme. E nisur nga kjo, hapi i parë i domosdoshëm duhet të jetë ndarja e taktikave të përdorura të terrorit nga koncepti i terrorizmit, si dhe përpjekja për të bërë dallimet e duhura në mes formave të ndryshme të sjelljes së dhunshme. Megjithatë, duhet të theksojmë faktin se pavarësisht që përkufizimi i terrorizmit ka evoluar përgjatë kohës, objektivat e tij politike, fetare dhe ideologjike kanë ndryshuar pjesërisht (Sloan, 2006).

Një tjetër autor i cili ka dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm mbi këtë çështje është Alex Schmid. Përpjekjet e tij të para u fokusuan në mbledhjen e të gjithë përkufizimeve të ndryshme të dhëna nga fjalorë të rëndësishëm, të përdorur nga shtete apo agjenci të ndryshme. Më pas, nëpërmjet analizës ai identifikoi elementë të ndryshëm që i jepnin formë termit dhe

arriti në përfundimin se nuk ka një përkufizim të vetëm, gjithëpërfshirës dhe të pranuar universalisht. E në këto kushte të pamundësisë së përkufizimit, sugjerimi i tij lidhej me gjetjen e mënyrave për ta dalluar atë qartësisht nga format e tjera të dhunës, duke identifikuar karakteristikat të cilat e dallojnë këtë fenomen nga të tjerat. Për realizimin e kësaj ideje ai bashkëpunoi me Abert Jongman. Puna e tyre kërkimore konsistoi në shqyrtimin e 109 përkufizimeve mbi terrorizmin, me qëllimin kryesor atë të identifikimit të elementëve përbërëse. Ata identifikuan 22 elemente, të cilat shfaqnin frekuencën më të lartë të përsëritjes në këto përkufizime (ku elementi i dhunës, forcës përdoret 83.5% dhe i dyti është motivi politik 65 %) dhe arritën në një konsensus për një përkufizim duke përfshirë pjesën më të madhe të këtyre elementëve. Terrorizmi është një metodë e cila ngjall ankth nëpërmjet akteve të dhunshme të përsëritura të kryera nga (gjysmë) individë klandestinë, grupe ose aktorë shtetërorë, për arsye idiosinkretike, kriminale ose politike, ku ndryshe nga vrasjet, objektivi ku ushtrohet dhuna nuk është në fakt objektivi kryesor. Viktimat njerëzore, pra, janë të përzgjedhura në mënyrë rastësore ose në mënyrë selektive nga një popullatë e synuar që do të shërbejë si gjenerues mesazhi (Schmid & Jongman, 1988: 28).

Përsa i përket kërcënimit tjetër transnacional, krimit të organizuar ekzistojnë shumë përkufizime. Një ndër përkufizimet që i referohet krimit të organizuar është “Krimi i organizuar përfshin çdo grup individësh, të cilët kanë si aktivitet primar shkeljen e ligjeve penale/së drejtës penale, për të patur pushtet dhe përfitime të paligjshme duke u angazhuar në aktivitete shantazhuese dhe me pas, në një moment të përshtatshëm, të angazhohen në manipulime financiare të ndërlikuara. Ndaj, autorët e krimit të organizuar mund të përfshijnë drejtues të korruptuar biznesesh, specialistë, apo edhe zyrtarë publik (National Advisory Committee, 1976: 213).

Joseph Albini autori i librit “The American Mafia” i vitit 1971 ofron një përkufizim mbi atë se çfarë konsiderohet krim i organizuar. Sipas tij: “me krim të organizuar do të kuptojmë çdo aktivitet kriminal që përfshin dy ose më shumë individë, të specializuar ose jo, që përfshijnë një formë të strukturës sociale, me një formë të caktuar lidhesh, duke përdorur forma të caktuara operimi, ku qëllimi final i organizatës gjendet në ndërmarrjet e këtij grupi të veçantë” (Albini, 1971: 37).

Gjithashtu ai identifikoi edhe katër llojet e krimit të organizuar;

1. Krimi i organizuar Politiko-Social, i cili i referohet krimeve të kryera nga forca guerile dhe grupet terroriste apo lëvizje sociale militantësh, të cilët përdorin dhunën, siç mund të jenë: Ku Kluks Klani, dhe Organizata Çlirimtarë Palestineze;
2. Krimi organizuar mercenar, i referohet krimeve të kryera nga grupe për fitim personal, krime pre e të cilave bëhen individë që nuk e presin diçka të tillë dhe jo të piketuar, si në rastet e vjedhjeve dhe grabitjeve të kryera nga banda kriminale të miturish dhe të rriturish. Mano Nera (Dora e Zezë), është një shembull i kësaj të fundit. Këto banda kriminale të 1880-ës (asnjë nuk ishte Dora e Zezë) në Shtetet e Bashkuara, dërgonin letra kërcënuese emigrantëve italianë, duke u kërkuar para. Zakonisht këto letra përmbanin shenja apo simbole të një dore të zezë. Shpesh, gabimisht, i referuar si një pararendës i Mafies, Dora e Zezë, ishte më shumë një metode krimi sesa një organizatë. Ajo nuk ofronte shërbime të paligjshme dhe nuk mund të siguronte imunitet, nëpërmjet korrupsionit politik, për anëtarët e saj apo operuesit e krimit;
3. Krimi i organizuar në Grupet e Orientuara, i cili i referohet krimeve të kryera nga grupe, si bandat e motoçiklistëve, ose banda adoleshentësh, ku qëllimi i tyre kryesor

ishite kënaqësia/argëtimi psikologjik, “kicks,” “rep,” “highs,” “bopping,” and “trashing,” sesa përfitime financiare;

4. Sindikata e Krimin, një grup i vazhdueshëm ose një organizatë e cila me anë të përdorimit të forcës, frikës dhe kërcënimeve merr pjesë në aktivitete të paligjshme të çdo shoqërie. Struktura e saj është e tillë që të ofrojë shërbime të paligjshme, për të cilën ka një kërkesë të madhe, përmes përdorimit të sekretit nga ana e bashkëpunëtorëve. Në këtë rast, sigurohet mbrojtje dhe imunitet për operatorët dhe anëtarët e saj, nëpërmjet korrupsionit politik apo shmangien e ndjekjes penale (Albini, 1971: 38-48).

Vihet re një konsensus në literaturë që krimi i organizuar është një ndërmarrje e vazhdueshme kriminale që racionalisht punon për të përfituar nga aktivitetet që janë shpesh kërkesa të publikut. Ekzistenca e tij vazhdon të mbahet nëpërmjet përdorimit të forcës, kërcënimit të kontrollit/monopolit ose nëpërmjet korrupsionit të zyrtarëve publik. Një tjetër autor, Dobovsek është i mendimit se realizimi i një përkufizimi të vetëm mbi krimin e organizuar është i pamundur, por edhe në këto kushte karakteristikat e identifikuar që përshkruajnë aktivitetet e krimin të organizuar kanë një dobishmëri të madhe/vlerë. Sipas tij, krimi i organizuar mund të përshkruhet si ndryshimi i shpejtë i formave të tij, në përgjigje të mjedisit. Gjithashtu ai merret me tiparet e krimin të organizuar, ku identifikon tipare të tilla si profesionalizmi, organizimi, mjetet e pakufizuara financiare dhe fuqi/potenciale të lartë korrupsioni (Dobovsek, 1996).

Krimi i organizuar shfaq karakteristika të ndryshme nga një shtet në tjetrin dhe kjo si rezultat i disa faktorëve, si atij gjeografik, ekonomik apo edhe social. Përsos kësaj, Luis Shelli mbron argumentin që edhe pse strukturat dhe aktivitetet e tyre ndryshojnë nga një vend në tjetrin si pasojë e disa faktorëve/rrethanave, të gjitha këto grupe kanë një të përbashkët të

pakontestueshme, ato janë të përfshira në procesin e pastrimit të parave për të fshehur përfitimet e tyre të mëdha. Ato përbëjnë kërcënim për sigurinë e vendeve ku operojnë dhe qeveritë e tyre, (Shelli, 1995). Në shumë studime, në raportet e qeverisë së SHBA-vë dhe të Taks Forcës Europiane, në komitete, komisione dhe organizata të tjera krimi i organizuar përfshin këto karakteristika:

- Nuk ka qëllime/motive ideologjike;
- Vepron në vazhdimësi, me periudha të gjata kohore; vazhdueshmëria është natyra e saj;
- Përdor taktika dhe strategji në plane afat-gjate, për të arritur qëllimet e krimit të organizuar;
- Qeveriset/Drejtohet nga rregulla dhe kode sekrete;
- Kërkon të monopolizojë produkte dhe shërbime;
- Ka hierarki organizative;
- Përdor dhunën/forcën dhe frikën;
- Kufizon anëtarësimin;
- Siguron produkte dhe shërbime të paligjshme, sipas kërkesës së tregut/publikut;
- Siguron përfitime të mëdha nëpërmjet aktiviteteve kriminale;
- Përdor korrupsionin për imunitet dhe kontroll;
- Krijon një ndarje të punës me specializim të detyrave/punës/pozicionit;
- Përfshin pastrimin e parave;
- Investon kapital në sipërmarrje të ligjshme dhe kërkon të kontrollojë këto biznese;
- Tregon aftësi për t'i u përshtatur ndryshimeve në ofertë, në kërkesë, në zbatimin e ligjit dhe në konkurrencë;

- Vepron ndërkombëtarisht;
- Përfshihet në më shumë se një aktivitet të paligjshëm (diversitet në biznes);
- Përdor biznesin e ligjshëm si fronte për aktivitete të paligjshme (Mallory, 2012: 9).

2.1.1 Trajtimi i rastit Shqiptar në literaturën ekzistues

Për sa i përket literaturës ekzistuese mbi trajtimin teorik të konceptit të sigurisë, për specifikat e rastit shqiptar, mund të themi se është relativisht i mangët. Megjithatë, koncepti i Sigurisë në vendin tonë ka ndjekur pak a shumë të njëjtin proces evoluimi si dhe në vendet e tjera, veçanërisht me vendet e vogla. Vihet re që koncepti i sigurisë që nga viti 1945 deri në 1990-të është harmonizuar tërësisht me konceptin e mbrojtjes, sigurinë e tërësisë territoriale të shtetit shqiptar (në ruajtjen e sovranitetit të vendit). Në aspektin e fuqisë së shtetit, në mënyrë të veçantë modernizimi i ushtrisë u konsiderua si prioriteti dhe elementi bazë që do të sillte forcimin e sigurisë, “Ushtria Popullore është fuqia e Armatosur e Republikës Popullore të Shqipërisë. Ajo ruan që të mos çenohen kufijtë e shtetit dhe shërben për mbrojtjen e paqes dhe të sigurisë” (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1946: Neni 94). Të gjithë elementët e fuqisë kombëtare të

shtetit Shqiptar duhet të ishin në funksion të mbrojtjes. Çdo gjë për mbrojtjen, çdo gjë për fitoren” (Arti Ushtarak i luftës popullore, 1985: 48).

Realisht, gjendja e Shqipërisë nga vlerësimi strategjik dhe ekonomik pas përfundimit të Luftës së dytë Botërore paraqitej shumë e vështirë. Kjo vështirësi vihej re tek brishtësia dhe pasiguria shumë e madhe, e cila vinte nga kërcënimet e vazhdueshme dhe pretendimet territoriale të fqinjëve ndaj saj. E gjendur në këto rrethana Shqipëria e kësaj periudhe, për të rritur sigurinë e saj, u përpoq të bëhej pjesë e aleancave me aktorë të rëndësishëm (BRSS-Kina) e parë kjo si një mundësi e mirë mbrojtjeje. Mund të përmendim këtu anëtarësimin e Shqipërisë në Traktatin e Miqësisë, Bashkëpunimit dhe Ndihmës Reciproke (Traktati i Varshavës), një traktat i bashkëpunimit të vendeve të Kampit Socialist. Përsa i përket aspektit ekonomik, mund të përmendim marrëdhënien e Shqipërisë me Kinën.

Megjithatë, sipas autores Miranda Vicker, “periudha pro-kineze, nuk ka rezultuar e dobishme ekonomikisht për Shqipërinë sa kish qenë aleanca e saj me Sovjetikët” (Vickers, 1998: 213). Kjo autore thekson edhe një moment shumë të rëndësishëm, nëpërmjet të cilës kaloi koncepti i sigurisë në Shqipëri. Ajo në analizën e saj thekson se pas dështimit të këtyre dy aleancave të mëdha, Shqipëria zgjodhi rrugën e izolimit total. “Shqipëria u bë një shtet kështjellë, sundimtarët e saj ishin të vendosur të mbronin sovranitetin dhe integritetin jo vetëm të Shqipërisë, por edhe të sistemit komunist” (Vickers, 1998: 213). Pra gjatë kësaj periudhe koncepti i sigurisë rezulton i pandashëm nga termi mbrojtje.

Mjedisi i ri gjeopolitik i shfaqur pas përfundimit të Luftës së Ftohtë solli edhe evoluimin e konceptit të sigurisë sonë. Në ndryshim nga periudha e mëparshme, kur

siguria u trajtua si siguri kombëtare, në fuqizimin e shtetit në terma ushtarak për ruajtjen e balancimit të fuqisë në sistem, siguria në këtë kontekst të ri nënkuptonte përfshirjen e aspekteve të gjithanshme të veprimtarive e shoqërisë në tërësi dhe shtetit demokratik. Ky lloj transformimi në çështjet e sigurisë solli domosdoshmërinë e një bashkëpunimi midis shteteve, duke krijuar premisat e nevojshme për krijimin e një rrjeti të zgjeruar të organizatave rajonale e ndër rajonale. Pra, vihet re që koncepti i sigurisë sonë kombëtare është i lidhur me sigurinë rajonale dhe globale, e cila bazohet tek përdorimi i diplomacisë, marrëveshjeve shumëpalëshe dhe tek zhvillimi i të gjithë komponentëve të fuqisë kombëtare.

Pavarësisht arritjeve pozitive, siguria e vendit tonë vijon ende të jetë e varur ndjeshëm nga rreziqet me natyrë të brendshme, të cilat burojnë nga korrupsioni, krimi i organizuar si dhe nga rreziqet e jashtme si rrjedhojë e veprimtarive kriminale ndërkombëtare, grupeve terroriste dhe forcimit të aktorëve jo-shtetërorë, të cilët cenojnë shtetin e së drejtës, institucionet tona kombëtare dhe zhvillimin ekonomik. Krimi i organizuar dhe terrorizmi sot përbëjnë një kërcënim ekzistencial për sigurinë kombëtare të Shqipërisë. Krimi i organizuar në Ballkan është një fenomen i ri, i cili ka evoluar gjatë luftërave në Gadishullin e Ballkanit gjatë dekadës së fundit të shekullit të 20-të. Autorja Vera Stojarova identifikon faktorët të cilët kanë ndikuar dhe lehtësuar veprimin e krimit të organizuar në rajonin e Ballkanit. Sipas saj, faktorët që kanë krijuar kushte të favorshme për përhapjen e këtij fenomeni janë luftërat e shkaktuara në këtë rajon, bllokadat ekonomike, dobësia e shteteve ballkanike në kontekstin e pas luftës, vakumi ligjor. “Në ditët e sotme rajoni i Ballkanit konsiderohet si epiqendra e krimit të organizuar, një fenomen transnacional dhe global“ (Stojarova, 2012: 91). Gjithashtu,

Stojarova argumenton se faktorët të cilët kanë ndikuar në përhapjen e krimit të organizuar në Shqipëri lidhen në pozicionin e saj gjeografik, luftën e Kosovës, problematikat lidhur me shtetin e së drejtës, mungesën e mjeteve juridike të nevojshme për të luftuar krimin e organizuar. Sipas saj këto faktorë kanë kontribuar në transformimin e vendit, në një vend me nivelin e lartë të kriminalitetit.(Stojarova, 2012).

Duhet theksuar fakti që nuk ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme për të pasur një situatë/tablo të qartë mbi lindjen dhe evoluimin e krimit të organizuar në Shqipëri. Megjithatë, shumë studiues janë përpjekur të identifikojnë periudha të lindjes dhe evoluimit të krimit të organizuar. Sipas "Federal Bureau of Investigation", rrënjët e para të krimit të organizuar në Shqipëri datojnë në shekullin e 15-të, në kohën e mbizotërimit të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Në këtë periudhë kemi shfaqjet e para të klaneve të cilat vepronin duke u bazuar tek kanuni dhe parimet e tij, si besnikëria/besa dhe fshehtësia. Çdo klan kishte kontrollin mbi një territor të caktuar dhe mbajtja e këtij kontrolli bëhej shkak i përdorimit të dhunës ndërmjet klaneve, të cilët përpiqeshin të zgjeronin/shtrinin territorin e tyre.

Gjithashtu sipas një studiuesi italian, Rossell, kemi shfaqjen e mafies shqiptare gjatë viteve 60-të. Kjo mafie, sipas tyre u krijua nga Sigurimi i Shtetit të atëhershëm nën regjimin komunist dhe filloi bashkëpunimin e tij me mafien italiane në rajonin e Pulias dhe merreshin kryesisht me trafikimin e cigareve (European Commission, 1999: 24). Xavier Raufer, profesor në Institutin e Kriminologjisë në Paris i konsideron grupet shqiptare si mafien e vërtetë në Ballkan, kjo për shkak të strukturës së tyre të veçantë sociale të shoqërisë së tyre, si një shoqëri me besim shumë të fortë në nderit dhe burrërisë, me probleme të shumta sociale dhe me kulturën e gjakmarrjes. Të gjitha

këto kanë ndikuar në transformimin, rritjen e efekshmërisë së këtyre grupeve si dhe bërjen e tyre pjesë të një rrjeti ndërkombëtar si rezultat i shkallës së lartë të organizimit dhe sofistikimit. Veprimtaritë e grupeve kriminale shqiptare kanë qenë kryesisht në trafikimin e drogës, armëve, emigrantëve ilegalë, kontrabandës së cigareve etj (Raufer, 2002).

Gjithashtu, Michaletos Ioannis, në artikullin e tij "Organized Crime in the Balkans-Albanian Mafia", nënvizon që në Ballkan grupi i cili mund të konsiderohet si "Mafia" është ai shqiptar. Krimi i organizuar shqiptar vepron në një trekëndësh Prishtinë (Kosovë) – Tetovë (Maqedoni) – Tiranë (Shqipëri). Ky grup, i cili është shumë i sofistikuar, ka arritur të kontrollojë pjesën më të madhe të trafikut të drogës në Europë si dhe trafikimin e grave dhe fëmijëve nga Ballkani drejt Europës Perëndimore (Ioannis, 2013). Ky argument është në rrafshin e pohimit, pasi autori në fjalë nuk sjell prova për të vërtetuar një qëndrim të tillë. Për të arritur në konkluzione të tilla, është e nevojshme të mbështetemi dhe në grupe të tjera të të dhënave, të cilat mungojnë në këtë drejtim.

Jana Arsovska, e cila është marrë me shumë se një dekadë për të kuptuar strukturën, aktivitetet/veprimtaritë e krimit të organizuar shqiptar në Ballkan, Europë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës arrin në konkluzionin se grupet kriminale shqiptare konsiderohen si shumë të dhunshme, të organizuara në mënyrë hierarkike, të disiplinuar dhe që bazohen në rregulla shumë të rrepta.

Grupet etnike shqiptare shpesh herë 'identifikohen' me mafien siciliane përse i përket mënyrës së organizimit. Përveç trafikimit të qenieve njerëzore, këto grupe janë të përfshira edhe në trafikimin e armëve, drogave, organeve si dhe në trafikun ilegal (Arsovska, 2012).

Vlen të theksojmë studimin e kryer nga Fabian Zhilla dhe Besford Lamallari me titull: “Krimi i organizuar. Vlerësimi i rrikut në Shqipëri”. Disa nga përfundimet e arritura nga ky studim janë:

- Krimi i organizuar investon për të korrupsuar policinë dhe prokurorinë;
- Grupet kriminale janë fuqizuar ekonomikisht, janë bërë më të rrezikshëm, efikase dhe më të sofistikuar, kjo si rezultat i bashkëpunimit të grupeve kriminale në Shqipëri me grupet e vendeve fqinje, sidomos me grupet shqiptare në BE;
- Krimi i organizuar shqiptar i investon të ardhurat e paligjshme në fusha të larmishme të ekonomisë së ligjshme, si industri ndërtimi, turizëm, fabrika të ndryshme përpunimi dhe koncesione. Rritja dhe përhapja e shpejtë e ndërtimeve shërben si tregues i injektimit të shumave të konsiderueshme të "parave të pista" në ekonomi;
- Shqipëria përbën një terren të favorshëm për transplantimin e rrjeteve kriminale shqipfolëse nga jashtë drejt Shqipërisë (Zhilla & Lamallari, 2015: 109).

Të gjitha këto tregojnë që krimi i organizuar në Shqipëri përbën një kërcënim serioz për sigurinë kombëtare. Kjo, sepse ai gjithnjë e më tepër po rrit prezencën në shoqërinë tonë si dhe po kthehet në një aktor të rëndësishëm, që minon dhe rrezikon mosfunksionimin e institucioneve përgjegjëse për luftimin kundër tij. Në këtë mënyrë ai vë në rrezik realizimin e dy parimeve themelore të një shteti, që janë siguria dhe mirëqenia e qytetarëve të saj.

Përsa i përket fenomenit të terrorizmit, mund të themi që në realitetin shqiptar është e vështirë të flitet për organizime dhe aktivitet të grupeve terroriste. Por kjo nuk mohon faktin se herë pas here janë krijuar situata të cilat në një mënyrë apo tjetër kanë favorizuar shtrirjen dhe operimin e këtyre lloj grupimeve në vendin tonë. Terrorizmi, ashtu sikurse edhe krimi i organizuar, shfrytëzojnë të gjithë problematikat që e udhëhiqnin Shqipërinë e pas viteve 90-të, për të shtrirë aktivitetet dhe influencën e tij në Shqipëri.

Prezenca në territorin shqiptar, ku besimi fetar në atë kohë ishte pak i organizuar, u mundësoi këtyre grupeve që të njohin gjendjen dhe nevojat e popullsisë, tërësisht të varfër, duke e konsideruar si një mundësi shumë e mirë për t'u shfrytëzuar. Taktikat që ato ndoqën ishte ajo e rekrutimit nëpërmjet dhënies së bursave e ndihmave për të studiuar në vende arabe, kryesisht në institucione teologjike, me të gjitha kostot e studimit të mbuluara nga ata (Deliso, 2007).

Në ditët e sotme terrorizmi përbën një kërcënim real për sigurinë kombëtare të Shqipërisë dhe kjo vihet re si në qëllimet e organizatës terroriste ISIS, e cila deklaron se Shqipëria është pjesë e territorit/Kalifatit të tyre, por edhe me rekrutimet e shqiptarëve për t'u bërë pjesë e kauzës/luftës së tyre.

Autori Arjan Dymishi është i mendimit se ideologjia e Islamit radikal është e fuqishme, sepse në nivel individual ai parashikon zgjidhje për të gjithë problemet shpirtërore dhe personale, duke predikuar zbatimin e praktikave Islame, në nivel nacional ai ofron zgjidhje për problemet socio-ekonomike-politike, duke predikuar instalimin e ligjit Islamik (sheriati), si dhe në nivel ndërkombëtar ai parashton krijimin e

një shteti Islamik, i cili bashkon të gjithë myslimanët nën një shtet dhe u jep zgjidhje të gjitha problematikave që u janë shkaktuar atyre nga jo myslimanët (Dyrmishi, 2015).

Nisur nga fakti që Shqipëria e ditëve të sotme (2015)-të gjendet pothuajse në të njëjtat problematika që e kanë shoqëruar shtetin tonë që pas viteve 1990-të, e rrit akoma edhe më shumë mundësinë e përdorimit të Shqipërisë si një vend i cili u mundëson grupeve terroriste realizimin e objektivave të tyre, rritjen e prezencës dhe shtrirjes së aktiviteteve të tyre. Pavarësisht përpjekjeve graduale për forcimin e shtetit pas viteve 90- tw, mund të themi që shteti dhe organet e sigurisë paraqesin akoma dobësi.

2.2.Evoluimi i konceptit të sigurisë si refleksion i mjedisit të sigurisë

Në traditën historike, siguria konsiderohet si një vlerë thelbësore në marrëdhënien midis njerëzve, por kuptimin e vet të mirëfilltë termi e fiton me shfaqjen dhe ekzistencën e shtetit sovran, i cili është subjekti që gjeneron siguri për qytetarët e vet. Ngjarjet botërore që nga viti 1648 e në vijim pasqyrojnë aspiratat politike, shoqërore, ekonomike dhe ushtarake të popujve të organizuar në shtete sovrane. Koncepti tradicional i sigurisë konsideron shtetin si objektin dhe burimin kryesor të sigurisë. Shtetet kanë përgjegjësinë t'u garantojnë mbrojtje dhe t'u sigurojnë mirëqënie qytetarëve të tyre. Sipas këtij koncepti, siguria reflektohet në termat e Sigurisë Kombëtare, e cila bazohet tek paradigma realiste, e cila shpjegon se shtetet në sistemin ndërkombëtar, në një anarki të plotë (mungesë e një autoriteti më të lartë të cilët ato duhet t'i japin llogari), janë gjithmonë në një dinamikë të vazhdueshme midis tyre për akumulimin e fuqisë dhe pushtetit, me qëllimin kryesor realizimin e interesave të tyre kombëtare. Shtetet për të

përmbushur interesat e tyre kombëtar mbështeten tek fuqia ushtarake si elementi më i rëndësishëm për garancinë e sigurisë së tyre.

Termi Siguri Kombëtare, përdoret shpesh edhe duke i'u referuar intensitetit të interesave, të cilat në këtë rast konsiderohen si interesa jetësorë (Scruton, 2007: 623) pasi kanë një vlerë themelore për kombin, që e ndihmojnë kombin të mbijetojë. Me Siguri Kombëtare, mund të kuptohet çdo gjë, që bën një shtet për të realizuar ekzistencën e tij si një shtet sovran, në një territor të caktuar, apo mbrojtjen e interesave të tij themelore. Pra në thelb të gjithë këtij termi, shtrohet çështja e mbijetesës së kombit ose shtetit. Në këtë kontekst, siguria është kuptuar si “siguri e territorit nga agresionet e jashtme, si mbrojtje e interesave kombëtare në politikën e jashtme, domethënë siguria ka qenë e lidhur më shumë me vendet sesa me popujt, më shumë me sigurinë e shtetit (qasja shteto-centrike) sesa me sigurinë e njeriut” (Mejdani, 2007: 34). Siç edhe mund të kuptohet, përcaktimi i interesave kombëtare e më së shumti intensiteti i këtyre interesave lidhet drejtpërdrejt me Sigurinë Kombëtare.

Në shekullin e 20-të, aleancat ishin format për realizimin e sigurisë rajonale nëpërmjet lindjes së konceptit mbrojtje kolektive, e cila nënkupton atë që shtetet me ideologji të njëjta bëjnë aleanca midis tyre, sepse në këtë mënyrë ato mund të arrijnë siguri më të lartë. Në këtë kontekst, pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore u konsiderua shumë e rëndësishme ndryshimi i sistemit ndërkombëtar nga një sistem i bazuar në parimin e politikave të balancës së fuqisë (politika të cilat i japin përparësi ruajtjes së sistemit të shteteve sovrane, të cilat veprojnë për të parandaluar mbizotërimin e ndonjë shteti, sjellje kjo e cila prodhon hapësira për luftë), drejt një sistemi të bazuar tek Siguria Kolektive.

Siguria duhet të konsiderohej tashmë një përgjegjësi kolektive dhe kjo do të instrumentalizohet nëpërmjet idesë së Lidhjes së Kombeve (Nye & Welch, 2014). Dështimi i Lidhjes së Kombeve dhe konceptit të saj të sigurisë kolektive çoi në idenë e krijimit të një sistemi kolektiv të ri të sigurisë (OKB-ja). Forma më e mirë e sigurisë do të mund të arrihej/realizohet nëpërmjet futjes së koncepteve si respektimi i të drejtave të njeriut, parimeve demokratike të qeverisjes, përdorimit të forcës dhe fuqisë ushtarake si mjete i fundit. Ky vizion i ri u mbështet në mendimin liberal të sigurisë. Megjithatë, konfrontimi dhe ballafaqimi i dy superfuqive tregoi se sistemi i sigurisë kolektive kishte limitet e tij dhe nuk ishte forma më e mirë e realizimit të nivelit të lartë të sigurisë. Mund të themi që edhe gjatë Luftës së Ftohtë, siguria ka qenë e bazuar tek konceptet si sovraniteti i shtetit, integriteti territorial si dhe autonomia e saj politike (qasje shteto- centrike), pra sërish siguria është përcaktuar në terma tërësisht ushtarake (Kissinger, 2004).

Fundi i Luftës së Ftohtë, transformimet e shpejta, problematikat e ndryshme të shfaqura në sistemin ndërkombëtar si krimi i organizuar, terrorizmi, emigracioni i pakontrolluar dhe i jashtëligjshëm, varfëria, problemet mjedisore etj. çuan tek domosdoshmëria e zgjerimit të konceptit të sigurisë. Kjo për shkakun se intensiteti i rrezikshmërisë së këtyre problematikave ishte po aq i rëndësishëm dhe i madh, sa edhe mbrojtja tradicionale ushtarake. Në këtë kontekst të ri, qasja tradicionale e sigurisë, e bazuar thjeshtë tek mbrojtja ushtarake dhe territori, pra tek objekti i vetëm themelor që duhej siguruar, shteti, rezultonte e papërshtatshme. Nisur nga kjo, bëhej e nevojshme identifikimi i fushave të reja të sigurisë dhe objekteve që duheshin sigurizuar. Siguria në këtë aspekt nuk duhej të kuptohej më vetëm në terma ushtarake, por edhe në terma

ekonomik, social, politik etj. Objekti i referimit nuk duhet të jetë më vetëm shteti, pra ka ardhur koha që në përshtatje të këtij konteksti të ri të shfaqur të shkojmë përtej qasjes/pikëpamjes realiste (Buzan, 1991).

Në këtë kontekst të ri të shfaqur ekzistoi dhe vazhdon të ekzistojë edhe sot një debat shumë i madh mbi formën më të mirë dhe garantuese të sigurisë. Ky debat u zhvillua ndërmjet mbështetësve të fuqisë së fortë, ku përdorimi i fuqisë ushtarake dhe masat shtrënguese duhet të mbesin format tradicionale për garantimin e sigurisë, dhe atyre të fuqisë së butë, ku përdorimi i elementëve të natyrës bindëse si negociatat, marrëveshjet për arritjen e nivelit të lartë të sigurisë duhet të mbizotërojnë në këtë kontekst të ri të shfaqur. Mbi bazën e përdorimit të fuqisë së butë u krijua dhe koncepti i sigurisë së tre D-ve [Defence, Diplomacy, Development/Mbrojtje, Diplomaci, Zhvillim] (MD, 2011: 5). Pra kombinimi i instrumenteve ekonomik-diplomatik dhe përdorimi i forcës ushtarake, si mjet i fundit, do të mund të garantonte sigurinë.

2.3.Siguria në optikën e qasjeve teorike; Shkolla e Kopenhagën & Welsh

Ekziston një debat shumë i madh në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare mbi ri konceptimin e sigurisë. Ky debat zhvillohet midis studiuesve të cilët mendojnë dhe argumentojnë për një domosdoshmëri të zgjerimit dhe thellimit të konceptit të sigurisë dhe studiuesve të cilët vazhdojnë të mbrojnë mendimin se objekti i vetëm i sigurisë duhet të vazhdojë të mbetet ende shteti dhe se ata për të realizuar interesin kombëtar të shteteve duhet të vazhdojnë të mbështeten tek instrumenti i fuqisë ushtarake. Ky debat mund të përkthehet në debatin e zhvilluar midis shkollës së konceptimit të gjërë të sigurisë dhe atij tradicional, të ngushtë, të sigurisë. Megjithatë, ky debat nuk ekziston

vetëm midis këtyre dy drejtimeve kryesore, por edhe brenda vetë studiuesve që mbrojnë zgjerimin e konceptit të sigurisë. Ekzistojnë shumë qasje teorike, të cilat kundërshtojnë qasjen tradicionale të sigurisë, por ndër shkollat më me rëndësi dhe influencë sot në botë janë: Shkolla e Kopenhagenit dhe e Aberystwyth (Welsh). Këto dy shkolla mendimi u zhvilluan pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe i përkasin qasjes post-pozitiviste në Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Ato mbartin karakteristikat/tiparet e neorealizmit si dhe konceptet sociale të Konstruktivizmit.

Shkolla e Kopenhagenit përpiqet që të jetë vija e ndërmjetme mes qasjes tradicionale të sigurisë dhe asaj kritike (Studimet Kritike të Sigurisë). Ndërsa, shkolla e Aberystwyth (Welsh) paraqitet më radikale në kritikën e saj ndaj konceptit tradicional të sigurisë. Shkolla e Kopenhagenit është një teori problem-zgjidhës, e cila e merr botën ashtu siç e gjen dhe përpiqet që të zgjidhë problemet që shfaqen. Dy konceptet themelore të saj janë: 1. Sigurizimi; 2. Desigurizimi (Taureck, 2006: 55). Ndërsa shkolla e Aberystwyth është një teori kritike, e cila kundërshton konceptin e sigurizimit të shkollës së Kopenhagenit, me argumentin se jo vetëm kërcënimet, por edhe objektet sigurizues janë konstrukte sociale. Sipas kësaj shkolle mendimi, mënyra më e mirë e të konceptuarit të sigurisë realizohet nëpërmjet lidhjes së saj me individët dhe njerëzit dhe shpjegimi i kësaj lidhje në termat e emancipimit.

Duhet të theksojmë që kjo shkollë paraqet më shumë ngjashmëri me objektivizmin sesa me reflektivizmin (Paulauskas, 2007: 221). Pyetjet ekzistenciale të kësaj shkolle janë: Kush janë kërcënimet dhe cilat janë mjetet si kundërpërgjigje ndaj tyre? Si janë ndërtuar objektet e sigurisë? Cilat janë mundësitë për të transformuar dilemën e sigurisë (rrethi vicioz në të cilën gjenden shtetet)? (Krause, 1998: 298). Ata i

shtrojnë të gjitha këto pyetje, sepse duke parë kontekstin, situatat e ndryshme në sistemin ndërkombëtar kanë bindjen se bota në të cilën ne jemi nuk funksionon për pjesën më të madhe të njerëzve, kështu që ata theksojnë mundësinë e ndryshimeve të mëdha në politikën botërore, sepse gjërat janë ndërtuar shoqërisht. (Booth, 2007: 11). Pavarësisht ndryshimeve midis këtyre dy shkollave, mund të themi që e përbashkëta më kryesore dhe më e rëndësishme lidhet me faktin që të dyja këto kundërshtojnë supozimet e konceptit tradicional të sigurisë. Kjo analizë e shkurtër midis këtyre dy shkollave më të rëndësishme të ditëve të sotme është e nevojshme për të dhënë një tablo më të qartë mbi mënyrat e konceptimit që ato [qasjet teorike] kanë për botën në të cilën jetojmë, si dhe pikëpamjet e tyre mbi format e përballimit të sfidave të sigurisë. Sikurse do të analizohet dhe justifikohet në vijim të këtij punimi, punimi doktoral do të jetë i fokusuar tek shkolla e Kopenhagenit, sepse ajo i përshtatet më së miri çështjes që trajtohet, si dhe i jep zgjidhje rastit shqiptar, i cili shërben dhe si rast studimor.

Shkolla e Kopenhagës lindi në Institutin e Kërkimeve për Konfliktin dhe Paqen në Kopenhagën. Përfaqësuesit më të rëndësishëm të saj, konsiderohen Barry Buzan, Ole Waever, Jaap de Wilde. Kontributi i rëndësishëm i kësaj shkolle lidhet me zgjerimin dhe thellimin e konceptit të sigurisë përtej çështjeve dhe kërcënimeve tradicionale, me fokus tek ato ushtarake. “Siguri quhet momenti kur një çështje paraqitet si rrezik ekzistencial për një objekt të përcaktuar referues” [tradicionalisht, por jo medoemos shtetin, i cili përfshin qeverisjen, territorin dhe shoqërinë]. (Collins, 151). Nisur nga ky përkufizim, shkolla e Kopenhagenit identifikon pesë kategori të përgjithshme të sigurisë, duke na dhënë në këtë mënyrë një qasje shumë sektoriale mbi sigurinë. Secila nga kategoritë përcaktohet nga *aktorët sigurizues* të cilët mund të jenë qeveritë, liderët politikë, grupet

e interesit, etj, si dhe nga *objektet referuese*, të cilat mund të jenë shtetet, individët, identitetet kolektive etj.

Sektorët e sigurisë janë:

- 1 Siguria ushtarake (objekti referues shteti);
- 2 Siguria ekonomike (objekt referues ekonomia kombëtare);
- 3 Siguria shoqërore (objekti referues identitetet kolektive);
- 4 Siguria politike (objekti referues sovraniteti kombëtar/ose ideologjia);
- 5 Siguria mjedisore (objekti referues ekosistemi dhe speciet).

Dy janë konceptet themelore me të cilat operon kjo shkollë mendimi: 1. Sigurizimi dhe 2. Desigurizimi. Teoria e Sigurizimit, e njohur ndryshe dhe si procesi i sigurizimit, u prezantua nga Buzan, Waever & de Wilde, në librin e tyre: *Security; A New Framework for Analysis* (1998). Sipas tyre, “sigurizimi është zhvendosja që e çon politikën përtej rregullave të themeluara të lojës dhe e inkuadron çështjen ose si një lloj të veçantë politike, ose si mbi politikën dhe përtej saj” (Buzan et al., 1998: 23). Nisur nga këndvështrimi i tyre, bëhet i domosdoshëm fakti që një aktor sigurizues të artikulojë një çështje paraprakisht të politizuar si një kërcënim ekzistencial për një objekt të caktuar referues. Fenomeni kalon në tre faza, i pa politizuar, i politizuar dhe i sigurizuar. Kur fenomeni është i pa politizuar, ai nuk është pjesë e axhendës politike dhe nuk ka mbi të një debat publik. Por pavarësisht kësaj kjo nuk nënkupton që fenomeni nuk ekziston nuk është aty, por thjesht ai nuk artikullohet , pra aktorët, kryesisht shteti, nuk merret me të. Në fazën kur fenomeni është i politizuar, përfshihet në debatin publik, por menaxhohet brenda sistemit politik. Në këtë rast fenomeni trajtohet nëpërmjet politikave publike dhe kërkon vendimmarrje qeveritare. Së fundmi, kur fenomeni është në fazën e

sigurizimit, ai konsiderohet si problem sigurie përmes një akti sigurizimi. Fenomeni konsiderohet si kërcënim ekzistencial për një objekt referues dhe nevojitet marrja e masave të jashtëzakonshme për ta zgjidhur atë. Vlen të theksohet se nuk është shumë e rëndësishme të ekzistojë një kërcënim ekzistencial, e rëndësishme është që një fenomen i caktuar të prezantohet si i tillë, pra si kërcënim ekzistencial. Ky përbën edhe elementin thelbësor i cili tregon qartësisht konstruktin social të sigurisë, premisë themelore kjo e qasjes konstruktiviste. Teoria e konstruktivizmit përcakton dhe metodologjinë e studimit të saj. “Sigurizimi mund të studiohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk ka nevojë për indikatorë. Mënyra e studimit të sigurizimit është nëpërmjet studimit të diskursit dhe konstelacioneve politike“ (Buzan et al., 1998: 25). Mbrojtësit e kësaj qasjeje argumentojnë se kërcënimet nuk janë aty jashtë në mënyrë objektive, por ato marrin jetë në sajë të një procesi të ndërtimit intersubjektiv. Në ndryshim nga determinizmi i qasjes realiste, rëndësi primare për këtë qasje ka procesi i ndërtimit të sigurisë dhe i kërcënimeve ndaj saj. Realizimi i procesit të sigurizimit bën të nevojshme ndjekjen e dy etapave të rëndësishme. Etapa e parë, lidhet me identifikimin e çështjes/fenomenit/problematikës nga një aktor sigurizues si qeveria, elita politike, shoqëria civile, apo ushtria si kërcënim ekzistencial/mbijetese për një objekt të caktuar referues të cilët mund të jenë individët, shteti, ekonomia, mjedisi etj. Ndërsa etapa e dytë lidhet me përdorimin e një ligjërimi nga ana e elitës politike, më synimin e bindjes së audiencës për marrjen e masave të menjëhershme/jashtëzakonshme të cilat shkojnë përtej rregullave standarde. Kjo konsiderohet edhe si etapa më e rëndësishme e një procesi sigurizimi të suksesshëm. Ndërsa përsa i përket konceptit/procesit të dytë, atij të desigurizimit, ai nënkupton lëvizje të fenomenit nga zona e kërcënimit ekzistencial drejt

sferës publike normale (Taureck, 2006: 54). Pra kthimi i këtij fenomeni në fazën e pa politizuar, ku ai ekziston, por nuk është më pjesë e axhendës politike dhe nuk ka një debat publik mbi të.

Në rastin e analizës të marrë në shqyrtim mund të shtrojmë disa pyetje. A janë identifikuar ndonjëherë kërcënime të cilat kanë rezultuar rreziqe ekzistenciale për sigurinë e Shqipërisë? Nëse po, kush kanë qenë këto çështje të cilat janë sigurizuar? Nëse jo, kush kanë qenë pengesat e shfaqura, të cilat nuk kanë lejuar të kuptuarin e këtyre kërcënimeve dhe trajtimin e tyre si çështje të cilat krijojnë domosdoshmërinë e sigurizimit të tyre? A ka ndodhur që në realitetin shqiptar të kryhet një proces i mirëfilltë sigurizimi? Nëse po, a janë ndjekur etapat e domosdoshme të këtij procesi? Nëse jo, kush kanë qenë faktorët të cilët kanë ndikuar në mos realizimin e etapave të këtij procesi. Në realitetin shqiptar sot, si paraqiten kërcënimet si krimi i organizuar dhe terrorizmi ndaj sigurisë kombëtare të saj? Cilët janë faktorët që e bëjnë të domosdoshëm dhe të menjëhershëm ndërmarrjen e një procesi të mirëfilltë sigurizimi?

Kapitulli III: Siguria Kombëtare dhe Ndërkombëtare

3.1. Siguria Kombëtare, evoluimi, politika, institucione

Ekzistojnë shumë përkufizime, por asnjë nuk i përket nocionit të sigurisë kombëtare. Shtetet kanë nevojë për një përkufizim të unifikuar, të njohur universalisht, për të kuptuar në mënyrë të njehsuar sigurinë kombëtare. Siguria kombëtare mund të përkufizohet "si aftësia për t'u përballur me agresionin e jashtëm dhe për t'i rezistuar atij" (Luciani, 1989: 151). Një tjetër përkufizim i rëndësishëm mbi termin është dhe ai i Ayoob, i cili argumenton se "siguria dhe pasiguria përkufizohen në lidhje me kërcënimet, si ato të brendshme ashtu edhe ato të jashtme, të cilat janë të afta të dobësojnë strukturat shtetërore (si ato territoriale ashtu edhe ato institucionale) dhe rregjimet qeveritare" (1995: 9). Për Ullman, kërcënim ndaj sigurisë kombëtare konsiderohet "një veprim ose një sërë veprimesh, të cilat në mënyrë drastike kërcënojnë cilësinë e jetës së banorëve të një shteti, ose ngushtojnë në mënyrë thelbësore gamën e zgjedhjeve politike në dispozicion të qeverisë së një shteti" (1983: 133).

Për të mbrojtur sigurinë kombëtare të tyre nga kërcënimet, shtetet duhet të bëjnë një vlerësim të të gjithë elementëve të fuqisë kombëtare të tyre, sepse vlerësimi i fuqisë kombëtare vjen si një domosdoshmëri për të ruajtur sigurinë e shteteve. Fuqia kombëtare është e përbërë nga elementë të fuqisë natyrore (gjeografia, burimet dhe popullsia) si dhe nga elementë të fuqisë shoqërore (fuqia ekonomike, ushtarake, politike, diplomatike dhe informative) (Jean, 1998:). Të gjithë këto elementë janë të rëndësishëm dhe përbëjnë atë që quhet ose konsiderohet fuqia kombëtare e një shteti. Për vendosjen e prioritetëve, qëllimeve, hartimit të strategjisë së sigurisë kombëtare, çdo shtet duhet të analizojë të gjithë elementët. Të gjitha elementët janë të rëndësishëm, por instrumenti më i

rëndësishëm që mund të zotërojë një shtet-komb është fuqia ushtarake. Hans Morgenthau argumenton se "në politikën ndërkombëtare, fuqia ushtarake qoftë si kërcënim i drejtpërdrejtë apo si mundësi përdorimi është faktori më i rëndësishëm material i cili kontribuon në fuqinë politike të një vendi" (Hoxha, 2011: 1).

Në mbështetjen dhe në çuarjen përpara të interesave kombëtare, elementë të tjerë të fuqisë kombëtare, sigurisht që luajnë një rol shumë të rëndësishëm, por për aq kohë sa shtetet vazhdojnë të jenë në gjendjen e anarkisë, fuqia ushtarake do të vazhdojë të luajë një rol vendimtar në politikën ndërkombëtare. Me të drejtë Kenneth Waltz shprehet se "në politikë thuhet që forca do të jetë mjeti i fundit, në politikën ndërkombëtare forca shërben jo si mjeti i fundit, por në të vërtetë si forcë e parë dhe e qëndrueshme" (Waltz, 2004: 5-6). Megjithatë, siç është vënë në dukje kohët e fundit nga Robert Art, fuqia ushtarake aq sa është e rëndësishme për funksionimin e sistemit ndërkombëtar, po aq është edhe një instrument i kushtueshëm dhe i rrezikshëm, i cili duhet të ushtrohet me shumë zgjuarsiri sepse "Përdorimi korrekt i fuqisë ushtarake nuk jep sigurinë që shteti do të mbrojë të gjitha interesat e tij, por përdorimi jo korrekt do të vendoste një barrë të rëndë në instrumentet e tjerë të fuqisë kombëtare dhe mund ta bëjë të pamundur për një shtet përmbushjen e objektivave të tij" (Art, 2004: 3-4).

Vendimet, nëse duhet përdorur fuqia ushtarake dhe si duhet përdorur ajo, mund të jenë më të rëndësishmet që mund të marrë një shtet. Çdo shtet, pas analizimit të të gjithë elementëve të fuqisë kombëtare të tij, i nevojitet hartimi i një strategjie, plani, politike mbi sigurinë kombëtare të tij, sepse në këtë mënyrë bëhen më të qarta qëllimet dhe objektivat e tij përse i përket sigurisë kombëtare, pozicionit dhe rolit të tij në arenën ndërkombëtare. Politika e sigurisë kombëtare është një dokument, i cili përshkruan se si

një vend ofron siguri për shtetin dhe për qytetarët e tij. Ky dokument mund të konsiderohet plan, strategji, koncept ose doktrinë (Law, 2007: 12). Politika e sigurisë kombëtare luan një rol të rëndësishëm si për të tashmen ashtu edhe për të ardhmen e një shteti. Sepse, ky dokument, pasqyron interesat bazë të një vendi si dhe jep udhëzimet apo rekomandimet për trajtimin e rreziqeve aktuale dhe ato të së ardhmes. Në hierarkinë e politikave të sigurisë, politika e sigurisë kombëtare është më superiorja. Ajo dallon prej politikave të tjera nga gama e gjerë e temave që ajo trajton.

Politikat e sigurisë kombëtare, edhe pse ndryshojnë nga njëri shtet në tjetrin si rezultat i shumë faktorëve, përlllogaritjeve, qëllimeve, burimeve dhe kapaciteteve reale të vëna në dispozicion, prirën apo kanë tendencën të jenë një dokument i vetëm dhe të bashkohen në tre pika kyçe, bazike. Pika e parë lidhet me përcaktimin e vizionit të shtetit për sistemin ndërkombëtar si dhe me rolin që luan një shtet i caktuar në atë sistem. Pika e dytë lidhet me vlerësimin e rreziqeve dhe mundësive aktuale dhe të ardhshme. Ky vlerësim përfshin si rreziqet e brëndshme, ashtu edhe ato të jashtme. Ndërsa për sa i përket pikës së tretë, në të cilën ato bashkohen, lidhet “me përgjegjësinë e aktorëve zbatues për trajtimin e këtyre sfidave dhe mundësive”. (Law, 2007: 14-15).

Politika e sigurisë kombëtare është strukturuar në mënyrë të atillë që të jetë gjithëpërfshirëse, sepse formulimi i një politikë gjithëpërfshirëse është mënyra më e mirë për të trajtuar të gjitha shqetësimet e aktorëve në nivel shtetëror. Për përmbushjen e objektivave të një shteti, pra për mbrojtjen e qytetarëve, shoqërisë dhe shtetit, normalisht duhet të shqyrtohen me kujdes një gamë e gjerë kërcënimesh, si kërcënimet ekonomike, konfliktet ndërshtetërore, konfliktet e brendshme, armët e shkatërrimit në masë, terrorizmi etj. Një çështje e cila duhet të merret në konsideratë lidhet me faktin se

meqenëse shtetet nuk janë të izoluar, pra nuk veprojnë të vetme, ata nuk mund të formulojnë një politikë sigurie tërësisht kombëtare. Anëtarësia e shteteve në organizata të ndryshme, të cilat lidhen me sigurinë ose ekonominë, patjetër që do të kenë ndikimin e tyre në formulimin e politikës së sigurisë kombëtare. “Kjo lidhet me respektimin e të drejtës ndërkombëtare”. (Law, 2007: 23). Politika e sigurisë kombëtare duhet të marrë në konsideratë dispozitat e atyre instrumenteve ligjor në të cilën është i anëtarësuar shteti. Strategjia e Sigurisë Kombëtare, në Fjalorin e termave Ushtarakë, përcaktohet si arti dhe shkenca e zhvillimit dhe e përdorimit të fuqisë politike, ekonomike dhe psikologjike të një vendi, së bashku me forcat e saj të armatosura, në kohe paqe dhe lufte, për garantimin e objektivave kombëtare. (Departamenti i Mbrojtjes SHBA, 1987:

232). Strategjia e Sigurisë Kombëtare është me të vërtetë përmbledhja e sigurisë, e strategjisë ekonomike dhe politike, bazuar në supozimin se cila është mënyra më e mirë për zhvillimin e sigurisë kombëtare dhe ndërtimin e rregullit ndërkombëtar. (Ikenberry, 2003: 132). Le të shohim se çfarë është në tërësi Strategjia e Sigurisë Kombëtare. Ajo trajton konceptin që ka shteti për strategjinë e sigurisë, objektivat e sigurisë në planin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, ka si qëllim analizimin e mjedisit të brendshëm e të jashtëm, për të bërë të mundur kështu evidentimin e rreziqeve, kërcënimeve dhe sfidave në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe kombëtar, me qëllim parashikimin dhe frenimin e rreziqeve, duke synuar evitimin ose përballimin e tyre. Strategjia e Sigurisë Kombëtare përcakton interesat, objektivat, prioritetet e vendit, rrugët dhe programet kryesore për realizimin e tyre. Përsa i përket interesave, ato mund t'i klasifikojmë sipas intensitetit të tyre në:

- Interes në nivelin e mbijetesës (Nëqoftëse nuk përmbushet, rezulton në shkatërrimin e madh dhe të menjëhershëm të një ose më shumë aspekteve kryesore të interesave thelbësore kombëtare)
- Interes jetik (Nëqoftëse nuk përmbushet, do të ketë konsekuenca të menjëhershme të interesave thelbësore kombëtare)
- Interes i rëndësishëm (Nëqoftëse nuk përmbushet, rezulton në dëmtime që në fund të fundit, do të dëmtojnë interesat thelbësore kombëtare)
- Interes periferik (Nëqoftëse nuk përmbushet, rezulton në dëmtime që në fund të fundit, kanë pak mundësi të prekin interesat thelbësore kombëtare) (Hoxha, 2010: 14).

Në një kontekst të përgjithësuar Strategjia shfaqet si një ekuacion me tri variabla, ajo është e barabartë me:

- **Qëllimet** (*objektivat që synohen të arrihen*),
- **Mjetet** (*me çfarë instrumentesh do të arrihen këto objektiva*) dhe
- **Mënyrat** (*si do të veprohet për arritjen e objektivave*).

Strategjia e Sigurisë Kombëtare, cilësohet si një ndër dokumentet më të rëndësishme me karakter kombëtar, menjëherë pas Kushtetutës së vendit.

3.2.Siguria Ndërkombëtare, evoluimi, politika, institucione

Ekzistojnë shumë përkufizime përsa i përket konceptit të sigurisë ndërkombëtare. “Siguria dhe pasiguria përkufizohen në lidhje me kërcënimet si ato të brendshme ashtu edhe ato të jashtme, të cilat janë të afta që të gjunjëzojnë ose të dobësojnë strukturat shtetërore, si ato territoriale ashtu edhe ato institucionale” (Collins, 2009: 16).

Përfaqësuesit e shkollës së Kopenhagenit e përkufizojnë sigurinë ndërkombëtare në një kontekst tradicional ushtarak. Sipas tyre, siguria ka të bëjë me mbijetesën. “Siguri quhet momenti kur një çështje paraqitet si rrezik ekzistencial për një objekt të përcaktuar referues”. (Buzan, Waever & de Wilde, 1998: 21). Në hartimin e politikave botërore, të gjithë aktorët transnacional, si individët, shtetet apo organizatat e ndryshme, luajnë një rol të rëndësishëm, sepse secili prej tyre është pjesë e një ekuacioni. Individët janë një nga aktorët transnacional, të cilët janë të aftë të bëjnë zgjedhje të lira, e kështu kontribuojnë në politikën botërore. Vendimet që ne ndërmarrim çdo ditë dhe grupet ku ne bëjmë pjesë, janë reflektimi i politikës sonë të jashtme, pavarësisht nëse jemi apo nuk jemi të vetëdijshëm për zgjedhjet tona të përditshme.

Për të kuptuar vendimmarrjen politike, ne duhet të përpiqemi të shikojmë përtej një faktori të vetëm ndikues. Merr një vlerë të rëndësishme identifikimi i faktorëve/variablave, të cilat ndikojnë apo influencojnë mbi zgjedhjet që bëjnë të gjithë aktorët transnacionale, kur ato përpiqen që të formulojnë një politikë të jashtme. Asnjëri nga faktorët në mënyrë të veçantë nuk mund të arrijë të shpjegojë plotësisht vendimet e ndërmarra në politikën e jashtme, sepse të tre faktorët janë të lidhur ngurtësisht me njëri-tjetrin. Faktorët që ndikojnë në procesin e politikës bërjes së jashtme janë:

- Kushtet globale të cilat mbizotërojnë në kohën e vendimit;
- Karakteristikat e brendshme të aktorëve transnacional;
- Liderët, të cilët drejojnë vendimmarrjen e aktorit transnacional. (Charles, 2009: 53).

Konteksti global ndikon në përcaktimin e marrjes së vendimeve, duke kufizuar në këtë mënyrë lirinë e aktorëve në ndërmarrjen e vendimeve politike. Ndryshimet e

mëdha në arenën ndërkombëtare gjatë viteve 90 sollën rreziqe të reja për sigurinë lokale dhe globale, duke ndryshuar në këtë mënyrë prioritetet në axhendën e shteteve, sepse çdo transformim global çon automatikisht në një vlerësim të ri, në një vendim të rëndësishëm nga aktorët transnacional në lidhje me këtë çështje, si dhe në një riformulim të politikës së jashtme të një shteti.

Terrorizmi ndërkombëtar, krimi i organizuar, trafiqet e paligjshme dhe korrupsioni, si efekte anësore të globalizmit, së bashku me arsenalet e armëve të mbetura nga Lufta e Ftohtë, janë identifikuar si rreziqet kryesore të cilat kërcënojnë sigurinë ndërkombëtare. Mjedisi i ri gjeopolitik i pas Luftës së Ftohtë karakterizohet nga “probleme sigurie të cilët janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin” (Lleshi, 2009: 181). Siguria ndërkombëtare varet nga shumë faktorë apo elementë, përveç këtyre të thëna më lart, mund të përmendim edhe sigurinë mjedisore, shoqërore, shtetet e dobëta, të cilat karakterizohen nga destabilitetet e shumta politike të shoqëruara me grushte shtetesh, demokraci të pakonsoliduara, institucione jo efikase, ekonomi të brishta, etj.

Përsa i përket shteteve të dobëta mund të themi që, si pasojë e mos izolimit të konflikteve të tyre të brendshme, ajo bën që vendet fqinje të përfshihen me një rregullsi që konsiderohet si e pashmangshme. Kjo lloj paqëndrueshmërie që rrjedh nga dobësia ka prirjen që të eksportohet në të gjithë rajonin. (Holsti, 2008: 135). Shumë nga problemet botërore të mjedisit dhe të sigurisë janë projektuar që të bëhen më të rënda në dekadat që do të vijnë. “Ndalimi i ndryshimeve klimatike globale, ruajtja e biodiversitetit, luftimi i sëmundjeve të transmetueshme, siguri i ujit të pastër, ulja e varfërisë, luftimi i kequshqyerjes dhe urisë, ruajtja e pyjeve, botës së ujit dhe e të tjerave burimeve të

rinovueshme të mbishfrytëzuara, janë vetëm disa nga sfidat e mjedisit me të cilat përballlet njerëzimi”. (Charles & Kegley, 2009: 517).

Të gjitha këto mund të paraqiten si rreziqe për sigurinë ndërkombëtare në të ardhmen e në këtë kontekst global të ndryshuar, çdo aktor duhet të bëjë vlerësimin e fuqisë së tij në raport me aktorin tjetër me të cilin ndër vepron, duhet të bëjë vlerësimin e duhur të burimeve financiare dhe kapaciteteve reale që ka në dispozicion dhe të përzgjedhë mënyrat më të mira për arritjen e objektivave të tij. Bëhet e domosdoshme kjo analizë nga aktorët, sepse problemet/sfidat globale janë të shumta, ndërsa burimet financiare të kufizuara. Në kushtet e pamundësisë për të zgjidhur çdo problem të shfaqur, behet e nevojshme seleksionimi i problemeve dhe radhitja e tyre sipas rëndësisë.

Karakteristikat e brendshme (problematikat e shfaqura dhe çështjet e brendshme të një shteti) ndikojnë në aftësinë e aktorit për të bërë zgjedhje dhe për të marrë vendime të rëndësishme mbi politikën e jashtme. Karakteristikat personale të drejtuesve, të cilët drejtojnë aktorët transnacionale, marrin një rëndësi të madhe në përpunimin e vendimeve ndërkombëtare. Ndryshimi i kontekstit global, karakteristikat e brendshme, ndërmjetësohen nga perceptimet e liderëve. Prandaj, në çdo shpjegim që jepet në lidhje me atë se përse ndërmerret një vendim i caktuar ndërkombëtar, është e domosdoshme që të vlerësohet paraprakisht sesi idetë dhe përfytyrimet e liderit kanë influencuar zgjedhjen e bërë.

3.2.1 Sfida të Mjedisit të ri të Sigurisë

Një mënyrë e të vlerësuarit të konflikteve ndërkombëtare është që fillimisht në të kuptojmë se të gjitha shtetet kërkojnë të akumulojnë një fuqi sa më të madhe në krahasim me shtetet e tjera. Nisur nga kjo, konflikti shndërrohet në një kusht të përgjithshëm që ekziston ndërmjet shteteve, duke i bërë ato që të luftojnë për fuqi, gjendje sa më të mirë si dhe aleanca të volitshme në sistemin ndërkombëtar. “Fuqia u jep shteteve disa përfitime të veçanta, ose u jep atyre aftësinë për të nxjerrë përfundime më të mira nga përpjekjet për marrëveshje mbi çështje të veçanta, të cilat kanë rëndësi për mirëqenien e tyre” (Goldstein, 2003: 195). Pjesa më e madhe e konflikteve ndërkombëtare, përfshirë ato që qëndrojnë prapa luftërave që zhvillohen tani, janë shqetësime e kërkesa konkrete, për kufij territorialë, etnike, revolucionare etj. Nisur nga kjo, konflikti ndërmjet shteteve nuk është një rrethanë e pazakonshme, por e zakonshme. Konflikti mund të përkufizohet “si një ndryshim në përfundimet e arritura të parapëlqyera të një rrethanë përpjekjesh për marrëveshje” (Goldstein, 2003: 197).

Ndërsa përsa i përket mjedisit të sigurisë është mjaft e vështirë që ta përkufizosh atë në mënyrë të prerë, e si rrjedhojë nuk është e lehtë të thuash se si do të zhvillohen konfliktet e ardhme. Megjithatë, mjaft studiues, kryesisht perëndimorë, përpiqen ti kategorizojnë konfliktet e ardhme në natyrë:

- hegjemoniste (për vendosjen e kontrollit mbi të gjithë rendin botëror);
- totale (lufta që zhvillon një shtet për të mundur e pushtuar një shtet tjetër);
- të kufizuar (për të arritur disa objektiva pa synuar kapitullimin e kundërshtarit);
- civile/ndër qytetarë (ndërmjet fraksioneve brenda një vendi);

- guerile/asimetrike pa vijë fronti). (Goldstein, 229-230).

Mjedisi dhe konfliktet, por edhe mjetet e tjera të dhunës, mund të përdoren si mjete ndikimi në përpjekje për të përmirësuar kushtet e zgjidhjes së interesave. Ekzistojnë një sërë debatesh dhe analizash për konfliktet e së ardhmes. Mjedisi dhe konfliktet kanë qënë fokusi kryesor i studimeve të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, por edhe temë kryesore në objektin e organizatave ndërkombëtare në nivel global apo rajonal. Kuptimi ynë mbi mjedisin e ri dhe sfidat që do të përballët ky mjedis nuk mund të plotësohet nga qasje analitike tradicionale apo klasike. Mjedisi i sigurisë nuk është i njëjtë siç ishte në shekullin e nëntëmbëdhjetë apo në vitet '30 të shekullit të njëzet, kur kanë ndodhur edhe konfliktet më të mëdha botërore. Sipas analistëve të ndryshëm mjedisi i ardhshëm do të influencohet jo vetëm nga elementë tradicionalë, por edhe nga aktorë dhe faktorë të ndryshëm, por edhe të rinj jo-traditionalë.

Mjaft autorë mbrojnë argumentin se sfidat e së ardhmes në mjedisin e sigurisë do të jenë konflikte në të cilat përveç forcave konvencionale, forcat ushtarake nuk do të jenë të vetme. Meqenëse, “fuqia ushtarake është një masë e dukshme e pushtetit të një kombi, demonstrimi i saj shërben për të ndikuar tek të tjerët” (Morgenthau, 2008: 99). Prestigji përdoret edhe si një frenues ndaj luftës si dhe përgatitjes për luftë. Shpresohet se prestigji i një vendi do të jetë aq i madh sa për të parandaluar vendin tjetër për të hyrë në luftë. Në të njëjtën kohë shpresohet që nëse kjo politikë prestigji dështon, mobilizimi i forcave të armatosura para shpërthimit konkret të luftës do ta vendosë vendin në pozitën ushtarake më të favorshme të mundshme. Në këtë moment, “synimet politike dhe ushtarake priren të shkrihen dhe të bëhen dy aspekte të ndryshme të së njëjtës

politikë”. (Morgenthau, 2008: 102). Autorët të cilët mbrojnë këtë tezë e shikojnë si jo shumë të mundshme luftën apo ballafaqimin e shteteve me forcat e tyre të armatosura.

Ekziston edhe një qasje tjetër mbi konceptimin e mjedisit të së ardhmes. Kjo njihet ndryshe edhe si paqja demokratike. Kjo teori mbështetet tek ideja se shtetet demokratike pothuajse nuk bëjnë kurrë luftë me njëra-tjetrën. Shpërndarja e qeverisjes demokratike në të gjithë botën do të pakësojë shumë probabilitetin për luftë. Historia dëshmon se ka arsye të shumta për të pranuar këtë propozim liberal. Shumë studime akademike të historisë moderne ndërkombëtare kanë treguar në mënyrë të bindshme se demokracitë e konsoliduara mirë nuk kanë bërë kurrë luftëra kundër njëra-tjetrës dhe vetëm ato kanë patur tendencë të formojnë bashkime paqësore të qëndrueshme (Pught,

2005: 2-5). Ky parim liberal argumenton se, demokracia prodhon më shumë vlera morale, duke përfshirë lirinë, të drejta njerëzore, të drejta qytetare, prosperitet dhe veçanërisht një rritje të kapaciteteve për të dekurajuar luftëra mes anëtarëve të komunitetit demokratik të shteteve. Sfidat e së ardhmes do të shkonin në përpjesëtim të zhdrejtë me sasinë e përpjekjeve për të promovuar më shumë sisteme demokratike në botë, duke krijuar një mjedis ku ndajnë të njëjtat vlera.

Mjedisi i sotëm i sigurisë dhe sfidat që shfaqen sot janë më pak problem i marrëdhënieve midis shteteve se sa problem brenda shteteve. Shtetet e reja dhe të dobëta janë vendndodhja kryesore e mjediseve të rrezikuara aktuale por edhe të të ardhmes. Ne mund të arrijmë t’i kuptojmë shumë mirë këto mjedise në qoftëse, studiojmë lindjen e shteteve dhe se si ato janë qeverisur. Ndër problemet themelore, është ai “i legjitimitetit, parimi i besimit fetar dhe parimi i bashkësisë natyrore” (Holsti, 2008: 4). Konfliktet shpërthejnë kryesisht në shtetet e bazuara mbi këto dy parimet e fundit, sepse ato janë

përrjashtuese. Kontradikta midis parimeve përrjashtuese të legjitimitetit dhe përrbërjes shoqërore dhe demografike të shumë shoqërive post-koloniale dhe post-sovjetike, krijon shtetet e dobëta dhe përrfundimisht edhe luftën. “Luftërat nuk zhvillohen përr politikën e jashtme, sigurinë apo statusin, ato zhvillohen përr shtetëformimin, qeverisjen, rolin dhe statusin e kombeve dhe bashkësive brenda shteteve” (Stoessinge, 2007: 19). Shtetet e dobëta karakterizohen nga një “mungesë e theksuar e rendit, paraqesin dobësi institucionale përr implementimin e një politike kombëtare, destabiliteti politik, centralizim të pushtetit, demokraci të pakonsoliduara, etj.” (Fawcett, 2009: 145). Shtetet e dobëta apo të dështuara janë kthyer në një ndër problemet më të rëndësishme përr rendin ndërkombëtar. Shtetet e dobëta apo të dështuara “abuzojnë me të drejtat e njeriut, provokojnë katastrofa humanitare si dhe sulmojnë fqinjët e tyre” (Fukuyama, 2008: 139).

Ekziston edhe një faktorë tjetër i rëndësishëm, si përrhapja e armëve të shkatërrimit në masë, e cila mund të ndikojë në mjedisin e së ardhmes. Përr disa studiues, sfida e rrezikut që i kanosej njerëzimit nga përrdorimi i armëve të shkatërrimit në masë do të merrte fund me fundin e Luftës së Ftohtë, mirëpo këto armatime vazhdojnë edhe sot të përrbëjnë një kërcënim përr të gjithë botën. Pavarësisht se vazhdimisht janë bërë përrpjekje përr parandalimin, pra mospërrhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, ka mjaft shtete, por edhe aktorë jo shtetërorë që i shohin armët e shkatërrimit në masë si pjesë joshëse të arsenaleve të tyre. Në botën në të cilën jetojmë sot, pra në kushtet e ekzistencës së përrhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, rreziqet që vijnë janë shumë shqetësuese. “Armët kimike, biologjike, bërthamore dhe radioaktive, jo vetëm po bëhen pjesë e qëndrueshme e arsenaleve të shteteve, por ato mund të bien edhe në duart e

terroristëve” (Collins, 2009: 340). Dhe kjo në fakt e bën gjendjen të jetë shumë alarmuese. Një nga sfidat e mundshme të mjedisit të sigurisë do të jenë rrjetet terroriste ndërkombëtare, të cilat po krijojnë mundësi e burime financiare dhe materialet për të ndërtuar dhe për të përdorur armët kimike, biologjike dhe radioaktive. Ekzistenca e këtyre armeve të shkatërrimit në masë, rrit vazhdimisht mundësinë e pasigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare të shteteve.

Mjedisi i ardhshëm i sigurisë mund të rrezikohet edhe nga diferencat kulturore midis rajoneve të ndryshme. Të flasësh për qytetërim do të thotë të flasësh për “hapësira, toka, relieve, klimë, bimësi, lloje kafshësh, përparësi këto të dhëna qysh më parë ose të fituara” (Braudel, 1987: 45). Gjithashtu mund të themi që nuk ka “qytetërim pa shoqëri”, të dy nocionet i përkasin të njëjtit realitet. (Braudel, 1987: 51). Në thelbin e çdo qytetërimi qëndron vizioni i botës që ai përfaqëson. Duke qenë se kulturat janë të ndryshme, në mjaft raste ato shoqërohen edhe me motive të tjera veçanërisht ato fetare. Në një vështrim më të përgjithshëm, ringjallja fetare në mbarë botën duket si një reagim kundrejt shekullarizimit, relativizmit moral. Ngjarjet e 11 Shtatorit patën në përmbajtje të tyre edhe frymëzimin ekstremist religjioz. Xhorxh Friedman e shpjegon këtë tendencë në mjedisin e sigurisë nën idenë e globalizmit. “Globalizimi mund të përcaktohet si integrimi i pandalshëm i tregjeve, i sistemeve të transportit dhe të komunikimit në përmasa të papara asnjëherë më parë, duke u dhënë mundësinë kështu korporatave, shteteve dhe individëve që shtrihen edhe më tej (Friedman, 2003: 6).

Tipari thelbësor i globalizmit është integrimi. Pra, në kuptimin më të gjerë, kemi kaluar nga një sistem ndërkombëtar i bazuar në ndarjen dhe muret [Lufta e Ftohtë] në

një sistem të bazuar gjithnjë e më tepër në integrim-bashkëpunim-bashkëjetesë. Sistemi i globalizimit është ndërtuar në bazën e tre ekuilibrave, të cilat ndikojnë te njëri-tjetri.

- Ekuilibri i parë është ekuilibri tradicional i forcave ndërmjet shteteve-kombeve.
- Ekuilibri i dytë i rëndësishëm i forcave në sistemin e globalizimit, është ai ndërmjet shteteve-kombe dhe tregjeve globale të cilat përbëhen nga investues që lëvizin paratë nëpër botë vetëm nëpërmjet përdorimit të internetit.
- Ekuilibri i tretë, i cili është pa diskutim më i rëndësishmi për sa i takon ngjarjeve të 11 shtatorit, është ai ndërmjet individëve dhe shteteve-kombe. Globalizimi, duke shembur muret e shumtë që kufizonin kontaktet mes popujve, si dhe njëkohësisht duke e lidhur botën në rrjete, u jep individëve nëpërmjet përdorimit të internetit më shumë fuqi se kurrë ndonjëherë, për të ndikuar qoftë tregjet, qoftë shtetet kombe.

Një vlerësim i rëndësishëm për mjedisin e sigurisë lidhet me nivelin e lartë të kërcënimit të Sigurisë Kombëtare dhe Ndërkombëtare nga operimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit. Nivelet dhe përhapja e krimit të organizuar dhe terrorizmit ,por edhe shkalla e lartë e organizimit të tyre janë kthyer në sfida të cilët shtetet direkt apo nëpërmjet koalicioneve organizohen për ta përballuar. Krimi i organizuar dhe terrorizmi të mpleksura edhe me krizën e rëndë ekonomike sot përbëjnë fenomen gjithmonë e më të rrezikshëm. Rritja e nivelit të operimit të krimit të organizuar dhe atij transnacional ka ardhur si pasojë e globalizimit, proces i cili ka shërbyer si një faktor lehtësues për operimin e veprimtarive kriminale dhe terroriste duke krijuar kushte të favorshme krimit

të organizuar dhe terrorizmit për të arritur përfitime dhe mundësira akoma dhe më të mëdha.

Krimi i organizuar dhe terrorizmi, janë të përbërë nga persona të cilët sillen si aktorë racional. Sipas termave Clausewitziane, “krimi i organizuar është në thelb një vazhdim i biznesit me mjete kriminale”. Ndërsa, “terrorizmi është vazhdimësia e politikave nëpërmjet përdorimit të dhunës” (Hoxha, 2010: 3). Të dyja përbëjnë sot rrezikun më të madh ndaj sigurisë, sepse veç e veç apo së bashku, këto veprimtari kriminale përdorin dhunën, korrupsionin e zyrtarëve shtetëror si dhe arritjen e përfitimeve sa më të mëdha financiare. Një ndër shqetësimet më të mëdha për qeveritë e shteteve, duhet të jetë një bashkëpunim i mundshëm ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit. Sepse, nëpërmjet këtij bashkëpunimi, të dyja veprimtaritë kriminale do të mund të siguronin përfitime akoma dhe më të mëdha, do të mund të rigjeneronin burimet e tyre, si dhe do të rrisnin efektivitetin e tyre, duke shkaktuar në këtë mënyrë, një rrezik të madh për sigurinë kombëtare të shteteve si dhe sistemin global në përgjithësi.

Nisur nga fakti që dukuri të tilla si krimi i organizuar dhe terrorizmi, gjithnjë e më tepër po kërcënojnë sigurinë globale, shtetet duhet të përpiqen maksimalisht për hartimin e politikave të duhura për t’i luftuar ato, sepse krimi në ditët e sotme jeton në një botë pa kufij. Në listën e hierakisë së prioriteteve të shteteve, lufta kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar renditen ndër vendet e para, sepse paraqesin nivelin e rrezikshmërisë më të lartë të kërcënimit ndaj sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare.

3.2.2.NATO dhe BE për menaxhimin e sigurisë

Ndryshimet në kontekstin global, sfidat/kërcënimet e shfaqura ndaj sigurisë ndërkombëtare, çuan në domosdoshmërinë e hartimit të Strategjive mbi sigurinë, me qëllim e marrjen e masave efikase, përdorimin e mjeteve dhe mënyrave të reja në përshtatje me këtë mjedis të ri të krijuar, me synimin final atë të përballimit të këtyre rreziqeve. Organizata e Atlantikut të Veriut (NATO) vazhdon ende të këtë objektivin e saj themelor, garantimin e mbrojtjes dhe sigurisë së përbashkët. Megjithatë u konsiderua i nevojshëm një ri konceptim strategjik mbi sigurinë dhe mbrojtjen pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Sepse, mjedisi strategjik në ndryshim, ka sjellë një dinamikë të re të operacioneve të sotme dhe të ardhme, një fushë më të gjerë, prej operacioneve klasike luftarake tek ato paqeruajtëse e humanitare. Nëse hedhim një vështrim në dekadën e fundit, shohim se ka pasur ndryshime gjeostrategjike që janë të lidhura me arritjet teknologjike dhe një rikonceptim të ri të forcës ushtarake dhe veprimtarisë së saj.

Aktualisht, ndryshimet e mjedisit të sigurisë dhe ndryshimi në doktrinën dhe teknologjinë që shkon së bashku me të, kërkojnë përshtatjen e mekanizmave të kontrollit të armëve për kushtet e sotme. Kapacitetet e sigurisë që kërkohen sot në një mjedis të ndryshëm të sigurisë, veçanërisht pas ngjarjeve në Ukrainë dhe në Lindjen e Mesme, janë komplekse dhe duhet të pasqyrohen në dokumente strategjike dhe të mund të implementohen në mënyrë efektive. Në Samitin e Lisbonës, NATO dha një sinjal të qartë në këtë drejtim duke vendosur administrimin ndërkombëtar të krizave dhe bashkëpunimin në fushën e sigurisë, së bashku me një angazhim kolektiv të mbrojtjes, si aktivitetin kryesor të saj. Ky qëndrim do të forcohet edhe nga krijimi i një aftësie të qëndrueshme civile-ushtarake.

Në ri konceptimin strategjik mbi sigurinë dhe mbrojtjen, NATO merr angazhimin për përballimin e sfidave që kërcënojnë sigurinë jo vetëm të shteteve të Aleancës, por edhe stabilitetin ndërkombëtar. Mund të përmendim këtu kërcënimet si përhapja e armëve bërthamore, ekstremizmi fetar, krimi i organizuar, terrorizmi, aktivitetet ilegale si trafikimi i njerëzve, drogës dhe armëve, sulmet kibernetike, ndryshimet klimaterike, konfliktet përtej kufijve të NATO-s, kufizimet në burime dhe kapacitete, etj. (NATO, 2010: 10-11). Mundësia e lartë e kërcënimeve asimetrike dhe e përdorimit të taktikave asimetrike në sferën ushtarake por dhe përtej saj, kërkon masat e duhura për t'iu përgjigjur këtyre kërcënimeve. Për më tepër, këto hapa duhet të merren jo vetëm në nivel kombëtar por edhe në nivel të bashkëpunimit ndër-shtetëror, duke përfshirë dhe sferën ushtarake. Vetëm në këtë mënyrë, mund të flasim për krijimin e parakushteve për kundërvënien efektive ndaj kërcënimeve dhe sfidave të sotme. Gjithashtu nuk mund të lëmë pa përmendur Samitin e Wales në 4-5 Shtator të vitit 2014, i cili konsiderohet si një ndër Samitet më të rëndësishëm pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, për shkak të trajtimit të detajuar të mjedisit gjeopolitik dhe sfidave të sigurisë globale, ku temat kryesore ishin Rusia dhe ISIS.

Edhe në këtë Samit vihet re theksimi i angazhimit të aleancës bazuar në konceptin strategjik, për mbrojtje kolektive, menaxhimi i krizave dhe bashkëpunim për siguri të përbashkët. Risia që sjell ky Samit lidhet me miratimin e Plan Veprimit të gatishmërisë së NATO-s si një kundërpërgjigje ndaj sfidave të sigurisë, përshtatja e strukturave të forcave të saj ndaj realiteteve të reja të sigurisë. Tema të tjera të rëndësishme që u trajtuan në këtë Samit, kishin të bënin me kërcënimet që vijnë nga Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut. Gjithashtu një tjetër risi që sjell ky Samit lidhet me

theksimin e faktit që sfidat e sigurisë globale janë të shumta, ndërsa sfida thelbësore për ne do të jetë përgjegjësia që duhet të marrë çdo shtet për të zhvilluar kapacitetet e nevojshme ndërvepruese dhe mbështetëse për përballimin e çdo sfide (Wales Summit Declaration, 2014).

Strategjia Europiane e Sigurisë përpiqet që të realizojë objektivat si proceset integruese, tregtinë e lirë, përhapjen e organizatave ndërkombëtare, çarmatosjen si dhe promovimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Sipas tyre, kjo është strategjia më efektive për të garantuar paqen. Në strategjinë e sigurisë së Bashkimit European, nënvizohet se "asnjë nga kërcënimet e reja nuk është thjesht ushtarake dhe asnjë nuk mund të përballlet vetëm me mjete ushtarake". (SS e BE, 2003:7). BE shpenzon më pak se gjysma e asaj që shpenzojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës në sektorin e mbrojtjes. Vendet e Bashkimit European mendojnë se duhet shpenzuar më shumë për ndihma dhe për dërgime të grupeve të ndryshme negociatore në të gjithë botën, sepse krizat apo konfliktet zgjidhen më mirë nëpërmjet diplomacisë dhe jo veprimeve ushtarake. Mbi bazën e prioriteteve të përcaktuara nga BE, mund të jetë e vërtetë që Bashkimi European ka aspirata për t'u bërë një superfuqi e re, por kjo nuk ka gjasa të jetë një qëllim realist, për aq kohë sa shtetet e Europës nuk kanë një qasje të koordinuar në politikën e jashtme (Mark, 2005: 5). Ndërsa përsa i përket përballimit të kërcënimeve si terrorizmi dhe krimi i organizuar, BE i percepton si një "kërcënim për sigurinë e brendshme dhe proceset demokratike" (The Response to Organised Crime, 2007).

Krimi i organizuar dhe korrupsioni janë pengesa për stabilitetin demokratik, institucionet e shëndosha dhe përgjegjëse, shtetin ligjor dhe zhvillimin ekonomik sidomos për vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilët aspirojnë integrimin. E nisur nga kjo

pikëpamje Strategjia Europiane e Sigurisë, përfshin mjetet dhe mënyrat për luftimin e të gjitha formave të trafikut, sidomos atij njerëzor, të drogës dhe të armëve. Pra përse i përket përballimit të këtyre kërcënimeve si terrorizmi, krimi i organizuar, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë, konfliktet rajonale, shtetet e dobëta, prioritetet europiane konsistojnë ”në matjen e kërcënimeve, në ndërtimin e një mjedisi të sigurt dhe në zhvillimin e një rregulli ndërkombëtar të bazuar tek multilaterizmi efikas” (Menotti, 2006: 154).

3.3.Çështje të Integritit të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare

Në të kaluarën e afërt, siguria e kombëtare dallohej nga siguria rajonale dhe ajo globale në së paku dy aspekte: në qellimin dhe në mjetet e përdorura. Qëllimet e sigurisë kombëtare më shumë kanë qenë të përqendruara dhe fokusuara mbi sovranitetin dhe mbrojtjen dhe fillimisht ka pasur “në konsideratë vlerësime për kundërshtarët [shtete] real dhe potencial në përdorimin e forcës së tyre, qoftë kur bëhet fjalë për forcë të dukshme ose të kamufluar” (Sarkesian et.al. 2008:4). Në kushtet aktuale, pjesa më e madhe e angazhimit të procesit të sigurisë kombëtare harmonizohet me aktivitetet e politikës së jashtme, sigurinë ndërkombëtare (e cila udhëhiqet nga kombinimi i masave diplomatike, politike, psikologjike dhe ekonomike) dhe me politikën e mbrojtjes (e cila buron nga doktrina ushtarake të Aleancës).

Si shembull klasik për harmonizimin e sigurisë kombëtare me atë rajonale janë anëtarësimi, integrimi dhe kooperimi me vende të tjera të rajonit dhe më gjerë në operacione të përbashkëta në ndihmë të paqes, në operacione në rast krizash humanitare dhe në raste të tjera fatkeqësish natyrore. Operacione të përbashkëta në kuadër të NATO-s apo me vende të tjera të rajonit aq sa janë kontribut ndërkombëtar, po aq rrisin

edhe efikasitetin operacional të vendit në përmirësimin e burimeve dhe kapaciteteve për të vënë në dispozicion të sigurisë kombëtare. Botëkuptimi tradicional i qëllimeve të sigurisë së brendshme (kombëtare) shërben që të sigurojë një shkallë optimale të sigurisë së qytetarëve, të sigurojë funksionim pa pengesa të institucioneve të shtetit dhe të vihet në mbrojtje të interesave dhe vlerave të shtetit. Siguria kombëtare në vendet e vogla (ku bën pjesë edhe vendi ynë) është fokusuar mbi kërcënimet e brendshme dhe të jashtme ndaj vendit ku nuk mund të theksohet në të njëjtën kohë se shteti nuk do të jetë burim i rrezikimit të sovranitetit dhe integriteti territorial të shteteve të tjera. Ky ndoshta është hapi i parë ku siguria kombëtare kontribuon në sigurinë rajonale e më gjerë. Nga qëllimet e konceptuara në këtë mënyrë të sigurisë kombëtare, principet e sigurisë kombëtare duhet të orientohen në drejtim të ballafaqimit me të gjitha format e rrezikut (terrorizmin, krimin e organizuar, migrimin jo legal, kontrabandën me drogë, me armë, trafikimin me njerëz dhe forma të tjera).

Integrimet euroatlantike, si qëllim strategjik i shtetit, perceptohen si garanci e sigurisë kombëtare e cila kontribuon për zhvillimin ekonomik, imponon standarde gjatë kooperimit dhe operacionalitetit të sistemit të sigurisë dhe ndikon direkt në ngritjen e nivelit të sigurisë humane, si thelbi i konceptit të sigurisë. Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me standarde bashkëkohore kontribuojnë në drejtim të bashkëpunimit më efikas dhe bashkëpunimit midis institucioneve ushtarake, policore dhe të zbulimit në nivel të brendshëm dhe për komunikimin e tyre më të mirë me institucionet simotra të shteteve të tjera dhe me organizatat ndërkombëtare të sigurisë. Standardizimi i praktikave është veçanërisht i rëndësishëm gjatë shkëmbimit të informatave dhe implementimit të procedurave operative. Kjo ndihmon për identifikimin me kohë për

zbulimin dhe shmangien e kërcënimeve terroriste, formave të krimit të organizuar, migrimeve ilegale dhe formave tjera të kërcënimeve ndaj sigurisë. Zhvillimi ekonomik kontribuon në drejtim të tërheqjes së investimeve të huaja, zvogëlimit të tensioneve sociale dhe numrit të dukurive socio-patologjike dhe në drejtim të angazhimit më të madh të popullatës të aftë për punë. Imazhi i përmirësuar ekonomik i shtetit i ndryshon prioritetet e sigurisë dhe mundëson krijimin e politikës afatgjate të brendshme të sigurisë.

Në përgjithësi, siguria kombëtare në kapacitete dhe në qëllime duhet t'i shfrytëzojë mundësitë që ofrojnë organizmat ndërkombëtare të sigurisë në drejtim të ruajtjes së sigurisë së brendshme dhe përkufizimit të politikës së sigurisë. Njëherësh, anëtarësia aktuale dhe e ardhshme në organizatat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me sigurinë (NATO, BE, OKB, OSBE etj.) dhe marrëdhëniet e vendit me partnerët e saj (strategjike) në fushën e sigurisë nënkupton zbatimin e detyrimeve të kontraktuara dhe harmonizimin e sigurisë kombëtare me orientimet strategjike dhe me veprimin operativ të organizatave ndërkombëtare. Procesi i ndërtimit të politikave të sigurisë nënkupton harmonizim të objektivave kombëtare me qëllimet e organizatave, aleancave ndërkombëtare, me ruajtjen (deri në një shkallë të caktuar) të veçorive kombëtare të sistemit të sigurisë dhe veçori të tjera të cilat burojnë nga vlerësime kombëtare dhe rajonale.

Në këtë drejtim, është e pritshme që të ekzistojnë dallime lidhur me vlerat dhe interesat e integruara në strategjitë e sigurisë kombëtare me ato ndërkombëtare. Në këtë këndështrim duket se ka një dilemë midis interesave kombëtare dhe atyre rajonale apo ndërkombëtare kur këto interesa jo gjithmonë përputhen. Debati priret që zgjidhja e

kësaj dileme mund të kalojë vetëm në shprehjen e mundësive për promovimin e prioriteteve kombëtare në harmoni dhe në perspektivë me interesat e mjedisit rajonal dhe global. Kjo është mënyra për të mundësuar ndërtim të qasjes integruese në ballafaqimin me kërcënimet ndaj sigurisë. Në një rast ballafaques vërejmë se Politika e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë pranon parimet, qëllimet dhe detyrat të cilat rezultojnë nga Koncepti Strategjik i NATO-s, nga Samiti në Lisbonë (2010) e në Wells (2014) si dhe nga Strategjia Evropiane.

Siguria jonë kombëtare është orientuar drejt zhvillimit të vazhdueshëm të kapaciteteve dhe aftësive të sigurisë me çka sigurohet roli i saj në mbrojtjen e interesave kombëtare në përputhje me standardet e NATO-s, dhe mundësohet kontributi i vendit në drejtim të mbrojtjes së sigurisë rajonale dhe globale përmes pjesëmarrjes së vendit tonë në operacionet ndërkombëtare për mbështetjen e paqes dhe sigurisë (SK 2014-28). Kjo shpreh lidhjen e sigurisë kombëtare (vendi ynë) me atë rajonale (NATO).

Shqipëria, si gjithë vendet e vogla përballet me dy dilema të ndërlidhura mes tyre. E para, anëtarësimi në NATO ofron siguri maksimale me shpenzime minimale për sa i përket sovranitetit formal, për dallim nga BE e cila ofron një spektër më të gjerë të sigurisë, pa sigurimin e garancisë ‘ushtarake’ për sigurinë dhe stabilitetin e shtetit. E dyta nevoja e integritit në BE nënkupton aprovimin e politikës së sigurisë si përgjigje ndaj sfidave të sigurisë. BE ofron zhvillim ekonomik dhe aprovimin e politikës së përbashkët të sigurisë. Edhe pse ka përjashtime, megjithatë një pjesë e madhe e vendeve fillimisht anëtarësohen në NATO dhe pastaj në BE. Vlerësuar nga aspekti strategjik, ndërkaq duke e lënë anash kontestin irracional me fqinjët, vendi ynë kufizohet me pesë vende, nga të cilët të gjithë aspirojnë, ose janë pjesë në NATO dhe në BE. Anëtarësimi

në NATO paraqiti një përgjigje të shtetit për mënyrën se si ai zgjedh që të fitojë garanci për siguri dhe mbrojtje kombëtare dhe të kontribuojë për ruajtjen e sigurisë ndërkombëtare në formë të angazhimit dhe solidaritetit në mbrojtjen e paqes në botë. Procesi i anëtarësimit në NATO ngriti dhe pyetjen: *'Kush/kujt i duhet më shumë, ne NATO-s apo NATO neve?'*. Anëtarësimi në NATO nuk do të thotë vetëm privilegje për vendet anëtare por edhe obligime dhe shpenzime. Koha ka treguar se siguria kombëtare nuk mund të arrihet pa sigurinë rajonale.

Kapitulli IV: Terrorizmi dhe Krimi i Organizuar, refleksione në

konceptin dhe procesin e sigurisë

Kur analizojmë terrorizmin ndërkombëtar dhe krimin e organizuar e pasojat e tij, të gjithë njëzëri kemi pranuar se ai përbën një sfidë të re. Zhvillimet aktuale, veprimet terroriste e kriminale të ndodhura kohët e fundit dhe roli i ISIS (Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë) në to, janë dëshmi e faktit se terrorizmi dhe krimi i organizuar, me pamjen e vet të fshehur, përpiqen të shfaqen si protagonist të këtij shekulli, duke kthyer në të pasigurte jetën e përditshme të banorëve të globit. Është e qartë se terrorizmi e ka ndryshuar mjedisin tonë të sigurisë, duke e rrezikuar gjithnjë e më shumë atë, por në të njëjtën kohë ai ka shtuar nevojën për forcimin e bashkëpunimit. Terrorizmi dhe krimi i organizuar nuk lindin në mjedis bosh. Pabarazia ekonomike dhe varfëria, situatat e konflikteve të armatosura, trafiket e paligjshme, shkeljet e të drejtave të njeriut janë disa shkaqe të mjaftueshme që shërbejnë si një terren i përshtatshëm për lindjen dhe zhvillimin e tyre.

Terrorizmi dhe krimi i organizuar, natyrisht, ka edhe bazën e vet ekonomiko-financiare. Kjo kryesisht në dukurinë e kontrabandës, në trafiket ilegale, drogën dhe pastrimin e parave që janë përhapur sidomos në vendet ku nuk funksionon shteti ligjor, ku vepron gjerësisht fenomeni i korrupsionit në organet e drejtësisë dhe të administratës publike, ku renditen edhe vendet e Ballkanit. Ato kërkojnë jo vetëm angazhimin e të gjitha kapaciteteve të brendshme, por edhe bashkëpunim ndërkombëtar të vendeve për parandalimin e tyre, si edhe një koordinim më efikas të veprimeve dhe përpjekjeve të të gjitha organizatave ndërkombëtare të lidhura me çështjet e sigurisë. Në të kundërtën, ato

shumë lehtë mund të kthehen në një gangrenë, e cila mund të paralizojë dhe minojë stabilitetin ndërkombëtar dhe zhvillimin.

Ky kapitull ka për qëllim të sjell në vëmendje, të analizojë dhe të japë rekomandimet e mundshme për terrorizmin dhe krimin e organizuar, jo si një dukuri e re, por si një dukuri që ka një histori të vetën të gjatë dhe që në vartësi të mjedisit të jashtëm e të brendshëm ndryshon format, metodat dhe qëllimet. Nevoja për një vështrim historik buron nga fakti se nuk mund t'i analizojmë zhvillimet aktuale pa njohur rrënjët dhe evoluimin e fenomenit të krimit të organizuar dhe të terrorizmit. Sot në literaturën bashkëkohore debati fillon që me përkufizimin e fenomeneve, duke ndjekur më pas evolucionin e tij, për t'u ndalur në veçoritë e terrorizmit dhe krimit të organizuar. Kontributi në studimin dhe analizën e fenomeneve ka për qëllim të shfaqet në faktin se sa dhe si janë të pranishëm e me çfarë mase ato ndikojnë në sigurinë tonë, a reflektohen ndryshimet e vullshme të formave, strukturave, objektivave të terrorizmit dhe krimit të organizuar jo vetëm në dokumentet strategjike, por edhe në sjelljen e publikut ndaj këtyre zhvillimeve.

4.1.Një vështrim historik i evoluimit të terrorizmit

Që të mund të përcaktojmë një linjë sa më realiste të evoluimit historik të terrorizmit, është e nevojshme që të trajtojmë më parë përkufizimin e termit dhe fushën e veprimit të tij. Dhe më tej të ndalemi në mënyrën se si ka evoluar qëllimi, objekti dhe instrumentet e këtij fenomeni. Përse është e nevojshme të studiohet anatomia e fenomenit dhe cilat janë prirjet aktuale? Ekzistojnë shumë debate përse i përket përkufizimit të terrorizmit, por përgjithësisht mendimi teorik është përafruar rreth përkufizimit si “përdorim i llogaritur

dhe i paligjshëm i dhunës apo kërcënimit me qëllim për të frikësuar e detyruar publikun dhe qeverinë për arritjen e qëllimeve e objektivave të cilat zakonisht janë politike, fetare apo ideologjike” (Dictionary of Military and Associated Terms. US Department of Defense 2005). Terrorizmi është konsideruar si një dhunë politike dhe objekti i tij bëhen pikërisht njerëzit e pafajshëm, qytetarët e paarmatosur, fëmijët, gratë, njerëzit e thjeshtë, zyrtarë të lartë/figura të rëndësishme politike, etj.

Terrorizmi përfshin katër elementë kryesorë:

1. paramendimin, vendimin nga ana e autorit përgjegjës për të kryer një veprim me qëllimin që të mbjellë terror dhe frikë tek të tjerët;
2. motivimin apo një kauzë, qoftë ajo politike, fetare apo ekonomike;
3. objektivat, zakonisht jo ushtarake, si figura politike, zyrtarë, kalimtarë të rastit, etj., dhe kjo bëhet me qëllim që të shkaktojë një ndjenjë pasigurie tek qytetarët ndaj shtetit të tyre.
4. shkatërrimin e objekteve për të dekurajuar investitorët e huaj [me këtë taktikë ato dobësojnë ekonominë e vendit qëllimisht] (Mingst, 2008: 271).

Një qëllim i rëndësishëm i grupeve terroriste lidhet me atë që nëpërmjet një veprimi ata të transmetojnë një mesazh, duke siguruar kështu një njohje më të madhe, pra të tërheqin vëmendje. Për të forcuar pozita e tyre, grupet terroriste bëhen shpesh pjese e veprimtarive në trafikimin e armëve dhe municioneve si dhe në vjedhje. Përpiqen të ndikojnë nëpërmjet veprimeve të tyre në dobësimin e autoriteteve shtetërore në mënyrë që më pas të ndikojnë në vendimet politike qeveritare. Historia e terrorizmit është e vjetër sa edhe vetë gatishmëria e njeriut për ta përdorur dhunën si mjet për të ndikuar tek politika. Karakteristikat e tij rrjedhin nga sistemi ndërkombëtar i shteteve

kombëtare, ndërsa sukcesi i tij varet nga ekzistenca e një masmedia në mënyrë që të krijojnë një atmosferë terrori mes njerëzve. Historia e njerëzimit ka njohur individë, grupe, organizata, madje edhe shtete të tëra terroriste, veprimtaritë e të cilave kanë lulëzuar kryesisht në kushte krizash, anarkie, kaosi, luftërash, në mungesë kushtesh sigurie, rendi e ligji.

Historia e lindjes së fenomenit të terrorizmit daton të paktën 2000 vjet përpara. Bazuar në kronologjinë historike, terrorizmi është shfaqur në forma të ndryshme dhe niveli i ndikimit të tij në çështjet e sigurisë nuk ka qenë gjithnjë i njëjtë, për shkak të kushteve në të cilat është zhvilluar. Manifestimet e para të terrorizmit i identifikojmë në Rajonin e Lindjes së Mesme (Palestinë) në shekullin e parë. Sekti i Zelotëve në Judenë e Lashtë konsiderohet si grupi i parë që ka ushtruar terror në mënyrë sistematike dhe që ka shfaqur të gjitha karakteristikat e një organizate terroriste. Zelotët ishin një sekt hebrenjsh, që njiheshin ndryshe me emrin sicarii, (Marsella & Moghaddam, 2004: 20). Filozofia tek e cila mbështeteshin përfaqësuesit e këtij sekti lidhej me mos llogaridhënien ndaj askujt përveçse Zotit. Nisur nga kjo pikëpamje ata u bënë përfaqësues të një lëvizje revolucionare hebreje, ku kauza e tyre ishte një rebelim/luftë ndaj autoriteteve të Perandorisë Romake (një formë e hershme e luftës anti-koloniale, luftës për pavarësi).

Nisur nga veprimet që kryenin anëtarët e këtij sekti, nga platforma politike dhe fetare që ata zbatonin, ata njihen si një organizatë e mirëfilltë terroriste. Përsa i përket zbatimit të platformës fetare, veprimet e tyre lidheshin me imponimin nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të forcës dhe dhunës të praktikave fetare si dhe përdorimi i drejtpërdrejtë i dhunës ndaj atyre anëtarëve të komunitetit hebre, të cilët konsideroheshin

si tradhtarë të çështjes kombëtare për pavarësi. Ndërsa për sa i përket zbatimit të platformës politike, objektivi themelor i tyre ishte pavarësia nga Perandoria Romake. Duhet theksuar fakti që qëllimet e tyre fetare dhe objektivat e tyre politike ishin të pandara dhe të udhëhequra nga e njëjta strategji, ajo e përdorimit të dhunës në mënyrë sistematike. Gjithashtu mund të konsiderohen si një organizatë terroriste qoftë nga forma e organizimit dhe mënyrat që ato përdornin për të rritur numrin e mbështetësit e tyre dhe për të fituar popullaritet (nëpërmjet përdorimit të teknikave të rekrutimit dhe vendosmëria për të realizuar objektivat e mësipërme), qoftë edhe nga mjetet që ato përdornin (sulme mbi objekte të caktuara, vrasjet, vetëvrasjet për të mos rënë në duart e armikut me qëllim fitimin e popullaritetit nëpërmjet ndikimit psikologjik) si edhe nga qëllimet (fitimi dhe shtimi i pasurisë, përdorimi i shteresave në nevojë për realizimin e synimeve të tyre).

Një tjetër grup i cili ka operuar në lashtësi dhe ka shfaqur karakteristikat e një organizate terroriste njihet me emrin ‘asasinët’; ishte një sekt sekret islamik, që vepronin në Iran dhe Siri duke filluar nga shekulli i XI deri në shekullin XIII. Ata vrisnin figura politike të Abasitëve dhe Selxhukëve për të terrorizuar kundërshtarët e tyre (Chaliand & Blin, 2007: 61). Në ndryshim nga sekti i zelotëve, asasinët kishin kapacitete dhe burime njerëzore të kufizuara dhe kjo ndikonte në mos realizimin e një përballje në një fushëbetejë. Si pasojë e pa mundësisë për realizimin e një ballafaqimi të tillë, për të rritur influencën e tyre, për të shkaktuar një impakt të madh psikologjik, ky grupim përdorte taktika të tilla si krijimin e kushteve të favorshme për protesta me qëllim krijimin e një destabiliteti politik, vrasjen e liderëve të kundërshtarëve për të realizuar objektivat e tyre (karakteristike e kësaj organizate terroriste të mirëfilltë), të cila mund të

shpinin në një ndryshim të mundshëm të regjimit/situatës aktuale (Chaliand & Blin, 2007: 80).

Fjala ‘terrorizëm’ e ka prejardhjen nga *Mbretëria e Terrorit* e nxitur nga Maxmilien Robespierre në vitin 1773, pas Revolucionit Francez. Revolucion i francez është një moment i rëndësishëm historik që shërbeu për shfaqjen e një lloji tjetër terrorizmi, shumë i ndryshëm në karakteristika më format e mëparshme të veprimtarive terroriste. Përgjatë kësaj periudhe lindi termi ‘terrorizëm shtetëror’, që lidhet me përdorimin dhe legjitimimin e përdorimit të dhunës ekstreme nga shteti në mbrojtje të sovranitetit. Regjimi i terrorit apo i ashtuquajtur i "*regime de la terreur*", nënkuptonte një instrument revolucionar i cili synonte të konsolidonte fuqinë e një qeverie nëpërmjet ushtrimit të presionit ndaj kundërshtarëve të regjimit. Robert Robespierre ishte i mendimit se virtyti duhet të ishte thelbi i qeverisjes gjatë kohës së revolucionit. Terrori, sipas tij, nuk është gjë tjetër veçse drejtësi, i fuqishëm, jo fleksibël dhe para së gjithash një vlerë e virtytit (Ganor, 2005). Në ndryshim nga periudha e mëparshme (lashtësia), ky lloj i ri terrorizmi së pari nuk operonte mbi baza fetare por ideologjie dhe së dyti përbëhej nga grupe të marginalizuara (grupe të nënvlerësuara, pakicat etnike raciale dhe gjuhësore etj), të cilat herë pas herë bashkëpunonin dhe bëheshin pjesë e trendëve si anarkik, nihilist, populist, marksist, fashist, racist, etj. Gjatë kësaj periudhe duhet theksuar fakti që justifikoheshin të gjitha format e përdorimit të dhunës në emër të botëkuptimit të grupit ku ato bënin pjesë, mbi mënyrën se si e konceptonin ata botën.

Karakteristikë e akteve terroriste në këtë periudhë kanë qenë veprime në nivelin individual, kjo për shkak të pamundësisë së financimeve të mëdha, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikonte në mos realizimin e një strategjie terrori në nivel kombëtar apo

ndërkombëtar (mungesë uniteti si pasojë e qëllimeve dhe interesave të ndryshme). Megjithatë duhet të theksojmë se në periudhën e Revolucionit Francez terrorizmi shfaq karakteristika të ngjashme me formën moderne të terrorizmit. Kjo lidhet me faktin se regjimi i terrorit në atë periudhë nuk ishte rastësor; përkundrazi ishte i organizuar dhe sistematik, me objektiv ndryshimin dhe krijimin enjë shoqërie më të mirë.

Në fund të shekullit 19-të dhe fillimet e shekullit të 20-të terrorizmi u zhvillua në një kontekst gjeopolitik dhe gjeostrategjik shumë interesant. Në nivelin gjeopolitik, shekulli i 19-të u karakterizua nga zbehja graduale e rendit të bazuar në Paqen e Vestfalisë (1648) dhe nga përdorimi i politikave të balancës së fuqisë duke i lënë kështu radhën shfaqjes së epokës së nacionalizmit (shpërbërja e dy perandorive të mëdha, asaj Otomane dhe asaj Austro-Hungareze) dhe fillesat e Luftës së Parë Botërore. Përdorimi i dhunës u kthye në instrumentin kryesor për të ndryshuar *status-quo*n. Rritja e nacionalizmit dhe shfaqja e ideologjive të djathta krijuan kushtet e favorshme/përshtatshme për një formë të re të përdorimit të dhunës/terrorizmit. Në ndryshim nga epokat e mëparshme, ku në shumicën e rasteve në thelb të akteve terroriste ishte feja, në kontekstin e ri të shfaqur, në thelb të akteve terroriste qëndronte nacionalizmi (fillesa e terrorit nationalist). Një shembull i kësaj fryme të re është edhe vrasja e Arqidukës Ferdinand (preteksti i fillimit të Luftës së Parë Botërore), e cila njihet si një vepër e një organizate terroriste serbe (Bashkim a Vdekje apo e njohur si Dora e Zezë, e krijuar në 1911, me qëllim kryesor krijimin e Serbisë së Madhe) si pasojë e lëvizjeve/situatës së krijuar në Bosnje nën petkun e revolucionit nationalist Serb (Dauti, 2014).

Gjithashtu nën frymën e epokës nacionaliste mund të përmendim edhe krijimin e një organizate tjetër terroriste IRA (The Irish Republican Army) e përbërë nga qytetarë irlandezë dhe nga grupi i anëtarëve të Vëllazërisë Irlandeze. Kauza e kësaj lëvizje kishte në thelb qëllimin e çlirimit kombëtar/pavarësia e tyre. Konsiderohet si një organizatë terroriste për shkak të taktikave dhe aktiviteteve që ajo kryente (si vrasjet, sulmet e shpejta, lufta guerrilase, rrëmbimet, bombardimet, kontrabanda etj) si një kundërpërgjigje ndaj sundimit britanik në Irlandë (Ranstorp & Brun, 2013: 6).

Gjatë kësaj periudhe terrorizmi është përdorur si çelësi për të përmbushur strategjitë e shteteve për realizimin e objektivave dhe interesave të tyre kombëtarë, si dhe për realizimin e ambicies së popujve të nënshtruar nga perandoritë koloniale. Ndërsa në nivelin gjeostrategjik, shekulli i 19-të dhe fillimet e shek. të 20-të u karakterizuan nga revolucioni industrial dhe zhvillimi teknologjik, duke i dhënë në këtë mënyrë hapësira shumë të mëdha lëvizjeve terroriste. Burimi kryesor për arritjen e objektivave për veprimtaritë/aktet terroriste është ai njerëzor dhe psikologjik, teknologjia mbetet një burim/faktor dytësor, por pavarësisht kësaj ky kontekst i ri teknologjik i shfaqur ka shërbyer si një kontribuues efektiv për plotësimin e nevojave të terroristëve. Bëhet i domosdoshëm përdorimi dhe zotërimi i teknologjive të reja nga ana e tyre, me qëllim përballjen me nivelin teknologjik të autoriteteve qendrorë. Nisur nga filozofia e mbrojtjes nga kundërshtari duke përdorur të njëjtat mjete, epoka e industrializimit dhe e evoluimit teknologjik u ka shërbyer shumë organizatave/grupimeve terroriste për të sofistikuar veprimtaritë e tyre si dhe u'a ka vështirësuar identifikimin autoriteteve shtetërore.

Në shek. 20-të, format e terrorizmit shtetëror më së shumti i identifikojmë të instrumentalizuara tek Gjermania Naziste, Italia Fashiste dhe tek Bashkimi Sovjetik Stalinist, sepse në këtë rast pasqyrohet më së miri përdorimi i dhunës sistematike ekstreme të terrorit (vrasjet masive, spastrimet etnike, gjenocidet) të kryera nga aparati policor shtetëror. Përdorimi i këtyre formave të terrorizmit shtetëror vazhdoi edhe përgjatë Luftës së Ftohtë me diktatura ushtarake në Amerikën Latine, Afrikë, etj. ku vihet re përdorimi i metodave terroriste. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe në Lindjen e Mesme, Azi dhe Afrikë lindën lëvizje nacionaliste kundër ish-vendeve koloniale si Britania e Madhe, Franca.

Në vitet 1960 – 1970, përveç grupeve nacionaliste u formuan edhe grupe të motivuara etnikisht dhe ideologjikisht si:

- ETA , një organizatë separatiste baske e cila vepron në Spanjë. Qëllimi i kësaj organizatë është shkëputja nga Spanja dhe krijimi shtetit të pavarur bask. ETA ka tiparet e një organizate terroriste për shkak të formave të përdorimit dhe të legjitimitetit të dhunës (justifikimi i përdorimit të dhunës për realizimin e objektivit madhor), teknikave (vrasja e zyrtarëve të lartë të qeverisë si një kundërpërgjigje) si dhe të strategjive që ajo përdor për rekrutime dhe rritjen e popullaritetit të saj. (Barros et.al, 2006: 2-4).
- PLO, një organizatë për çlirimin e Palestinës, e krijuar në vitin 1964, me qëllimin kryesor pavarësinë e shtetit të Palestinës me Jerusalemin Lindor si Kryeqytet nëpërmjet luftës së armatosur. Konsiderohet si një organizatë terroriste, sepse e

bazon aktivitetin e saj në përdorimin e dhunës dhe terrorit si dhe përdor të njëjtat mjete dhe teknika të veprimtarive terroriste¹.

- FARC, një organizatë e Forcave të Armatosura Revolucionare të Kolumbisë, e krijuar në vitin 1964, e përbërë nga anëtarë me ideologji marksiste-leniniste të cilët ishin anti-imperializmit. Njihet si një organizatë terroriste që kryen aktivitete (vrasje, rrëmbime, grabitje) të cilat bazohen në përdorimin e dhunës. Gjithashtu njihet si organizata më e madhe në botë e trafikimit të drogës. Duhet theksuar fakti që në ditët e sotme pavarësisht se kjo organizatë nuk kryen aktivitete të dhunshme si më parë, ajo vazhdon të mbetet një kërcënim real për sigurinë kombëtare të Kolumbisë. (Tayectoria de las Farc 1949-2013: 2014).
- NAXAL, një organizatë e krijuar në vitin 1967 në një fshat të vogël (Naxalbari) në pjesën perëndimore të Benga-it, anëtarët e të cilës ishin të lidhur ngushtë me Partinë Komuniste të Indisë (Maoiste). Konsiderohet si një organizatë terroriste sepse përdor teknikat si vrasjet e njerëzve të fuqishëm me qëllimin kryesor nxitjen e një lufte civile si dhe i kryen aktivitetet e saj duke u bazuar tek instrumentet e përdorimit të dhunës dhe terrorit. (Kujur: 2008:)
- Brigada e Kuqe në Itali, një organizatë e krijuar në vitin 1970 me qëllimin kryesor përmbysjen e shtetit italian kapitalist-demokratik dhe zëvendësimin e tij me diktaturën e proletariatit, nëpërmjet formës të një lufte të armatosur. Gjithashtu, konsiderohet një organizatë me tipare terroriste, si pasojë e përdorimit të akteve të dhunshme (rrëmbime, vrasje, sabotime etj) me qëllim de stabilitetin e Italisë si dhe për nga mënyra e operimit. (Sundquist, 2010: 55) .

¹ Shiko për më shumë Kenneth Katzman, (2002). "The PLO and Its Factions"
<http://www.au.af.mil/au/awc/awcgate/crs/rs21235.pdf>

Një shtim të dukshëm morën aktet terroriste në Lindjen e Mesme pas Luftës së Dytë Botërore. Aktet terroriste në këtë rajon, përveç karakteristikave të përgjithshme, të ngjashme me ato në rajone të tjera të botës mbartin edhe veçori specifike. Frymëzimi e motivimi i tyre buron nga faktorë të brendshëm si dhe nga faktorë të jashtëm. Rrënjët e tyre duket se kanë fillesat në frymëzim fetar dhe dalëngadalë ato kapërcejnë në kërkesa politike me ndjenjë të theksuar anti-amerikanizmi. Analiza e akteve terroriste në rajonin e Lindjes së Mesme (të cilat shpesh herë kanë qenë të sponsorizuara nga vetë aktorët shtete), reflekton nevojën e shpjegimit jo vetëm me situatën por edhe me interesat strategjike në rajon (Mingst, 2008: .172). Operimi i këtyre organizatave terroriste (por edhe i disa të tjerave) gjatë këtyre viteve çoi në domosdoshmërinë e studimeve dhe analizave më të thelluara ndaj këtij fenomeni, sepse ato po ktheheshin në kërcënime reale jo vetëm për sigurinë kombëtare të shteteve ku ata vepronin, por edhe për sigurinë globale e cila u trondit me sulmin e 11 Shtatorit të vitit 2001 të kryer nga organizata terroriste Al- Kaeda, e cila do të trajtohet specifikisht në vijim të punimit, sepse konsiderohet si forma e cila ndikoi në transformimin e konceptin të sigurisë dhe u konsideruar si kërcënim më madhor i sigurisë kombëtare/ndërkombëtare.

4.2. Tipologjitë e terrorizmit

Historia e gjatë e fenomenit/dukurisë së terrorizmit, prezente në shumë pjesë të botës, ka pasqyruar motive të ndryshme. Përsa i përket ndarjes tipologjike të këtij fenomeni duhet të kemi të qartë dallimet ndërmjet terrorizmit shtetëror, separatist, revolucionar, fetar, të brendshëm dhe atij ndërkombëtar. Qëllimi i analizës së tipologjisë lidhet jo thjesht me njohjen, por me mundësinë e parashikimit të natyrës së terrorizmit që ndeshet

aktualisht si dhe që mund të zhvillohet në një të ardhme jo të largët. Në vendet perëndimore institucione të njohura i kushtojnë një vëmendje të veçantë natyrës/tipologjisë së fenomenit. Për këtë arsye, punimi do të bazohet jo vetëm në analizat e tyre por edhe në metodologjinë e përdorur nga ta, për ta aplikuar në rastin tonë studimor.

Në vijim do të zhvillohet një analizë e tipologjive më të njohura të terrorizmit.

- ***Terrorizmi shtetëror:*** Përdorimi sistematik i mjeteve të dhunës nga qeveria e një shteti, me qëllim të kontrollit absolut mbi popullatën e tij. Pra, është një formë e përdorur për mbajtjen e kontrollin absolut të pushtetit. Ky lloj terrorizmi arriti kulmin e tij me Gjermaninë naziste, Italinë fashiste si ekstreme të djathta dhe në Bashkimin Sovjetik në udhëheqjen e Joseph Stalin në ekstremin e majtë.
- ***Terrorizmi separatist:*** Përdorimi i mjeteve të dhunës deri edhe në një konflikt të armatosur nga grupime të cilat duan të krijojnë një fragmentarizim brenda një shteti të caktuar, me qëllim krijimin e shtetit të tyre, ose bashkimin me një komb ekzistues, me të cilin ata mendojnë se kanë të njëjtat karakteristika të përbashkëta (pra shkëputje/pavarësi). Ky lloj terrorizmi është tipike për pakicat kombëtare të një shteti. Duhet theksuar fakti që shpeshherë këto lloj grupimesh i quajnë edhe grupe terroriste etno-nacionaliste separatiste për shkak të mjeteve, teknikave dhe qëllimet e njëjta që ata kanë. Kjo tipologji terrorizmi është identifikuar kryesisht në Irlandën e Veriut, në Greqi dhe në Spanjë, nëpërmjet formacioneve të IRA-s, MAVI-t, dhe ETA-s (Bale, The Monterey Terrorism Research and Education Program).

- ***Terrorizmi revolucionar*** : Përdorimi i dhunës nga grupime të cilat kanë si objektiv të tyre përmbysjen e një rendi të caktuar (atë aktual) dhe zëvendësimin e tyre me një strukturë tjetër politike. Ky lloj terrorizmi ka qenë më shumë i lidhur me ideologjitë politike komuniste. Mund të përmendim këtu organizatën NAXAL, ku anëtarët e saj ishin të lidhura me partinë komuniste (Maoiste) (Rapoport, 1977: 1853-56).
- ***Terrorizmi fetar***: Përdorimi i praktikave të dhunës nga grupe të caktuara, me qëllim rezistencë dhe luftë ndaj atyre që janë armiq të Zotit si dhe vendosja dhe ndjekja në shoqëri e parimeve dhe ligjeve të praktikave fetare. Ky lloj terrorizmi i bazuar tek bindjet fetare është identifikuar kryesisht në mesin e viteve '70 me lëvizjet integraliste në Lindjen e Mesme, si Xhihadi Islamik, Hamasi, Hesbullahu dhe Al Kaeda (Bale, The Monterey Terrorism Research and Education Program).
- ***Terrorizmi i brendshëm***: Përdorimi i instrumenteve të dhunës ndaj popullsisë civile dhe përdorimi i taktikave si shkatërrimi infrastrukturor i një shteti nga grupe që operojnë brenda kufijve të tij, me synimin e shkaktimit të frikës dhe terrorit, si një formë për të ndikuar në politikën kombëtare.
- ***Terrorizmi ndërkombëtar***: Operimi i grupeve terroriste edhe përtej kufijve të shtetit ku ata janë krijuar, kjo ka ardhur si rezultat i evoluimit dhe përmirësimit të strukturave të tyre. Ky lloj terrorizmi i përdorur ka si synim shtimin e rrjeteve dhe celulave në shumë vende të tjera përtej kufirit nacional, në mënyrë që të fuqizojnë pozitat e tyre për të realizuar synimet (kauzat) e tyre në vendet ku ata janë krijuar (Stepanova, 2008: 5-9).

Gjithnjë e më shumë është bërë e vështirë dhe shumë e paqartë përkufizimi ndërmjet terrorizmit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar, si pasojë e faktit që terrorizmi ndërkombëtar është një aktivitet i cili kryhet/vepron në territoret e më shumë se një shteti dhe përfshin qytetarët e më shumë se një shteti. Sipas Kodit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës terrorizmi i brendshëm dhe ai ndërkombëtar janë të përkufizuara në këtë mënyrë:

- ***Terrorizmi i brendshëm*** nënkupton të gjitha aktivitetet që përmbajnë këto karakteristika: përfshijnë akte të rrezikshme kundrejt jetës njerëzore, që shkelin ligjet shtetërore apo federale. Të gjitha aktet të cilat kanë për synim: (i) të frikësojnë apo të krijojnë presion tek popullsia civile; (ii) të ndikojnë te politikat e qeverisë duke ndjell frikë dhe presion ose (iii) të ndikojnë qeverisjen e një vendi me shkatërrim në masë, vrasje apo rrëmbime. Ndodhin kryesisht brenda juridiksionit territorial të SHBA-ve.
- ***Terrorizmi Ndërkombëtar*** nënkupton të gjitha aktivitetet që përmbajnë këto karakteristika: përfshijnë akte të rrezikshme kundrejt jetës njerëzore, që shkelin ligjet shtetërore apo federale. Të gjitha aktet të cilat kanë për synim: (i) të frikësojnë apo të krijojnë presion tek popullsia civile; (ii) të ndikojnë te politikat e qeverisë duke ndjell frikë dhe presion ose (iii) të ndikojnë qeverisjen e një vendi me shkatërrim në masë, vrasje apo rrëmbime. Ndodhin kryesisht jashtë juridiksionit territorial të SHBA-ve, ose kapërcejnë kufijtë kombëtarë në aspektin e mjeteve me të përdorura (Federal Bureau of Investigation, 2014)².

² Për më shumë shiko: Definitions of Terrorism in the U.S. Code. Retrieved September 1, 2014: <https://www.fbi.gov/about-us/investigate/terrorism/terrorism-definition>.

Pra, si përfundim, përse i përket tipologjive të terrorizmit ato mund ti përmbledhim sipas origjinës, konflikt nacional-etnik, politiko-ideologjik dhe konflikt fetar. Ndërsa përse i përket burimeve, kemi terrorizëm me burim të brendshëm i cili mund të jetë i origjinave të ndryshme, por ai është i nxitur, i mbështetur dhe i organizuar nga elementë të brendshëm; kemi terrorizëm me burim nga jashtë i cili mund të kryhet nga elementë të brendshëm, por me mbështetje dhe drejtim nga jashtë.

4.2.1 Struktura e organizimit të organizatave terroriste

Format dhe modelet e organizimit të grupeve terroriste janë të shumëllojshme, por më të njohura dhe të përhapura gjerësisht janë strukturat hierarkike; struktura në rrjete (network) si dhe kombinimi i të dytë parave (hierarkike-rrjet). Megjithatë, dinamikat e brendshme të këtyre grupeve, rrethanat specifike të mjedisit dhe kohës në të cilat ato veprojnë e vështirësojnë arritjen e një përcaktimi të përgjithshëm dhe përfundimtar mbi strukturën e tyre të organizimit. Dinamikat e brendshme mund të jenë: bashkimi i organizatave të vogla më grupe më të mëdha, apo edhe e anasjelltas, ndërsa në mjedise dhe në periudha të ndryshme fuqia dhe veprimtaria e tyre mund të jetë e ndryshme (mund të kenë më shumë kapacitete, mjete dhe prioritetet dhe në disa periudha më pak). Forma më e përhapur e organizimit është ajo tradicionalja, e përbërë nga një udhëheqës/lider, i cili vendos qëllimet dhe objektivat e organizatës dhe nga anëtarët, ku secili prej tyre ka detyra të posaçme në realizimin e objektivave si menaxhimi i mjeteve të komunikimit, çështjet e logjistikës, rekrutimit, trajnimit, propagandës etj. Në nivel taktik, organizata si rregull është e ndërtuar në celula që përbëhen nga 3-10 anëtarë, çka siguron një nivel të lartë sigurie. Karakteristikë e celulës është se në shumicën e rasteve

anëtarët e saj kanë marrëdhënie familjare, me qëllimin kjo ruajtjen e fshehtësisë (US Army Tradoc/Handbook 2007: 3-5).

Përsa i përket modelit hierarkik, rrjetit apo kombinimit të të dyjave, mund të themi se zbatues të modelit hierarkik konsiderohen të gjitha grupet që kanë një lidhje vertikale (dhënia e komandës, kontrolli dhe përgjegjësia). Ata të cilët preferojnë këtë model, janë grupet/organizatat që kanë si qëllim kryesor kontrollin absolut dhe legjitimimin e përdorimit të dhunës nëpërmjet veprimit politik (US Army Tradoc/Handbook 2007: 6). Ndërsa grupet moderne gjithnjë e më shumë kanë tendencën për t'u organizuar sipas strukturës së rrjetit, për shkak të qëllimeve të përbashkëta, gjithashtu nëpërmjet organizimit në rrjete ato kanë më shumë efekshmëri qoftë në impakt, por edhe në forcimin e pozitave të tyre. Mund të përmendim këtu si shembull rrjetet zinxhir, të cilat merren zakonisht me kontrabandimin e mallrave, njerëzve apo pastrimin e parave. Ndërsa përsa i përket kombinimit të të dy modeleve, atë mund ta shikojmë të integruar tek organizata terroriste Al-Kaeda, e cila vazhdon të ruajë strukturën hierarkike, por përdor dhe organizimin në formën e rrjetit për t' i u përshtatur kontekstit të sotëm dhe për të forcuar në të njëjtën kohë pozitën dhe fuqinë e saj. (US Army Tradoc/Handbook 2007: 7-8).

4.3. Forma e terrorizmit në dhe pas sulmit të 11 Shtatorit 2001

Sulmi i 11 shtatorit i kryer nga organizata terroriste Al- Kaeda kundër SHBA-ve demonstroi evoluimin, efikasitetin dhe nivelin e impaktit më të madh të veprimtarive terroriste në historinë e njerëzimit. Kjo formë e re terrorizmi e shfaqur ishte e përmasave ndërkombëtare, e ndryshëm nga ai i mëparshmi i shfaqur kryesisht si një dukuri e cila

operonte brenda shteteve, brenda një rajoni, shoqërive apo komuniteteve të caktuara. Al Kaeda, e udhëhequr nga Osama bin Laden, është një rrjet fundamentalistësh islamikë nga shumë vende, ndër të cilat përfshihen edhe vende jashtë Lindjes së Mesme. Ajo motivohet nga dëshira për të instaluar regjime islamike në Lindjen e Mesme dhe përpiket gjithashtu të ndëshkojë Shtetet e Bashkuara për mbështetjen e tyre ndaj Izraelit dhe për lidhjet e tyre të ngushta me regjimet e korruptuara të Lindjes së Mesme.

Duhet theksuar fakti që ky transformim erdhi si rezultat i një konteksti të ri në sistemin ndërkombëtar, globalizmit. Organizata terroriste Al-Kaeda për të kryer këtë sulm mbi shtetin më të fuqishëm të botës nuk pati nevojë për ndërmjetësimin e ndonjë shteti, sepse ata shfrytëzuan të gjitha mundësitë dhe lehtësirat që vinin si rezultat kontekstit të ri të shfaqur. Ngjarjet e 11-Shtatorit ndikuan në ndryshimin e axhendës politike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke aplikuar konceptin e procesit të sigurizimit. Kjo çështje u bë pjesë e një debati publik të gjerë, u identifikua si një çështje e cila përbënte një kërcënim ekzistencial për sigurinë kombëtare dhe gjithashtu u përdor si ligjërime nga elita politike e asaj kohe, me qëllim bindjen e audiencës për marrjen e masave të menjëhershme. Ligjërimi i përdorur përveç të tjerash theksonte domosdoshmërinë e bashkëpunimit ndërkombëtar. Ndjekja e këtyre dy etapave (identifikimi i rrezikshmërisë dhe bindja e audiencës) çoi në riformulimin e interesave/objektivave amerikane, duke vendosur në plan të parë të hierarkisë së prioriteteve të politikës së tyre të sigurisë kombëtare luftën kundër terrorizmit (u njoh si një luftë asimetrike), e cila u pasua me hartimin e strategjisë kombëtare kundër terrorizmit.

Kjo strategji u mbështet në katër qëllime kryesore, të cilat njihen ndryshe edhe si 4D (Defeat-Deny-Diminish-Defend);

1. Qëllimi i parë lidhej me angazhimin për mposhtjen e terroristëve dhe organizatave të tyre, duke përdorur të gjithë elementet e fuqisë kombëtare (fuqinë ekonomike-politike-teknologjike-diplomatike-ushtarake). Objektivat që u vendosën për të realizuar këtë qëllim lidheshin me identifikimin e anëtarëve dhe liderëve të grupeve/organizatave terroriste, lokalizimin e vendodhjes së tyre, e më pas shkatërrimi i rrjeteve të komunikimit dhe burimeve financiare, me qëllim dobësimin e strukturave të tyre.
2. Qëllimi i dytë lidhej me mohimin/pengimin e marrjes së sponsorizimeve nga shtete të caktuara. Objektivat për të realizuar këtë qëllim lidheshin me kërkesat për bashkëpunim ndërkombëtar dhe përgjegjësi maksimale nga shtetet ku ata operojnë për ti luftuar, tolerancë zero për shtetet të cilat sponsorizojnë këto organizata, forcimi i kërkesave mbi transparencën dhe standardet e llogaridhënies. Në listën e këtyre shteteve bënin pjesë: Irani, Iraku, Siria, Libia, Kuba, Sudani, dhe Koreja e Veriut.
3. Qëllimi i tretë i përcaktuar në strategjinë kombëtare për luftën kundër terrorizmit lidhej me zvogëlimin e hapësirave dhe kushteve që mund të shfrytëzohen nga këto organizata, si p.sh. vendet në krizë apo shtetet e dobëta, të cilave ju mungojnë atributet kryesore të një shteti. Për të realizuar këtë qëllim u vendos si objektiv partneriteti ndërkombëtar me shtete e dobëta.
4. Dhe se fundi qëllimi i katërt lidhej me mbrojtjen e interesave kombëtare, qytetarëve amerikanë, por edhe qytetarët jashtë Amerikës.

Objektivat për të realizuar këtë qëllim ishin: Ndërgjegjësimi kombëtar dhe ndërkombëtarë për nivelin e lartë të rrezikshmërisë së këtij kërcënimi, si dhe implementimi i menjëhershëm i kësaj strategjie në funksion të Sigurisë Kombëtare (National Strategy for Combating Terrorism, 2003). Masa e parë e marrë nga qeveria amerikane për të realizuar objektivin e luftës kundër terrorizmit ishte pushtimi i Afganistanit, eliminimi i menjëhershëm i rrjetit më të madh terrorist, Al Kaeda-n me në krye liderin e saj Osama bin Laden. Sulmi mbi Afganistanin nisi më 7 tetor 2001 dhe regjimi i talebanëve u shemb me 9 nëntor të po atij viti, me rënien e Mazar-e Sherifit, një qytet strategjik në veri të vendit. Menjëherë pas kësaj u pushtuan qytetet e Heratit, Kabulit dhe Xhelalabadit, ndërsa pjesa tjetër e talebanëve të mbetur, u dorëzuan (Stoessinger, 2007: 307).

Ndonëse Amerika arriti që të pushtonte brenda një kohë shumë të shkurtër Afganistanin, ajo nuk arriti dot që të realizonte objektivin e saj të dytë, atë të kapjes së organizatorit kryesor të 11 shtatorin, Osama bin Laden. Megjithatë lidërsipi politik amerikan ishte i vendosur në vazhdimin e luftës kundër terrorizmit, sepse ky fenomen i zhvilluar në këtë kontekst të ri nuk ishte një sfidë vetëm për sigurinë kombëtare amerikane, por shikohej nga ata edhe si një kërcënim i sigurisë globale. Rruga e vetme e sigurisë, duhet të ishte vetëm veprimi dhe parandalimi i saj. Ndërsa masa e dytë lidhej me pushtimin e Irakut, sepse ai posedonte armë të shkatërrimit në masë, ishte një shtet me regjim diktatorial dhe një vend destinacion i mundshëm për strehimin e liderit dhe terroristëve të Al-Kaedës. “Diktaturat e rrezikshme për Amerikën duheshin shndërruar në demokraci me forcën e armëve, nëse kjo ishte e domosdoshme” (Stoessinger, 2007:

308). Në këto kushte të kërcënimit të sigurisë ndërkombëtare, implementimi i menjëhershëm i doktrinës së re të luftës parandaluese bëhej i domosdoshëm.

Duhet të nënvizojmë faktin që ndërhyrja e Amerikës nuk u mbështet fuqishëm siç ndodhi me rastin e pushtimit të Afganistanit. Mund të jenë të shumta arsyet si p.sh., ligjërimi i përdorur dhe arsyet e ndërhyrjes nuk rezultuan shumë bindëse (nuk u arrit sigurizimi i plotë i çështjes), duke i shkaktuar në këtë mënyrë Amerikës më shumë kosto se sa përfitime. Një faktor tjetër i rëndësishëm muund të jetë reagimi i qeverive kryesore europiane dhe opinionit publik european ndaj qasjes amerikane kundër Irakut. Europa hezitoi ta trajtonte Irakun si një çështje të izoluar dhe u përpoq me veprimet e saj ta trajtonte brenda një konteksti të gjerë të marrëdhënieve transatlantike, sepse opinioni publik european ishte kundër luftës. Duhet të përmendim një faktor të rëndësishëm, i cili ndikoi në një lëkundje të opinionit publik dhe shteteve europiane, e cila lidhej me vendosjen e një bombe terroriste në Madrid në vitin 2004, e cila pas analizave rezultoi se kishte qenë e organizuar nga Al-Kaeda. Kjo ngjarje shërbeu për hartimin e një strategjie të BE-së në luftën kundër terrorizmit, sepse ai u konsiderua si kërcënim më i madh për sigurinë jo vetëm të BE, por për të gjitha shtetet e sistemit ndërkombëtar, kërcënim për vlerat dhe parimet demokratike.

Kjo strategji synonte 4 qëllime kryesore:

1. Qëllimi i parë lidhej me parandalimin e rekrutimeve të qytetarëve të BE nga organizatat terroriste. U vendosën disa objektiva për të realizuar këtë qëllim si identifikimi i njerëzve të përfshirë në këto organizata, identifikimi i metodave, mjeteve propagandistike dhe kushteve sociale që i detyronin

njerëzit të bëheshin pjesë e këtyre grupacioneve, zhvillimi i kapaciteteve për t'i u kundërpërgjigjur.

2. Qëllimi i dytë ishte mbrojtja e atyre që mund të jenë objektiv i sulmeve të mundshme të këtyre organizatave. Si objektiv për realizimin e saj u konsiderua shtimi i masave të sigurisë brenda hapësirës së BE (kontroll i rreptë, pasaportat biometrike, siguri më e madhe në aeroporte dhe në vende publike etj).
3. Qëllimi i tretë i vendosur nga kjo strategji lidhej me shkatërrimin e aktiviteteve dhe rrjeteve terroriste me objektiv kryesor atë të rritjes së kapaciteteve kombëtare të shteteve anëtare për të rezultuar të suksesshme.
4. Qëllimi i katërt i kësaj strategji ishte përgjigjja ndaj organizatave terroriste që kërcënonin sigurinë. Objektivat për të realizuar këtë ishin përgjegjësia e çdo shteti për t'iu përgjigjur çdo sulmi terrorist që ndodh brenda territorit të tij dhe marrja e gjitha masave të nevojshme nga ata për përballimin e situata të mundshme.

Kjo strategji theksonte përgjegjësinë themelore/kryesore që kanë shtetet anëtare për luftën ndaj terrorizmit, e për të patur efekshmërinë e duhur ato duhet të ndajnë ndërmjet tyre praktikat më të mira, eksperiencat e tyre në zhvillimin e kapaciteteve kombëtare, duhet të bashkëpunojnë për shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre dhe me institucionet përkatëse të ngarkuara me detyrat specifike, duhet të promovojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në një luftë të përbashkët, si dhe duhet të kontribuojnë me asistencë për zhvillimin e vendeve të treta (The European Union Counter-Terrorism Strategy 2005).

Pra, në këto kushte të rritjes së incidenteve të tilla brenda kontinentit europian, behej i domosdoshëm bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet Europës-Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe qeverive të Lindjes së Mesme për të parandaluar pasiguritë që vinin nga veprimtaritë terroriste. Mirëpo edhe në këtë situatë, shanset për një bashkëpunim të efektshëm rezultuan të diskutueshme sepse idetë, qëllimet, interesat e dy aktorëve shumë të rëndësishëm (BE-SHBA) ishin të ndryshme përsa i përket të njëjtës çështje. SHBA-ja e konsideronte rajonin e Lindjes së Mesme si një faktor shumë të rëndësishëm për destabilitetin ndërkombëtar (ato duhet të demokratizohen, sepse përbejnë kërcënim në rast të kundërt), ndërsa aktori tjetër i rëndësishëm BE-ja ishte tregu kryesor për eksportet nga Lindja e Mesme, gjithashtu me një varësi nga furnizimet energjetike të Afrikës së Veriut dhe Gjirit Persik. Interesat e ndryshme ndikojnë drejtpërsëdrejti në mos efikasitetin e bashkëpunimit ndërkombëtar në mbrojtje të përbashkët kundër kërcënimeve reale të cilat vënë në pikëpyetje dhe rrezikojnë sigurinë globale.

Lufta kundër terrorizmit të përmasave ndërkombëtare të shfaqur në 11 Shtator2001 tregoi se nuk mund të ishte një zgjidhje përfundimtare e politikave të sigurisë kombëtare të një shteti të vetëm. Për të rezultuar fitues ndaj kësaj lufte, ajo duhet të kuptohet dhe pranohet si kërcënim i përbashkët jo vetëm i shkruar në dokumente strategjik, por i zbatuar ashtu siç duhet. Bashkëpunimi ndërkombëtar ndaj luftës kundër terrorizmit duhet të përbëjë prioritetin themelor të politikave të sigurisë së shteteve, sepse veprimtaritë terroriste prodhojnë nivelin më të lartë të pasigurisë. Këtë e demonstroi akoma edhe më shumë sulmi terrorist në Janar 2015 në Paris 'ndaj "Charlie Hebdo". Impakti i këtij sulmi ishte shumë i madh, ai shkaktoi ndjenjën e frikës dhe pasigurisë jo vetëm të opinionit publik në mbarë botën, por edhe te qeveritë e shteteve.

Sulmet dhe aktet terroriste të kohëve të fundit të shkaktuara nga organizatat ndërkombëtare terroriste si Al-Kaeda (në Lindjen e Mesme dhe në Afrikën e Veriut) dhe ISIS (shteti islamik i përhapur në Siri, Irak, Liban, Libi, Nigeri), konsiderohen si kërcënimi/rreziku më i madh për sigurinë e Europës dhe Amerikës, por edhe për sigurinë globale në tërësi. Për sa i përket organizatën terroriste ISIS, në vijim të punimin do ta analizojmë më gjerësisht, jo vetëm se është pjesë e aktualitetit të sotëm, por edhe sepse mënyra e organizimit dhe operimit të saj është një formë e re tjetër terrorizmi të shfaqur, ku ka karakteristikat e ndërthurjes së krimit të organizuar dhe elementëve të terrorizmit.

4.4. Një vështrim historik i evoluimit të krimit të organizuar

Termi krim i organizuar është përdorur për herë të parë në vitin 1896 në raportin vjetor të Shoqatës për Parandalimin e Krimit, në Nju- Jork. Sipas këtij raporti, ky term përdorej për “veprimet e prostitucionit dhe të bixhozit, të mbrojtura nga zyrat publike” (Fijnuat & Paoli, 2004: 23). Në atë kohë konsideroheshin si krim i organizuar të gjitha bizneset ilegale, në të cilat përfshiheshin politikanë, oficerë policie, juristë, etj. Mbi krimin e organizuar ka një shumëllojshmëri përkufizimesh, por sipas institucioneve ndërkombëtare përkufizimet mbi të janë:

- Sipas Këshillit të Europës me krim të organizuar kuptojmë: *“Veprimtari të fshehta të bëra nga grupe të organizuar prej më shumë se tre apo më shumë personash, për një kohë të gjatë me synimin e kryerjes së krimeve të rënda nëpërmjet veprimit të përbashkët dhe duke përdorur frikësimin, dhunën, korrupsionin ose mjete të tjera për të siguruar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të*

tërthortë një përfitim financiar ose të një lloji tjetër material” (Concil of Europe:

6):

- Sipas organizatës së specializuar për luftën kundër krimit të organizuar, Interpol me krim të organizuar kuptojmë *“Grupe që kanë një strukturë të përbashkët dhe të përbërë, objektivi parësor i të cilit është të sigurojë të ardhura nëpërmjet veprimtarive të fshehta, shpesh me anë të frikës dhe korrupsionit”* (Nesbitt, 1993: 319):
- Sipas, Organizatës së Kombeve të Bashkuara, krimi i organizuar i referohet: *“Veprimtari kriminale me përmasa të mëdha e kryer nga grupe personash, të mirë organizuar apo pak të organizuar, për pasurimin e anëtarëve në dëm të komunitetit dhe qytetarëve. Në shumë raste realizohet nëpërmjet shkeljes flagrante të ligjit, përfshirë krime kundër personit dhe shpesh në bashkëpunim me korrupsion politik”* (United Nations, 1975: 8).

Krimi i organizuar është një dukuri e cila paraqet një trajektore të ndryshme për vendet e botës, për disa vende ai është një fenomen i njohur shumë herët, ndërsa për pjesën tjetër njohja më të është relativisht e re. Sipas shumë studiuesve, kanabisi është njohur prej njerëzimit që në kohët e hershme, ndërsa në Europën Perëndimore, kjo lloj droge është shfaqur në shekullin e XVI-të. Mendohet se kanë ekzistuar grupe kriminale gjatë Perandorisë Osmane dhe që pas shekullit të XVI-të këto banda janë bërë aktive në qytetin e Stambollit (Yucel and Frank, 210). Në shekullin e XVII-të, Moska është konsideruar si qendra e shoqërisë kriminale ruse. Kriminaliteti profesional rus, ka filluar të konsolidohet në vitin 1740 (Yakov, 184). Krimi i organizuar prej shumë dekadash ka krijuar struktura të njohura ndërkombëtarisht si: Organizatën ‘Cosa Nostra’ (org.

Italiano-amerikane), 'Kamorra' (napolitane), 'Banda Irlandeze', 'Yakuza' (japoneze), 'Triadat' (kineze), kartelet kolumbiane dhe meksikane të drogës, 'Mafia' (ruse) etj.

Organizatat kriminale mund ti klasifikojmë si:

- organizata kriminale tradicionale të njohura ndërkombëtarisht, si struktura e Pesë të mëdhenjve (Mafia siciliane dhe italo-amerikane, Mafia ruse, Yakuza japoneze, Triada kineze);
- organizata kriminale më të vogla që karakterizohen nga mirëorganizimi i tyre, të cilat punojnë në funksion të Pesë të mëdhenjve (organizatat kriminale të Nigerisë, Panamasë, Porto Rikos, Xhamajkës, Republikës Dominikane, Kolumbisë, Turqisë, Afrikës Veriore etj. (Bashkurti, 2008: 197).

Një faktor shumë i rëndësishëm i cili ka kontribuar në krijimin e kushteve të përshtatshme për operimin e grupeve kriminale ka qenë dhe lufta, pavarësisht se ky fenomen ka ekzistuar gjithmonë. "Gjendja anarkike, në të cilën ndodhen shtetet, krijon domosdoshmërinë e luftës, si forma më efektive për ekzistencën apo mbijetesën e tyre" (Holsti, 2008: 8). Për disa të tjerë, origjina e luftës gjendet në thellësinë e 'psikikës njerëzore'. Në ditët e sotme shtetet e reja dhe të dobëta janë vendodhja kryesore e luftërave të sotme dhe të së ardhmes. Pavarësisht shkaqeve të fillimit dhe të vazhimit, "lufta në vetvete përbën një çorganizim social, i cili ndikon në rritjen e strukturës së kriminalitetit" (Hysi, 2005: 219).

Gjithashtu, luftërat ndikojnë në dobësimin e ekonomisë së një vendit, kjo për faktin se shtetet në luftë, ndryshojnë orientimin e ekonomisë duke e fokusuar atë drejt industrisë ushtarake dhe asaj të mbrojtjes. Në kohë lufte, shumica e krimeve kryhet për shkak të rrethanave dhe gjendjes së shkaktuar. Gjatë periudhës së zhvillimit të luftës,

krijohen kushtet e favorshme për forma të tjera të krimit si rrëmbimet e personave, abuzimet seksuale, krime kundër njerëzimit etj. Kaosi i shkaktuar nga lufta sjell mosfunksionimin e plotë të shtetit dhe të institucioneve të tij, duke i hapur rrugë në këtë mënyrë operimit të veprimtarive të organizuara kriminale. Këto grupe shfrytëzojnë gjendjen e kaosit të krijuar nga lufta me qëllim krijimin e bazave, për fuqizimin e tyre nëpërmjet arritjeve të përfitimeve, aktivitet të cilën e vazhdojnë edhe pas përfundimit të luftës. Në këto kushte krimi gjen hapësirat e duhura boshe për të depërtuar dhe për të kryer veprimtaritë e saj si dhe kthehet në një kërcënim për sigurinë e shteteve pas përfundimit të luftës. Gjithashtu, grupet kriminale shfrytëzojnë edhe situatat e krizave të ndryshme ndërkombëtare, rajonale për të fuqizuar pozitat e tyre.

Vihet re një evoluim i krimi i organizuar në ditët e sotme, këto veprimtari shfaqin zhvillime të mëdha në mënyrën e organizimit, e cila vërehet qartë në trafikimin në përmasa të mëdha të llojeve të ndryshme të drogave, në përdorimin e nivelit të lartë të dhunës si dhe në rritjen e ndikimit në pasigurinë e shteteve të sistemit ndërkombëtar. Krimi i organizuar ka njohur rritje të përmasave të mëdha në të gjitha rajonet e botës. Ndër to mund të përmendim Afrikën e cili po përballet gjithnjë e më shumë me operimin e krimin e organizuar, ku vendet e Afrikës së Veriut, si Egjipt, Marok, Algjeri etj., përveç trafikimit të kanabisit drejt Lindjes së Largët, Europës dhe SHBA-së, kanë filluar edhe kultivimin e drogave. Në të njëjtat pozita gjendet edhe Azia ku niveli i pasigurisë së qytetarëve sa vjen e rritet. Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe pjesën lindore të Azisë, kryesisht vende të tilla si Kina, Hong-Kongu apo Tajvanin gjithnjë e më shumë po dallohen për prodhime droge, trafikim, prostitucion etj.

Ndërsa përsa i përket Kontinentin European mund të themi që për një kohë shumë të gjatë krimi i organizuar në Europën Perëndimore është tipizuar nga mafia italiane si dhe nga grupet kriminale të vendeve si Franca apo Gjermania. Vihet re një rritje e nivelit të operimit të krimit të organizuar në Europë pas viteve 90-të. Vendet e shumta ish - komuniste u përballen me grupe kriminale, të cilat kryenin aktivitete të tilla si, trafikimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual, emigrimi ilegal, trafikimi i armëve etj. Një formë tjetër e rëndësishme e krimit të organizuar në Europë është edhe krimi kibernetik. Interneti po përdoret si një mjet për realizimin e veprimtarive të tilla si trafikimi i drogave të ndryshme apo edhe kërcënimet. Ndër format më të përhapura të krimit kibernetik, mund të jenë, "virusimi, futja në sistemet kompjuterike pa autorizim, vjedhje e financave në llogaritë bankare kur personat kryejnë veprime me bankën nëpërmjet internetit, prodhime ilegale të disqeve të software-ve etj" (Wall, 2002: 3). Evoluimi i krimit të organizuar ka treguar përpjekjet e saj të vazhdueshme për ndërtimin e bazave dhe strukturave të fuqishme, të cilat kanë rivalizuar fuqinë e shteteve duke nxjerrë në pah dobësinë e institucioneve shtetërore. Gjithashtu evoluimi i veprimtarive kriminale në forma, teknika, mjetë dhe struktura ka treguar se impakti i tij si kërcënues i sigurisë kombëtare/ndërkombëtare të shteteve bëhet gjithnjë e më i madh.

4.4.1. Karakteristika të Krimit të Organizuar Transnacional.

Krimi transnacional nuk është një fenomen i ri. Grupet e ndryshme kriminale kanë operuar prej shekujsh, përmes kufijve transnacional. Mund të përmendim këtu, marrëdhëniet midis mafias italiane dhe asaj amerikanë gjatë viteve 1950-të, apo

operacionet e trafikut të kokainës nga kartelet kolumbiane të drogës. Përpara se të përpiqemi të kuptojmë se çfarë është krimi transnacional, duhet të bëjmë një saktësim, një dallim ekzistencial ndërmjet krimit të organizuar ndërnacional dhe krimit të organizuar transnacional. Kur flasim për krim të organizuar ndërnacional, ne "nënkuptojmë një organizim kriminal të një vendi, i cili operon edhe në vende të tjera". Ndërsa, kur flasim për krim transnacional, ne "kuptojmë një organizim kriminal të një vendi, i cili vepron edhe në vende të tjera, por nëpërmjet bashkëpunimit me organizimet kriminale të këtyre vendeve" (Poda, 14).

Ndonëse termat krim transnacional dhe krim i organizuar përdorën shpesh herë për të këmbyer vendin e njëra - tjetrës, duhet të kuptojmë dhe të bëjmë dallimin që ekziston midis tyre. Sepse, jo të gjitha krimet transnacionale ndërmerren prej grupeve të krimit të organizuar dhe jo të gjitha grupet e krimit të organizuar janë të përfshira në krimin transnacional. Krimi transnacional i referohet tradicionalisht aktiviteteve kriminale, të cilat shkojnë përtej ligjeve, (pra duke i shkelur ato) të dy ose më shumë shteteve. Kombet e Bashkuara në Konventën e tyre Kundër Krimit të Organizuar Transnacional e kanë përkufizuar krimin transnacional pak më gjerësisht, duke përfshirë brenda tij "çdo aktivitet kriminal që kryhet në më shumë se një shtet, i planifikuar në një shtet, por i ekzekutuar në një tjetër, ose i kryer në një shtet, por me efekte që prekin juridiksionet e shteteve fqinje" (Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional, 2000).

Në ditët e sotme, krimi i organizuar ka fituar një dimension transnacional. Forcimi dhe shtrirja aktuale e krimit transnacional është atribut i dy faktorëve kryesorë: i lëvizjes së lirë dhe shëmbjes së regjimeve diktatoriale. Lëvizja e lirë e njerëzve,

mallrave, kapitaleve dhe parave, ka kontribuar në zhvillimin e ekonomive formale dhe jo formale, të cilat operojnë përmes kufijve kombëtarë. Rritja e krimit të organizuar transnacional, është e lidhur ngushtë me procesin e globalizimit. Progresi i lartë teknologjik ka lehtësuar komunikimet dhe lëvizshmërinë. Gjithashtu, në një treg gjithnjë e më tepër global, aktorët e jashtëligjshëm, grupet kriminale si dhe partnerët e tyre përfitojnë shumë nga shanset tregtare. Globalizimi i tregjeve financiare ka njohur ritme të larta që pas viteve 90-të, duke u krijuar kështu kushte të favorshme grupeve kriminale. Globalizimi ka ndikuar në fuqizimin e individëve, të cilët janë në gjendje të veprojnë fuqishëm në arenën ndërkombëtare si dhe të kthehen në një rrezik të madh për sigurinë kombëtare. Faktori i dytë, i cili ka ndikuar në rritjen e krimit transnacional, lidhet me periudhën e shembjeve të regjimeve diktatoriale dhe drejtimi i këtyre shoqërive drejt sistemeve demokratike pas viteve 90-të.

Rritja e konflikteve civile me mbarimin e Luftës së Ftohtë ka ndikuar në dobësimin e autoritetit të shtetit. Pas viteve 90-të, vendet në tranzicion u krijuan mundësira të mëdha depërtimi dhe përfitime të mëdha parash grupeve kriminale transnacionale, duke kontribuar në këtë mënyrë në përhapjen e krimit transnacional. Institucionet e brishta, demokracia e pa konsoliduar e këtyre vendeve, i favorizuan së tepërmi grupet e angazhuara në aktivitete kriminale transnacionale, për krijimin e bazave të tyre të strehimit në këto vende. Konfliktet etnike dhe civile, të shfaqura pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, krijuan një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarive të grupeve kriminale transnacionale. Një rast tipik, janë luftërat e zhvilluara në Ballkan. Pikërisht këto luftëra, krijuan rrjete të organizuara kriminale, të cilët kryenin veprimtari të tilla si, trafikimi i armëve, mallrave, naftës, trafikimin e qenieve njerëzore etj.

Pra, procesi i globalizimit, konfliktet etnike dhe civile pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, periudha e tranzicionit për vendet të cilët shembën regjimet diktatoriale dhe i drejtuan shoqëritë e tyre të mbyllura drejt hapjes, ekonomisë së tregut etj., ishin faktorë me një impakt shumë të rëndësishëm në rritjen e krimit të organizuar transnacional. Nëpërmjet këtyre faktorëve krimi i organizuar i ka kaluar kufijtë nacional duke sjellë implikime jo vetëm për sigurinë kombëtare, për sigurinë publike, por ai ndikon në një mënyrë të fuqishme edhe për stabilitetin e regjimeve (Collins, 2009: 433). Kjo vjen si pasojë e aftësisë së krimit transnacional për të përshkruar kufijtë dhe për të kryer krime larg vendit të tij të origjinës. Natyra e tij e fshehtë, i krijon aftësi krimit transnacional për të korruptuar dhe për të shkatërruar aktorin qeveritar.

Krimi transnacional po kthehet në një sfidë shumë të rëndësishme për të gjitha shtetet. Qeveritë e vendeve të ndryshme e shohin krimin transnacional si një kërcënim për sigurinë e tyre kombëtare, sepse ai ka arritur të depërtojë në pikat më të dobëta të organizimit shtetëror, nëpërmjet teknikave të korrupsionit të funksionarëve në sektorë dhe në nivele të ndryshme. Gjithashtu, krimi transnacional kërcënon sigurinë kombëtare të shteteve edhe në aspektin ekonomik. Grupet kriminale, shpeshherë riinvestojnë të ardhurat e tyre në ekonominë formale, një strategji kjo për pastrimin e parave të tyre. Kjo strategji e tyre, përbën një kërcënim serioz për ekonominë kombëtare. Edhe pse në pamje të parë, investimi i këtyre grupeve kriminale duket se do të ndikojë në zhvillimin ekonomik të një vendi të caktuar, kjo nuk është e vërtetë. Pikërisht, këto lloj investimesh sjellin fuqizimin akoma e më shumë të këtyre grupeve kriminale, por e gjitha kjo në dëm të së ardhmes së atij vendi. Sepse, "lëvizjet e kapitalit nga grupet kriminale, të bëra me qëllimin e vetëm për pastrimin e parave të tyre, ndikojnë në krijimin e destabilizimit të

ekonomisë si dhe në dobësimin e aftësive vepruese në fushën financiare të qeverive”

(Poda, 35).

Pushteti i fuqishëm ekonomiko-financiar i grupeve kriminale, kërcënon ekonominë kombëtare dhe sistemet demokratike. Pjesa më e madhe e ekonomisë së një vendi, rrezikon pra kërcënohet të përfundojë dalëngadalë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nën kontrollin e plotë të krimit të organizuar, në rast se qeveritë e shteteve nuk marrin masat e nevojshme dhe efektive për ta luftuar krimin. Shoqëritë, të cilat karakterizohen nga niveli i lartë i krimit transnacional, shpeshherë shikohen negativisht nga investitorët e ligjshëm. Investitorët e huaj dhe të ligjshëm ngurrojnë të angazhojnë kapitalet e tyre financiare, sepse këto shoqëri karakterizohen nga mungesa e transparencës, shteti i dobët ligjor si dhe nga korrupsioni i lartë. Krimi transnacional kërcënon sigurinë kombëtare, sepse grupet kriminale transnacionale, nëpërmjet veprimtarive të tyre kriminale me qëllim përfitimin, dëmtojnë individët dhe shoqërinë në tërësi.

4.4.2. Karakteristikat e krimit të organizuar në rajonin e Ballkanit Perëndimor

Rajoni i Ballkanit reflekton të njëjtin evoluim të krimit të organizuar si dhe në rajonet e tjera. Ai shfaq njëkohësisht edhe tiparet e mjedisit ku zhvillohet. Por si çdo fenomen tjetër edhe ai nuk mund të mos veprojë në lidhje të ngushtë me rrjetet ndërkombëtare të krimit, në disa raste edhe duke qenë shumë më përpara aktivitetit parandalues të organeve ligjore në këto vende.

Shfaqja e krimit të organizuar në Kroaci vërehet me shkëputjen e saj nga ish-Jugosllavia dhe në embargon e armëve, duke detyruar në këtë mënyrë qeverinë kroate ti drejtohet tregut të zi për të siguruar mbrojtjen e tyre. Periudha më e artë e operimit të grupeve

kriminale kroate konsiderohet periudha e luftës. Të etiketuar/promovuar si heronj të luftës, shumica e këtyre grupimeve e vazhduan veprimtarinë e tyre kriminale edhe pas saj. Kaosi i krijuar si rezultat i shkëputjes u pasua me mungesën e mbikëqyrjes mbi shpenzimet e parave nga buxheti i shtetit, çka u mundësoi rrethana të favorshme individëve për të përfituar në aspektin financiar dhe në atë politik.

Vlen të theksohet fakti që në Republikën e Kroacisë, grupet kriminale nuk operojnë sipas formës klasike, sepse nuk ekzistojnë marrëdhëniet hierarkike ndërmjet anëtarëve të grupit. Krimi i organizuar në Republikën e Kroacisë pas viteve 90-të u përcaktua nga tre elementë të rëndësishëm: - pozicioni gjeografik; - proceset gjithëpërfshirëse ndërkombëtare; - pasojat e shpërbërjes së Jugosllavisë. Fushat në të cilën operoi/operon krimi i organizuar ishin: "kontrabanda me narkotikë, pastrimi i parave, armët, trafikimi i qenieve njerëzore, korrupsioni, kërcënimet, vrasjet" (Stojarova, 2007: 93).

Ndërsa përse i përket shfaqjes dhe forcimit të krimit të organizuar në Serbi, faktorët që ndikuan ishin kaosi i luftës dhe anemia e plotë shoqërore, e cila u theksua më shumë me futjen e sanksioneve ekonomike të OKB-së. Kjo ndikoi shumë në krijimin e një klime shoqërore dhe psikologjike ku çdokush që arrinte të thyente bllokadën e OKB- së, perceptohej si një person që kishte arritur rezultate pozitive dhe jo si një person që kishte kryer veprimtari të jashtëligjshme. Në këto rrethana të krijuara, shteti jo vetëm i toleronte operimin e këtyre veprimtarive kriminale, por ishte në disa raste vetë shteti që i nxiste këto veprimtari.

Duhet theksuar fakti që krimi i organizuar serb ka jetuar në simbiozë me shtetin, dhe të dy këta aktorë kanë përfituar nga njëri-tjetri. Gjithashtu, mund të themi që niveli

më i lartë i kriminalitetit të shfaqur në Serbi ka ardhur si rezultat i konfliktit Kroato- Boshnjak, ku këto grupe kriminale kanë luftuar për llogari të grupeve paramilitare të mbështetura nga qeveria serbe. Mënyra e strukturimit të këtyre grupeve kriminale është horizontale. Kjo nënkupton mungesë të një hierarkie të fortë midis grupeve si dhe një shkallë të lartë pavarësie në lidhje me aktivitetet e tyre, sepse anëtarët e nivelit të mesëm nuk koordinohen nga një udhëheqës. Fushat në të cilën vepron krimi i organizuar në Serbi janë: kontrabanda narkotike, trafikimi i personave, pastrimi i parave, vjedhjet, shpërdorimi i burimeve publike dhe privatizimeve, prodhimi i paligjshëm i programeve kompjuterike (software), etj (Stojarova, 2007: 100).

Pozicioni strategjik e bën Turqinë një vend shumë të rëndësishëm transiti për emigracionin e paligjshëm në drejtim të vendeve të Bashkimit Europian, duke krijuar kështu kushte të favorshme për operimin e veprimtarive kriminale. Vihet re që me përfundimin e Luftës së Ftohtë, grupet kriminale turke u përfshinë në trafikimin e heroinës shumë herë më shumë se vitet e mëparshme, si dhe krijuan lidhje të forta me vendet furnizuese të Azisë Qendrore. Situata e luftërave dhe kaosi i shkaktuar në vendet e Ballkanit konfliktual pas viteve 90-të rritën intensitetin dhe operimin e fushave të veprimit të grupeve kriminale turke, duke i kthyer ato në kontrolluesit e fortë të trafikimit të heroinës në Europë. Ja vlen të theksohet fakti që grupet kriminale turke përdorin metodën e pastrimit të të ardhurave si rezultat i trafikimit të heroinës në biznese të ligjshme dhe nëpërmjet transaksioneve bankare. Përsa i përket mënyrës së strukturës së grupeve kriminale turke ajo ka qenë historikisht hierarkike dhe homogjene, por gjatë viteve të fundit është vënë re një bashkëpunim i tyre me grupe të tjera kriminale që veprojnë në Europë. Fushat në të cilën vepron krimi i organizuar në Turqi janë:

trafikimi i drogës, i qenieve njerëzore, kontrabanda, falsifikimi i parave, grabitjet, krime të rënda kundër shtetit (Michaletos: 2007).

Qeveritë e shteteve si Kroacia, Serbia dhe Turqia vazhdimisht kanë bërë përpjekje për të përmirësuar situatën duke ndjekur strategji të cilat kufizojnë veprimin e krimit të organizuar në vendin e tyre. Përsa i përket Kroacisë, duhet të theksohet fakti që pavarësisht se pas viteve 90-të u gjend në të njëjtat rrethana problematike ku vihej re rritja e intensitetit të operimit të veprimtarive kriminale të shkaktuara nga lufta dhe periudha e tranzicionit, ajo lëvizi dhe vazhdon të lëvizë më hapa më të shpejtë dhe të sigurtë se vendet e tjera të rajonit përse i përket krijimit të politikave dhe strategjive efikase kundër krimit të organizuar. Arritjet pozitive të Kroacisë, e cila sot konsiderohet si modeli më i mirë për t'u ndjekur nga vendet e rajonit i propozuar nga BE-ja, erdhën si rezultat i të kuptuarit të nivelit të kërcënimit të këtij fenomeni ndaj sigurisë kombëtare të Kroacisë. Krimi i organizuar u konsiderua si një çështje që duhej sigurizuar për shkak të rrezikut ekzistencial që i shkaktonte vendit. E në këto rrethana bëhej e domosdoshme marrja e masave të jashtëzakonshme. Mund të themi që u aplikua një proces sigurizimi dhe u ndoqën etapat nëpërmjet të cilave kalon ky proces. Pra krimi i organizuar u bë pjesë e debatit publik-politik, u identifikua si kërcënim si çështje e cila duhej sigurizuar dhe bënte të domosdoshme marrjen e masave të jashtëzakonshme. Politikat e hartuara dhe të aplikuara bënë që brënda shumë pak vitesh të arrestoheshin për korrupsion zyrtarë të lartë dhe këto politika fillestare ndihmuan në realizimin e etapës së dytë, atë të ligjërimit politik për bindjen e audiencës për nivelin e kërcënimit. Këto politika ndikuan në rritjen e besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore dhe kjo si rezultat i politikave konkrete që demostroi qeveria kroate. Një masë tjetër e jashtëzakonshme

dhe efikase ishte edhe krijimi i një strukture të veçantë të quajtur USKOK (Zyra kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit)³, e cila kishte legjitimitetin për të hetuar çdo zyrtar të lartë, pavarësisht me ose pa imunitet.

Politikat qeveritare kroate rezultuan efikase në adaptimin e rregulloreve të nevojshme për ngritjen dhe vënien në funksion të një sistemi të zbatimit të ligjit si dhe në krijimin e një bazë të dhënash mbi krimin, në ndryshim p.sh.: nga Serbia ku asaj vazhdimisht i kërkohet nga vendet anëtare të Bashkimit European dokumentimi i të dhënave të besueshme, rezultate dhe qëndrueshmëri përse i përket luftës kundër krimit të organizuar. Serbia, pavarësisht rezultateve pozitive në disa raste ku mund të përmendim këtu operacionet e zbatimit të ligjit, të cilat i dhanë fund Klanit të Zemunit apo adoptimi i Kodit të ri penal që hyri në fuqi në 1 Janar 2006, i cili përmban përkufizime ligjore të “krimit të organizuar”, “grupeve të krimit të organizuar” dhe “grupeve të tjera të krimit të organizuar” (Projekti Rajonal Carpo, 2006: 97), ende nuk janë arritur rezultatet e pritura dhe vihet re një mungesë e theksuar e mekanizmit të të dhënave të besueshme dhe të qëndrueshme në luftën kundër krimit të organizuar.

Ndërsa për sa i përket politikave qeveritare në Turqi, vihen re përmirësimi i programeve të mëparshme dhe një riorganizim i institucioneve në luftën kundër krimit të organizuar. Gjithashtu, Turqia ka vënë në zbatim në vitin 2013 një plan veprimi kundër operimit të veprimtarive kriminale si dhe ka rritur nivelin e bashkëpunimit me vendet e rajonit, me vendet e Bashkimit European si dhe është bërë pjese e organizmave ndërkombëtarë që merren me luftën kundër krimit të organizuar. Pavarësisht arritjeve dhe rezultateve shume pozitive të arritura, duhet theksuar fakti që Turqia vazhdon ende të mbetet një nga vendet kryesore të trafikimit të heroinës në vëndet e Bashkimit

³ Për më shumë informacion shiko:

European dhe më gjerë. Përsa i përket vendeve të cilat u morën në trajtim, mund të themi që duhet të tregohet akoma edhe më shumë vendosmëri nga qeveritë e vendeve, nevojitet një koordinim më i madh ndërmjet institucioneve në luftën kundër krimit të organizuar, sepse pavarësisht përpjekjeve pozitive nuk janë arritur akoma objektivat e duhura. Gjithashtu duhet theksuar fakti që lufta kundër krimit të organizuar nuk mund të arrijë suksesin e duhur në rast se nuk ekziston fryma e vërtetë e bashkëpunimit me fqinjët.

Bashkëpunimi rajonal nuk duhet të mbesi thjeshtë në kuptimin sipërfaqësor të të thënë në deklarata të ndryshme të krerëve të këtyre qeverive, apo thjesht në firmosjen e marrëveshjeve rajonale bashkëpunuese në kuadër të realizimit të kriterëve apo kushteve për arritjen e objektivit, atë të integritetit të tyre në Bashkimin European, por ajo duhet të kuptohet vërtetë si një përgjegjësi dhe e mirë e siguri së përbashkët. Vihet re një mungesë e theksuar dëshire nga ana e shteteve që kanë rezultuar të suksesshëm në adaptimin efikas të strategjive të Bashkimit European ndaj luftës kundër krimit të organizuar, për të ndarë eksperiencën e tyre me vendet e tjera të cilat akoma nuk kanë arritur nivelin e duhur. P.sh. Kroacia, një vend i cili gjendej në të njëjtat kushte problematike siç ishte, Serbia, Maqedonia, Bosnje-Hercegovina apo Mali i Zi pas viteve

90-të, arriti që të përparonte më shpejt dhe të bëhej pjesë e Bashkimit European. Kështu që vendet si Serbia, Turqia, por edhe vendet e tjera të Europës Juglindore, duhet të përpiqen që të adaptojnë politikat dhe strategjitë e duhura për të luftuar krimin e organizuar, në mënyrë që të përmbushin prioritetet e tyre si dhe të kontribuojnë në krijimin e një mjedisi sa më lartë sigurie në nivel kombëtar por edhe në nivel global.

4.4.3.Format kryesore të evoluimit të krimit të organizuar dhe transnacional

Krimi i organizuar vepron me një serë formash, përdor trafikimin e lëndëve narkotike, trafikimin e armëve, trafiket e paligjshme të cilat bazohen në trafikimin e femrave për qëllime prostitucioni apo edhe trafikimin e fëmijëve, korrupsionin si një taktikë për të ndikuar tek funksionarët e niveleve të ndryshme qeveritare, kontrabandën, riinvestimin e parave të tyre në mënyrë që t'i kthejë kapitalet e tyre të paligjshme në kapitale të ligjshme etj. Të gjitha këto format të përdorura shërbejnë për të përmbushur qëllimet kryesore të krimit të organizuar, atë të përfitimit në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të një fitimi financiar. Të gjitha përfitimet që i akumulojnë nëpërmjet këtyre formave përpiqen t'i shndërrojnë nga kapitale të paligjshme në kapitale të ligjshme.

Është i domosdoshëm për ta shndërrimi i kapitaleve, sepse ai u shërben si një mjet fuqizimi në veprimtaritë e ardhshme, si dhe si një mënyrë për të mos tërhequr vëmendjen e institucioneve shtetërore. Kjo formë njihet ndryshe si procesi i pastrimit të parave, ku këto fitime të arritura kthehen në para normale, të pastra dhe legale. Për investimin e këtyre kapitaleve përdoren bizneset, firmat e ndërtimit, lojërat e fatit etj. Shtrirja e sistemit financiar botëror si dhe rënia e barrierave të udhëtimit ndërkombëtar janë kombinuar për të ofruar burime, mundësi dhe mjete për të konvertuar të ardhurat e paligjshme në fonde të ligjshme” (Poda, 40). Në ditët e sotme procesi i shndërrimit të kapitaleve të paligjshme në kapitale të ligjshme përbën një problem shumë madhor për shtetet, e në mënyrë të veçantë për vendet në tranzicion ose shtetet e dobëta (weak state). Sepse kjo kategori shtetesh karakterizohen nga një kaos i përgjithshëm, me institucione jo efikase, mos respektimin e ligjit, paqëndrueshmëri të lartë politike, ekonomi të brishta etj. Ekonomia informale e vendeve në tranzicion, krijon kushte të përshtatshme për

legjitimitetin e kapitaleve të paligjshme të realizuara si pasojë e veprimtarive kriminale. Përsa i përket strukturës së organizimit/modelit që operojnë grupet kriminale, ato mund të jenë struktura tepër të forta hierarkike, të cilat karakterizohen nga ndarje rolesh dhe lidhje gjaku ndërmjet anëtarëve të grupit, si dhe nga struktura horizontale, të cilat karakterizohen nga lidhjet shoqërore, miqësore, interesash të përbashkëta ndërmjet anëtarëve të grupit. Ekziston një debat mbi idenë së bëhen pikërisht kushtet sociale të vështira, faktori vendimtar që nxit individët në të njëjtin status të krijojnë struktura të tilla kriminale. Studimet e shumta në ditët e sotme tregojnë se krimi i organizuar ka ndryshuar tendencat në dy drejtime kryesore: në atë të subjekteve të përfshira në të dhe të veprimtarisë së tij (Hysi, 2005: 166).

Gjithnjë e më tepër grupet kriminale po përpiqen të bëjnë pjesë të grupeve të tyre, personat me një influencë të madhe në tregjet botërore dhe profesionistë/specialistë në fushat e tyre. Përveç kësaj strategjie, grupet e ndryshme kriminale që operojnë në botë po përpiqen që të ndryshojnë strukturat dhe format e tyre të bashkëpunimit, për të patur më shumë efekshmëri dhe për të përfituar më shumë nëpërmjet shmangies së strukturës hierarkike dhe përqendrimin tek aleancat dhe bashkëpunimet ndërmjet grupeve. Gjithashtu, sipas klasifikimit të Jay Albanese, i cili i referohet organizatës kriminale amerikane Cosa Nostra, tre janë modelet e krimit të organizuar:

1. modeli hierarkik (e cila ka të bëjë me pamjen zyrtare të Cosa Nostra si një etnitet kombëtar burokratik);
2. modeli padron-klient (rrjet lokal- etnik);
3. modeli i ndërmarrjes (ndikimet e veprimtarive ekonomike të tregut mbi strukturat e grupit) (Lampe, 2003)

Ndërsa përsa i përket strukturave për ta parë krimin e organizuar transnacional, ekzistojnë tri modele të cilat merren në konsideratë nga qeveritë e shteteve për të hartuar strategjitë e tyre në lidhje me luftën ndaj këtij fenomeni. Modeli hierarkik i krimit të organizuar transnacional, modeli i rrjetit dhe ai i tregut. Përsa i përket modelit hierarkik, ai nënkupton një strukturë të përbërë nga persona ku secili prej tyre është i ngarkuar dhe përgjegjës për një veprim të caktuar dhe përdorin në mënyrë sistematike dhunën dhe korrupsionin si mjete për të realizuar objektivat e tyre. Grupet e strukturuar sipas këtij modeli luajnë një rol të rëndësishëm strategjik, janë shumë të fuqishëm dhe paraqesin nivelin më të lartë të rrezikshmërisë, krahasuar me grupet e strukturuar ndryshe. Ndërsa për grupet të cilët strukturoren sipas modelit të rrjetit, ato karakterizohen nga fleksibiliteti i shpërbërjes dhe aftësia e tyre rigjeneruese.

Në ndryshim nga modeli hierarkik, këto grupe shfaqen si më të përshtatshme për shmangien e identifikimit nga autoritetet qeveritare të vendeve të caktuara, mundësinë më të madhe për bashkëpunim me grupet e tjera me qëllim rritjen e efikasitetit të veprimtarive të tyre. Ngjashmëria e tyre me modelin hierarkik konsiston në përdorimin e mjeteve të dhunës për realizimin e objektivave të tyre. Modeli i tretë i organizimit të krimit të organizuar transnacional është ai i tregut, ku grupet kriminale i shmangen lehtësisht zbatimit të ligjit. Karakteristikë e këtyre grupeve janë organizime të vogla, por shumë konkurruese midis tyre, formë kjo e cila rrit efikasitetin e tyre. Ata strukturoren në këtë mënyrë, pra duke përdorur formën e tregut, sepse besojnë se "krimet në administratë dhe në kompanitë e mëdha, kontribuojnë shumë më tepër se çdo lloj forme tjetër, në dobësimin e ekonomisë formale" (Collins, 2009: 447-448).

4.5. Analizë mbi strategjitë e parandalimit të krimit të organizuar/ transnacional

Në kushtet kur krimi transnacional gjithnjë e në rritje po kërcënon sigurinë kombëtare të shteteve bëri të domosdoshme marrjen e masave të nevojshme dhe formulimin e strategjive efikase nga qeveritë e shteteve për t'a parandaluar këtë kërcënim. Shtetet u përpoqën të reagonin duke vënë në dispozicion të gjitha elementët e fuqisë kombëtare me qëllim krijimin e një ambienti të sigurtë për qytetarët e tyre. Nisur nga niveli i lartë i rrezikshmërisë së kërcënimit, për të luftuar krimin transnacional shtetet u përpoqën që të formulonin përveç strategjive individuale kombëtare edhe strategji të përbashkëta. Mund të përmendim këtu angazhimin nga BE në vitin 2001 për marrjen e masave parandaluese dhe ligjore kundër krimit të organizuar. Kjo strategji konsistonte në forcimin e legjislacioneve kombëtare të shteteve anëtare të BE, në dokumentimin e të dhënave të besueshme dhe në qëndrueshmërinë e tyre, në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies me qëllimin e vetëm atë të parandalimit të praktikave dhe veprimtarive kriminale, si dhe me zhvillimin e kapaciteteve kombëtare të shteteve anëtarë për të përballuar këto kërcënime ndaj sigurisë. (Concil Of Europe: Preventive Legal Measures Againsts Organized Crime, 2001).

Vazhdimisht nga BE-ja janë hartuar strategji për të luftuar krimin e organizuar transnacional, mund të përmendim edhe strategjinë e 2005, apo edhe atë të vitit 2011. Duhet të theksojmë se përveç angazhimit për të forcuar kapacitetet e shteteve dhe legjislacionet e tyre, janë krijuar edhe agjenci të posaçme për t'i u kundërpërgjigjur kërcënimeve të sigurisë së përbashkët, por edhe për të realizuar objektivat e strategjive përkatëse. Mund të përmendim p.sh.: -EUROPOL (Zyra Policore Europiane 1994), agjencia e zbatimit të ligjit, me qëllimin kryesor atë të përmirësimit të bashkëpunimit

efektiv midis autoriteteve të shteteve anëtare të cilat janë kompetente dhe merren me luftimin dhe parandalimin e të gjitha formave të veprimtarive të shkaktuara nga krimi i organizuar transnacional dhe terrorizmi. Kjo agjenci bashkëpunon edhe me shtete të tjera të cilët nuk janë anëtarë të BE, si Australinë, Kanadanë, SHBA-në dhe Norvegjinë⁴;

-EUROJUST (Agjencia për Bashkëpunimin Gjyqësor në BE 2002), është një organ i BE-së i cili ka për qëllim përmirësimin e koordinimit midis autoriteteve gjyqësore të shteteve anëtare, të cilat merren specifikisht me zgjidhjen e çështjeve dhe problematikat që shkaktohen nga veprimtaritë e krimit të organizuar transnacional duke rritur nivelin e pasigurisë brenda BE-së⁵;

-CEPOL (Kolegji European i policisë 2005), u krijua me qëllimin e ofrimit të trajnimeve për oficerët e lartë të policisë, të cilët përballen me kërcënimet ekzistenciale ndaj sigurisë, si dhe për shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira për bashkëpunimin e përbashkët të zbatueshmërisë së ligjit (Policy Department C: Citizens' Rights and Constitutional Affairs, 2011: 61). Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Krimin e Organizuar Transnacional, hyri në fuqi në shtator 2003”, e cila u përforcua më tej në ”Konventën kundër Korrupsionit në 2005”.

Edhe Strategjia Kombëtare e SHBA-së lidhur me luftën kundër krimit të organizuar në vitin 2011-të, e konsideroi krimin e organizuar si një nga kërcënimet më të mëdha për sigurinë kombëtare amerikane, por edhe atë globale, sepse veprimi i krimit të organizuar transnacional me aktivitetet e tij sillte implikime të mëdha për sigurinë publike, institucionet demokratike, ekonominë e vendeve. Kërcënimi që vinte nga krimi i organizuar transnacional ishte i nivelit të lartë, sepse vihet re një përdorim gjithnjë e në

⁴ Për më shumë shiko: <https://www.europol.europa.eu/>

⁵ Për më shumë shiko: <http://www.eurojust.europa.eu/>

rritje i veprimtarive kriminale nga grupet dhe organizatat terroriste. Krimi i organizuar transnacional kërcënonte sigurinë globale, sepse vihej re një sofistikim dhe fuqizim i tyre në rajone të ndryshme të botës, kryesisht si pasojë e funksionimit të tyre nëpërmjet rrjeteve (Strategy US to Combat Transnacional Crime, 2011).

Mirëpo pavarësisht bashkëpunimeve të ndryshme, rezultateve pozitive në disa raste, mbështetjes nga politik bërësit, profesionistët, akademikët etj., krimi transnacional jo vetëm që nuk ka pësuar ulje, por përkundrazi po rritet dita –ditës dhe po kthehet në një rrezik serioz për sigurinë kombëtare. Bashkëpunimet nuk kanë rezultuar shumë të suksesshme dhe nuk kanë patur një ndikim të fuqishëm për të luftuar krimin e organizuar, sepse pavarësisht rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit, zbatimi i ligjit mbetet akoma një veprimtari kombëtare e kufizuar në juridiksionin e një territori të caktuar, ndërkohë që krimi i organizuar ka kufij ndërkombëtarë.

Përsa i përket agjencive të krijuara në BE, si p.sh. EUROPOL, këto mbeten akoma një problematikë e madhe, sepse nuk kanë kompetencat e drejtpërdrejta për arrestime të këtyre grupeve kriminale. Juridiksioni i saj lidhet vetëm me dhënien e informacionit, mbështetjes dhe koordinimit të operacioneve, ndërsa përgjegjësia dhe juridiksioni vazhdon të jetë vetëm i shtetit anëtar në BE. Një faktor tjetër i cili ka ndikuar në mos suksesin e bashkëpunimeve lidhet edhe me objektivat e ndryshëm. Shtetet kanë shumë objektiva për të realizuar, ndërsa organizimet kriminale përqendrohen vetëm në një objektiv, në atë të përfitimeve sa më të mëdha. Qeveritë e vendeve të ndryshme duhet të marrin masa konkrete-të rrepta dhe duhet të përpilojnë

strategji të aplikueshme, në mënyrë që të rezultojnë të suksesshme ndaj këtij kërcënimi të rëndësishëm të sigurisë.

Hartuesit e strategjive duhet të marrin në konsideratë modelet mbi strukturat e organizimit të këtyre grupeve kriminale, në mënyrë që mjetet dhe mënyrat e tyre të luftimit dhe parandalimit të rezultojnë të suksesshme, sipas parimit njih mirë armikun dhe strategjinë e tij dhe më pas krijo strategji për ta shkatërruar në pikat e tij të forta dhe të dobëta. P.sh.: Nëse pjesë e strategjisë sonë të përzgjedhur do të jetë modeli hierarkik, pas njohjes, mund të hartohet strategjia e cila zhvillon kapacitetet për të mundësuar identifikimin dhe targetimin e lidershit të këtij grupimi kriminal, si dhe identifikimin e burimeve dhe resurseve të tyre, me qëllimin strategjik të zvogëlimit të fuqisë së tyre.

E njëjta filozofi duhet të ndiqet nga hartuesit e strategjive kombëtare të shteteve të ndryshme edhe për luftimin e krimit të organizuar në formë rrjeti (formimi i rrjeteve për të luftuar rrjetet), si dhe në formë tregu (zhvillimi i kapaciteteve të cilat mundësojnë identifikimin e tregjeve të paligjshme), për të rezultuar të suksesshëm dhe për të pasur një strategji efikase dhe të aplikueshme. (Collins). Duhet të tregohen striktë në objektiva, të cilat janë të realizueshëm dhe jo në përpilimin e shumë strategjive me shumë objektiva, sepse kjo e komplikon shumë arritjen e efekshmërisë. Gama e gjerë e objektivave krijon shumë probleme dhe gjithashtu humbjen e fokusit kryesor duke e kthyer strategjinë thjeshtë të përpiluar në një dokument zyrtar, por pa efekshmëri dhe aplikueshmëri.

Përsa i përket realizimit të një bashkëpunimi efektiv ndërkombëtar, ai duhet të bazohet në shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre, në dorëzimin e atyre që kryejnë veprimtari kriminale në shtetet përkatëse si dhe në ngrirjen e llogarive dhe sekuestrimin

e pasurive të grupeve kriminale (Poda, 41). Duhet të theksojmë faktin që lufta dhe parandalimi i krimit të organizuar nuk paraqitet si një sfidë e thjeshtë për shtetet; ato duhet të bëhen më të vetëdijshëm për nivelin e lartë të rrezikshmërisë së këtij kërcënimi dhe duhet të tregohen më të vendosur për ta luftuar në mënyrë kombëtare, me strategji të zbatueshme si edhe nëpërmjet bashkëpunimit multilateral, në mënyrë që të rezultojnë të suksesshëm në përballimin e kësaj sfide.

4.6.Ndërthurja dhe ndikimet e krimit të organizuar dhe terrorizmit në procesin dhe konceptin e sigurisë

Në ditët e sotme kërcënimet më të mëdha për mjedisin e sigurisë vijnë nga aktorë jo-shtetërorë transnacionale si organizatat kriminale dhe ato terroriste (NATO, 2010). Në kushtet ku gjithnjë e më tepër shtetet po e humbasin monopolin e dhunës si brenda dhe jashtë tij, sfida ndaj këtyre aktorëve jo-shtetërorë merr një dimension tjetër, sepse tashmë kërcënimi ndaj sigurisë nuk vjen më si rezultat i një shteti të caktuar, apo grupeve të motivuara për realizimin e kauzave të tyre. Midis organizatave transnacionale ekzistojnë dallime të mëdha, por duhet të theksojmë se ndërmjet tyre lokalizojmë edhe shumë ngjashmëri. Organizatat terroriste dhe kriminale shfaqin të gjitha tiparet e një aktori racional, kjo vihet re në shfrytëzimin e të gjitha hapësirave, mundësive të këtij sistemi të ri ku ne jetojmë (Globalizmi). Një faktor tjetër që i'u jep atyre tiparin e një aktori racional është mbështetja e tyre në instrumentet e përdorimit të dhunës dhe terrorit, e cila është e ngjashme me instrumentet që përdorin shtetet në një luftë për realizimin e objektivave të tyre.

ndërmjet këtyre dy organizimeve transnacionale identifikojmë dallime dhe ngjashmëri. Dallimi i parë ndërmjet tyre lidhet me motivet, objektivat dhe qëllimet të cilat kanë ndikuar në krijimin e organizatave të tyre. Organizatat terroriste, herët ose vonë, tentojnë drejt organizatave politike, pavarësisht faktit të motivimit, i cili mund të jetë në disa raste fetar. Ato në fund të fundit si qëllim final kanë sjelljen e një ndryshimi politik. Ndërsa përsa i përket organizatave kriminale, objektivi i tyre primar lidhet me përfitimin.

Dallim tjetër i rëndësishëm ndërmjet tyre është përdorimi i dhunës i niveleve të ndryshme. Organizatat terroriste karakterizohen nga niveli i lartë i përdorimit të dhunës, terrorit dhe nivelit të lartë të impaktit psikologjik. Edhe pse organizatat kriminale e përdorin dhunën, ai është i një niveli dhe qëllimi tjetër, ata e përdorin dhunën në vrasjen e njerëzve si politikanë, gazetarë, rivalët në veprimtaritë e tyre etj. Përdorimi i dhunës nga organizatat kriminale është një taktikë për të mbrojtur strukturat e tyre. Në ndryshim nga organizatat terroriste, këto grupe kriminale në përzgjedhjen e përdorimit të dhunës nuk janë në mënyrë të rastësishme. Një tjetër dallim lidhet me përdorimin e instrumentit të korrupsionit. Organizatat kriminale e përdorin si një strategji për të lehtësuar veprimtaritë e tyre të trafikimit si dhe për uljen e rrezikshmërisë së identifikimit të tyre nga autoritetet qendrore. Ndërsa për organizatat terroriste, ky instrument nuk është kaq shumë i rëndësishëm. Ajo e cila ka më shumë rëndësi për këto organizata është propaganda për të afruar sa më shumë individë dhe shtete rreth kauzës së tyre, në mënyrë që më pas të mundën të sigurojnë financime dhe mbështetje për fuqizimin e veprimtarive të ardhshme.

Ngjashmëria midis tyre konsiston në faktin që të dy këta aktorë jo-shtetërorë mbështeten tek rrjetet, të cilat mund të jenë lokale, rajonale apo globale, një formë shumë efikase e përdorur nga ata për t'i u shmangur sulmeve të mundshme të reagimit të efektshëm qeveritar. Si organizatat kriminale transnacionale dhe ato terroriste shfrytëzojnë dobësitë institucionale që paraqesin shtetet e dobëta, pra janë prezente dhe operojnë brenda kufijve të tyre (Baylis et.al, 2012: 236-239). Shqetësim për sigurinë kombëtare dhe globale sot konsiderohet bashkëpunimi i organizatave kriminale me organizatat terroriste. Kjo vihet re në përdorimin e tregjeve të paligjshme dhe në përdorimin e formave të krimit të organizuar si trafikimi i drogës, vjedhjet, falsifikimet, trafikimin e armëve etj nga organizatat terroriste. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi përfitojnë të dy aktorët jo-shtetërorë, në aspektin e akumulimit të sasive të mëdha të kapitalit si dhe në rigjenerimin e burimeve të tyre për t'iu kundërpërgjigjur reagimeve qeveritare/kombëtare-ndërkombëtare.

Ndërkohë, si rreziku më i madh i sigurisë globale sot identifikohet fuqizimi i aktorit transnacional jo-shtetëror, i terrorizmit. Në ndryshim nga organizatat kriminale, që si motiv kryesor kanë përfitimin, organizatat terroriste kanë kauza “politike”. Pasiguria bëhet dyfish më e madhe kur ata fuqizohen akoma edhe më shumë, duke përdorur format dhe metodat kriminale, si dhe mund të shërbejnë si faktor për radikalizimin e anëtarëve të cilët janë pjesë e veprimtarive kriminale. Sepse në këtë rast shtetet e sistemit ndërkombëtar përballen me një aktor jo-shtetëror shumë të fuqizuar, asimetric dhe të pa lokalizuar në mënyrë përfundimtare.

4.6.1. Organizata terroriste ISIS (Rast analize)

Në përpjekje për të kuptuar organizatën terroriste ISIS, e cila konsiderohet sot si organizata më e fuqishme, që ndikon në destabilitetin e sistemit ndërkombëtar dhe në pasigurinë e nivelit të lartë në mjedisin e sigurisë, duhet patjetër të kuptojmë lëvizjen e Vehabizmit, sepse shfaq të njëjtat karakteristika në motive, por edhe në mënyrën dhe mjetet që ajo përdor për operimin e saj. Vehabizmi ishte një lëvizje brenda Islamit, e cila kishte si qëllim kryesor pastrimin e fesë Islame dhe kthimin në Islamin e profetit Muhamed dhe tri gjeneratave të tij pasuese. Dy shtyllat kryesore në të cilën mbështetej kjo pikëpamje ishin Kurani dhe Suneti (tregime/hadithe të cilat nuk janë të përfshira në Kuran, por që trajtojnë çështje nga sfera publike dhe private e jetës njerëzore).

Baza e ligjit të Sheriatit përbehet nga Kurani dhe Suneti, dhe mbi bazën e tyre bëhet diktimi i sjelljes së përditshme morale. Në Arabinë Saudite vihet re një ndjekje e përpiktë e këtyre rregullave të bazuara në ligjin e Sheriatit, e si pasojë e kësaj, Arabia Saudite u kthye në qendrën e Islamit. Por përveç ndjekjes së këtyre rregullave, ndikoi edhe një faktor tjetër i rëndësishëm, që e ktheu atë në qendrën kryesore të Islamit. Ishte prania e qyteteve islame të shenjta të Mekës dhe Medinës. Filozofia e kësaj lëvizje për respektimin dhe ndjekjen e rregullave sipas ligjit të Sheriatit shërbeu për formulimin e strategjisë dhe veprimtarisë së tyre. Të gjithë ata të cilët nuk i respektojnë dhe nuk i bëjnë pjesë së jetës së tyre këto rregulla duhej të vriteshin, gratë dhe vajzat duhej të dhunoheshin dhe pasuria e tyre duhej të konfiskohej.

Doktrina e tyre bazohej në tre shtylla kryesore: - 1 sundimtar;- një autoritet;- një xhami ku autoritetin për ta implementuar këtë i takonte mbretit të arabisë i cili kishte pushtetin absolut të dhënë nga zyrtarët e lartë të lëvizjes së Vehabizmit. Mbi bazën e

kësaj filozofie u ndërmorën fushat e tyre për instalimin e frikës dhe përdorimi i dhunës së përshkallëzuar duke e legjitimuar veprimtarinë e tyre nën flamurin e Xhihadit. Strategjia e tyre u implementua me fushatën e pushtimeve dhe sundimit të komuniteteve lokale si dhe më detyrimin për konvertimin e tyre në Vehabistë. Kjo aleancë kishte kontrollin në pjesën më të madhe të Gadishullit arabik dhe janë faktuar sulmet e tyre të herëpashershme për kontroll edhe në qytetin e Medinës, Sirisë dhe Irakut. (Amiri, 2002: 44-51).

Mund të themi që organizata ISIS është një lëvizje bashkëkohore e Vehabizimit. Ka të njëjtat motive, qëllime si lëvizja Vehabiste, por ndryshon vetëm përsa i përket pretendimit të autoritetit të Arabisë Saudite për të sunduar dhe për të vazhduar të jetë qendra e Islamit në Lindjen e Mesme. Ato janë kundër kësaj pikëpamje, si pasojë e aleancës së saj me perëndimin dhe ndikimin që kjo e fundit ka pasur në modernizimin e Arabisë Saudite. ISIS është e ngjashme me lëvizjen Vehabiste edhe përsa i përket taktikave që ajo përdor, si përdorimi i dhunës së përshkallëzuar, krijimi i klimës së terrorit, si dhe synimit të saj për të pasur kontroll mbi komunitete të caktuara të besimit sunit, e realizuar kjo nëpërmjet fushatave të shumta të pushtimit të territoreve të caktuara nën legjitimimin e luftës së xhihadit. Gjithashtu ajo ngjason edhe përsa i përket mjeteve të propagandës që ajo përdor për shtimin e popullaritetit ndaj saj, nëpërmjet përdorimit të teknikave të rekrutimit nëpërmjet përdorimit të forcës dhe imponimit, por edhe nëpërmjet bashkëpunimit me organizata të tjera për të rritur pozitat dhe fuqitë e tyre.

ISIS është një organizatë xhihadiste, e përbërë nga ekstremistë suni, të cilët kanë si qëllim kryesor rikthimin e Islamit të epokës së profetit Muhamed ku baza e ligjit të shariatit buronte nga Kurani dhe suneti, pra krijimi i Kalifatit Islamik. Kthimi në këtë

epokë të artë të Islamit do të mund të realizohet nëpërmjet luftës së xhihadit (lufta e shenjtë), kundër armiqve të brendshëm dhe të jashtëm të Islamit. Fillesat e krijimit të kësaj organizate i identifikojmë në fushatën ushtarake të ndërmarrë nga SHBA-ja në vitin 2003 në Irak dhe inkurajimin nga ana e SHBA-së pas pushtimit të Irakut të instalimit të një sistemi demokratik nën udhëheqjen e Shiitëve. Kaosi i shkaktuar si pasojë e luftës dhe inkurajimi i instalimit të një sistemi demokratik nën regjimin shiit, shërbyen si nxitëse për fillesat e kësaj organizate.

Popullsia sunite pavarësisht se ishte një pakicë kishte patur tradicionalisht kontrollin në Irak. Ai i cili njihet si udhëheqësi i organizatës ISIS sot është Ebu-Bekr al- Bagdadi, i cili u bë pjesë e kryengritjes e cila shpërtheu në Irak menjëherë pas pushtimit të tij. Në 2010 ai u bë udhëheqës i Al-Kaedës në Irak, e cila më pas u njoh si organizata ISIL (Shteti Islamik i Irakut dhe Levantit), e krijuar në prill 2013-të. Kufijtë e këtij shteti Islamik (kalifati), do të përfshinin të gjithë zonën e madhe të Sirisë (Bilal- al sham), kontrolli i tyre do të shtrihej nga Afrika Perëndimore në Azinë Qendrore , gjithashtu pjesë e këtij kufiri do të ishin edhe disa zona të Europës (jihad forums on August 18, 2014).

Strategjia e tyre për realizimin e qëllimit të organizatës u implementua, me përfshirjen e tyre në situatën e krijuar në Siri, e cila u pasua me pushtimin dhe kontrollin e qytetit Raqqa. Kontrolli mbi Raqqa-n shërbeu për shndërrimin e kësaj organizate në ISIL në ISIS (Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë me kryeqytetin e saj të shpallur Raqqa-n). Më pas strategjia e tyre u pasua me ndikimin e kësaj organizatë në nxitjen e tensioneve ndërmjet pakicave sunite të Irakut dhe qeverisë së udhëhequr nga Shiitët me synim kontrollin mbi rajonet e Irakut të Veriut dhe të Jugut. Si rezultat i prodhimit të këtij

tensioni organizata ISIS arriti pushtimin dhe kontrollin e saj mbi provincën Fallujah (afër kryeqytetit të Bagdadit) dhe më pas pushtimi dhe kontrolli i Mosulit (Internacional Institute for Strategic Studies, 2015: 304-308).

Për të vazhduar me tej me situatën në Libi, rënien e qyteteve si Bengazi, Sirte, Deana, Nofilia nën kontrollin e organizatave të ndryshme terroriste, të cilat kanë shpallur aleancë dhe mbështetje ndaj ISIS dhe kauzës së tyre. Mund të përmendim këtu Bengazin, e cila është në kontrollin e një organizate terroriste e udhëhequr nga Ansar al- Sheriati, i cili e ka shpallur atë shtet islamik dhe aleatë të ISIS. Gjatë gjithë kësaj periudhe strategjia e ndjekur nga ta ka qënë e fokusuar në dy fronte, në marrjen e kontrollit mbi qytete të caktuara, nëpërmjet përdorimit të dhunës, si dhe në përpjekjen e ndërtimit të strukturave mbështetëse të saj në Turqi, Jemen, Arabi Saudite, në provincën e Sinait në Egjipt, Afganistan, Tunizi, Algjeri etj., si teknikë kjo për të fuqizuar pozitat e saj.

Në ditët e sotme po përbën kërcënimin më të madh të sigurisë globale organizata terroriste ISIS dhe këtë e demonstroi përsheptimi i operacioneve të saj më një shtrirje të madhe dhe aktivizimi i grupeve jashtë sferës së saj, të cilat kanë treguar mbështetje . Strategjia e tyre globale për të vënë në kontrollin e tyre vendet që karakterizohen nga destabiliteti, padiskutim që prodhon efekte globale. Kjo organizatë paraqitet si rreziku më i madh i sigurisë për shkak të karakteristika që ajo shfaq: -Aftësi ushtarake operative në Siri dhe Irak e përbërë edhe nga luftëtarë të huaj (arabo-mysliman, por edhe nga vendet perëndimore) dhe kjo tregon dimensionin e shtrirjes së saj; -Posedimi i arsenalit të armatimeve, të cilat janë të ngjashme me arsenalin e ushtrive të rregullta kombëtare; - Zonat e kontrollit (1/3 e territorit të Irakut dhe Sirisë); -Kapitale financiare të

konsiderueshme si pasojë e kontrollit të tyre mbi infrastrukturën e zonave të kontrollit, ku mund të përmendim eksportimin e produkteve të naftës si dhe fitimet të cilat vijnë nga përdorimi i aktiviteteve kriminale si grabitje, rrëmbime etj.; -Impakti shumë i madh i tyre në krijimin e klimës së pasigurisë, frikës dhe terrorit për opinionin publik global, e kryer kjo nëpërmjet ndërmarrjeve të sulmeve apo edhe nëpërmjet përdorimit të mjeteve të sotme teknologjike si shfaqja e filmimeve me qëllim rritjen e mbështetjes, por edhe të demonstrimit të fuqisë dhe pushtetit të tyre në rajon (The Mair Amit Intelligence and Terrorism Information Cente 2014: 3-6).

ISIS është shembulli i organizatës më të sofistikuar terroriste, sepse ajo ka arritur të krijojë të gjitha aftësitë dhe kapacitetet gjysmë-kombëtare me synimin e vetëfinancimit të infrastrukturës së saj ushtarake. Ashtu sikurse vënë në funksion shtetet të gjitha elementët e fuqisë së tyre kombëtarë për realizimin e mbrojtjes së interesave të tyre kombëtarë, ashtu paraqitet edhe sjellja e kësaj organizate në përmbushjen e kauzës për të cilën ajo u krijua. Gjithashtu ISIS është shembulli i bashkëpunimit ndërmjet organizatave të ndryshme terroriste dhe grupeve të cilat përdorin në veprimtaritë e tyre format e krimit të organizuar. Por njëkohësisht mund të themi që nëse ato arrijnë të fuqizohen akoma edhe më shumë dhe arrijnë të zhvillojnë të gjitha kapacitetet e një shteti, kjo formë na rikthen sërish tek konceptit tradicional i sigurisë, ku kërcënimet vijnë nga shtete të caktuara dhe objekti i sigurisë ishte shteti. Nëse nuk ndërmerren masat e duhura nga shtetet e sistemit ndërkombëtar për zvogëlimin dhe më pas eliminimin e veprimtarive të kësaj organizate, nëpërmjet sigurizimit të kësaj çështje, mjedisi i sigurisë do të të karakterizohet nga niveli i lartë i pasigurisë dhe gjendjes së kaosit.

Ecuria nga vullnetar në terrorist nuk është lineare, as dhe e pashmangshme dhe shumica e njerëzve që kthehen nga lufta në Siri mund të mos jenë kërcënim terrorist, vështirësia është se si mund të dallohen ato (Hayrudin Somun at Today's Zaman 2014). Liderët e shumë grupeve ekstremistë kanë treguar se nuk kanë hezituuar për sulme kërcënuese terroriste si në vendet me shumicë myslimane ashtu edhe në ato me shumicë jo-myslimane. Pothuajse të gjithë ata që luftuan kundër Bashkimit Sovjetik në Afganistan u bënë terroristë më pas, megjithëse rrethanat ishin të ndryshme (Hayrudin Somun at Today's Zaman 2014). Kur njerëzit shkuan në Afganistan gjatë periudhës së Talebanëve, ata nuk kishin koncept të zhvilluar për al-Qaedën dhe terrorizmin lokal e global. Kjo u arrit atëherë ku ata u njohën me argumentet e Bin Laden-it për të sulmuar "*armikun larg*".

Tashmë situata ka evoluar, ISIS ka shpallur shtetin islamik, po tenton të ndërtojë mekanizma të funksionimit si entitet shtetëror, duke u bërë kështu pika fundore e përfundimit të vullnetarëve që janë aktualisht pjesë e terrenit të konfliktit në Siri. Sipas disa studiuesve ISIS-it i duhet edhe mbështetje në realizimin e strategjisë së tij, nisur edhe nga fakti që lideri i tij njihet si takticien ushtarak me aftësi të provuara, ekziston rreziku i organizmit të selektuar të kthimit të vullnetarëve dhe përdorimit të tyre për akte terroriste në vendet e origjinës ndoshta deri selektime për në vendet e koalicionit ndërkombëtar kundër ISIS.

Si përfundim, përveçse një kërcënim lokal e rajonal për paqen në Lindjen e mesme, shteti islamik përbën një kërcënim global. Pas deklarimit të Kalifatit dhe pretendimit të një roli udhëheqës mes grupeve xhihadiste në botë, ISIS tashmë paraqet një rrezik për sigurinë ndërkombëtare. Shteti islamik mund të kthehet në një inkubator

terroristësh për të eksportuar militantë e planifikuar akte terroriste në vendet perëndimore, por edhe mund të shërbejë si kauzë frymëzimi për organizim aktesh terroriste nga individë të veçuar por me impakt të madh.

Shteti Islamik ka theksuar ambicien e tij për t'u bërë një tregues i përhershëm në hartën e Lindjes së Mesme. Grupi nuk do të kishte qenë në gjendje të realizonte një shtrirje kaq të madhe ose të paraqesë veten si një entitet shtetëror, si e aftë për të kontrolluar territore dhe ushtruar pushtet mbi një popullsi prej miliona, në qoftë se ai nuk kishte qenë i armatosur plotësisht. ISIS zotëron një arsenal armatimi krahasueshëm me një ushtri konvencionale. Pjesë e arsenalit në zotërim kërkon njohuri në përdorim dhe mirëmbajtje që sipas të dhënave të shërbimeve të inteligjencës, ISIS nuk i disponon, çka mund ta çojë grupimin në nevojë rekrutimesh individësh me background ushtarak deri dhe me pagesa marramendëse për trajnime. Një kampanë alarmi dhe “mundësi” kjo për institucionet e sigurisë për të orientuar grumbullimin e informacionit dhe penetrime në radhët e propaganduesve, rekrutuesve, financuesve deri te grupimi për të marrë informacion mbi taktikat dhe teknikat për realizimin e objektivave dhe mundësuar kështu monitorimin dhe parandalimin.

Ndërsa Siria bëhet përherë e më e ndarë, grupet ekstremiste krijojnë rrënjë më të thella e strehë më të sigurt atje. Rreziku rritet jo vetëm në Siri, por edhe në vendet që luajnë pritësin për refugjatët sirianë. Refugjatët mund të jenë kategoria më e mundshme si target për rekrutime të mëtejshme.

Në Master planin ”dhjetë shtetet e dekadës tjetër” të shtetit islamik përfshihet edhe Ballkani. Për herë të parë u përdor edhe gjuha shqipe në deklarata. Sado efekt propagandistik apo fantazi e shfrenuar mund të duket, nuk duhet vepruar sikur ngjarjet

po ndodhin në një planet tjetër. Është tashmë fakt që shumë vullnetarë nga Ballkani i janë bashkuar grupeve radikale islamiste në Siri dhe me bashkimin e Al Nusras me ISIS, një pjesë e tyre i janë bashkangjitur ISIS-it.

Pavarësisht motiveve të vullnetarëve nga trevat shqiptolëse, tendencave në rënie për shkak edhe të masave dhe adresimeve ligjore, rreziku qëndron. Kthimi i tyre në vendet e origjinës mund të krijojë premisa për themelimin e celulash radikale ekstremiste deri në organizim aktesh terroriste. Përçarjet dhe ambiciet mes grupeve për sferë influencash mund të çojnë militantët shqiptolës në ndërmarrje aktesh terroriste edhe në vendet e tyre të origjinës si mjet “për t’u bërë prezent dhe krijuar identitet në radhët e ISIS-it”.

Është shqetësues fakti, që kësaj radhe teatri i konfliktit sirian përfshiu një numër më të madh se çdo herë tjetër vullnetarësh shqiptolës. Pavarësisht faktorëve dhe motiveve që i shtynë të shkojnë në këtë rajon konflikti, kthimi i tyre në vend përbën një sfidë të shumëfishtë: sfidë për institucionet e sigurisë për të monitoruar aktivitetin e tyre në kthim, për të bërë diferencimin midis atyre që kthehen të zhgënjyer, të mashtruar dhe të bindur për t’iu kthyer jetës normale me ata që janë radikalizuar tashmë dhe kanë synime e plane konkrete; sfidë për institucionet e shtetit për të hartuar plane gjithëpërfshirëse për integrimin në jetën ekonomike dhe sociale të vendit, sfidë edhe për vetë komunitetin mysliman shqiptar për të elaboruar forma e metoda të predikimit dhe edukimit teologjik sipas islamit tradicional shqiptar, një shkollë fetare integruese e paqedashëse.

Çështja e politikave dhe masave diferencuese mbi vullnetarët e kthyer nuk është vetëm një problem vetëm i yni, ballkanas, por edhe evropian e më gjerë, çka kërkon

koordinim dhe bashkëpunim edhe për harmonizim të kuadrit ligjor në nivel rajonal. Mënyra e trajtimit nga autoritetet shtetërore të vullnetarëve të kthyer, do të ketë një ndikim të rëndësishëm në sjelljen e tyre në të ardhmen

Roli i komunitetit ndërkombëtar është i rëndësishëm, si për integrimin e plotë të të kthyerve, ashtu edhe për identifikimin e menaxhimin e atyre që mund të paraqesin rrezik. Autoritetet shtetërore nuk mund ta bëjnë vetëm këtë. Atyre do t'u duhet ndihma e komunitetit ndërkombëtar për një monitorim afatgjatë të të kthyerve.

Shqipëria nuk është immune ndaj këtij kërcënimi. Vendi ynë ka qënë pjesë e koalicionit ndërkombëtar “Liria e Irakut”, pjesë e misionit të NATO-s, ISAF në Afganistan, është tashmë pjesë e koalicionit ndërkombëtar kundër shtetit islamik, dhe vendi ynë është i angazhuar me kontribut konkret në mbështetje e armatime qeverisë irakene dhe kurdëve të Irakut. Pjesëmarrja e vendit tonë në këto koalicione ka gjetur mbështetje të gjerë në terrenin shqiptar. Nuk ka pasur asnjëherë deri më sot protesta kundër marrjes pjesë në Afganistan apo gjetkë, siç ka pasur raste në disa vende perëndimore. Faktori ynë politik e social është mbështetës i këtij kontributi domethënës që jep vendi në kuadër të sigurisë kolektive e globale. Por, gjithsesi përfshirja e Ballkanit në hartën e shpallur të shteti islamik, sado propagandistik të jetë, duhet të tërheqë vëmendjen e institucioneve të sigurisë për të adresuar analiza afatgjata në ndihmë të ndërtimit të politikave parandaluese.

Aktet terroriste në France, aktet barbare nga grupi i kryesuar nga Boko Haram në Nigeri, situata në Jemen etj, me synim krijimin e një shteti islamik atje, indikacionet për akte terroriste edhe në vende të tjera perëndimore janë një sirenë alarmi për

dimensionin ndërkombëtar të kërcënimit terrorist dhe një ridimensionim në çështjet e sigurisë.

4.7. Lidhja midis Shkollës së Kopenhages, fenomeneve (Krimi i organizuar & Terrorizmit) dhe Shqipërisë si rast studimor.

Por në çfarë raportesh qëndrojnë midis tyre qasja teorike, fenomenet e marra në shqyrtim dhe rasti studimor? Sikurse është argumentuar dhe në seksionet e mëparshme të këtij punimi, një ndër risitë kryesore të Shkollës së Kopenhagen-it është thellimi dhe zgjerimi i konceptit të sigurisë. Nëse thellimi lidhet me nivelet e analizës, zgjerimi nënkupton përfshirjen në spektrin e sigurisë të fenomeneve të reja të cilat përbëjnë kërcënim për sigurinë e aktorëve. Këto kërcënime kanë të bëjnë kryesisht më të ashtëquajturën kërcënime jo-tradicionale duke përfshirë dhe aktorë jo shtetëror në ndryshim nga qasja tradicionale të Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Në këtë mënyrë vendoset një lidhje e qartë midis qasjes teorike të përdorur dhe fenomeneve të marra në shqyrtim. Si terrorizmi ashtu edhe krimi i organizuar bëjnë pjesë në kërcënimeve jo- tradicionale ndaj sigurisë. Duke qënë se vetë Shkolla e Kopenhagen-it ngrihet kryesisht mbi bazën e qasjes konstruktiviste atëherë një rol të veçantë merr ligjërimi dhe perceptimi ndaj fenomeneve të ndryshme. Një fenomen konsiderohet si çështje sigurie kur ai perceptohet dhe artikullohet si i tillë. Në funksion të këtij argumenti një vend të rëndësishëm në punim zë edhe procesi i sigurizimit. Prandaj, përzgjedhja e kësaj kornize teorike është në funksion të përmbushjes së qëllimit të këtij punimi, i cili është të analizojë implikimet e krimit të organizuar dhe terrorizmit në nivelin e sigurisë.

Duke qënë se modeli i hulumtimit i përzgjedhur për këtë studim është ai i rastit studimor, korniza teorike aplikohet në studimin e implikimit të krimit të organizuar dhe

terrorizmit në Shqipëri dhe në qasjen e ndjekur për trajtimin e këtyre fenomeneve dhe rekomandimeve me qëllim përmirësimin e situatës. Për të realizuar këtë synim, studimi i rastit të Shqipërisë fokusohet në evoluimin e konceptit të sigurisë në vendin tonë, duke u ndalur në analizimin e dokumentave strategjik të sigurisë kombëtare; në identifikimin e tipareve të krimit të organizuar dhe terrorizmit sikurse dhe tek qasjet ndaj tyre; në procesin e (mos)sigurizimit ndaj fenomeneve si dhe në analizimin e dy dokumentave strategjik, SSK dhe SSU me qëllim vlerësimin e përshtatshmërisë së tyre me mjedisin e ri të sigurisë.

Kapitulli V: Analizë e mjedisit të sigurisë në vendin tonë (Shqipëri)

“Në themel të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë është aspirata e popullit shqiptar dhe vullneti politik për të realizuar vizionin e përbashkët, për një atdhe që garanton siguri, drejtësi, barazi dhe mirëqenie për të sotmen dhe brezat e ardhshëm; një vend i lirë, demokratik dhe i zhvilluar, anëtar i përkushtuar i NATO-s dhe i integruar në Bashkimin European”. (SSK, 2014: 3)

Shqipëria trashëgon një kulturë të pasur dhe histori komplekse. Kombi shqiptar është përballur dhe ka kapërcyer sfidat e shumta, të cilat kanë përcaktuar zhvillimin dhe kanë formësuar karakterin e tij. Shqyrtimi i mjedisit strategjik, nxjerr në pah se rreziqet ndaj sigurisë kombëtare nuk janë të izoluara nga njëra - tjetra por të lidhura dhe të ndërvarura. Siguria jonë ndikohet nga një ndërthurje e rreziqeve tradicionale dhe jo tradicionale, të shkaktuara nga krimi i organizuar, individë të korrumpuar, terrorizmi, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë dhe armëve me rreze të largët veprimi, përfshirë rreziqet ekonomike, politike dhe ndaj qeverisjes së mirë. Këto kërcënime burojnë nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Analiza e mjedisit të sigurisë merr në konsideratë të gjithë elementet e sigurisë kombëtare si një proces që shqyrton tërësinë e përparësive, dobësive dhe mundësive që ofron mjedisi strategjik dhe rreziqeve me të cilat përballet vendi. Rreziqet aktuale ndaj sigurisë kombëtare janë më të ndërlikuara dhe të ndërvarura se në të kaluarën. Zgjerimi dhe thellimi i konceptit të sigurisë pasqyroj një qasje shumë sektoriale mbi sigurinë. Në ditët e sotme rreziqet ndaj sigurisë kombëtare nuk janë vetëm të karakterit ushtarak (objekti referues shteti); por edhe kërcënime ndaj sigurisë ekonomike (objekt referues ekonomia kombëtare); siguria shoqërore (objekti referues identitetet kolektive); siguria politike (objekti referues

sovrانيتeti kombëtar/ose ideologjia); siguria mjedisore (objekti referues ekosistemi dhe speciet).

Me gjithë tendencën e qartë pozitive, siguria e vendit vijon ende të jetë e varur ndjeshëm nga rreziqe me natyrë të brendshme sikurse dhe nga rreziqe të jashtme të cilat krijojnë sfida të reja në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe kohezionin social. E thënë ndryshe, analiza e sigurisë realizohet në tri nivele. Në nivelin e brendshëm, siguria e Shqipërisë kërcënohet nga korrupsioni, operimi i veprimtarive të krimit të organizuar dhe terrorizmit, të cilat cenojnë shtetin e së drejtës, institucionet tona kombëtare dhe zhvillimin e ekonomisë. Këto fenomene gjejnë hapësirat dhe kushtet e favorshme për të fuqizuar veprimtaritë e tyre, si pasojë e shumë faktorëve si institucionet e brishta, mos zbatueshmëria e ligjit, ekonomia e dobët, besimi i ulët i qytetarëve tek institucionet e shtetit, etj. Në nivelin rajonal, siguria e Shqipërisë kërcënohet nga problematikat dhe konfliktet e mundshme të shteteve të rajonit, si pasojë e pretendimeve historike të trashëguara. Ndërsa në nivelin ndërkombëtar, siguria e Shqipërisë kërcënohet nga rreziqe të cilat nuk janë më vetëm konvencionale por edhe me natyrë hibride, rrjedhojë e veprimtarive të organizatave kriminale ndërkombëtare, grupeve terroriste, forcimit të aktorëve jo shtetërorë si dhe ndryshimeve klimaterike dhe demografike globale. Pavarësisht këtyre rreziqeve, vendi ka aftësi për të ushtruar kontroll të mjaftueshëm mbi ngjarjet që kanë burim të brendshëm. Këto aftësi maksimizohen përmes proceseve të vendimmarrjes. Anëtarësia në NATO, afrimi i vazhdueshëm me Bashkimin European dhe prania aktive në sistemet e tjera të sigurisë ndërkombëtare paraqesin një garanci të besueshme për përballjen me faktorët e rrezikut me burim të jashtëm.

Kuptimi dhe trajtimi tërësor i mjedisit strategjik krijon mundësinë për të marrë vendimet e duhura, për të përfituar nga mundësitë dhe për të minimizuar ekspozimin e vendit ndaj rreziqeve. Mënyra se si ne do të qasemi ndaj sfidave dhe mundësive do të jetë përcaktuese për të ardhmen tonë. “Siguri quhet momenti kur një çështje paraqitet si rrezik ekzistencial për një objekt të përcaktuar referues” [tradicionalisht, por jo medoemos shtetin, i cili përfshin qeverisjen, territorin dhe shoqërinë] (Collins, 2001: 151). Sfidat me të cilat ne përballemi ashtu sikurse edhe shtetet e tjera të sistemit ndërkombëtar janë të shumta por sfidat ekzistenciale të sigurisë sonë kombëtare duhet të konsiderohen krimi i organizuar dhe terrorizmi sepse ato ndikojnë në mos realizimin e prioritetit themelor të shtetit që është siguria dhe mirëqenia për qytetarët e tij, duke vënë në pikëpyetje ekzistencën e vetë shtetit. E nisur nga ky kërcënim madhor, këto dy çështje duhen sigurizuar, duhet aplikuar një proces i mirëfilltë sigurizimi (ndjekja e dy etapave të nevojshme të procesit) si dhe marrja e masave të jashtëzakonshme për zgjidhjen e këtij kërcënimi.

5.1.Evolimi i konceptit të sigurisë në vendin tonë

Koncepti i Sigurisë në vendin tonë ka ndjekur pak a shumë të njëjtin proces evoluimi si edhe në vendet e tjera, veçanërisht vendet e vogla. Deri në periudhën e përfundimit të regjimit komunist (1990) koncepti i sigurisë harmonizohej tërësisht me konceptin e mbrojtjes, sigurinë e tërësisë territoriale të shtetit shqiptar. Deri në këtë periudhë ne nuk mund të flasim për një dokument të mirëfilltë i cili të ketë trajtuar Sigurisë në konceptin e tij të gjerë, ndaj në mungesë të kësaj ne do të përpiqemi ti referohemi dokumenteve të cilat zëvendësonin ose plotësonin elementët e procesit të sigurisë. Për periudhën e formimit të shtetit


shqiptar deri në atë të mbretit Zog, është e pamundur ti referohemi ndonjë dokumenti konkret. Ajo që spikat gjatë kësaj periudhe është fakti që vendi ynë siguronte sovranitetin e vet nën protektoratin apo kujdesin e një fuqie të madhe apo traktateve ndërkombëtare të kontrolluara prej fuqive të mëdha.

Një analizë më të detajuar mund të realizojmë për periudhën e pas vitit 1944. Në Shqipërinë e pas Luftës së Dytë Botërore, siguria ishte e lidhur me ruajtjen e tërësisë territoriale dhe sovranitetin e vendit, e cila do të mund të realizohej vetëm nëpërmjet realizimit të disa objektivave të përcaktuara. Objektivat e përcaktuara me synim forcimin e sigurisë lidheshin me rindërtimin e vendit pas luftës, me zhvillimin ekonomik i cili do të mund të realizohej nëpërmjet aleancave të shtetit shqiptar me aktorë të rëndësishëm në sistemin ndërkombëtar, modernizimi i Ushtrisë Kombëtare, si dhe kundërpërgjigjja e menjëhershme ndaj çdo agresioni të mundshëm, i cili do të cenonte sovranitetin e Shqipërisë. Në aspektin e fuqisë së shtetit, në mënyrë të veçantë modernizimi i ushtrisë u konsiderua si prioriteti dhe elementi bazë që do të sillte forcimin e sigurisë; “Ushtria Popullore është fuqia e Armatosur e Republikës Popullore të Shqipërisë. Ajo ruan që të mos cenohen kufijtë e shtetit dhe shërben për mbrojtjen e paqes dhe të sigurisë” (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1946: Neni 94).

Realisht, gjendja e Shqipërisë nga vlerësimi strategjik dhe ekonomik pas përfundimit të Luftës së dytë Botërore paraqitej shumë e vështirë. Kjo vështirësi vihej re tek brishtësia dhe pasiguria shumë e madhe, e cila vinte nga kërcënimet e vazhdueshme dhe pretendimet territoriale të fqinjëve ndaj saj. "Miqësia" me Jugosllavinë e Titos kishte pësuar një thyerje të madhe (1948).

E gjendur në këto rrethana Shqipëria zgjodhi të bëhet pjesë e "Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit dhe të Ndhmës Reciproke" një traktat ky i bashkëpunimit midis vendeve të Lindjes.

Figura 1: Harta e Traktatit te Varshavës



Burimi: <http://www.concisewesternciv.com/images/europCdWrr.jpg>

Shqipëria ishte një nga tetë vendet e bllokut komunist që më 14 maj 1955 bashkë me Bullgarinë, Çekosllovakinë, Hungarinë, Poloninë, Gjermaninë Lindore, Rumaninë dhe Bashkimin Sovjetik nënshkruan këtë marrëveshje, që u njoh si "Traktati i Varshavës". Pjesëmarrja në një koalicion të tillë për Shqipërinë u konsiderua si një mundësi e mirë mbrojtjeje sepse në traktat parashikohej që në rast sulmi të armatosur ndaj një shteti pjesë e aleancës, do të ofrohej ndihmë ushtarake e menjëhershme nga shtetet e tjera. Gjithashtu, pjesëmarrja në këtë aleancë shtetesh i jepte jetë ëndrrës së drejtuesve të shtetit shqiptar për të pasur një kontakt më të drejtpërdrejtë me Bashkimin

Sovjetik, si superfuqia komuniste e kohës. Pra pjesëmarrja në Traktatin e Varshavës cilësohej me interes për Shqipërinë për disa arsye:

- ***Nga pikëpamja e sigurisë***, duke qenë pjesë e një aleance të tillë Shqipëria ndihej më e qetë dhe më e sigurtë karshi sulmeve të mundshme nga fqinjët.
- ***Nga pikëpamja ekonomike***, Shqipëria e ndodhur në një pozicion shumë favorizues e strategjik, në kryqëzimin e rrugëve midis Lindjes dhe Perëndimit, shpresonte se marrëdhënia e mirë me BS, do të sillte përfitime edhe nga ana ekonomike. Konfiguracioni gjeostrategjik i Shqipërisë, ishte mjaft i nevojshëm për Traktatin e Varshavës dhe vetë sovjetikët, të cilëve iu interesonte me çdo kusht një dalje në det, për të kontrolluar dhe mbajtur nën vëzhgim të përhershëm të gjithë Mesdheun e në këtë kuadër, Shqipëria synonte e pretendonte të fitonte të paktën ndihma ekonomike nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera të Europës Lindore.
- ***Nga pikëpamja politike***, regjimit të Hoxhës, përfshirja në Traktat i sillte më shumë siguri dhe prestigj dhe më shumë mundësi për jetëgjatësi politike.

Traktati i Varshavës konsiderohet si rasti i parë ku Shqipëria dhe regjimi i atëhershëm i Enver Hoxhës bëhet pjesë e një aleance kolektive ndërkombëtare. Traktati i Varshavës ishte jo vetëm një bashkim “vullnetar“ i vendeve të ish-kampit socialist në një aleancë ushtarake, por edhe një kundërpërgjigje ndaj strukturave ushtarake të perëndimorëve, siç ishte NATO-ja e themeluar në vitin 1949-të.

Vendi ynë nëpërmjet nënshkrimit të këtij pakti pati mundësinë të kishte kontakte më të drejtpërdrejta me Bashkimin Sovjetik. Miqësia e besimi ndërmjet vendeve komuniste të Traktatit të Varshavës arriti deri në atë pikë sa që Enver Hoxha pranoi t’u

jepte sovjetikëve bazën e Vlorës, që në të vërtetë ishte një pikë shumë e rëndësishme strategjike jo vetëm në Ballkan, por edhe më gjerë. Megjithatë, pati edhe momente kur udhëheqja shqiptare u gjet në një udhëkryq, në lidhje me qëndrimin ose jo në Traktatin e Varshavës. Në krye të listës së pakënaqësive, ishte qëndrimi tolerues e liberal i Nikita Hrushovit ndaj Titos dhe pastaj me radhë çështja polake, hungareze, kineze dhe së fundi vetë Baza e Vlorës. Këtyre pakënaqësive i'u bashkuan edhe ambiciet për pushtet personal të Enver Hoxhës, e cila ndikoi me tej në daljen 'de facto' nga ky traktat në vitin 1963, dhe 'de-jure' në vitin 1968.

Dalja në skenë e Kinës dhe përplasjes së saj me Bashkimin Sovjetik ndikuan në ndryshimin e kursit të politikës të Enver Hoxhës. Kjo u shfaq nëpërmjet një strategjie e cila u fokusua në afrimin e saj me Kinën, nëpërmjet një aleance e cila do ta ndihmonte Shqipërinë në zhvillimin e saj ekonomik. Ky zhvillim ekonomik do të përmirësonte akoma edhe më shumë realizimin e objektivit të modernizimit të ushtrisë. Partneriteti dhe bashkëpunimi midis dy vendeve u pa me pozitivitet edhe nga Kina, ajo e konsideronte Shqipërinë një pikë mbështetëse dhe strategjike për të depërtuar më tej në Evropë, si dhe e shikonte me shumë interes përkrahjen që mund ti jepte Shqipëria pranimi të Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), në cilësinë e anëtares së kësaj organizate. Për të arritur objektivat e saj strategjik, Kina i ofroi Shqipërisë një ndihmë të madhe ekonomike. Duhet theksuar fakti se nga pikëpamja logjike, kjo aleancë ishte gati e pamundur, po të kemi parasysh distancën gjeografike që i ndan të dy vendet, por pavarësisht kësaj, lidhjet e ngushta midis Shqipërisë dhe Kinës, zgjatën deri më 1977. Prishja e kësaj aleance erdhi si pasojë e divergjencave të shumta, kryesisht të karakterit ideologjik, më vonë edhe atyre me karakter politik midis të dy vendeve.

Megjithatë, sipas Vicker periudha pro-kineze nuk ka qenë aq e dobishme ekonomikisht për Shqipërinë sa kishte qenë aleanca e saj me sovjetikët (Vickers, 1998: 213). Në lidhje me sigurinë kombëtare nuk mund të lëmë pa përmendur marrëdhëniet e komplikuar (afrimi dhe përplasjeje), të Shqipërisë me Jugosllavinë e Titos. Mund të përmendim këtu nënshkrimin e një traktati miqësie dhe bashkëpunimi në fushën e ekonomisë mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në korrik të 1946-tës. Bashkëpunimi i tyre në fushën e ekonomisë kishte si qëllim integrimin e ekonomisë shqiptare dhe asaj jugosllave. Vlen të theksojmë se qeveria jugosllave i shikonte investimet në Shqipëri si investime të cilat lidheshin me të ardhmen e Jugosllavisë. Kërkesa për pranimin e Shqipërisë si republika e 7-të e Jugosllavisë, mund të konsiderohet si një nga momentet ku siguria jonë kombëtare u vu në kërcënim e shkrirjes së Shqipërisë në Federatën Jugosllave.

Pas dështimit të këtyre dy aleancave të mëdha, Shqipëria zgjodhi rrugën e izolimit total. “Shqipëria u bë një shtet kështjellë, sundimtarët e saj ishin të vendosur të mbronin sovranitetin dhe integritetin jo vetëm të Shqipërisë, por edhe të sistemit komunist” (Vickers, 1998: 213). Regjimi i ashpër komunist, i cili zgjati për gati një gjysmë shekulli (1944-1990), ndikoi drejtpërsëdrejti në mos zhvillimin e Shqipërisë si dhe e largoi akoma edhe më shumë nga vendet perëndimore dhe idetë e tyre liberale demokratike.

Arsyet të cilat ndikuan në strategjinë e vetë izolimit të Shqipërisë në atë kohë janë disa, por ndër më të rëndësishmet prej tyre mund të veçojmë:- Besimin e madh që kishte regjimi mbi faktin se Shqipëria pavarësisht se ishte një vend i vogël e me resurse njerëzore dhe ekonomike të kufizuara mund t’ia dilte të përballonte, madje edhe të fitonte kundrejt një armiku të mundshëm më të madh në numër dhe fuqi; -Besimi se

formimi i një Ushtrie Popullore me unitet dhe ndjenjë të lartë atdhedashurie, do të ishte elementi i nevojshëm i cili do ti siguronte mbrojtjen e nevojshme Shqipërisë; - Gjeopolitika, përplasja mes dy fuqive/botëve me ideologji të ndryshme (Lufta e Ftohtë) do e favorizonte Shqipërinë të gjente hapësirat e duhura për të “lundruar” mes dy kampeve; -Faktorët politiko-diplomatik në kuptimin që sado e fuqishme të bëhej ushtria shqiptare, secila nga superfuqitë ishte në gjendje përsa i përket fuqisë së kapaciteteve të përballonte një shtet të vogël dhe të varfër si Shqipëria, por kjo u përdor si një strategji nga qeveria shqiptare e asaj kohe për të rritur besueshmërinë e shoqërisë së saj ndaj pushtetit duke propaganduar se në nësë forcojmë dhe arrijmë të krijojmë një ushtri të fortë mund të garantojmë sigurinë tonë. Mbarimi i Luftës së Ftohtë e ballafaqoi Shqipërinë me mungesën e gjetjes së hapësirave për të operuar si më parë.

Kjo shprehte njëkohësisht ndryshimin e konceptit të sigurisë (mbrojtjes) nga ai që lidhej me aleanca politiko-ushtarake në një koncept që bazohej tërësisht vetëm në faktorin e brendshëm. Kalimi në këtë lloj koncepti dukej jo realist, për faktin se mjedisi rajonal i sigurisë në Ballkan bazohej në aleanca ndërkombëtare të cilat ishin në gjendje “luftë” të ftohtë dhe në çdo kohë vendi ynë mund të kthehej direkt apo indirekt në teatër konflikti.

Sikurse vihet re, qëllimet strategjike të Shqipërisë, mbrojtja e lirisë dhe e pavarësisë së atdheut, në atë kohë mbështeteshin në ndihmën e jashtme ose në konjunkturën ndërkombëtare gjë e cila ishte e njohur vetëm nga elita politike e asaj kohe jo e njohur nga populli, si dhe në faktorin e brendshëm, në forcën, në atdhetarinë, në trimërinë e popullit tonë, në armatosjen dhe përgatitjen e tij të gjithanshme, në gatishmërinë e lartë dhe të përhershme të Forcave të Armatosura (Republika Popullore

Socialiste e Shqipërisë, 1985: 11). Diktatura komuniste, argumentonte se ishte e domosdoshme armatosja dhe përgatitja ushtarake për të gjithë popullin, zëvendësimi i ushtrisë së përhershme të kazermës me popullin ushtar, me Ushtrinë Popullore si pjesë përbërëse të ushtrisë së madhe të popullit, duke bërë “të gjithë ushtarët qytetarë dhe gjithë qytetarët ushtarë” (Lenin, 1976: 254).

Pas një sërë nismash të ndërmarra për konceptimin e ri për mbrojtjen e vendit dhe të Forcave të Armatosura, Arti Ushtarak Popullor u implementua si strategji. Ky dokument i klasifikuar në atë kohë si sekret, përpiket të trajtojë të gjitha parimet që duhet të udhëhiqnin vendin dhe luftën e tij për përballimin e armikut, mënyrën se si duhet të bëhej kjo luftë dhe strategjitë operacionale e taktike që duheshin ndjekur në rast sulmi. Sikurse vihet re, në dokumentin strategjik të kohës “Arti Ushtarak i Luftës Popullore”, Shqipëria pretendonte vetëm të mbrohej në rast sulmi e jo të sulmonte ndonjë vend tjetër. Pra, strategjia ushtarake e kohës ishte e fokusuar mbi konceptin e mbrojtjes totale. Është interesante të studiojmë disa nga karakteristikat kryesore të Artit Ushtarak Popullor (doktrina mbrojtëse), pasi në mënyrë principiale ato i gjejmë edhe në dokumentet strategjik të vendeve të tjera, por dallimi kryesor qëndron në krahasimin e resurseve duke vlerësuar se siguria e vendit tonë në këtë periudhë kërcënohej për shkak edhe të raportit të forcave që mund të krijoheshin në rast konflikti :

- Mbrojtja e çdo pëllëmbë territori të shtetit, bazuar vetëm në forcat e veta të brendshme.
- Organizimi dhe përgatitja e gjithë popullit për mbrojtjen e atdheut, duke theksuar se objektivat politiko-ushtarakë në luftë, parashikohet të arrihen nga i gjithë populli dhe jo vetëm nga Ushtria Popullore.

- Përparësia e njeriut ndaj armës, pasi “fatin e luftës e vendos kurdoherë njeriu”.
- Përballimi i gjendjeve dhe situatave nga më të vështirat, me synim mundjen e armikut.
- Përgatitja për zhvillimin e një lufte të gjatë por që do të na ndihmojë në shkatërrimin e armikut (Hoxha, 1983: 411).

Të gjithë elementët e fuqisë kombëtare të shtetit Shqiptar duhet të ishin në funksion të mbrojtjes. Çdo gjë për mbrojtjen, çdo gjë për fitoren” (Arti Ushtarak i luftës popullore, 1985: 48). Duhet të theksojmë faktin që gjatë kësaj periudhe shpenzimet për mbrojtje (buxheti i mbrojtjes shkonte në 20% të GDP) ishin shumë të mëdha dhe kjo ndikoi në mos zhvillimin në aspektin ekonomik të Shqipërisë, por që do të kishte ndoshta të njëjta pasoja në rast të një konflikti të mundshëm. Pra gjatë kësaj periudhe koncepti i sigurisë rezultoi i pandashëm nga termi mbrojtje. Konceptet moderne për sigurinë në Shqipëri në këtë periudhë nuk njiheshin pothuajse fare e jo më të zbatoheshin. Siguria e vetme që njihesh ishte ajo ushtarake e cila theksonte sigurinë e shtetit mbi gjithçka. Për forcimin e sigurisë në këtë këndvështrim, Shqipëria e kësaj periudhe u mbështet tek modernizimi i forcave të armatosura si elementi kryesor i realizimit të mbrojtjes së tërësisë territoriale dhe sovranitetit të tij, tek aleancat me aktorë të rëndësishëm, tek izolimi (vetëmbrojtja popullore) dhe mbrojtja totale.

Mjedisi i ri gjeopolitik i shfaqur pas përfundimit të luftës së Ftohtë solli evoluimin e konceptit të sigurisë, pasi kjo periudhë u shoqërua me ndryshime të mëdha gjeopolitike dhe gjeostrategjike. Në aspektin gjeopolitik kemi rrëzimin/rënien e regjimeve komuniste në të gjitha vendet e Lindjes, pjesë e të cilave ishte edhe Shqipëria, dhe nisjen e një procesi për integrimin e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore në

strukturat e NATO-s dhe BE-së. Ky proces do të mund të realizohej vetëm me zhvillimet e kapaciteteve të tyre institucionale dhe realizmin sipas standardeve të rritjes së zhvillimit ekonomik dhe politik të tyre.

Shpërbërja e ish-Jugosllavisë solli problematika të reja me kufijtë e vendit dhe u shoqërua me fenomenin e një destabiliteti në rajon. Edhe në nivel global procesi u shoqërua me shfaqjen e rreziqeve të reja për sigurinë, të cilat nuk ishin njohur më parë në këto përmasa, si krimi i organizuar, terrorizmi, nacionalizmi, religjionet, mjedisi etj. Mund të themi që përsa i përket kërcënimeve nga nacionalizmi dhe religjionet/besimet fetare nuk ishin plotësisht të panjohura ato kishin qenë prezente edhe gjatë periudhës komuniste, por kjo formë regjimi i kishte pothuajse shuar fare me format dhe mënyrat që pushteti kishte përdorur në minimizimin e operimit të tyre.

Ndërsa përsa i përket nivelit strategjik, mjedisi i ri çoi në rikonceptimin e sigurisë, sepse u vlerësua qartë që nuk mund të kishte siguri kombëtare pa siguri rajonale dhe globale. Ky ishte një evoluim i konceptit të sigurisë, në ndryshim nga periudha e mëparshme, kur siguria u trajtua si siguri kombëtare në fuqizimin e shtetit në terma ushtarak për ruajtjen e balancimit të fuqisë në sistem. Ky lloj transformimi në çështjet e sigurisë solli domosdoshmërinë e një bashkëpunimi midis shteteve, duke krijuar premisat e nevojshme për krijimin e një rrjeti të zgjeruar të organizatave rajonale e ndër rajonale. Bashkëpunimi rajonal u kthye në një parakusht për realizimin e objektivit strategjik të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore për anëtarësimin e tyre në strukturat Euro-Atlantike (NATO-BE). Duhet theksuar fakti që bashkëpunimi rajonal mbart me vete dy aspekte shumë pozitive.

Së pari, ndikon në përmirësimin e gjendjes politike dhe ekonomike të vendeve të rajonit dhe së dyti, parapërgatit shtetet për t'u afruar në rrugën e integritit drejt aleancave të tjera më të mëdha e më të rëndësishme.

Mjedisi i ri i sigurisë ndikoi edhe në evoluimin e konceptit të sigurisë në realitetin shqiptar. Aderimi i Shqipërisë në OSBE, nënshkrimi i Aktit final të Traktatit të Helsinkit më 16 Shtator 1991 dhe të Kartës së Parisit për një Europë të Re më 17 Shtator 1991, shënuan ndryshimin e kursit të politikës shqiptare, daljen e saj nga vetë izolimi ndërkombëtar dhe përqafimi i vlerave perëndimore të lirisë, demokracisë dhe sundimit të ligjit⁶ (Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë). Prioritetet themelore të qeverisë shqiptare pas viteve 90-të ishin anëtarësimi i vendit në NATO dhe në BE. Ky konsiderohet si momenti i rikonceptimit të sigurisë kombëtare, tashmë i bazuar tek koncepti i mbrojtjes dhe sigurisë kolektive, krejtësisht i ndryshëm nga koncepti i mëparshëm. Në përmbushje të këtyre dy objektivave strategjike, Shqipëria filloi të bëhej pjesë e shumë bashkëpunimeve rajonale mbi sigurinë dhe zhvillimin ekonomik.

Mund të përmendim këtu disa prej tyre.

- Nismën e Europës Qendrore (CEI), në kuadër të procesit të integritit në BE. Qëllimi i kësaj nisme konsiston në bashkëpunimin e vendeve të rajonit në fushën politike, ekonomike si dhe tek marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë;⁷
- Procesi i bashkëpunimit midis vendeve të Europës Juglindore (SEECP), përsa i përket paqes, forcimit të sigurisë, stabilitetit të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, zhvillimit ekonomik-politik-shoqëror, drejtësia, lufta kundër krimit të organizuar, drogës dhe trafikeve të paligjshme të armëve dhe terrorizmit (Fita, 2011: 36).

⁶ Për më shumë shiko: <http://www.mfa.gov.al/>

⁷ Për më shumë shiko: <http://www.cei.int/>

- Iniciativa e bashkëpunimit të vendeve të Europës Juglindore (SECI), e sugjeruar nga SHBA-të në 1996, me qëllim bashkëpunimin rajonal ndër-kufitar, bashkëpunimin në sektorin e drejtësisë, në luftimin e fenomeneve si terrorizmi, krimi i organizuar, trafikimi i paligjshëm i drogave dhe i armëve;⁸
- Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore, i iniciuar në vitin 1999 nga Gjermania, e cila konsiderohet si nisma më e rëndësishme për rregullimin afatgjatë të marrëdhënieve të shteteve në rajon. Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore, pas vitit 2008, u shndërrua në Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC). Veprimtaria e saj fokusohet në pesë drejtime kryesore: në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror; në infrastrukturë dhe energji; në drejtësi dhe punët e brendshme; në fushën e sigurisë; - në bashkëpunimin parlamentar dhe kapitalit njerëzor (Broshurë e këshillit për bashkëpunim rajonal);
- Procesi i Stabilizim Asocimit (SAP), një proces specifik i BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor, për të mundësuar futjen sa më të shpejtë të shteteve në familjen europiane. Çdo vendi, i duhet të nënshkruajë në mënyrë individuale Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA), si një fazë e fundit përgatitore për negocimin e kandidaturës për në BE. (RSH, Fletorja zyrtare 14 korrik 2014);
- Procesi i angazhimit të vendeve të Europës Juglindore në bashkëpunimin e fushës së sigurisë dhe mbrojtjes rajonale (SEDM) në nivel Ministerial;
- Gjithashtu mund të përmendim edhe iniciativa të tjera ku Shqipëria është pjesë, si Organizatën e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BSCE), nismën Adriatiko-Joniane (AII), kartën e Adriatikut (A3), etj.

⁸ Për më shumë shiko: <http://secinet.info/>

Marrja pjesë në këto iniciativa të rëndësishme tregon se koncepti mbi sigurinë në Shqipëri ka pësuar një evoluim dhe bashkëpunimi jo vetëm ndërmjet shteteve të rajonit, por edhe me gjërë, konsiderohet si një domosdoshmëri për të përballuar sfidat që kërcënojnë sigurinë tonë kombëtare por edhe atë globale. Siguria jonë kombëtare është e lidhur me sigurinë rajonale dhe globale e cila tashmë bazohet tek përdorimi i diplomacisë, marrëveshjeve shumëpalëshe dhe tek zhvillimi i të gjithë komponentëve të fuqisë kombëtare (ekonomik-politik-shoqëror-diplomatik-ushtarak).

5.1.1 Analizë mbi dokumentet strategjik të sigurisë kombëtare

I pari dokument i rëndësisë së lartë strategjike për Shqipërinë post-komuniste, cilësohet një dokument i vitit 1996, i cili më shumë se një dokument i mirëfilltë strategjik ishte një përmbledhje diskutimesh të zhvilluara në kuadër të hapjes së kursit të parë të Kolegjit të Mbrojtjes, i cili pati mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e ku referuan diplomatë, politikanë e figura të rëndësishme akademike të çështjeve të sigurisë nga SHBA, Italia, Gjermania, Turqia, Anglia dhe Kolegji i Studimeve Strategjike "Xhorxh Marshall". Ky dokument, i emërtuar "Politika e Sigurimit Kombëtar në Shoqërinë Demokratike", hapi rrugën e studimit tërësor për problemet themelore të politikës së sigurimit e të mbrojtjes në vend, si dhe prirjet e integrimit me probleme analoge të politikës së aleancës, të cilat mund të hulumtohen drejt vetëm në kuadër të këtyre pasqyrimeve (Akademia e Mbrojtjes, 1996:9).

Politika e Sigurimit Kombëtar në Shoqërinë Demokratike pasqyron një sërë mendimesh dhe idesh përgjithësuese mbi nocionin e sigurisë në periudhën e pas Luftës së Ftohtë. Vihet re një përpjekje e qeverisë shqiptare për të mësuar nga praktikrat dhe

përvojat e shteteve të tjera në funksion të implementimit të strategjive mbi sigurinë kombëtare të Shqipërisë, duke marrë në konsideratë rrethanat dhe kushtet e vendit tonë. Mund të përmendim këtu referimin e mbajtur nga akademiku por edhe ushtaraku i lartë, gjeneral Karlo Zhan, mbi "Interesat Kombëtare dhe Politika e Sigurimit", ku duke iu referuar rastit italian, jep një kontribut të rëndësishëm në kuptimin se kush duhet të cilësohet e kush jo interes kombëtar për vendin. Ai e vendos theksin në faktin që "Në një botë gjithnjë e më të plotë e të ndërruar, përcaktimi i interesave kombëtarë të një shteti duhet domosdoshmërisht të marrë në konsideratë interesat kombëtare të shteteve të tjera" (Zhan, 1996: 47).

Ky dokument nuk mund të konsiderohet një plan konkret apo strategji e sigurisë sepse ai nuk ofron objektiva, qëllime, mjete dhe një mënyrë të qartë se si do të operojë shteti shqiptar për realizimin e hartimit dhe implementimit të një strategjie të sigurisë kombëtare të tij. Gjithashtu, ai nuk mund të konsiderohet një dokument strategjik sepse në të nuk shprehet qëndrimi i qeverisë dhe i shtetit ndaj çështjeve të sigurisë, element shumë i rëndësishëm ky për cilësimin e dokumenteve strategjik të një vendi. Megjithatë, pavarësisht faktit që në këtë dokument nuk merret në shqyrtim mjedisi i sigurisë, kërcënimet apo rreziqet me të cilat do të përballlet vendi ynë, ky dokument ka rëndësi për faktin që në këtë periudhë për herë të parë filluan të trajtoheshin dhe të merreshin në konsideratë çështje të cilat përfshiheshin në konceptin e zgjeruar të sigurisë. Këto çështje ishin të pa trajtuara më parë në realitetin shqiptar, e për pasojë nuk kishte patur asnjëherë një debat të hapur dhe të gjerë mbi këto çështje. Ky dokument shërbeu për bërjen e diskutimeve paraprake, të cilat më vonë çuan në hartimin e dokumenteve

strategjike si Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, apo Strategjisë Ushtarake të RSH.

Kushtetuta e Republikës dhe Strategjia e Sigurisë Kombëtare (SSK) janë dy dokumentet bazë që përcaktojnë parimet, organizimin, vlerat dhe sfidat e të ardhmes për shtetin dhe shoqërinë shqiptare. Dallimi midis tyre konsiston në faktin se Kushtetuta është dokument rregullator afatgjatë i shtetit të së drejtës, kurse SSK është një platformë me karakter kombëtar, në mbështetje të Kushtetutës dhe në funksion perspektiv. SSK pasqyron zhvillimet e politikave shtetërore për sigurimin e qytetarëve, të shoqërisë e të shtetit demokratik shqiptar ndaj kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme (Ministria e Mbrojtjes, 2005:7) ndaj edhe mund të konsiderohet në nivel hierarkik, superiore ndaj politikave të tjera të sigurisë, pasi merr në shqyrtim jo vetëm kërcënimet dhe rreziqet e brendshme por edhe ato në nivel rajonal e ndërkombëtar, duke mbajtur në vëmendje edhe mjedisin strategjik global.

Periudha e tranzicionit, e shoqëruar me destabilitet, mungese të theksuar kapacitetesh, kriza e vitit 1997, konflikti i Kosovës, etj., kanë shërbyer si faktorë të rëndësishëm për tej zgjatjen e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Shqipërisë. Dokumenti u miratua me ligjin Nr. 9322, Datë 25.11.2004 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK) të Republikës së Shqipërisë”. Po kështu, në vitin 2002 u miratua me anë të ligjit Nr. 8930 Datë 25 Korrik 2002 “Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë”, e cila edhe pse nuk ka të njëjtin nivel rëndësie me dokumentin e SSK, erdhi si vijim i procesit të Rishikimit të Plotë të Mbrojtjes Kombëtare (Ministria e Mbrojtjes, 2002:6).

Vihet re se Strategjia Ushtarake (SU) e Republikës së Shqipërisë, është përpjekur t'i trajtojë çështjet ushtarake nën një këndvështrim të ri, të ndryshëm nga ai i kohës së komunizmit, duke i dhënë përparësi mbrojtjes ushtarake, nëpërmjet zgjidhjes paqësore të konflikteve. Ajo nuk cënon integritetin dhe stabilitetin e vendeve të tjera dhe mbështet fuqishëm politikat e bashkëpunimit dhe jo të konfrontimit (Ministria e Mbrojtjes, 2002: 7). Rëndësia e SU, qëndron në faktin se ajo shërbeu si një dokument udhërrëfyes për të ardhmen e Forcave të Armatosura (FA) të RSH, duke e përqendruar vëmendjen në riorganizimin dhe modernizimin e tyre. Strategjia Ushtarake mund të thuhet se ka shërbyer si një dokument mbështetës për SSK e 2004. Gjithashtu edhe në Strategjinë Ushtarake të RSH në vitin 2007, vihet re ndjekja e të njëjtit kurs, një strategji mbrojtëse jo kërcënuese ndaj fqinjëve dhe komunitetit ndërkombëtar. Mbështetet tek parimi dhe inkurajimi i bashkëpunimit me fqinjët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me mjete diplomatike. Synimi i saj ishte ndërtimi i një force të përbashkët, kundërvepruese dhe me qëndrueshmëri të lartë.

Dokumenti i SSK-së 2004, është një dokument i cili pasqyron qëndrimin e qeverisë ndaj siguri dhe përpiqet të sjellë në vëmendje kërcënimet dhe rreziqet që i kanosen shtetit dhe shoqërisë shqiptare. Strategjia e Sigurisë Kombëtare përbën bazën nga e cila rrjedhin veprimet e tjera 'operacionale' e 'taktike', më të detajuara, lokale dhe më të zhdërvjellëta (Shiroka, 2010: 90). Gjithashtu ky dokument ofron mënyrat dhe mjetet në vijë të përgjithshme që duhen vënë në dispozicion për realizimin e siguri në përmbushje të interesave kombëtare të përcaktuara.

"Siguria" nuk nënkupton vetëm një koncept politik e ushtarak, karakteristikë e periudhës së komunizmit, por ajo nënkupton përfshirjen e aspekteve të gjithanshme të

veprimtarisë e shoqërisë në tërësi dhe shtetit demokratik. Ky dokument nuk kishte si synim trajtimin e të gjitha çështjeve të mundshme të sigurisë, por ai përqendrohet në një qëndrim të caktuar, që shteti mban për çështjet e cilësuar të rëndësishme për fushën e sigurisë, duke dhënë në vija të përgjithshme zgjidhjet e mundshme. Anëtarësimi në NATO dhe BE identifikohen si objektivat parësore në funksion dhe në dobi të sigurisë së vendit (Shiroka, 2010: 21). Ky dokument konsiderohet i rëndësishëm, sepse vihet re përcaktimi i interesave kombëtare i cili shërbeu si bazë për formulimin e politikës së jashtme të vendit dhe strategjive të tjera kombëtare. Në përshtatje të mjedisit të ndryshuar të sigurisë globale, Strategjia e Sigurisë Kombëtare e RSH, nuk u përqëndrua vetëm në çështje të tilla si ruajtja e sovranitetit shtetëror, integritetit territorial e mbrojtja e respektimi i qytetarëve, por mori në konsideratë edhe “mjedisin gjeostrategjik të sigurisë, shkallën e garancisë që japin sistemet kolektive të sigurisë, si dhe burimet e kapacitetet reale në dispozicion të vendit” (Republika e Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes, 2005: 11).

Kryesisht të gjitha Strategjitë e Sigurisë Kombëtare hartohen që:

- të sigurojnë që qeveria do t'i trajtojë të gjitha rreziqet në mënyrë gjithëpërfshirëse;
- të rrisin efikasitetin e sektorit të sigurisë duke optimizuar kontributet e të gjithë aktorëve të sigurisë;
- të drejtojnë zbatimin e politikës;
- të ndërtojnë konsensusin e brendshëm të vendit;
- të rrisin besimin dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar (Law, 2007: 12).

Duke pasur parasysh këto arsye dhe duke marrë në konsideratë praktikat e vendeve të tjera, SSK e RSH identifikoi si kërcënim dhe rrezik për sigurinë fenomene të ndryshme dhe i kategorizoi ato sipas tri niveleve të analizës:

- Në nivel të brendshëm :
 - o Krimi i organizuar në vend
 - o Destabiliteti politik
 - o Zhvillimi i pamjaftueshëm ekonomik
 - o Emigracioni i paligjshëm
 - o Fatkeqësitë natyrore
 - o Problemet demografike, kryesisht lëvizjet e pakontrolluara të popullsisë nga zonat rurale drejt zonave urbane
 - o Dezinformimi i opinionit publik
 - o Zhvillimi i pamjaftueshëm i arsimit, shkencës dhe kulturës
- Në nivel ndërkombëtar (rajonal):
 - o Përdorimi i forcës Ushtarake
 - o Ringjallja e ndjenjave nacionaliste apo konflikteve etnike
 - o Terrorizmi
 - o Krimi i organizuar
 - o Trafiqet e paligjshme
- Në nivel global:
 - o Përhapja e ASHM apo lëndëve radioaktive
 - o Ndotja e mjedisit
 - o Reduktimi i burimeve hidrike (Ministria e Mbrojtjes, 2005: 27-32).

Nisur nga ky kategorizim vlen të theksojmë faktin që Globalizimi, por edhe proceset e bashkëpunimit, kanë ndikuar që SSK e RSH të mos karakterizohet si një strategji e “mbyllur” kombëtare, pasi tashmë vendet nuk janë krejtësisht të izoluara por veprojnë në kuadër të marrëveshjeve reciproke. Interesante në këtë dokument është këndvështrimi që i bëhet çështjes shqiptare, duke theksuar se çështja kombëtare shqiptare synohet të arrihet nëpërmjet integritit europian dhe euroatlantik të vendeve të rajonit, si dhe zgjidhjeve që sigurojnë garanci afatgjatë dhe të pranueshme për bashkësinë ndërkombëtare (Ministria e Mbrojtjes, 2005: 21).

Nëse hedhim një vështrim mbi vendosjen e kërcënimeve, mund të identifikojmë që krimi i organizuar dhe terrorizmi janë konsideruar si kërcënime serioze të sigurisë sonë por edhe globale, dhe mbeten ende sot kërcënime tepër serioze për sigurinë. Risia që solli ky dokument lidhet me formulimin e parë serioz dhe konkret të një strategjie kombëtare në funksion të konsolidimit të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare. Gjithashtu pozitive është arritja e një konsensusi të plotë të aktorëve të ndryshëm mbi çështjet e sigurisë, trajtimi dhe identifikimi i kërcënimeve ndaj sigurisë së brendshme të shtetit dhe shoqërisë shqiptare, duke u bazuar jo vetëm në kushtetutën dhe legjislacionin shqiptar, por duke respektuar edhe marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare.

Megjithatë pavarësisht shumë aspekteve pozitive dhe risive që solli ky dokument strategjik, duhet të themi që sërish ky dokument mbart me vete kufizime, të cilat mund të lidhen me mungesën e eksperiencës së mjaftueshme për analizimin dhe trajtimin e këtyre çështjeve. Vihet re mos përcaktim i qartë i mjeteve dhe mënyrave që do të përdoren për të arritur zgjidhjet e duhura mbi problematikat dhe kërcënimet e shfaqura, e

cila shoqërohet edhe me një mungesë të zhvillimit të kapaciteteve të duhura. Elementët e fuqisë kombëtare në këtë periudhë karakterizohen nga një analizë zhvillimi jo e plotë.

5.2.Krimi i Organizuar në Shqipëri

Studiues të ndryshëm, referuar formave dhe qëllimeve të krimit të organizuar, vijnë në idenë se në vendin tonë nuk ka pasur organizime konvencionale të krimit të organizuar. Kjo edhe ndoshta për veçoritë specifike të historisë dhe traditës së vendit tonë. Megjithatë, kjo nuk i ka penguar studiuesit e huaj për të përcaktuar një hartë gjenetike të tendencave aktuale të grupeve të veçanta, bazuar në organizimet sociale dhe historike të shoqërisë shqiptare që në historinë e Mesjetës së Shqipërisë. Këto element socio-kulturor të trashëguar, të cilat përbëjnë sot dhe karakteristikat e krimit të organizuar shqiptar, lidhen me element të tillë si besa (premtimi për të ruajtur integritetin e grupit), lidhjet miqësore dhe farefisnore (grupet e krimit të organizuar kanë në strukturat e tyre individ nga e njëjta familje, miqësi apo fis), sikurse dhe hakmarrja (marrja e hakut si ndaj grupeve rivale ashtu edhe nga individët që mund të tradhetojnë grupin, është karakteristike e këtyre grupeve).

Sipas një studimi të institutit italian Rossell-i kemi shfaqjen e mafies shqiptare gjatë viteve 60-të. Kjo mafie sipas tyre u krijua nga Sigurimi i shtetit të atëhershëm nën regjimin komunist dhe filloi bashkëpunimin e tij me mafien italiane në rajonin e Pulias dhe ato merreshin kryesisht me trafikimin e cigareve (Fondazione Rosselli, European Commission, 1999: 24). Pavarësisht këtij studimi dhe analizës së tij duhet të tregojmë një kujdes të madh. E arsyeshmja në këtë rast do të ishte më shumë marrja e kësaj të dhënë në një formë këndvështrimi i cili mund të jetë i vërtetë, por për aq kohë sa ka një mungesë të theksuar të të dhënave konkrete në këtë

drejtim pohimi i saj do të ishte një dhënë jo plotësisht e besueshme. Të gjithë mund të kenë informacione sekrete apo dhe mund të hamendësojnë për ekzistencën e një mafie shtetërore ose mafia në kontrollin e shtetit, po për aq kohë sa nuk ka të dhëna të mjaftueshme ky pohim duhet të merret me rezerva.

Ekzistenca e kontrabandës edhe në regjimin komunist është e provuar nga disa burime të tjera referuese. Por mbetet pak e besueshme fakti i krijimit të mafies. Dhe kjo sepse studiuesit serioz, gati në tërësi vijnë në përfundimin se në regjimet diktatoriale fusha e veprimit të mafies bëhet shumë e kufizuar dhe gati inekzistente, pasi vetë regjimi nuk pranon konkurrencë në kontrollin e pushtetit. Pranohet përsëmbull që mafia siciliane pothuaj pushoi ekzistencën e vet gjatë regjimit të Musolinit. Në të njëjtën mënyrë nuk mund të flitej për mafien ruse në kohën e Stalinit. E njëjta situatë do të ishte edhe për çdo lloj grupimi në regjimin komunist, i cili kishte kontroll absolut të autoritetit të vet në të gjithë territorin.

Sipas zyrtarëve të FBI dhe raporteve të tyre, mafia shqiptare filloj të bëhej aktive në SHBA rreth viteve 80-të, si rezultat i emigrimit të shqiptarëve në Amerikë. Pra, operimi i formave të krimit të organizuar nuk është diçka e panjohur edhe për realitetin shqiptar, kryesisht në vëndet e tjera, pavarësisht faktit se ekzistojnë të dhëna shumë të pakta mbi këto veprimtari.

Zhvillimi dhe fuqizimi i aktiviteteve kriminale shqiptare erdhi pas viteve 90-të si pasojë e disa faktorëve të rëndësishëm që ndikuan në favorizimin dhe në krijimin e kushteve të përshtatshme për to dhe zgjerimin e fushës së operimit të veprimtarive të tyre. Situata në Shqipërinë e viteve 90-të (rënia e regjimit komunist dhe hapja e Shqipërisë drejt Perëndimit) paraqitej favorizuese për zhvillimin e dukurisë së krimit të

organizuar pasi: Pjesa më e madhe e popullsisë ishte e varfër dhe kishte probleme të theksuara dhe serioze të plotësimit të kushteve të mbijetesës; situata politike shoqërohej me situata de stabilizuese, sepse elita politike përpiqej më shumë të gjente mënyra për të mbajtur pushtetin, sesa mënyra për të rindërtuar shtetin. Nga ana tjetër, ndihmat ekonomike, financiare që jepnin vendet europiane dhe SHBA-ja, jo rrallë nuk mbërrinin në destinacion dhe përfundonin në persona apo grupe që nuk kishin asgjë të përbashkët me qëllimin dhe objektivat e kësaj ndihme. E gjithë kjo situatë e paraqitur shërbeu si moment i favorshëm për operimin e veprimtarive kriminale dhe përfitimet e tyre ekonomike.

Një nga format e veprimtarisë kriminale është trafikimi i qenieve njerëzore. Në Shqipëri trafikimi i qenieve njerëzore ka ardhur si rezultat i mungesës së një ligji antitrafik dhe situatë socio-ekonomike por edhe të sigurisë në Shqipërinë e viteve '90. Vihet re që vetëm pas vitit 2001 trafikimi i qenieve njerëzore u konsiderua si një problem madhor dhe pas këtij identifikimi filloi edhe marrja në konsideratë e formave dhe mjeteve për të goditur dhe parandaluar këtë fenomen. Hapi i parë lidhej me ndërmarrjen e reformave ligjore, të cilët e konsideronin trafikimin si vepër penale. Sipas statistikave të Raportit të Vlerësimit për zbatimin e Sigurisë Kombëtare për luftën kundër trafikut të qenieve njerëzor 2005-2007, Shqipëria nuk është vend tranziti apo destinacioni, ajo kryesisht është një vend origjine për trafikun ndërkombëtar të femrave dhe fëmijëve. Vendet kryesore destinacioni për gratë dhe vajzat shqiptare janë Greqia, Italia, Maqedonia, Kosova. Identifikimi i vonshëm i këtij problemi madhor u ka krijuar kushtet e nevojshme grupeve kriminale për operimin dhe shtrirjen e kësaj veprimtarie.

Disa nga arritjet e qeverisë shqiptare në periudhën 2005-2007 kanë konsistuar në ngritjen e Njesisë Anti-Trafikim në Ministrinë e Brendshme në varësi të Koordinatorit Kombëtar për luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, si dhe angazhimi i tyre në ngritjen e një baze të dhënash mbi këtë fenomen dhe luftën ndaj tij. Megjithatë duhet të theksojmë se pavarësisht disa përpjekjeve pozitive vihet re një zbatim i pjesshëm i kuadrit ligjor kundër trafikimit si dhe të dhënat zyrtare të pamjaftueshme në këtë drejtim (Republika e Shqipërisë, Ministria e Brendshme, Strategjia Kombëtare e Luftës Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010). Analizimi i të dhënave zyrtare mbi personat e trafikuar nxjerr në pah se edhe në ditët e sotme Shqipëria vazhdon të konsiderohet vend origjine për trafikimin e burrave, grave dhe fëmijëve që i nënshtrohen shfrytëzimit brenda dhe jashtë vendit, sidomos në Belgjikë, Francë, Gjermani, Itali, Irlandë, Holandë, Zvicër, Mbretëria e Bashkuar (Strategjia dhe Plani kombëtar i veprimit 2014-2017.) Pavarësisht masave të ndërmarra ndër vite, trafikimi i qenieve njerëzore edhe në ditët e sotme është një problem dhe janë të njëjtët faktorë të cilët e nxisin - pasiguria dhe situata e rënduar ekonomike e tyre. Kjo formë përdoret nga grupet kriminale, sepse përfitimet e tyre janë shumë herë më të larta sesa kostot e përfshirjes. Megjithatë, duhet të theksojmë se në ditët e sotme Shqipëria nga një vend origjine konsiderohet më shumë si një vend transit për trafikimin e qenieve njerëzore

Mund të përmendim bashkëpunimet e para të grupeve kriminale me mafien italiane, duke fituar një farë autonomie në menaxhimin e drogës, shfrytëzimit të prostitucionit dhe tregut të zi për bashkëkombësit e tyre në Itali (Europol, 2004: 22) si

dhe bashkëpunimin ndërmjet grupeve kriminale shqiptare, turke, maqedonase dhe kosovare në trafikimin e heroinës. Ky bashkëpunim favorizohet nga pozicioni gjeografik i Shqipërisë midis vendeve prodhuese të drogës së fortë në Lindje, siç janë Afganistani dhe Turqia, dhe vendeve konsumatore në Perëndim, siç janë shtetet anëtare të BE-së (Zhillari & Lamallari, 2015: 19).

Përsa i përket drogave të paligjshme, vihet re se ndër vite, qeveritë shqiptare kanë bërë përpjekje për luftën kundër trafikut të tyre dhe kjo reflektohet në miratimin e të gjitha konventave të Kombeve të Bashkuara, në miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër drogës 2004-2010, në miratimin e planit kombëtar të veprimit etj. Megjithatë, akoma shfaqen problematika madhore në këtë drejtim. Ende në ditët e sotme Shqipëria vazhdon të konsiderohet si një vend transiti për heroinën me origjinë nga Afganistani si dhe një vend transiti për kokainën e prodhuar në Amerikën Latine, që përbën edhe veprimtarinë kryesore të grupeve kriminale shqiptare sot (OCTA 2009: 34).

Përdorimi i Shqipërisë si një vend transiti për kokainën që prodhohet në vendet e Amerikës Latine dhe transportohet në Europë paraqitet edhe në raportet e UNODC –së (UNODC 2013.) Përveç kokainës dhe heroinës, në realitetin shqiptar vihet re edhe kultivimi i kanabisit në një pjesë të konsiderueshme të territorit shqiptar si Malësia e Madhe, Tropojë, Krujë, Dibër, Mallakastër, Vlorë, Berat, Tepelenë, Gjirokastrë, Lazarat. Ky kultivim është favorizuar nga kushtet klimaterike të vendit dhe prodhimi shkon për konsum të brendshëm, por edhe si destinacion për konsumatorët e vendeve të Europës. Grupet kriminale përdorin si vende transiti Malin e Zi dhe Kosovën për trafikimin e saj në vendet Skandinave dhe të Europës Qendrore. Gjithashtu, në operacionin e zhvilluar në Lazarat janë zbuluar 5 laboratorë të përpunimit dhe prodhimit të vajit të hashashit, e

cila tregon se gjithnjë e më shumë po vihet re një sofistikim i grupeve kriminale përsa i përket trafikimit të drogës¹⁰. Theksojmë se trafikimi i drogës, si një drejtim i rëndësishëm i veprimtarive kriminale, në realitetin shqiptar ka kaluar në disa etapa:- trafikim nga jashtë për përdorim në tregun e brendshëm dhe transit; - kultivim i bimëve narkotike për eksport, ngritja e laboratorëve për përpunim në vend me qëllim rritjen e vlerës si mall në treg; -sofistikim i mjeteve të transportit së saj nëpërmjet përdorimit të automjeteve, gomoneve deri tek përdorimi i avionëve të vegjël (pra përdorimi i tokës, detit dhe ajrit); - zgjerimi i zonës së kultivimit nga veriu në jug, pra i hapësirës territoriale të Shqipërisë.

Rrugët nëpërmjet të cilave është trafikuar droga nga grupet kriminale shqiptare me destinacion Italinë, kanë qënë përdorimi nga ata i porteve detare të Durrësit dhe Vlorës. Ndërsa rrugët e ndjekura për trafikimin e saj në Greqi kanë qënë përdorimi i pikave kufitare të Kapshticës dhe Kakavijës. Në ditët e sotme vihet re trafikimi i drogës nëpërmjet Korfuzit, duke përdorur si pikë strategjike qytetin e Sarandës (Koromani, 2014). Pyetja që shtrohet në këtë rast: Si ka mundësi që ky trafikim të rezultojë i suksesshëm kur njihet/dihet se nga kalon? Një nga format që përdorin grupet kriminale është bashkëpunimi dhe infiltrimi i tyre në radhët e policisë, ryshfetet dhe ushtrimi i formave të presionit dhe pushtetit në radhët e doganierëve, për lehtësimin e veprimtarisë së tyre. Mirëpo pavarësisht kësaj në realitetin shqiptar bëhet shumë e vështirë verifikimi i tyre si rezultat i mungesës së të dhënave dhe rasteve të regjistruara të bashkëpunimit të grupeve kriminale me policinë dhe doganat. Kjo mungesë e theksuar behet shkak që në këtë drejtim kjo formë e bashkëpunimit të mbetet thjeshtë në kuadrin e konstatimit dhe besimit që kjo gjë ndodh, duke e vështirësuar pohimin e një e besueshëm të këtij fakti.

¹⁰ Për më shumë shiko: <http://www.asp.gov.al/index.php/rezultatet-e-operacionit-ne-lazarat>

Një faktor i rëndësishëm që ndikoi në zgjerimin e fushës së këtyre veprimtarive kriminale, pas viteve 90-të konsiderohet kriza/kolapsi ekonomik i vitit 1997-të, e cila u shoqërua me destabilitet, rrezikimin e rendit kushtetues, përmbysjen e qeverisë dhe me mungesën e sundimit të ligjit. Kjo krizë çoi në rritjen e nivelit të papunësisë, nivelin e lartë të informalitetit, mjedis shumë i përshtatshëm për legjitimimin e kapitaleve të paligjshme të veprimtarive kriminale në kapitale të ligjshme (nëpërmjet procesit të njohur të pastrimit të parave). Forma e përdorur nga persona të implikuar në krimin e organizuar ishte investimi në fusha të ndryshme, veçanërisht në ndërtime, por mund të themi që kjo e dhënë vazhdon ende sot të mbetet në kuadër të një perceptimi si rezultat i mos transparencës së të dhënave.

Gjithashtu situata e konflikteve në rajon ka ndikuar në rritjen e mundësive të bashkëpunimit të grupeve kriminale shqiptare me grupe kriminale jashtë territorit të saj. Konflikti i Kosovës, ndikoi në rritjen e trafikut të femrave dhe prostitucionit, veprimtari të përdorura nga grupet kriminale dhe kjo raportohet nga agjencia Interpol. Kjo formë e përdorur u pa si një mundësi e mirë për përfitimin të shpejta, të cilat do të shërbenin më tej si mjet për forcimin e trafikimit të drogës, për një logjistikë më të mirë dhe të sigurtë si dhe në korrupsionin e zyrtarëve të lartë, si një strategji për vazhdimësinë e veprimtarive të tyre kriminale.

Si përfundim në këtë pjesë mund të themi që: -Zakonisht struktura e grupeve kriminale të cilat merren me trafikimin e qenieve njerëzore është në formën e një celule e përbërë nga 3-5 persona të cilët bashkëpunojnë shpesh edhe me grupe të tjera. Edhe në

ditët e sotme trafikimi i qenieve njerëzore mbetet një problem edhe pse ka njohur rënie si pasojë e ashpërsimit të masave ligjore kundër saj. Ndërsa përsa i përket strukturës së organizimit të këtyre grupeve kriminale, mund të themi që ndër vite ajo ka njohur evoluim. Krimi i organizuar shqiptar është i bazuar tek modeli italian, tek mbështetja e lidhjeve të forta familjare dhe shoqërore, tek përdorimi i dhunës morale dhe psikologjike (shantazhi si formë) dhe korruptimi i zyrtarëve të lartë me synim mos identifikimin dhe ndëshkimin nga autoritetet e shtetit. (Senator Alberto 2007).

Grupet kriminale në përgjithësi janë të përbërë nga 3-4 anëtarë. Megjithatë, nëse do ta ndanim në periudha, mund të konstatojmë se rreth viteve 1997-1999 kemi shfaqjen e bandave, të cilat karakterizoheshin nga përdorimi i lartë i dhunës, veprimi i hapur, numri i lartë i anëtarëve si dhe kontrolli mbi lagje apo qytete të caktuara. Veprimtaritë e tyre ishin të fokusuara tek vrasjet dhe grabitjet e pronës private. Mund të përmendim disa prej këtyre bandave, si ajo e Gaxhait, e Pusit të Mezinës, e Rrugës së Kavajës, e Çoles (Zani Çausht). Më pas si rezultat i sofistikimit të organizimit, logjistikës dhe territorit, kemi shfaqjen e grupeve kriminale të specializuara në trafikimin ndërkombëtar të drogës, prostitucionit, klandestinet dhe kontrabandës. Mund të themi se tipike e kësaj forme të sofistikuar të shfaqur është banda e Durrësit dhe ajo e Lushnjës. Grupet kriminale në këtë periudhë janë karakterizuar nga struktura hierarkike e organizimit të tyre. Vihet re se pas viteve 2005 e deri më sot, gjithnjë e më tepër grupet kriminale kanë zgjedhur si formë të organizimit të tyre, ndërveprimin në mënyrë aktive me rrjetet kriminale por gjithnjë duke ruajtur autonominë e tyre.

Kjo lloj forme konsiderohet nga grupet kriminale shqiptare, por jo vetëm, si forma më efiçente për shtimin e kapitaleve dhe përfitimeve nga veprimtaritë e tyre si trafikimi i llojeve të

ndryshme të drogës, armëve dhe trafikut të emigrantëve. Ndërsa përsa i përket trafikimit të qenieve njerëzore ajo nuk kryhet nëpërmjet formës së rrjetit, mbetet ende një veprimtari e cila kryhet nga bashkëpunimi i dy ose tre personave.

Shqipëria vazhdimisht e ka konsideruar krimin e organizuar si një fenomen i cili sjell pasiguri të madhe për shtetin, por edhe për qytetarët e saj. E në këto kushte, qeveritë shqiptare në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar kanë bërë përpjekje në përmirësimin e kuadrit ligjor. Mund të përmendim këtu amendamentet e ndryshuara në Kodin Penal në përshtatje me kriteret europiane. Gjithashtu miratimin e ligjeve Nr. 9248: Mbi parandalimin dhe goditjen e Krimit të Organizuar, apo ligjin Nr. 9084 mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave në vitin 2004, strategjitë kundër krimit të organizuar, etj. Pavarësisht disa arritjeve, ende sot krimi i organizuar me veprimtaritë e tyre përbëjnë rrezikun kryesor të sigurisë në Shqipëri, sepse këto veprimtari ndikojnë në paqëndrueshmërinë politike dhe ekonomike të vendit si dhe në mirëqenien e qytetarëve të saj.

Identifikimi në ditët e sotme i rritjes së nivelit të trafikimit të lëndëve narkotike si dhe bashkëpunimi i grupeve kriminale me grupe të tjera jashtë territorit shqiptar, e përforcon akoma edhe më shumë rrezikshmërinë e këtij fenomeni. Kjo për dy arsye, e para lidhet me faktin se rritja e trafikimit të drogës sjell më shumë kriminalitet në vend dhe korrupsion në agjencitë ligj zbatuese dhe e dyta, përdorimi i trafikimit të drogës përforcon pozicionet e grupeve kriminale shqiptare në tregjet ndërkombëtare, kjo si rezultat i bashkëpunimit me grupe të fuqishme që veprojnë brenda, por edhe jashtë Europës, rrit fuqinë e tyre financiare për të mbrojtur veprimtaritë e tyre duke i'a vështirësuar qeverive luftimin dhe parandalimin e fushës së zgjeruar të veprimtarive të tyre.

Megjithatë, është i rëndësishëm të theksohet fakti se përveç paaftësisë institucionale, vihet re edhe një reagim i dobët i shoqërisë shqiptare përkundrejt zhvillimit të këtij fenomeni. Ky reagim i dobët vjen si rezultat i besimit shumë të ulët që ka shoqëria tek institucionet dhe si rezultat i perceptimit të tyre mbi nivelin e lartë të korrupsionit që ekziston në realitetin shqiptar. Në këto kushte bëhet e domosdoshme sigurizimi i fenomenit të krimit të organizuar në Shqipëri, sepse ai përbën një rrezik ekzistencial për sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve të saj.

5.3.Lufta kundër krimit të organizuar si një parakusht i sigurisë dhe integritetit

Objektivi i parë i Shqipërisë post-komuniste lidhej me anëtarësimin e saj në NATO. E gjithë periudha deri në zyrtarizimin e Shqipërisë si anëtare më të drejta të plota e aleancës (2009) është karakterizuar nga një sërë reformash, të cilët përfshijnë ndryshimet ligjore dhe përshtatjen me standardet e kërkuara, me ndryshime konceptuale/doktrinarë/rishikimi i dokumenteve strategjike, me transformimin dhe modernizimin e forcave të armatosura (FASH), në reduktimin e tyre, specializimin e personelit, etj.

Anëtarësimi në NATO konsiderohet si një arritje e madhe për shtetin shqiptar dhe për sigurinë tonë. Por, në të njëjtën kohë ajo përbën edhe një sfidë të së ardhmes. Shqipëria, në kushtet e mjedisit të sotëm strategjik dhe gjeopolitik, duhet të tregojë barazi në përgjegjësi si çdo shtet tjetër anëtar i aleancës. Kjo do të mund të realizohet nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve ndërvepruese dhe elementëve të fuqisë kombëtare. Gjithashtu, realizimi i këtij objekti nuk mund të arrihet vetëm nga vullneti i mirë politik, por nga tregues konkretë.

Ndërsa objektivi i dytë, ai i anëtarësimit të saj në strukturat e BE, mbetet ende një sfidë e parealizuar. Gjatë gjithë këtyre viteve është bërë përpjekje për të përmbushur kriteret e përcaktuara nga Bashkimi European, të cilat lidhen me: 1- Forcimin e shtetit të së drejtës; 2- Zhvillimin Ekonomik; 3- Bashkëpunimin rajonal, (Drejtësia, Liria, Siguria). Në optikën e Bashkimit European, zgjerimi përmes anëtarësimit të vendeve të tjera, nga njëra anë është parë si një mundësi e mirë për të rritur sigurinë e përbashkët dhe përballimin e këtyre sfidave apo kërcënimeve por nga ana tjetër pranimi dhe integrimi i këtyre shteteve e sjell Bashkimin European më afër zonave problematike. Për këto arsye, Bashkimi European është shprehur vazhdimisht i gatshëm të ndihmojë shtetet që e aspirojnë integrimin, me synim forcimin e institucioneve të tyre, zhvillimin ekonomik dhe implementimin e strategjive për Mbrojtjen e Përbashkët Europiane në fushën e Sigurisë. Megjithatë, pavarësisht faktit të arritjeve dhe përmirësimit në disa drejtime, ka akoma shumë punë për tu bërë nga politika shqiptare.

Sot lufta kundër krimit të organizuar përbën një nga faktorët më të rëndësishëm të cilët pengojnë anëtarësimin tonë, sepse krimi i organizuar pengon zhvillimin dhe realizimin e objektivave si forcimi i shtetit ligjor, rendin, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore për funksionimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet fakti që kohët e fundit përfaqësuesit e Bashkimit European gjithnjë e më tepër po nënvizojnë në deklaratat e tyre që qeveritë shqiptare duhet të dokumentojnë të dhëna të besueshme përse i përket luftës kundër krimit të organizuar, duhet të dokumentojnë për një qëndrueshmëri në këtë drejtim dhe të japin rezultate konkrete, sepse ende në sektorin e sigurisë nuk janë arritur objektivat e duhura.

Problematika lidhet jo me mungesën e një strategjie kombëtare në luftën kundër krimit të organizuar, por me zbatueshmërinë dhe aplikueshmërinë efektive të kësaj strategjie. Në këto kushte, lufta kundër krimit të organizuar përbën një nga prioritetet kryesore në axhendën e sigurisë së shtetit shqiptar.

Shqipëria sot përballlet me kërcënime të brendshme dhe të jashtme. Në aspektin e brendshëm, Shqipëria përballlet me kërcënime të cilat lidhen me krimin e organizuar, trafiket e jashtëligjshme (drogë, armë, njerëz), fatkeqësitë natyrore, terrorizëm. Ndërsa në aspektin e jashtëm, Shqipëria përballlet me kërcënime të cilat lidhen me krimin dhe terrorizmin transnacional, përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, konfliktet rajonale, etj. Megjithatë, duhet theksuar fakti që të gjitha këto kërcënime ne i ndajmë me partnerët tanë të ngushtë; Bashkimin Europian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me fqinjët tanë, si dhe me vendet demokratike me të cilët ne ndajmë të njëjtat vlera.

Disa refleksione në konceptin e sigurisë, krijojnë idenë se krimi i organizuar, më tepër se terrorizmi, është një dukuri që nuk mund të quhet edhe më tej nacional. Ai ka evoluar në forma, struktura dhe dinamikën e vet, duke i kapërcyer kufijtë konvencionalë. Krimi i organizuar sot vepron në rrjet, të cilat janë multinacionale. Ndërthurja e organizimeve nacionale me rajonale duket se ka për bazë dy shkaqe kryesore. Së pari, në kërkim të tregjeve për objektivin e vet (drogë, trafik, prostitucion etj) ai detyrohet të marrë format e konglomeratit dhe integron në organizatat e veta pjesëtarë pa dallim kombësie, i orientuar vetëm mbi bazë objektiva interesi. Së dyti, ndërthurja i mundëson të lehtësojë konkurrencën e fortë që ekziston midis këtyre organizimeve. Kjo është një arsye përse edhe koncepti i sigurisë reflekton natyrën e evoluimit të rrezeve kërcënuese.

Në këto kushte edhe shteti shqiptar ka ndjekur të njëjtën strategji që përdorin edhe partnerët tanë. Për të parandaluar veprimtaritë kriminale i është dhënë një rëndësi e madhe bashkëpunimit rajonal, sepse ky bashkëpunim është parë si domosdoshmëri për të mbrojtur dhe rritur sigurinë. Bashkëpunimi rajonal ka qenë dypalësh dhe shumëpalësh. Mund të përmendim dokumentin bazë në luftën kundër Krimin “Strategjia Ndër sektoriale në Luftën kundër Krimin të Organizuar, Trafikeve dhe Terrorizmit” e miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë në Gusht të 2008. Vlen të theksohet se objektivat e përcaktuara dhe angazhimet e ndërmarra, janë në një linjë me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit. Në këtë strategji, vihet re një ndarje e detyrave dhe e përgjegjësisë që ndërmarrin të gjitha institucionet, në funksion të arritjes së rezultateve pozitive në luftën kundër veprimtarive kriminale. (Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Krimin të Organizuar, Trafikeve dhe Terrorizmit, 2008: 12-13). Pavarësisht ndarjes së përgjegjësisë dhe përcaktimit të detyrave kryesore, ende kërkohet më tepër për të arritur nivelin e duhur të bashkëpunimit dhe koordinimit midis institucioneve përkatëse të ngarkuara në luftën kundër veprimtarive kriminale.

Po ashtu përse i përket bazës ligjore, mund të shihet se ekziston një bazë e mirë ligjore në luftën kundër krimin të organizuar, por problematikë madhore mbetet fakti i mos zbatueshmërisë së ligjit, i cili ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në krijimin e një klime të madhe mosbesimi të qytetarëve ndaj shtetit dhe institucioneve të tij. Për të kuptuar faktin se përse përfaqësues të shumtë të Bashkimit Europian në deklaratat e tyre flasin për mos tolerim dhe për nevojën e rezultateve konkrete, të besueshme dhe të qëndrueshme në luftën kundër krimin të organizuar nga qeveria shqiptare në këto

momente, duhet të analizojmë objektivat e parashikuar nga Strategjia Ndërsektoriale, cilat prej tyre janë arritur dhe cilat nuk janë arritur ende..

Një Strategji parashikon objektiva afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Nga analizimi i kësaj strategjie, vihet re që janë arritur disa nga objektivat afatshkurtra dhe afatmesme, por nuk janë arritur objektivat afatgjatë. Objektivi strategjik afatgjatë i kësaj strategjie është, *“ndërtimi i një shoqërie pa kërcënime nga krimi i organizuar, në paqe dhe në përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve, duke dhënë në këtë mënyrë imazhin e një vendi të qetë e me standarde të larta të sigurisë”* (Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Krimin të Organizuar, Trafikeve dhe Terrorizmit, 2008: 22). Parashikohej se në fund të vitit 2013, Shqipëria do të ishte një vend i cili jo vetëm që do të mund të kishte identifikuar grupet kriminale por do t'i kishte shkatërruar këto grupe, ku operimi i veprimtarive kriminale do të ishte minimizuar dhe ato nuk do të përbënin një shqetësim për komunitetin, ndërsa niveli i sigurisë, zbatueshmëria e ligjit, respektimi i të Drejtave të Njeriut do të ishte i lartë. Mos arritja e këtij objektivi afatgjatë, që në njëfarë mënyrë përbën dhe shtyllën kryesore të Strategjisë vë në pikëpyetje anëtarësimin me të drejta të plota pranë strukturave europiane.

Gjithashtu, mund të përmendim edhe strategjinë ndërsektoriale në luftën kundër krimin të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit (2013-2020) si dhe Planin e veprimit (2013-2016). Synimi afatgjatë i kësaj strategjie konsiston në realizimin e objektivit të krijimit të një mjedisi sa më të sigurtë për shoqërinë shqiptare, duke minimizuar kërcënimet nga krimi i organizuar dhe terrorizmi, si dhe sundimi i ligjit në vend. Në këtë strategji nënvizohet angazhimi dhe përgjegjësia e çdo institucioni shtetëror për ndërtimin e infrastrukturës së plotë ligjore, rritjen e kapaciteteve dhe

aftësive teknike-profesionale-operacionale, aplikueshmëria e masave si dhe rritja e bashkëpunimit ndërinstitutional për implementimin efikas të strategjisë.

Përsa i përket plotësimit të objektivit të forcimit të koordinimit institucional për bashkëpunim në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, plani i veprimit parashikon realizimin e aktiviteteve trajnuese efikase, rritjen e aksesit në data bazë-n e institucioneve përkatëse si dhe raportimet/statistikat e herëpashershme për të kuptuar ecurinë. Masat e ndërmarra në Planin e Veprimit për përmbushjen e objektivit të parandalimit të trafikut të drogës, trafikimit të qenieve njerëzore etj., janë intensifikimi i strukturave shtetërore me qëllim identifikimin, hetimin dhe dënimin e atyre që kryejnë këto veprimtari, krijimi i një sistemi të konsoliduar të dhënash periodike, përmirësimi i legjislacionit penal dhe identifikimi i potencialeve njerëzore që mund të bien preh e trafikimit të qenieve njerëzore si dhe ulja e prodhimit të kanabisit në shumë qytete të Shqipërisë. Ndërsa përsa i përket përmbushjes së objektivave, si parandalimi dhe goditja e procesit të pastrimit të parave, dobësimit të financave të rrjeteve kriminale të krimit të organizuar dhe terrorizmit, masat e ndërmarrura nga Planin e Veprimit do të jenë, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive të tyre (Strategjia Ndërsektorale në luftën kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të paligjshme dhe Terrorizmit, 2013).

Në kushtet e sotme bëhet i domosdoshëm, jo vetëm angazhimi maksimal i të gjithë institucioneve shtetërore por edhe ndërgjegjësimi i plotë i shoqërisë shqiptare. Për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit, kriminalitetit dhe terrorizmit në Shqipëri duhet të impenjohet e gjithë shoqëria, sepse ndodhemi përpara një momenti kritik, i cili lidhet jo vetëm me rrezikimin e Integritetit tonë pranë strukturave europiane, por me rrezikun ekzistencial të brendshëm të shtetit shqiptar, pasi

vihet në pikëpyetje siguria dhe mirëqenia e qytetarëve të tij. Për ta ulur këtë nivel të lartë pasigurie nevojitet, vendosmëri dhe vullnet i përbashkët politik, presion shoqëror, shpejtësi reformash nga njerëz të cilët nuk kanë vetëm dëshirën e madhe, por vendosmërinë dhe motivimin e duhur për të mos u ndalur nga asgjë, me qëllimin e vetëm implementimin e reformave dhe krijimin e një niveli të lartë sigurie.

5.4.Veçori të operimit të terrorizmit.

Është e vështirë të flitet për organizime dhe aktivitet të grupeve terroriste në vendin tonë. Sipas deklarimeve zyrtare janë shfaqur veprime kriminale, por ato nuk janë shndërruar në aktivitete të grupimeve terroriste. Dhe kjo jo për meritë të organizimit dhe aftësisë së strukturave shtetërore sesa për veçori të organizmit social dhe traditës në vendin tonë. Por, nuk mohohet fakti se herë pas here janë krijuar situata të cilat në një mënyrë apo tjetër kanë favorizuar shtrirjen dhe operimin e këtyre lloj grupimesh në vendin tonë. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të boshllëkut dhe situatave kaotike që janë krijuar në periudha të ndryshme pas viteve '90. Nuk është e rastit që Shqipëria e pas viteve 90-të u bë një vend i dëshiruara si strehë për pjestarë të Xhihadit Islamik dhe Al- Kaedës. Faktorët të cilët ndikuan në lëvizjen e celulave të organizatave terroriste lidheshin me pozicionin gjeografik të vendit, me situatën kaotike në rajon, me numrin e lartë të popullsisë shqiptare që i përkiste besimit fetar mysliman dhe pothuaj një padije për rrymat e ndryshme brenda besimit, me situatën e paqëndrueshme politike, me institucionet e dobëta dhe paaftësinë e tyre për të ushtruar kontroll mbi kufijtë e territorit të Shqipërisë, me ekonominë e brishtë, me varfërinë e pjesës më të madhe të qytetarëve si dhe nga politikat e ndërmarrura nga qeveria shqiptare e asaj kohe.

Në formën e organizatave jo qeveritare, disa prej të cilave të mbështetura dhe të financuara nga Al-Kaeda, disa grupime filluan të operonin në Shqipëri nën petkun e organizatave humanitare për përmirësimin e kushteve në vend, duke krijuar kështu kushtet e favorshme për krijimin e bazave me qëllim promovimin e kauzës së tyre. Shqipëria bëhet vendi i parë në Europë i cili merr pjesë në Konferencën e Organizatës Islamike në vitin 1992. Nisur nga fakti që situata ekonomike në Shqipërinë post- komuniste ishte shumë e rënduar, u konsiderua se bashkëpunimi në investime do të ishte një përfitim pozitiv për rimëkëmbjen e ekonomisë shqiptare. Kjo shërbeu si momenti më i përshtatshëm për vërshimin e investimeve të huaja nga vendet islamike (saudite) në sektorë të ndryshëm si ato të telekomunikacionit, banka, transport, etj.

Prezenca në territorin shqiptar, ku besimi fetar në atë kohë ishte pak i organizuar, u mundësoi këtyre grupeve që të njihnin tërësisht gjendjen dhe nevojat e popullsisë së varfër, duke e konsideruar si një mundësi shumë të mirë për t'u shfrytëzuar. Taktikat që ato ndoqën ishin ajo e rekrutimit nëpërmjet dhënies së bursave e ndihmave për të studiuar në vendet arabe, kryesisht në institucione teologjike me të gjitha kostot e studimit të mbuluara nga ata (Deliso, 2007: 30-31). Kjo strategji e ndjekur do i shërbente shumë fuqizimit të rrjetit të tyre, ato do të mund të kishin mbështetje sepse do të konsideroheshin nga popullata shqiptare si individë të cilët ndihmojnë njerëzit në nevojë dhe gjithashtu pas kthimit të këtyre individëve nga studimet, jo rrallë ato do të ishin një burim shumë i mirë rekrutimi për njerëzit e tjerë por edhe për përhapjen më të gjerë të kauzës së tyre.

Një element tjetër i cili ndikoi për zgjerimin dhe operimin e grupeve ekstremiste fetare në Shqipëri ishin trazirat dhe kriza e viteve 1997-të dhe konfliktet në rajon si lufta

në Bosnje e më vonë në Kosovë, duke shfrytëzuar mungesën e sundimit të ligjit për të forcuar bazat e tyre.

Përsa i përket akteve terroriste me origjinë të brendshme të identifikuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, megjithëse ato shfaqen sporadike, mund të përmendim aktin e kryer në vitin 1995 në supermarketin VEFA në Tiranë, ku humbën jetën disa persona dhe pati dëme të konsiderueshme materiale. Ky akt i kryer u konsiderua si një akt terrorist i brendshëm, i kryer nga pjesarë të organizimit kriminal të njohur si "Hakmarrja për Drejtësi". Ndërsa përsa i përket aktit terrorist me origjinë të jashtme në bashkëpunim me shtetas shqiptar, u konsiderua akti i vitit 1994 në postën kufitare të fshatit Peshkopi, Gjirokastrë. Pjesëtarë të organizatës terroriste MAVI, u futën në territorin shqiptar, rrethuan repartin ushtarak, vranë 2 oficerë, plagosën disa ushtarë, rrëmbyen dy prej tyre si dhe plaçkitën të gjithë armatimin e disponuar nga ky repart (Strategjia ndërsektorale në luftën kundër Terrorizmit, 2011-2015, 7573). Gjithashtu mund të përmendim aksionin e autoriteteve shqiptare në bashkëpunim me autoritetet amerikane në parandalimin e një sulmi të planifikuar ndaj ambasadës amerikane dhe shkatërrimin e një celule të Al-Kaedës e cila vepronte në vendin tonë nëpërmjet aktivitetit të disa shoqatave arabe (The 9/11 Commission Report, 2004: 127).

Kërcënimet terroriste gjithnjë e në rritje dhe ngjarja e 11 Shtatorit, e bënë këtë çështje prioritare në fushën e sigurisë globale. Nisur nga ky kontekst global, Shqipëria në bashkëpunim të ngushtë me SHBA-të por edhe me qeveritë e vendeve të tjera, adaptoi në vitin 2002 "Planin e Veprimit Kombëtar Kundër Terrorizmit". Pozicioni gjeografik i Shqipërisë dhe dominimi i popullsisë myslimane mund të krijojë mjedisin e përshtatshëm për krijimin e bazave terroriste, sidomos ato me baza fetare dhe kjo e bëri të

domosdoshme hartimin e një plani për ta parandaluar shfaqjen dhe shtrirjen e këtij fenomeni.

Megjithatë duhet të sqarojmë dhe të bëjmë kujdes kur kategorizojmë një grup, popullsinë myslimane si potencial kryesor për krijimin e bazave terroriste. Me këtë nënkuptojmë që grupet terroriste, për të realizuar ideologjitë e tyre politike fshihen pas kauzës fetare dhe përdorin fenë dhe besimtarët e kësaj feje për realizimin e qëllimeve të tyre. Sipas këtij plani veprimi, dy ishin drejtimet kryesore për të parandaluar terrorizmin; e para lidhej me terrorizmin e brendshëm; dhe e dyta, me atë të jashtëm/ndërkombëtar.

- Terrorizmi i brendshëm u nda në dy kategori:
 - o terrorizmi i cili mund të jetë i origjinave të ndryshme, i nxitur, i mbështetur dhe i organizuar nga elementë të brendshëm terrorist, me qëllim destabilizimin e vendit;
 - o terrorizmi me bazë nga jashtë, i cili mund të kryhet nga elementë të brendshëm, por me mbështetje dhe me drejtim nga jashtë.
- Ndërsa terrorizmi ndërkombëtar mund të kategorizohet në:
 - o terrorizmi në territorin shqiptar, i planifikuar, i mbështetur nga elementë krejtësisht të huaj, kjo si rezultat i dështimit të qeverive shqiptare për kontrollin mbi kufijtë e tyre që nga 90-ta;
 - o terrorizmi ndërkombëtar me pjesëmarrjen e elementëve shqiptar, si pasojë e rekrutimit të tyre, i cili kryen aktivitete jashtë territorit të Shqipërisë (Plani i veprimit Kombëtar në luftën kundër terrorizmit 2002).

Në këtë plan veprimi për të zgjidhur problematikat që shoqëronin shpesh institucionet e specializuara në fushën e luftimit të këtij fenomeni, u bë e domosdoshme ngritja e një strukture e përbërë nga specialistë dhe ekspertë në fushën e informacionit dhe sigurisë pranë kabinetit të Kryeministrit. Detyra specifike e kësaj strukture do të ishte përpunimi i informacionit nga burime të ndryshme alternative, me qëllim arritjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve për çështjet që rrezikojnë sigurinë, nëpërmjet krijimit të infrastrukturës së nevojshme dhe mbështetëse. Gjithashtu angazhimi i të gjitha institucioneve të shtetit për ndërmarrjen e iniciativave ligjore, masave operative, mjetet e duhura dhe bashkëpunimi ndërinstitutional për të parandaluar këtë fenomen. Pra, në këtë plan veprimi secili nga institucionet i kishte të përcaktuara qartë objektivat dhe mjetet që i nevojiteshin për realizimin e qëllimeve.

Pavarësisht disa arritjeve, ky plan veprimi nuk arriti të përmbushë të gjitha prioritetet e vendosura. Shqipëria pavarësisht ratifikimit të të gjithave konventave ndërkombëtare në lidhje me luftën kundër terrorizmit dhe përcaktimit të detyrave për çdo institucion përkatës, vazhdon ende të mbetet një vend me problematika të shumta. Këto problematika lidhen me kontrollin e dobët në kufijtë e saj, me një polici jo efektive, problematika të mëdha me gjyqësorin dhe kjo si rezultat i burimeve të saj të kufizuara (State Department Country Report of Terrorism, 2004). Përveç burimeve të kufizuara vihet re një mungesë e theksuar e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve për implementimin e strategjive apo planeve kombëtare të krijuara për mbrojtjen e sigurisë kombëtare. Ato mbesin thjesht të shkruara, të përshtatura me planet e veprimit të BE, SHBA-së apo institucioneve të ndryshme ndërkombëtare por pa efektshmërinë e duhur.

Kjo vihet re edhe tek strategjia ndërsektorale për luftën kundër terrorizmit (2011-2015) e miratuar në vitin 2011. Në këtë strategji, sikurse edhe tek ajo pararendëse (2008), autoritetet angazhohen për identifikimin e faktorëve dhe shkaqeve që sjellin terrorizmin, për evidentimin dhe dokumentimin e veprimit institucional të të gjithë aktorëve të cilët marrin detyrimin për luftën kundër terrorizmit, përcaktimin e situatës aktuale në vend dhe masat për ndjekjen, parandalimin dhe mbrojtjen ndaj këtij fenomeni. Kjo tregon që shumë nga objektivat e mëparshëm kanë mbetur të parealizuara. Ende mungojnë të dhënat e dokumentuara, niveli i reagimit institucional është shumë i dobët, kuadri ligjor pavarësisht ndryshimeve mbetet i dobët dhe jo efikas. Ndërsa përsa i përket faktit që thjesht përpiqen të implementojnë strategjitë e aktorëve të rëndësishëm në sistemin ndërkombëtar, për të qenë në një kah drejtimi me ato, këtë e tregon edhe strategjia e 2011 e cila është hartuar duke u mbështetur tek strategjia e BE e fokusuar në katër drejtime kryesore: në atë të parandalimit, mbrojtjes, ndjekjes dhe reagimit ndaj terrorizmit.

Që një strategji të konsiderohet e suksesshme dhe efikase, ajo duhet që të përmbushë objektivat e saj afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Në strategjinë ndërsektorale në luftën kundër terrorizmit, disa nga objektivat afatshkurtra që duhet të ishin arritur janë:

- Përgatitja dhe përqasja e legjislacionit sipas standardeve të BE-së, në lidhje me luftën kundër krimit të terrorizmit, si dhe e akteve të tjera të funksionimit të strukturave që kanë përgjegjësi në këtë drejtim, bazuar në strategjitë e tjera si dhe në planet përkatëse të veprimit;

- Krijimi i një sistemi të transmetimit të informacionit brenda strukturave të përfshira në luftën kundër krimit të terrorizmit;
- Zgjerimi i zbatimit të teknikave të reja të investigimit, brenda suazës së përcaktuar në ligj, për të gjitha format e shfaqjes së krimit të terrorizmit;
- Zhvillimi dhe thellimi i transparencës për komunitetin në lidhje me kujdesin dhe vigjilencën për parandalimin dhe zbulimin e terrorizmit dhe ekstremizmit;
- Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme profesionale për specialistët që punojnë në strukturat që kryejnë veprimtari kundër krimit të terrorizmit dhe shfrytëzimin e eksperiencave të vendeve të tjera në këtë drejtim (Qendra e publikimeve Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 2011: 7258).

Përsa i përket këtyre objektivave, ka rezultate pozitive në përjasjen e legjislacionit sipas standardeve të BE-së dhe realizimit të trajnimeve profesionale për specialistët të cilët punojnë në strukturat e luftës kundër terrorizmit. Por pavarësisht trajnimeve të shumta, vihet re një përpjekje gati minimale për zgjerimin e teknikave të investigimit apo krijimit të sistemit të transmetimit të informacionit. Ndërsa përsa i përket objektivit të rritjes së ndërgjegjësimit të komunitetit dhe qytetarëve mbi rrezikshmërinë e këtij kërcënimi, mund të themi që edhe në këtë drejtim nuk është bërë mjaftueshëm.

Shoqëria shqiptare ende nuk ka arritur ndërgjegjësimin e duhur dhe kjo duhet të konsiderohet si një element shumë shqetësues për elitën politike, sepse pa

ndërgjegjësimin e qytetarëve të saj, asnjë nismë e marrë nuk mund të rezultojë e suksesshme dhe efektive.

Përsa i përket objektivave afatmesëm, në këtë strategji parashikoheshin që deri në vitin 2013 të jenë realizuar:

- Forcimi dhe realizimi i një kontrolli efektiv të kufirit shtetëror, si dhe të të huajve të dyshimtë, duke iu përafuar standardeve të vendeve të BE-së;
- Krijimi i një baze të dhënash për shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit, apo të huaj të dyshimtë me qëndrim në vendin tonë, për të cilët ka informacione se kryejnë vepra penale në lidhje me krimin e terrorizmit;
- Kryerja e studimeve të plota në drejtim të goditjes e parandalimit të formave të ndryshme të krimit të terrorizmit, përcaktimi i nevojave materialo- financiare për strukturat që operojnë në këtë drejtim dhe plotësimi i tyre mbi bazën e mundësive që ka çdo institucion (Qendra e publikimeve Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 2011: 7258).

Mund të themi që edhe këto objektiva nuk janë realizuar plotësisht ende sot në 2016 pasi akoma nuk kemi një bazë të dhënash të plotë apo forcim dhe kontroll efektiv të kufirit dhe kemi mungesë studimesh mbi ecurinë e çdo institucioni në parandalimin dhe goditjen e terrorizmit.

Ndërsa objektivat afatgjatë janë:

- Hartimi i një sistemi ligjor apo akteve të tjera sipas standardeve të BE-së dhe që krijon hapësirën e duhur apo instrumentet e nevojshme për parandalimin e goditjen e krimit të terrorizmit;
- Paraqitja e strukturave të shtetit shqiptar si partnerë të aftë profesionalisht, të barabartë dhe të besueshëm për strukturat homologe të vendeve të tjera;

- Përgatitja e materialeve studimore nga specialistët që merren me luftën kundër terrorizmit, duke përcaktuar nivelin e kërcënimit terrorist në rrafshin ndërkombëtar dhe ndikimet e tij në vendin tonë, format që ata përdorin për të arritur qëllimet e tyre.

Objektivat edhe në këtë drejtim vihen re se nuk janë realizuar. Sipas raportit të Departamentit të Shtetit (2013) mbi luftën kundër terrorizmit, Shqipëria konsiderohet si një vend i cili ende vazhdon ta ketë zbatueshmërinë e ligjit në nivele të ulta, kjo si rezultat i nivelit të lartë të korrupsionit i shoqëruar me një sistem gjyqësor ende të dobët. Pavarësisht disa përpjekjeve pozitive, duhet të theksohet fakti që një ndër faktorët që ka penguar arritjen e këtyre objektivave është fakti se qeveria shqiptare ka konsideruar si prioritare kërcënimin ndaj krimit të organizuar, ndërsa terrorizmin e kanë konsideruar si një kërcënim më të vogël (DASH, Contry Reports on Terrorism, 2013). Megjithatë, vihet re një rritje e ndjeshmërisë përse i përket aktiviteteve ekstremiste dhe kërcënimit të tyre ndaj sigurisë kombëtare të Shqipërisë. Mund të përmendim këtu aksionin kundër terrorizmit të kryer në Mars të 2014-tës dhe arrestimin e 8 personave, dy prej të cilëve të vetëshpallur Imamë dhe gjashtë të tjerë praktikantë të fesë myslimane.

Këto persona u dyshuan si rekrutues të xhihadistëve për të luftuar me grupet radikale islamike ISIS dhe Jabhat al-Nusra. Ata akuzohen si persona të cilët kanë organizuar dhe financuar rekrutimin e xhihadistëve shqiptar që luftojnë në Siri. Nuk ekzistojnë të dhëna të sakta, por mendohet se gjatë viteve 2012-2014 janë rekrutuar 90- të militantë xhihadist. Sipas raportit të Departamentit të Shtetit Amerikan të 2014- tës, Shqipëria edhe pse mbetet një vend i cili mbështet shumë luftën kundër terrorizmit

dhe këtë e tregon edhe bashkimi i saj në koalicionin global në luftën kundër ISIS, ajo vazhdon ende të mbetet burim i luftëtarëve të huaj të cilët shkojnë në Siri. E në këto kushte, Shqipëria duhet të përpiqet më shumë në zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve të saj sepse paraqet shumë mangësi dhe problematika (DASH, County Report on Terrorism, 2014).

Shqipëria nuk duhet të përqendrohet vetëm tek identifikimi i individëve të cilët operojnë si rekrutues brënda vendit, por duhet të krijojë instrumentet e duhur dhe duhet të bashkëpunojë ngushtë me partnerët e saj, për të identifikuar edhe shqiptarët të cilët jetojnë jashtë territorit të saj dhe janë pjesë e grupeve të cilët rekrutojnë luftëtarë në mbrojtje të kauzes së Shtetit Islamik (ISIS). Sipas një raporti të IBNA (Independent Balkan News Agency), në Itali janë identifikuar celulat xhihadiste, anëtarët e së cilave janë shqiptarë nga Shqipëria dhe Kosova, që rekrutojnë të rinj për ti dërguar në Siri. Sipas identifikimeve të kryera, këta persona janë të deklaruar si emigrantë që punojnë në Itali, por që kanë krijuar baza të forta të rrjetit xhihadist me celulat e vendosura në Romë, Milano, Lucca dhe Siena . Pasi i rekrutojnë të rinjtë që jetojnë në Itali, ato më tej shkojnë në Shqipëri, Greqi, Turqi dhe më pas në Siri, ky është itinerari që ato ndjekin (Independent Balkan News Agency, 19 January 2015). Shqipëria duhet të forcojë kapacitetet e saj në kontrollin e kufijve me qëllim që të bëjë të gjitha verifikimet e duhura mbi personat që hyjnë dhe dalin nga territori i saj, sepse lejimi dhe rritja e ekstremizmit fetar do të ndikojë në pasigurinë kombëtare të saj. Sepse gjithnjë e më tepër ideologjia e Islamit radikal po fuqizohet dhe po përqafohet nga shumë mysliman nëpër botë përfshirë edhe shqiptarët.

Edhe për Arjan Dyrishin, ekspert i çështjeve të sigurisë dhe inteligjencës në Shqipëri, ideologjia e Islamit radikal është e fuqishme, sepse në nivel individual ajo parashikon zgjidhje për të gjithë problemet shpirtërore dhe personale, duke predikuar zbatimin e praktikave Islame, në nivel nacional ajo ofron zgjidhje për problemet socio- ekonomike-politike, duke predikuar instalimin e ligjit Islamik (sheriati), si dhe në nivel ndërkombëtar ajo parashtron krijimin e një shteti Islamik, i cili bashkon të gjithë myslimanët nën një shtet dhe u jep zgjidhje të gjitha problematikave që u janë shkaktuar atyre nga jo myslimanët (Dyrishi, 2015).

Flitet shpesh që edhe pse shumica e shqiptarëve janë myslimanë, islami radikal ka pak ndjekës dhe nuk mund të konsiderohet islami radikal si një problem kombëtar. Përkundrazi, kërcënimet që vijnë nga ekstremistët fetar duhet të konsiderohen si rreziqe madhore për sigurinë tonë kombëtare. Mundësitë për krijimin e bazave të operimit të tyre në Shqipëri janë të mëdha, kjo si rezultat i faktit që edhe pse kanë kaluar gati 25- vite që nga rënia e komunizmit, Shqipëria ende është një vend me një nivel të lartë papunësie, me një nivel të ulët ekonomik, institucione jo efikase, me një gjyqësor ende të dobët, me një shoqëri e cila nuk beson tek institucionet. Të gjitha këto faktorë lehtësojnë operimin dhe krijimin e bazave për rritjen e ekstremizmit Islamik në Shqipëri, e ndihmuar edhe nga fakti se pozicioni gjeografik i Shqipërisë është një pikë strategjike për përmbushjen e interesave të grupe terroriste (ISIS). Gjendja e rënduar ekonomike e qytetarëve shqiptar mund të shërbejë si një element i fuqishëm për rekrutimin e tyre, përkundrazi pagesave dhe kjo nënkupton që mund të rekrutohen edhe njerëz të cilët nuk besojnë në ideologjinë e Islamizmit, por e shikojnë si një mundësi për të përmirësuar jetën e tyre dhe për të siguruar mbijetesën. Në këto kushte duhet të ndryshojë mënyra e trajtimit mbi këtë fenomen, duke i kushtuar një vëmendje të madhe.

5.5.Procesi i Sigurizimit ndaj kërcënimit të krimit të organizuar dhe terrorizmit

Pavarësisht faktit se krimi i organizuar dhe terrorizmi shikohen si kërcënime për sigurinë kombëtare të shumë shteteve por edhe për sigurinë globale, në rastin shqiptar ato janë ekzistenciale për mbijetesën e shtetit dhe mirëqenien e qytetarëve të saj. Nuk mund të anashkalojmë faktin se lufta kundër terrorizmit, e sidomos krimit të organizuar, ka qenë gjithnjë pjesë e axhendës së prioritetëve të qeverive shqiptare që pas viteve 90- të por politikat dhe strategjitë e ndërmarra nuk kanë arritur rezultatin e dëshiruar.

Nëpërmjet një procesi reflektimi mbi politikat e ndjekura ndër vite arrijmë në konkluzionin se ka patur përpjekje pozitive për luftimin e fenomeneve të tilla, të cilat duket se në shumicën e tyre kanë ardhur si rezultat i përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara nga NATO, BE, apo organizma të tjerë ku Shqipëria i ka patur si prioritet për t'u integruar, sesa të kuptuarit nga politikbërsit shqiptar të situatës reale të nivelit të kërcënimit ndaj sigurisë sonë. Mund të përmendim vizitën dy-ditore të Zv. Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme z. Ilir Meta në Republikën e Serbisë në gusht të 2010-tës. Në Deklaratën e tij për shtyp Z. Meta shpreh:

”Jam takuar sot dhe kam diskutuar në frymë konstruktive me autoritetet më të larta serbe, Presidentin Tadiç, Zv. Kryeministrat Gjeliç dhe Daçiç si dhe me mikpritësin tim, Ministrin e Punëve të Jashtme Vuk Jeremiç, për një erë të re në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Serbisë, të cilën e konsideroj si një gur themeltar për stabilitetin në rajon, për një bashkëpunim të zgjeruar në të gjitha fushat me interes të ndërsjellë, në shërbim të të dy vendeve, dhe për të zgjeruar njohjen mes nesh, si rruga e vetme për të përmbushur aspiratat e popujve tanë për një të ardhme më të mirë, për një rajon të sigurt, një jetë më të begatë dhe një integrim të shpejtë evropian.

Gjithashtu nënshkruam me Zv. Kryeministrin dhe Ministrin e Brendshëm z. Daçiç, një marrëveshje të rëndësishme për bashkëpunimin në fushat e luftës kundër krimit të organizuar, kontrollit kufitar dhe trafikut ilegal, që do të kontribuojë për një rajon më të sigurt. Do të punojmë ngushtë së bashku për ti kthyer kufijtë tanë në një mur të fortë për të parandaluar aktivitetet e krimit të organizuar që sot nuk njeh kombësi, por në të njëjtën kohë do të punojmë për ti bërë ato transparente për publikun.” (Meta, 2010).

Mund të themi që ky bashkëpunim i ngushtë më tepër është parë si një element i domosdoshëm për përshejtimin e procesit integrues evropian sesa një bashkëpunim i nevojshëm për sigurinë kombëtare të këtyre dy shteteve. Gjithashtu, vëmë re që në realitet këto mbetën thjeshtë në kuadrin e takimeve zyrtare dhe të dy vendet akoma nuk kanë arritur rezultatet e pritshme në luftën kundër aktiviteteve të krimit të organizuar si dhe niveli i transparencës ndaj publikut mbetet akoma i vogël.

Vëmë re se qeveritë shqiptare reagojnë dhe ndërmarrin veprime kryesisht kur mbi to ushtrohet presion nga aktorë të rëndësishëm në sistemin ndërkombëtar.

Në raportin e Komisionit për Këshillin dhe Parlamentin Evropian të qeshorit 2014, për progresin e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar si dhe në reformat e gjyqësorit nënvizohet se “ Në luftën kundër korrupsionit, për të avancuar me vendosmëri në rrugën e integritetit evropian, Shqipëria duhet të fokusohet në zbatimin e legjislacionit në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit, rritjen e hetimeve pro aktive dhe miratimin e masave që i bëjnë hetimet më eficientë, me qëllim që të konsolidohen përpjekjet fillestare dhe të krijohet një historik solid hetimesh, ndjekjesh penale dhe dënimesh me vendime të formës së prerë për çështje korrupsioni.

Thelbësore në luftën kundër korrupsionit do të jetë edhe reforma e thellë në gjyqësor. Në luftën kundër krimit të organizuar, për të avancuar me vendosmëri në rrugën e integritit evropian, Shqipëria ka nevojë të zhvillojë më tej historikun e rezultateve (*track record*) përmes forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, forcimit të efikasitetit të hetimeve proaktive dhe përdorimit sistematik të hetimeve financiare, forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar kur përfshihet edhe Europol-i, si edhe intensifikimit të përpjekjeve për të goditur çdo formë krimit të organizuar. Në reformën e sistemit gjyqësor, për të avancuar me vendosmëri në rrugën e integritit evropian, Shqipëria ka nevojë të zbatojë me rigorozitet reformën në gjyqësor, përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me Komisionin e Venecias, miratimit të dispozitave kyçe shtesë për forcimin e pavarësisë dhe llogaridhënies – në përputhje me udhërrëfyesin për reformën në sistemin gjyqësor – si edhe zbatimit adekuate të masave të miratuara“ (Progres raporti i KKPE për Shqipërinë, 2014).

Nisur nga kjo panoramë mund të themi, që të gjitha këto problematika pikë së pari duhet të shikohen nga elita Shqiptare jo si detyrime për integritet, por si domosdoshmëri për konsolidimin e demokracisë dhe sigurisë sonë kombëtare, sepse këto janë instrumentet matëse për funksionimin dhe sigurinë e brendshme të Shqipërisë.

Gjithashtu për sa i përket krimit të organizuar mund të themi që, presioni i ushtruar nga përfaqësuesit e lartë të BE-së për dokumentimin e të dhënave të besueshme dhe të qëndrueshme në luftën kundër të gjitha formave të krimit të organizuar, çoi në angazhimin e qeverisë shqiptare nën ndërmarrjen e operacioneve policore për asgjësimin e plantacioneve të kultivimit të kanabisit në Shqipëri. Mund të përmendim këtu operacionin e parë, atë të Qeshorit 2014 në Lazarat, si dhe operacionin në disa fshatra dhe komuna të thella të Dukagjinit. Ky angazhim i qeverisë Shqiptare duhej të ishte ndërmarrë pa nevojën e një presioni ndërkombëtar duhet të ishte identifikuar si kërcënim sigurie për sigurinë tonë.

Një faktor shumë i rëndësishëm i cili ka çuar në mos efikasitetin e dëshiruar të këtyre operacioneve dhe luftës kundër këtyre fenomeneve, ka qenë edhe mos shoqërimi në mënyre paralele me politika sociale dhe ekonomike, të cilat janë një domosdoshmëri për ndërmarrjen e politikave efikase dhe të suksesshme. Ndërsa përsa i përket terrorizmit, politikat nuk kanë rezultuar të suksesshme deri më sot, sepse vihet re që qeveria shqiptare ndër vite pavarësisht se ka hartuar strategji, ajo në realitet nuk e ka perceptuar si një rrezik real dhe potencial për sigurinë e Shqipërisë, krahasuar me rrezikun e krimit të organizuar. Perceptimi nga aktorë të rëndësishëm, i rrezikshmërisë së lartë të këtij fenomeni ndaj sigurisë kombëtare, por edhe si një kërcënim i rëndësishëm në nivelin global, ka mjaftuar që Shqipëria ta bëjë pjesë të prioriteteve të saj mbi kërcënimet ndaj sigurisë, pra në realitet thjeshtë është përpjekur që të jetë në të njëjtën linjë politike me aktorët e rëndësishëm, pa zhvilluar analizat e duhura në kontekstin shqiptar me qëllim identifikimin e nivelit të rrezikshmërisë që paraqet ky fenomen në realitetin tonë. Kjo vihet re edhe në vendosjen e hierarkisë së prioriteteve në Strategjinë e sigurisë kombëtare, ku ky fenomen është parë më shumë si një kërcënim në nivel rajonal dhe global, por jo të brendshëm.

Ligjërimi i mbajtur nga elita politike shqiptare mbi këtë fenomen bazohet mbi këtë strategji. Kjo pasqyrohet më së miri edhe në intervistën që Ministri i Jashtëm i Shqipërisë Z. Ditmir Bushati dha për Zërin e Amerikës në 20 Prill të 2014-tës pas takimit me Sekretarin amerikan të Shtetit z. John Kerry, mbi rolin e rëndësishëm të Shqipërisë kundër ekstremizmit. Në këtë intervistë Z. Bushati shpreh “Ndër tematikat që biseduam me sekretarin e shtetit ishte dhe lufta e përbashkët që po zhvillojmë kundër fenomenit të terrorizmit dhe dhunës ekstreme, si dhe rolit kyç që luan Shqipëria për shkak të përkatësisë së saj në NATO, në arkitekturën e sigurisë në Europën Juglindore apo Ballkanin Perëndimor. Shqipëria do të mirëpresë një Samit që do të zhvillohet në Maj së bashku me

Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vijim të samitit që organizoi Presidenti Obama në Uashington, për sa i përket fenomenit të ekstremizmit që është mjaft evident sot për sot, dhe që është një fenomen global. Risia e samitit të Tiranës ka të bëjë me pjesëmarrjen dhe gamën e gjerë të çështjeve që do të trajtohen, por edhe me pjesëmarrës të cilët nuk do jenë thjesht politikanë apo zyrtarë të lartë, por edhe përfaqësues të shoqërisë civile apo përfaqësues të komuniteteve fetare nga të gjitha vendet e rajonit dhe më gjerë“ (Bushati, 2014).

Terrorizmi ka përbërë kërcënim për sigurinë globale që pas përfundimit të luftës së Ftohtë i cili vazhdon ende sot, por cili ka qenë kontributi real i Shqipërisë në këtë drejtim. Mund të themi që kontributi i Shqipërisë thjeshtë ka qenë në përpjekjen për ta njohur si kërcënim, të qenit pjesë e shteteve të cilët e luftojnë atë si fenomen, përpjekje për të adoptuar strategjitë e vendeve të rëndësishme, pra vetëm kaq. Mungon kontributi i saj për të bërë studime të thelluara me qëllim identifikimin e të gjithë faktorëve që mundësojnë në realitetin shqiptar zhvillimin e këtij fenomeni si dhe rrezikshmërinë e lartë që ai paraqet për sigurinë tonë kombëtare. Pa diskutim kjo ka ndikuar në hartimin e strategjive jo-efikase për luftën kundër tij, e për pasojë ka zgjeruar hendekun e mundësisë së zhvillimit më tej të këtij kërcënimi.

Në ditët e sotme, duhet të theksojmë se siguria kombëtare e Shqipërisë kërcënohet më shumë se kurrë nga fenomeni i terrorizmit, kjo si rezultat i mjedisit gjeopolitik të shfaqur dhe në ndryshim, problematikave të shumta që karakterizojnë Shqipërinë dhe forcimi i organizatës terroriste ISIS. Në kushtet e sotme bëhet e domosdoshme që krimi i organizuar dhe terrorizmi në Shqipëri të konsiderohen si çështje të cilat duhet të sigurizohen dhe të aplikohet procesi i sigurizimit, sepse niveli i rrezikshmërisë së tyre ndaj sigurisë tonë kombëtare është ekzistencial.

Në një intervistë të dhënë me datë 6/11/2014, Prokurori i Përgjithshëm z. Adriatik Llalla në emisionin Top Story në Top-Chanel u shpreh ndër të tjera edhe për

terrorizmin ndërkombëtar dhe krimin e organizuar, pyetje këto të drejtuara nga gazetari Sokol Balla. Qëndrimi i tij mbi këto dy çështje ishte i tillë: **Sokol Balla:** Ndalemi tek terrorizmi ndërkombëtar më saktë ISIS. Realisht sa e përfshirë është Shqipëria në furnizimin e terroristëve dhe në luftën kundër tij?

Adriatik Llalla: Së pari, Shqipëria si anëtare e Nato-s ka përgjegjësinë e saj dhe ka detyrimet e saj për të mbështetur Aleancën në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar. Njëherazi edhe legjislacioni shqiptar parashikon ndëshkimin e personave që ndihmojnë terrorizmin ose e ushtrojnë vetë atë. Kemi arrestuar një sërë personash.

Sokol Balla: Krimi i organizuar është një prioritet. Si është Shqipëria në këtë sfidë?

Adriatik LLalla: Shqipëria përballet përditë me luftën kundër krimit të organizuar, një situatë që u diskutua edhe me prokurorin Italian. Gjatë këtyre viteve, individë që janë marrë me trafikim lëndësh narkotikë, prostitucion dhe veprimtari të tjera kriminale përpiqen t'i investojnë pasuritë në Shqipëri, duke përfutur edhe nga informaliteti ekonomik. Institucionet tona po punojnë në mënyrë intensive. Theksoj që në bashkëpunim me BE-në presim shumë shpejt të vëmë në punë projektin mbi bazën e të cilit do të kemi të dhëna elektronike, që të kontrollojmë të dhënat në të gjithë republikën nga zyrat e Prokurorit të Përgjithshëm (Llalla, 2014). Prokurori i përgjithshëm nuk e ka autoritetin për të identifikuar kërcënimet kryesore të sigurisë, ai thjeshtë zbaton ligjet dhe bazohet të kushtetuta.

Çështjet që duhen sigurizuar për shkak të nivelit të lartë të rrezikshmërisë, pikë së pari duhet të identifikohen dhe të kuptohet nga elita politike shqiptare. Ende sot politika shqiptare nuk i konsideron këto dy fenomene si kërcënime ekzistenciale të sigurisë sonë.

Për ta ilustruar këtë, mund të përmendim këtu takimin e 20 Janarit 2015, ku Ministri i Punëve të Brendshme Saimir Tahiri priti në Tiranë homologun e Kosovës Z. Skënder Hyseni. Tema qendrore e këtij takimi ishte bashkëpunimi i Shqipërisë dhe Kosovës në luftën kundër Krimin të Organizuar dhe Terrorizmit. Në deklaratën e tij Z. Tahiri shpreh se “Është tashmë e qartë për ne që veçanërisht ngjarjet që ndodhën në Paris kanë hapur një kapitull të ri të domosdoshëm për Evropën në tërësi, për rajonin e Ballkanit në veçanti, por është po kaq e detyrueshme që të hapim një kapitull të ri bashkëpunimi intensiv, konkret, në nivel politik patjetër, por edhe operacional për të arritur bashkërisht suksese të forta dhe të qëndrueshme në luftën kundër çdo tendence radikalizmi. Deri më sot ne kemi një bashkëpunim të shkëlqyer qoftë nga pikëpamja e shkëmbimit të informacionit, qoftë nga pikëpamja e procedimeve lidhur me këtë çështje, por mbetet ende shumë për të bërë, për të shënuar praktika të suksesshme në rezultate solide në luftën kundër krimin të organizuar, por në veçanti në luftën kundër terrorizmit” (Tahiri, 2015). Vihet re që sërish kur flitet për këto fenomene flitet në mënyrë të përgjithshme, në kontekstin rajonal dhe global duke e anashkaluar pothuajse fare ndikimin dhe implikimin e tyre në kontekstin e brendshëm kombëtar.

Kërcënimi i sigurisë nga krimi i organizuar është intensifikuar shumë dhe kjo si rezultat i dy faktorëve. E para lidhet me faktin që nëse deri dje grupet kriminale tona, janë marrë me kultivimin e Kanabisit në zona të centralizuara/lokalizuara, me trafikimin e drogës, qenieve njerëzore, armëve dhe janë bërë pjesë e rrjeteve ndërkombëtare, sot situata ekonomike e përkeqësuar ka ndikuar në perceptimin e kultivimit të kanabisit si një biznes familjar, pra është konsideruar si një mundësi e mirë për përmirësimin e situatës së tyre ekonomike dhe mirëqenies së tyre familjare. Kjo ka çuar në kultivimin e kanabisit në nivel

kombëtar, pra shtirjes së kësaj veprimtarie në të gjithë Shqipërinë.

Gjithashtu kushtet e rënda ekonomike, mos besueshmëria e qytetarëve tek shteti dhe institucionet e tij, kanë kontribuar tek ideja se bërja pjesë në grupime të cilat kryejnë aktivitete kriminale, është mënyra më e mirë për të përmirësuar jetën e tyre dhe të familjeve.

E dyta lidhet me faktin e dështimit të politikave dhe strategjive në luftimin, parandalimin dhe minimizimin e këtij kërcënimi, duke çuar kështu tek dobësimi akoma edhe më shumë i institucioneve shtetërore dhe jo tek përmirësimi i tyre. Mos forcimi i shtetit edhe pse kanë kaluar 25-vite ndikon si në aspektin e brendshëm duke minuar ekzistencën e tij si rezultat i paaftësive për të përmbushur parimet themelore si siguria dhe mirëqenia për qytetarët e tij, ashtu edhe në aspektin e jashtëm duke u konsideruar si një shtet i dobët me problematika themelore, të cilat pengojnë anëtarësimin e tyre në BE.

Krimi i organizuar edhe terrorizmi duhet të konsiderohen rreziqe/kërcënime ekzistenciale për sigurinë kombëtare të Shqipërisë, sepse të gjitha kushtet e brendshme të vendit u krijojnë rrethana të përshtatshme organizimeve terroriste. Dhe kjo sepse veprimtaritë e grupeve/organizatave kriminale si atyre terroriste shfrytëzojnë problematika të cilat shoqërojnë shtetet e dobëta për të fuqizuar pozitat e tyre në funksion të realizimit të qëllimeve dhe objektivave të tyre. Mos marrja e masave të duhura kundër përhapjes së këtij fenomeni do të ndikonte akoma edhe më shumë në dobësimin e mëtejshëm të instrumenteve shtetëror. P.sh. në rastin e organizatës terroriste ISIS, problematika për Shqipërinë është e dyfishtë, sepse kjo organizatë jo vetëm gjen kushtet e favorshme për të rekrutuar shqiptarë në luftën e tyre të shenjtë për krijimin e një Kalifati arab, por pasojat e tyre janë akoma edhe më të mëdha në të ardhmen nëse këto individë kthehen në Shqipëri.

Këto persona, tashmë të rekrutuar dhe të trajnuar, mund të shërbejnë si përhapës së ideologjisë edhe për shumë shqiptar të tjerë si dhe si iniciatorë të ndonjë sulmi të mundshëm për të përçuar një mesazh. Të gjithë këto faktorë e bëjnë të domosdoshëm procesin e sigurizimit. Ky proces, në mënyrë që të rezultojë i suksesshëm, duhet të kalojë nëpërmjet të gjitha fazave. Faza e parë, e cila lidhet me debatin publik-politik, mund të themi se është zhvilluar kohët e fundit por duhet të shtohet më tej intensiteti dhe nga politika duhet të theksohet fakti që krimi i organizuar dhe terrorizmi janë çështje të cilat duhet të sigurohen, sepse përbëjnë kërcënimin ekzistencial për sigurinë e shtetit, qytetarëve dhe mirëqenies së tyre dhe ndaj tyre duhen marrë masa të jashtëzakonshme. Mos zhvillimi i këtij debati në periudhat e mëparshme dhe mos identifikimi i terrorizmit dhe krimin të organizuar si kërcënime ekzistenciale tregon se në Shqipëri nuk ka ndodhur kurrë një proces i mirëfilltë sigurizimi. Megjithatë duhet të theksojmë se pavarësisht zhvillimit të një debati publik-politik kohëve të fundit (pozitive), gjuha e përdorur në këto debate ka qenë më shumë e fokusuar në terma fyese dhe sulme personale, sesa në dhënien e argumenteve dhe fakteve. Në këtë drejtim duhet bërë më shumë, sepse argumentimi mes të tjerave do të shërbente rritjes së ndërgjegjësimit të publikut, por edhe vetë klasës politike për rëndësinë madhore të këtyre problemeve.

Faza e dytë e procesit të sigurizimit është përdorimi i një ligjërimi politik me qëllim bindjen e audiencës për domosdoshmërinë e sigurizimit të këtyre fenomeneve me nivel të lartë të rrezikshmërisë ndaj sigurisë dhe marrjen e masave të jashtëzakonshme për parandalimin e tyre. Pa diskutim kjo fazë do të karakterizohet nga vështirësi të shumta për elitën politike shqiptare. Kjo për faktin se shoqëria shqiptare ka një nivel shumë të ulët

besueshmërie ndaj shtetit dhe institucioneve të tij, shoqëruar kjo edhe me faktin e një perceptimi të shoqërisë që mbështetja kryesore për të përballuar jetën në Shqipëri mbetet vetëm tek familja. Megjithatë nëse punohet me vullnet të plotë dhe të palëkundur kjo situatë pa diskutim ndryshon.

Rritja e nivelit të besimit të shoqërisë realizohet me demonstrim të politikave konkrete në përmirësimin dhe forcimin e institucioneve shtetërore dhe politikave për përmirësimin e situatës ekonomike për qytetarët. Gjithashtu rritja e besueshmërisë së shoqërisë, ndikon edhe në rritjen e ndërgjegjësimit dhe ofrimit të mbështetjes së saj përkundrejt prioritetëve të përcaktuara dhe politikave të ndërmarra nga qeveria.

Marrja e masave të jashtëzakonshme për të sigurizuar këto dy çështje (krimi i organizuar dhe terrorizmi) duhet të lidhet fillimisht me hartimin e një politike gjithëpërfshirëse, në hartimin e një strategjie të mirëfilltë me objektiva mjete dhe mënyra efektive dhe të aplikueshme, në ndryshim nga strategjitë e mëparshme ku ishin thjeshtë strategji teorike pa efektivitetin e duhur në aplikueshmëri. Në këto kushte, të gjitha kapacitetet e fuqisë kombëtare të shtetit shqiptar duhet të vihen në dispozicion/funksion të realizimit të këtij procesi dhe kalimin e këtyre çështjeve nga faza e sigurizimit tek faza e desigurizimit, e cila nënkupton kalimin e këtyre çështjeve në procesin normal dhe mos konsiderimin e tyre si kërcënim ekzistencial sigurie. Për aq kohë sa nuk do të arrihet tek procesi i desigurizimit, nuk do të mund të flasim për një proces sigurizimi të suksesshëm. Sfidë ndaj këtyre kërcënimeve të sigurisë është shumë e madhe, por elementi bazë dhe themelor për përballimin e tyre mbetet të kuptuarit dhe të aplikuarit e menjëhershëm të procesit të sigurizimit si e vetmja rrugë efikase për përballimin e këtyre kërcënimeve ekzistenciale për sigurinë tonë kombëtare.

5.6 Refleksion mbi SSK (2015) dhe SSU (2015) të Republikës së Shqipërisë

Strategjia e Sigurisë Kombëtare konsiderohet si dokumenti themelor planifikues i *sigurisë kombëtare* të Republikës së Shqipërisë. Qëllimi i këtij dokumenti është udhëheqja e vendit në përmbushje të interesave kombëtare si konsolidimi i një demokracie funksionale, zhvillimi i një ekonomie tregu të qëndrueshme dhe mbrojtja dhe siguria e qytetarëve të saj. Nisur nga ky qëllim, në këtë strategji vihet re identifikimi i 8 objektivave kryesore që duhet të realizohen.

- Objektivi i parë lidhet me përmirësimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë, e cila do të mund të realizohet nëpërmjet reformave dhe strategjive specifike për minimizimin e hapësirave të korrupsionit me qëllim forcimin e sistemit gjyqësor. Gjithashtu rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional, forcimi i kontrollit dhe administrimit të territorit nga agjencitë e zbatimit të ligjit do të mund të kontribuojnë në realizimin e këtij objekti.
- Objektivi i dytë lidhet me forcimin e institucioneve publike me qëllim rritjen e besueshmërisë së qytetarëve ndaj tyre. Kjo do të realizohet nëpërmjet zbatimit të strategjisë për reformimin e administratës publike, baza e së cilës do të jetë ndjekja e procedurave të meritokracisë dhe profesionalizmit dhe depolitizimit të administratës publike.
- Objektivi i tretë lidhet me nxitjen e zhvillimit të ekonomisë së qëndrueshme.
- Objektivi i katërt lidhet me zhvillimin nëpërmjet strategjive të veçanta të një sistemi arsimor cilësor.
- Një objektiv tjetër, ai i pestë i rëndësishëm në këtë strategji, është fuqizimi i Sektorit të Sigurisë dhe Mbrojtjes për përballimin e kërcënimeve dhe rreziqeve ndaj sigurisë kombëtare, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë të FASH (Forcat e

Armatosura të Shqipërisë), agjencive të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve inteligjente.

- Objektivi gjashtë është forcimi i kohezionit shoqëror dhe identitetit kombëtar që përbëjnë faktorin vendimtar për garantimin e sigurisë kombëtare të shtetit.
- Objektivi shtatë lidhet me forcimin e rolit rajonal dhe ndërkombëtar të Shqipërisë, nëpërmjet një politike të jashtme të mbështetur tek parimet e bashkëpunimit, fqinjësisë së mirë, partneritetit strategjik me SHBA-në,
- Ndërsa objektivi tetë lidhet me përshpejtimin e procesit të integritetit në BE, nëpërmjet përmbushjes së të gjitha detyrimeve të caktuara.

Në këtë strategji, përveç objektivave të përcaktuar dhe mënyrave se si do të realizohen ato vihet re një ndarje e kërcënimeve në tri nivele:- i brendshëm; -rajonat; - global. Përsa i përket nivelit të brendshëm, konsiderohen si rreziqe korrupsioni i nivelit të lartë në administratën publike dhe në sistemin e gjyqësorit. Gjithashtu konsiderohet si një rrezik serioz krimi i organizuar i cili gjithnjë e më tepër po fuqizohet duke fituar pushtet ekonomik, prania e shumë strukturave të panevojshme në strukturat policore, mungesa e kapaciteteve energjetike, ndryshimet e klimës, sëmundjet dhe epidemitë e ndryshme, përballja me emigracionin masiv. Kërcënime për mjedisin rajonal konsiderohen nacionalizmi, i cili mund të çojë në rihapjen e çështjeve të kufijve dhe mosmarrëveshjet e pazgjidhura ndërshtetërore. Ndërsa si kërcënime për mjedisin global identifikohen terrorizmi ndërkombëtar dhe trafiket e paligjshme si pasojë e pozitës gjeografike të Shqipërisë, armët e shkatërrimit në masë, si dhe një rrezik i mundshëm i një sulmi konvencional ndaj njërës prej vendeve të NATO-s, i cili do të çojë në përfshirjen e Shqipërisë në këtë konflikt (Strategjia e Sigurisë Kombëtare, 2014). Nëse bëjmë reflektim mbi SSK vërejmë mangësi dhe problematika dhe do të arrijmë në konkluzionin se në të vërtetë ato nuk paraqesin zgjidhje për çështjet aktuale, por thjeshtë parashtrijnë anën teorike të problematikave të vendit tonë.

Problematika e parë lidhet me faktin e mos evidentimit të Shqipërisë si një vend i dobët, përkundrazi ajo konsiderohet si një vend i cili ka bërë përparime të dukshme dhe të rëndësishme në konsolidimin e demokracisë, zhvillimit të ekonomisë së qëndrueshme dhe përmirësime në sundimin e ligjit. Kjo lë të kuptojë që duhet të vazhdojmë në të njëjtin drejtim për ti përforcuar akoma edhe më shumë. Në të vërtetë situata është nuk paraqitet kaq pozitive, pavarësisht përpjekjeve ndër vite për të përmirësuar situatën.

Edhe pse kanë kaluar më shumë se 25-vite, Shqipëria vazhdon të ketë të njëjtat problematika të mëparshme. Institucione jo efikase, ekonomi e brishtë, destabilitet politik i cili vjen si rezultat i përmbushjes së interesave të elitave të ndryshme politike dhe jo bashkëpunim midis opozitë-pozitë në të mirë të interesave kombëtar, varfëri, humbje të besimit tek institucionet shtetërore nga shoqëria shqiptare, emigrim si një mënyrë për të pasur një jetë më të mirë, etj. Shqipëria është një shtet i dobët, sepse ai nuk i plotëson elementët thelbësor të një shteti të fortë, të cilët janë forcimi i brendshëm i tij, shoqëruar në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë me besimin e shoqërisë se ky është sistemi më i mirë i cili meriton të mbrohet, të zhvillohet dhe të forcohet nëpërmjet reformave të ndërmarra. Kjo nuk ndodh në realitetin tonë dhe si pasojë SSK përveçse të parashtrojë një qasje teorike, nuk arrin dot të jetë efektive në realizimin dhe përmbushjen e objektivave dhe interesave kombëtare. Pavarësisht se në këtë strategji kombëtare është theksuar fakti që tipari themelor i SSK është përqendrimi tek elementët e brendshëm të sigurisë kombëtare, në realitet ky përbën mangësinë e saj, pasi vetëm janë përmendur në mënyrë sipërfaqësore problematika e brendshme si zbatueshmëria e ligjit, sistemi i dobët gjyqësor, korrupsioni, krimi i organizuar etj., duke u mjaftuar me thënien se bëhet e domosdoshme hartimi i strategjive për

përmirësimin e tyre, por nuk janë identifikuar se cilat do të jenë strategjitë konkrete të cilat do të mund të përmirësojnë zbatueshmërinë e ligjit, uljen e hapësirave korruptive, forcimin e sistemit të drejtësisë, etj.

Gjithashtu në këtë dokument theksohet shumë që FA shqiptare do të duhet të zhvillojnë kapacitetet në mënyrë që të shërbejë si një mbështetje në angazhimet në kuadër të misionëve të NATO-s, por në të nuk përmendet fakti që kjo forcë duhet të zhvillohet edhe për mbrojtjen e institucioneve të vendit nga veprime të mundshme të organizatave terroriste që gjithnjë e më tepër po e shikojnë Shqipërinë si një vend ideal strehimi.

Problematika e dytë lidhet me konceptimin e SSK përsa i përket ndarjes në nivele të kërcënimeve. Vihet re që në të tri nivelet, kërcënimet janë paraqitur në nivelin sipërfaqësor, duke i ngatërruar shpeshherë me rreziqet me të cilat përballojnë të gjitha shtetet e sistemit ndërkombëtar, kur në të vërtetë SSK-ja e një shteti duhet të bëjë përpjekje për të identifikuar kërcënimet e brendshme reale të shtetit të tij, të cilat favorizohen nga faktorë të ndryshëm, dhe kjo vjen si rezultat i analizave të rrethanave dhe kushteve specifike. Mendoj se duhet bërë një kujdes i madh në renditjen e intensitetit të kërcënimeve.

Gjithashtu, p.sh. përsa i përket mjedisit rajonal, nënvizohet që kërcënimet mund të vijnë nga rritja e nacionalizmave si pasojë e ekzistencës së shoqërive të ndara, apo kërcënime që mund të vijnë si rezultat i mosmarrëveshjeve të pazgjidhura ndërshtetërore. Mungon tërësisht identifikimi i mosmarrëveshjeve të pazgjidhura që ka Shqipëria, konkretisht me cilat shtete. Në të tri nivelet vihet re se thjeshtë kërcënimet janë paraqitur formalisht, sepse mungon specifikimi i veprimeve konkrete të cilat do të ndërmerren për të parandaluar, mbrojtur sigurinë e shtetit shqiptar nga kërcënimet apo sfidat në të tri nivelet, atë kombëtar, rajonal dhe global.

Dokumentit tjetër strategjik SSU, që konsiderohet edhe si dokumenti themelor që jep

parimet dhe konceptet kryesore për zhvillimin, përdorimin dhe drejtimin e FA të Republikës së Shqipërisë, u miratua në 2015. Ky dokument pasqyron të gjithë faktorët që ndikojnë në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të sigurisë. Në këtë dokument nënvizohet se kërcënimet ndaj sigurisë globale mund të shkaktohen nga aktorë shtetërorë dhe jo-shtetërorë të cilët zhvillohen me shumë shpejtësi dhe përdorin mjete asimetrike, të cilat kanë pasoja shumë të mëdha për sigurinë kombëtare, rajonale dhe globale. E në këto kushte bëhet e domosdoshme krijimi i kapaciteteve të afta, të cilat mund të reagojnë me efikasitet ndaj kërcënimeve që vijnë nga këta aktorë.

Ndërsa në nivelin rajonal, kjo SU konsideron si kërcënime ekzistencën e fenomeneve si korrupsioni, krimi i organizuar dhe trafiket e paligjshme, të cilat shkaktojnë destabilitet e për pasojë sjellin pasiguri. Përsa i përket mjedisit të brendshëm, në këtë strategji pasqyrohen si kërcënime përdorimi i Shqipërisë si një vend tranist i narkotikëve me origjinë nga Azia si dhe kërcënimet të cilat vijnë si rezultat i destabilitetit në Lindjen e Mesme dhe Afrika e Veriut. Gjithashtu si kërcënim i brendshëm i mjedisit të sigurisë konsiderohet transferimi i konflikteve, kryesisht atyre me bazë fetare, emigracioni i paligjshëm, trafiket e formave të ndryshme, ekspozimi i Shqipërisë ndaj një sulmi të mundshëm terrorist, etj.

Kjo strategji ka bërë një kategorizim të rreziqeve konvencionale dhe jo-konvencionale, të cilat kërcënojnë sigurinë e brendshme të Shqipërisë. Rreziku konvencional konsiderohet si një rrezik minimal, si pasojë e partneritetit dhe anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Ndërsa si kërcënime jo-konvencionale, nënvizohen terrorizmi, fatkeqësitë natyrore, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë, sulmet kibernetike, krimi i organizuar, destabiliteti politik, cënimi i linjave kryesore të komunikimit dhe të furnizimeve si siguria e linjave energjetike. Koncepti i sigurisë dhe mbrojtjes në këtë dokument strategjik është i lidhur ngushtë me konceptin e sigurisë së aleancës së NATO-s. Politika e mbrojtjes

sonë nuk identifikon asnjë shtet si armik dhe përpiqet të nënvizojë se përdorimi i forcës ushtarake do të jetë mjeti i fundit i përdorur.

Ndërsa përsa i përket rolit të FA të RSH, në këtë dokument nënvizohet konsolidimi i saj në një forcë profesionale me cilësi të lartë operacionale, ndërvepruese, nëpërmjet modernizimit të saj, në funksion të realizimit të misioneve brenda dhe jashtë vendit nën drejtimin e NATO-s, BE-së, OKB-së. Gjithashtu në këtë strategji përcaktohen detyrat kryesore që duhet të realizojë FASH në kohë paqeje, krize dhe lufte (Strategjia e Sigurisë Ushtarake, 2015)

Nëse do të bënin një reflektim edhe SSU, karakterizohet nga njëserë problematikash, të cilat e kthejnë atë në një dokument strategjik të karakterit teorik dhe vështirësisht të aplikueshëm. Problematika e parë lidhet me një paqartësi dhe mos koordinim të atyre që konsiderohen si rreziqe për sigurinë kombëtare të Shqipërisë nga ato që përcakton SSK dhe ato që parashtrohen tek SSU. Kjo vihet re edhe përsa i përket dy niveleve të tjera atij rajonal dhe global. P.sh., kërcënimin nga një sulm i mundshëm terrorist në SSU është konsideruar si një kërcënim i brendshëm i sigurisë, ndërsa tek SSK një sulm i tillë nuk është i përfshirë tek kërcënimet apo sfidat e brendshme të Shqipërisë, të njëjtën mund të themi edhe sigurinë energjetike, ku të dy dokumentet e kanë renditur në nivele të ndryshme.

Problematika e dytë lidhet me mangësitë që paraqiten për rrezikun konvencional, sepse nga njëra anë thuhet që rreziku është minimal si pasojë e anëtarësimit tonë në NATO, nga ana tjetër thuhet gjithsesi se nuk duhet shpërfillet një kërcënim i tillë. Problematika në këtë rast lidhet me faktin se vetëm është identifikuar, por nuk është dhënë asgjë konkrete se si do të përballëshim ne në rast se ndodhte një kërcënim i tillë. Kjo strategji nuk parashikon asgjë për përballimin e ndonjë agresioni të mundshëm/ konflikti ushtarak.

Ndërsa problematika e tretë lidhet me të ardhmen dhe rolin e forcave tona të armatosura, pasi në SSU nuk parashikohet qartësisht se si dhe ku do të përdoren FA, pasi mungon identifikimi i qartë i aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë të cilët kërcënojnë rendin dhe sigurinë tonë kombëtare. Gjithashtu, roli dhe misioni i FA është i paplotë, pavarësisht ndarjes dhe detyrave të tyre specifike në kohë paqeje, krize dhe lufte. P.sh. thuhet zgjerimi i spektrit të angazhimeve të tyre, por vetëm kaq nuk përcaktohet qartë dhe në cilat drejtime. Nënvizohet fakti se në kohe krize detyra kryesore e saj është mbrojtja e popullit dhe vendit në rast kërcënimesh, por edhe këtu nuk jep mënyrat dhe mjetet që do të përdorë për ta realizuar këtë gjë. Gjithashtu në kohë lufte përcakton si detyrën kryesore të saj ndërmarrjen e operacioneve ushtarake në mbrojtje të territorit të vendit dhe popullsisë së saj, por nuk parashikon ose nuk identifikon asnjë shtet të mundshëm i cili mund të cenojë për shkak të politikave të tij të ndjekura, sovranitetin dhe integritetin territorial të Shqipërisë. Pas analizimit të dy dokumenteve të fundit strategjik të RSH, mund të themi që këto dokumente janë më shumë të karakterit teorik dhe formal, sesa strategji të mirëfillta dhe efikase për realizimin e prioriteteve dhe interesave kombëtarë të Shqipërisë.

Konsiderimi si arritje të politikave apo masave të ndërmarra, duke i krahasuar me ato të mëparshmet, nuk është një tregues i plotë sepse kjo gjë nuk na çon askund, përkundrazi mund ta bëjë situatën akoma edhe më problematike. Politikbërsit duhet të kuptojnë njëherë e mirë se elementi bazë për funksionimin e një demokracie të konsoliduar, për zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme, për mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve të saj është përcaktimi i qartë dhe i drejtpërdrejtë i prioriteteve dhe interesave kombëtar të Shqipërisë.

Nëse ne do të vazhdojmë të mos bëjmë analizat e duhura, për të përcaktuar nëpërmjet një vizioni afatgjatë interesat kombëtar, atëherë ne kurrë nuk do të arrijmë të realizojmë dhe implementojmë dokumentet strategjik të sigurisë kombëtare të RSH që na përfaqësojnë ne. Dokumentet tona do të shpalosin thjeshtë një situatë të përgjithshme e cila thjesht informon por nuk jep zgjidhje dhe nuk do të ndikojnë në zhvillimin e Shqipërisë në të gjitha aspektet/ elementët e fuqisë së saj. SSK dhe SU nuk pasqyrojnë gjë tjetër veçse fytyrën reale të një shteti, analizimi i tyre nxjerr në pah dështimin ose fuqinë e shtetit.

Mos realizimi i dokumenteve strategjik të mirëfilltë pasohet nga strategji apo plane veprimi të pa aplikueshme dhe pa efektivitetin e duhur. Çdo gjë është si një mekanizëm, ku secila pjesë varet nga funksionimi i të gjithë elementëve të saj. Të gjithë ata të cilët merren me hartimin e SSK dhe SU apo edhe strategjive të tjera të cilat mund të konsiderohen si të dytat në nivelin e hierarkisë së politikave, duhet të tregojnë përgjegjshmëri dhe profesionalizëm për të bërë analizat e duhura në shërbim të zhvillimit të Shqipërisë.

Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve të fuqisë së shtetit shqiptar, duhet të konsiderohet prioritet madhor i padiskutueshëm dhe kjo arrihet vetëm kur ka vullnet të përbashkët për të kaluar përtej interesave të caktuara të elitës politike. Nëse ne do vazhdojmë të hartojmë strategji të tilla, të cilat janë thjeshtë përshkruese por pa thelb, ne rrezikojmë ekzistencën e shtetit tonë si dhe paaftësi për të realizuar një funksionim normal të demokracisë si dhe në krijimin e një mjedisi të sigurtë për qytetarët e RSH.

Pa u realizuar kjo e para e cila është thelbësore, ne as që mund të pretendojmë të kemi një pozicion të mirë në sistemin ndërkombëtar dhe të mund të kontribuojmë në zgjidhjen e problematikave në nivelin global. Duhet të theksoj faktin që deri më sot, nga elitat e ndryshme politike shqiptare është menduar se si të mund të bëjmë aleancat e duhura apo të bëhemi pjesë

e organizmave të ndryshëm ndërkombëtar, thjeshtë duke implementuar dhe adaptuar politikat e tyre, sepse i kanë parë si zgjidhjet më të mira për zhvillimin e Shqipërisë, kur në fakt duhet të kishte qenë e kundërta. Bërja pjesë e këtyre organizimeve të rëndësishme ndërkombëtare duhej të shikohej si një element ndihmues për realizimin, zhvillimin dhe forcimin e elementeve të brendshëm i cili duhet të kishte qenë synimi primar.

Kapitulli VI: Përfundime dhe rekomandime

6.1 Përfundime

Koncepti tradicional i sigurisë e konsideron shtetin si objektin dhe burimin kryesor të sigurisë. Përgjegjësia themelore e shtetit është t'u garantojë mbrojtje dhe t'u sigurojë mirëqenie qytetarëve të tij. Shtetet, për të përmbushur interesat e tyre kombëtar, mbështeten tek fuqia ushtarake si elementi më i rëndësishëm për garantimin e sigurisë së tyre. Shekulli 20-të u karakterizua nga një evoluim i konceptit të sigurisë, ku aleancat u konsideruan si forma më e mirë për realizimin e sigurisë rajonale, nëpërmjet lindjes së konceptit të mbrojtjes kolektive. Siguria në këtë periudhë u konsiderua si përgjegjësi kolektive e shteteve në sistemin ndërkombëtar duke u mbështetur tek parimet, si: respektimi i të drejtave të njeriut, parimeve demokratike të qeverisjes dhe përdorimit të forcës e fuqisë ushtarake si mjeti i fundit.

Vlen të theksohet se gjatë Luftës së Ftohtë, siguria ka qenë e bazuar tek koncepti i sovranitetit të shtetit, integriteti territorial si dhe tek autonomia politike. Mjedisi i ri gjeopolitik dhe gjeostrategjik i pas Luftës së Ftohtë, solli rikonceptimin e sigurisë. Problematikat e ndryshme të shfaqura në sistemin ndërkombëtar, të tilla si: krimi i organizuar, terrorizmi, emigracioni, degradimi mjedisor, konfliktet etnike, shtetet e dobëta, armët e shkatërrimit në masë, etj., çuan tek domosdoshmëria e zgjerimit dhe thellimit të konceptit të sigurisë. Nisur nga kjo panoramë, u bë e nevojshme identifikimi i fushave të reja të sigurisë dhe objekteve të cilat duheshin sigurizuar. Pra siguria nuk u kuptua më vetëm në terma ushtarak, por edhe në terma ekonomik, politik, shoqëror, etj. dhe objekti i referimit nuk u konsiderua më vetëm shteti.

Nga një vlerësim i sfidave ndaj mjedisit të sigurisë, identifikojmë se niveli më i lartë i pasigurisë kombëtare dhe globale vjen si pasojë e operimit të krimit të organizuar dhe terrorizmit (aktorë jo-shtetëror transnacional), shoqëruar kjo edhe me krizën ekonomike. Të dy këto fenomene përbëjnë kërcënimin më të madh ndaj sigurisë sot, sepse veç e veç apo së bashku këto veprimtari kriminale përdorin dhunën në një shkallë të gjerë, korrupsionin si mjet për të korruptuar zyrtarët shtetëror, si dhe arritjen e përfitimeve sa më të mëdha. Evoluimi i krimit të organizuar ka treguar përpjekjet e tij të vazhdueshme për ndërtimin e bazave dhe strukturave të fuqishme, të cilat kanë rivalizuar fuqinë e shteteve duke nxjerrë në pah dobësinë e institucioneve shtetërore. Gjithashtu, evoluimi i veprimtarive kriminale në forma, teknika, mjete dhe struktura të ndryshme ka treguar se impakti i tij si kërcënim për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare të shteteve bëhet gjithnjë e më i madh. Bashkëpunimi i grupeve të krimit të organizuar dhe atyre terroriste, vihet re në: përdorimin e tregjeve të paligjshme dhe në përdorimin e formave të krimit të organizuar si trafikimi i drogës, vjedhjet, falsifikimet, trafikimin e armëve, etj. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi përfitojnë të dy aktorët jo-shtetërorë, si në aspektin e akumulimit të sasive të mëdha të kapitalit ashtu dhe në rigjenerimin e burimeve të tyre për t'i u kundërpërgjigjur reagimeve qeveritare/kombëtare-ndërkombëtare.

Sulmi i 11-Shtatorit i kryer nga organizata terroriste Al-Kaeda pasqyroi më së miri evoluimin, efikasitetin dhe nivelin më të lartë të impaktit të veprimtarive terroriste. Kjo formë e re e shfaqur ishte e përmasave ndërkombëtare, i ndryshëm nga ai i mëparshmi i shfaqur kryesisht si një dukuri e cila operonte brenda shteteve, brenda një rajonit, shoqërive apo komuniteteve të caktuara.

Ky transformim erdhi si rezultat i një konteksti të ri të shfaqur (Globalizmi). Rreziku më i madh i sigurisë globale sot konsiderohet të jetë fuqizimi i aktorit transnacional jo-shtetëror, i terrorizmit (Organizata terroriste ISIS). Organizata terroriste ISIS paraqitet si

rreziku më i madh i sigurisë për shkak të karakteristikave që ajo shfaq - ajo përbën shembullin e organizatës më të sofistikuar terroriste, sepse ajo ka arritur të krijojë të gjitha aftësitë dhe kapacitetet gjysmë kombëtare me synimin e vetëfinancimit të infrastrukturës së saj ushtarake. ISIS pasqyron shembullin më të mirë të bashkëpunimit ndërmjet organizatave të ndryshme terroriste dhe grupeve të cilat përdorin në veprimtaritë e tyre format e krimit të organizuar. Përveçse një kërcënim lokal e rajonal për paqen në Lindjen e Mesme, shteti islamik përbën një kërcënim global. Pas deklarimit të Kalifatit dhe pretendimit të një roli udhëheqës mes grupeve xhihadiste në botë, ISIS tashmë paraqet një rrezik për sigurinë ndërkombëtare. Shteti islamik mund të kthehet në një inkubator terroristësh, për të eksportuar militantë të planifikuar për akte terroriste në vendet perëndimore, por edhe mund të shërbejë si kauzë frymëzimi për organizim aktesh terroriste nga individë të veçuar por me impakt të madh.

Sikurse terrorizmi ndërkombëtar, krimi transnacional po kthehet në një sfidë shumë të rëndësishme për sigurinë kombëtare të shteteve, sepse ai ka arritur të depërtojë në pikat më të dobëta të organizimit shtetëror, nëpërmjet teknikave të korrupsionit të funksionarëve në sektorë dhe në nivele të ndryshme. Krimi transnacional kërcënon sigurinë kombëtare të shteteve edhe në aspektin ekonomik. Shpeshherë këto grupe investojnë të ardhurat e tyre në ekonominë formale, një strategji kjo për pastrimin e parave të tyre duke përbërë një kërcënim serioz për ekonominë kombëtare. Pra, pjesa më e madhe e ekonomisë së një vendi rrezikon dhe kërcënohet të përfundojë dalëngadalë, nën kontrollin e plotë të krimit të organizuar, në rast se qeveritë e shteteve nuk marrin masat e nevojshme dhe efektive për ta luftuar krimin.

Koncepti i Sigurisë në vendin tonë ka ndjekur pak a shumë të njëjtin proces evoluimi si edhe në vendet e tjera të sistemit ndërkombëtar, vecanërisht shtetet e vogla. Për forcimin e sigurisë, Shqipëria e periudhës (1945-1990) u mbështet tek modernizimi i forcave të

armatosura si elementi kryesor i realizimit të mbrojtjes së tërësisë territoriale dhe sovranitetit të tij, tek aleancat me aktorë të rëndësishëm, tek izolimi (vetëmbrojtja popullore) dhe mbrojtja totale. Gjate kësaj periudhe koncepti i sigurisë rezulton i pandashëm nga termi mbrojtje.

Mjedisi i ri gjeopolitik i shfaqur pas përfundimit të luftës së Ftohtë solli evoluimin e konceptit të sigurisë në Shqipëri, e cila nuk trajtohet më në fuqizimin e shtetit në terma ushtarakë, por siguria kombëtare lidhet me sigurinë rajonale dhe globale, e cila tashmë bazohet tek përdorimi i diplomacisë, marrëveshjeve shumëpalëshe dhe tek zhvillimi i të gjithë komponentëve të fuqisë kombëtare.

Faktorët që kanë lehtësuar lindjen dhe zhvillimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit në Shqipëri kanë qenë përmbysja e sistemit komunist, ekonomia e dobët, destabiliteti politik, kriza/kolapsi ekonomik i vitit 1997-të, që u shoqërua me destabilitet, rrezikimin e rendit kushtetues, përmbysjen e qeverisë dhe me mungesën e sundimit të ligjit. Edhe situata e konflikteve në rajon (shpërbërja e ish-Jugosllavisë) ka ndikuar në rritjen e mundësive të bashkëpunimit të grupeve kriminale shqiptare me grupe kriminale jashtë territorit të saj.

Sot lufta kundër krimit të organizuar përbën një nga faktorët, por edhe kushtet më të rëndësishëm për anëtarësimin në BE, pasi krimi i organizuar pengon zhvillimin dhe realizimin e objektivave si forcimi i shtetit ligjor, rendit, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore për funksionimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Në kushtet kur krimi i organizuar dhe terrorizmi konsiderohen si sfida globale, edhe shteti shqiptar ka ndjekur të njëjtën strategji që përdorin partnerët e tij. Për të parandaluar veprimtaritë kriminale, i është dhënë një rëndësi e madhe bashkëpunimit rajonal, sepse ky bashkëpunim është parë si domosdoshmëri për të garantuar dhe rritur nivelin e sigurisë.

Ekziston një bazë e mirë ligjore në luftën kundër krimit të organizuar por problematikë madhore mbetet fakti i mos zbatueshmërisë së ligjit, i cili ka ndikuar në mënyrë të

drejtpërdrejtë në krijimin e një klime mosbesimi të qytetarëve ndaj shtetit dhe institucioneve të tij dhe instalimit të kulturës së mosndëshkueshmërisë ndaj atyre që shkelin ligjin.

Në rastin e Shqipërisë, kërcënimet ndaj sigurisë vënë në pikëpyetje ekzistencën e shtetit dhe mirëqenien e qytetarëve të saj. Fakti që deri më sot këto dy fenomene janë përcaktuar thjeshtë vetëm si prioritet kryesor të sigurisë, tregon se nuk ka ndodhur një proces i mirëfilltë sigurizimi që kërkon vëmendjen e politikës dhe opinionit publik.

6.2.Rekomandime

- Së pari, duke marrë në konsideratë mjedisin bashkëkohor të sigurisë është e nevojshme që krimi i organizuar dhe terrorizmi në Shqipëri të konsiderohen si çështje të cilat duhet të sigurizohen dhe të aplikohet procesi i sigurizimit me të gjithë etapat e tij, sepse niveli i rrezikshmërisë së tyre ndaj sigurisë së shtetit, qytetarëve dhe mirëqenies së tyre është ekzistencial dhe kjo bën të domosdoshme marrjen e masave të jashtëzakonshme.
- Së dyti, sigurizimi i këtyre çështjeve ka nevojë dhe për një mbështetje në bazë, e cila mund të arrihet nëpërmjet përdorimit të një ligjërimi politik me qëllim bindjen e audiencës për domosdoshmërinë e sigurizimit të këtyre fenomeneve.
- Së treti, kërkohet angazhimi i të gjithë elementëve të fuqisë kombëtare të shtetit shqiptar në funksion të realizimit të këtij procesi dhe kalimin e këtyre çështjeve nga faza e sigurizimit tek faza e desigurizimit e cila nënkupton kalimin e këtyre çështjeve në procesin normal dhe mos konsiderimi i tyre si kërcënim ekzistencial sigurie
- Së katërti, duhet të merren masa për luftën kundër këtyre dy fenomeneve, sepse mos marrja e masave të duhura kundër përhapjes së tyre do të ndikonte akoma edhe më shumë në dobësimin e mëtejshëm të instrumenteve shtetëror.

- Së pesti, është e nevojshme të hartohen dhe zbatohen politika konkrete në përmirësimin dhe forcimin e institucioneve shtetërore si dhe politika për përmirësimin e situatës ekonomike për qytetarët, me qëllim rritjen e nivelit të besimit të shoqërisë tek shteti. Rritja e besueshmërisë së shoqërisë, ndikon edhe në rritjen e ndërgjegjësimit dhe ofrimit të mbështetjes së saj përkundrejt prioriteteve të përcaktuara dhe politikave të ndërmarrura nga qeveria
- Së gjashti, rekomandohet të ndiqet një politikë gjithëpërfshirëse, një strategji kombëtare me objektiva, mjete dhe mënyra efektive dhe të aplikueshme, në ndryshim nga strategjitë e mëparshme të cilat paraqiten thjeshtë si strategji teorike pa thelb. Mos realizimi i dokumenteve strategjik të mirëfilltë pasohet nga plane veprimi të pa aplikueshme dhe pa efektivitetin e duhur.
- Së shtati, është e nevojshme që politikbërsit të ndërgjegjësohen për faktin se elementi bazë për funksionimin e një demokracie të konsoliduar, për zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme, për mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve të saj është përcaktimi i qartë dhe i drejtpërdrejtë i prioriteteve dhe interesave kombëtar të Shqipërisë.
- Së teti, është e domosdoshme që të kalohet përtej interesave të caktuara të elitës politike, ku zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve të fuqisë së shtetit shqiptar, të konsiderohen si prioritete madhore. Kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet ndërgjegjësimit kolektiv dhe vullnet të përbashkët.

Bibliografia

➤ Literaturë

- Alexander, J. (1976). International Terrorism: National, Regional and Global Perspectives. New York: Praeger.
- Arsovska, J. (2006). Understanding a Culture of Violence and crime: The kanun of Lek Dukagjini and the Rise of Albanian sexual- Slavery Racket. European Journal of Crime, Criminal Law and Justice. Vol 14/2.
- Arsovska, J. (2015). Decoding Albanian Organized Crime. Culture, Politics and Globalization. Oakland, California: University of California Press.
- Art, R., & Waltz K. (2004). "The use of force: military power and international politics". Rowman& Littlefield Publisher.
- Ayoob, M. (1995). "The third world Security Predicament". Boulder: Lynne Rienner.
- Bale, J. Definition of terrorism. The Monterey Terrorism Research and Education Program.
- Baldwin, D. (1997). "The concept of Security". Review of International Studies. British International Studies Assosation.
- Bashkurti, L. (2008). "Krizat ndërkombëtare". Tiranë: Mirgeeralb.
- Baylis, J., Wirtz, J., Collins, G., & Cohen, E. (2012). Strategjia në botën bashkëkohore: Hyrje në studimet e strategjisë. Tiranë:UET Press.
- Booth, K. (1991). "Security Emancipation". Review of International Studies 17 (4).

- Booth, K. (2007). Theory of World Security. Cambridge: Cambridge University Press.
- Boulding, K. (1963). "Towards a Pure Theory of Threat Systems". American Economic Review 53.
- Braudel, F. (1987). "Gramatikë e qytetërimeve". Tiranë: Shtëpia e Librit dhe Komunikimit.
- Brodie, B. (1950). "National Security Policy and Economic Stability". New Haven, CT, Yale Institute for International Studies, Memorandumi Nr. 33.
- Buzan, B. (1991). "People, States and Fear: An agenda for international Security Studies in the post-cold war era". Harvester Wheatsheaf.
- Buzan, B., në Ole Wæver & Jaap de Wilde (1998), "Security. A New Framework for Analysis", London: Lynne Rienner Publishers.
- Centro Nacional de Memoria Historica. (2014). Guerrilla y población civil. Trayectoria de las FARC 1949-2013. Tercera edición. Bogotá: CNMH.
- Chaliand, Gerard & Blind Arnaud. (2007). 'The History of Terrorism: From Antiquity to Al Qaeda'. Berkeley, Los Angeles, California: University of California Press.
- Charlss W. Kegley, Jr. (2009). "Politikat Botërore". Tiranë: UFO Press.
- Collins, A. (2009). "Studime bashkëkohore të sigurisë". Tiranë: UET Press.
- Dahl, R & Lindblom, Ch. (1953). "Politics, Economics and Welfare". The University of Chicago Press.
- Dauti, D. Dora e Zezë dhe terroristi i quajtur Gavrillo Princip. Botuar në gazetën Telegraf më 28.06.2014. Për më shumë shiko:

<http://www.telegrafi.com/lajme/dora-e-zeze-dhe-terroristi-i-quajtur-gavrillo-princip-26-6861.html>.

- Deliso, Ch. (2007). The Coming Balkan Caliphate: The Threat of Radical Islam to Europe and the West. London: Praeger Security International.
- Departamenti i Mbrojtjes i SHBA (1987), “Fjalor i Termave Ushtarake”. Washington.
- Dimitrijevic, V. (1973). “The Concept of Security in International Relations”. Beograd: Savremena Administracija.
- Dobovsek, B. (1996). Organized Crime: Can we unify the definition. In: Policing in Central and Eastern Europe: Comparing Firsthand Knowledge with Experience from the West. Tetrieved June 2006.
- Enders, W., & Sandles ,T. (2006). The Political Economy of Terrorism. New York: Cambridge University Press.
- Enver, H. (1983). “Për Ushtinë Popullore” Vëll I. Tiranw: Shtëpia botuese 8 Nëntori.
- European Commission.(1999). Organized Criminality Security in Europe. Fondazione Rosselli.
- Fijnuat, C., & Paoli, L. (2004). “Organized crime in Europe”. Concepts, Patterns and Control Policies in European Union and Beyond. Hollandë: Springer.
- Fita, E. (2011). Cështje Europiane dhe të Sigurisë, Nr. 20. Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësi.
- Friedman, Th. (2003). “Bota në kohën e terrorizmit ”. Tiranë: IDK.
- Fukuyama, F. (2008). “Ndërtimi i shtetit”. Tiranë: AIIS.

- Ganor, B. (2005). The Counter –Terrorism Puzzle: A Guide for decision makers. The International Policy Institute for Counter Terrorism. New Brunswick (U.S.A) and London (U.K): Transaction Publishers.
- Goldstein, J. (2003). “Marrëdhënie Ndërkombëtare”. Tiranë: Dituria.
- Herz, J.(1950). “Idealist internationalism and the security dilemma”. World Politics 2.
- Hewedy, A. (1989). “Militarization and Security in the Middle East”. London: Pinter Publishers.
- Hobbes, Th. (2008). “Leviathan”. Republished by Forgotten Books.
- Hoffman, B. (2006). Inside Terrorism (2 nd ed). New York: Columbia University Press.
- Hoffmann, S. (1972). “Weighting the Balance of Power”. Foreign Affairs, Westview Press.
- Holsti, K. (2008). “Shteti, Lufta dhe gjendja e luftës”. Instituti i Studimeve Ndërkombëtare. Tiranw: Shtëpia Botuese AIIS.
- Howard , R., & Sawyer, R, eds. (2006). Terrorism and Counterterrorism: Understanding the New Security Environment. Publishers Dubuque, Iowa: McGraw Hill, Contemporary Learning Series.
- Hoxha, L. (2010). Leksion “Çështje të Strategjisë Ndërkombëtare; Agenda e re në Strategjinë e Sigurisë”. Tiranë: UET.
- Hoxha, L. (2011). “Analizë Strategjike 2”, Leksioni Nr. 4. Tiranë: UET, Tiranë 2011.
- Hysa, V. (2005). “Kriminologjia”. Tiranë: Kristalina.

- Ikenberry, J. (2003). "American Grand Strategy in the Age of Terror". Department of National Security and Strategy Textbook, Volume IV. Carlisle Barracks: U.S. Army War College.
- Internacional Institute for Strategic Studies. (2015). The Military Balance: The annual assessment of global military capabilities and defence economics of 171 countries.
- Jean, K. (1998). Gjeopolitika. Tiranw: Shtëpia botuese e Ushtirsë.
- Jervis, R. (1976). "Perception and Misperception in International politics". Princeton: Princeton University Press.
- Joseph, A. (1971). The American Mafia: Genesis of a Legend. New York: Irvington Press.
- Karlo Zhan (1996), "Interesat kombëtare dhe Politikat e Sigurimit" në "Politika e Sigurimit Kombëtar në Shoqërinë Demokratike", Shtëpia Botuese e Ushtrisë
- Kissinger, H. (1999). Diplomacia. Tiranë: Lidhja e Shkrimtarëve.
- Krause, K. (1998). 'Critical Theory and Security Studies: The Research Programme of "Critical Security Studies"', Cooperation and Conflict, Vol. 33, No. 3.
- Krause, L & Joseph Nye, J. (1975). "Reflections on the Economics and Politics of International Economic Organizations". "World Politics and International Economics". Washington D.C.:Brookings Institution.
- Krell, G. (1979). "The Development of the Concept of Security", Arbeitspapier 3. Frankfurt: Peace Research Institute.

- Kujur, R. (2008). Naxal Movement in India: A profile. New Delhi, India: Institute of Peace and Conflict Studies.
- Laquer, W. (1997). Terrorism. London: Weidenfeld and Nicolson.
- Laquer, Wolter. The Age of Terrorism (2 nded). Boston: Little & Brown, 1987.
- Law, D. (2007). “Praktikat më të mira në fushën e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare”. Revista Mbi Zhvillimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Tiranë: Botimet Toena.
- League Convention. (1937). Convention for the Prevention and Punishment of Terrorism. Article 1(2).
- Lenin, V. (1976). “Mbi luftën Ushtrinë dhe Mbrojtjen”. Vëll I, Tiranë.
- Lippman, W. (1943), “US Foreign Policy: Shield of the Republic”. Boston: Publisher Hamish Hamilton.
- Lleshi, A. (2009). “Gjeopolitika e Ballkanit dhe Perspektivat në Rajon”. Tiranë: Geer.
- Luciani, G. (1989). “The economic content of security”, Journal of Public Policy, 8/2.
- Mallory, S. (2006). Understanding Organized Crime. Sadbury, Massachusetts: Jones and Bartlett Publishers.
- Matthews, B., & Ross. L. (2010). “Metodat e Hulumtimit. Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane”. Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik (CDE).
- Mark, L. “Why Europe Will Run the 21st Century”, New- York: Fourth Estate.

- Marsella, A., & Moghaddam, F. (2004). The Origins and Nature of Terrorism: Foundations and Issues. Journal of Aggression, Maltreatment & Trauma, Vol. 9, Issue 1-2. The Haworth Press.
- Mejdani, R. (2007), “Disa mendime mbi Rishikimin e Dokumentit të Strategjisë”. Revista Mbi Zhvillimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Tiranë: Botimet Toena.
- Menotti, Lucarela, Sonia and Roberto (2006). “The use of force as Coercive Intervention”, in Sonia, Lucareli and Ian Manners, eds, Values and Principles in European Union, Foreign Policy. London: Routledge.
- Michaletos, I. (2007). “Turkish Organized Crime”. Athens- Greece: Wordpress.org. November 12.
- Michaletos, I. (2013). Organized Crime in the Balkan-Albanian Mafia. Balkaninside. December 29.
- Mingst, K. (2008). “Bazat e marrëdhënieve ndërkombëtare”. Tiranë: AIIS.
- Morgenthau, H. (2008). “Politika ndërmjet kombeve”. Tiranë: AIIS.
- Najrn Al-'Arniri. Sa'id Mahmud. (2002). The Birth of Al-Wahabi Movement And it's Historic Roots.
- Nobilo, M. (1988). “The Concept of Security in the Terminology of International Relations”. Political Thought, October-December.
- Nye, J., & Welch, D. (2014). Konflikti dhe bashkëpunimi në Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Tiranë: Dudaj.
- Paulauskas, K. (2007). The Security Studies: The Status Quo and the Trends. Vilnius, Lithuania: Military Academy of Lithuania.

- Poda, Zamir. “Krimi i organizuar transnacional”. Shtëpia Botuese Morava.
- Pugh, J. (2005). Democratic Peace Theory: A review and Evaluations. Center for Mediation Peace and Resolutions of Conflict, International.
- Ranstrop, Magnus & Brun, Hans. (2013). Terrorism Learning and Invation: Lessons from PIRA In Northen Ireland. Sweden: Swedish National Defence College: Center for Asymmetric Threat Studies.
- Rapoport, D. (1977). The Government is up in the air over Combating Terrorism. National Journal, Vol. 9.
- Raufer, X. (2002.) At the heart of the Balkan chaos: the Albanian mafia.
- Schmid, A., & Jongman, A. (1988). Politikcal Terrorism: A New Guide to Actors, Authors, Concept, Data Bases, Theories and Literature. Amsterdam: North Holland, Transaction Books.
- Schreier, F. (2010). Trends and Challenges in International Security: An Inventory. Geneva Center for the Democratic Control of Armed Forces (DCAF).
- Scruton, R. (2007). “The Palgrave Macmillan Dictionary of Political Thought”. Published by Palgrave Macmillan.
- Shelly, I. (1995). Transnational Organized Crime. Journal of International Affairs, 48 (2).
- Simon, J. (1994). The terrorist Trap. Bloomington: Indiana University Press.
- Sindquist, V.(2010). "Political Terrorism: An Historical Case Study of the Italian Red Brigades." Journal of Strategic Security. Vol.3, no. 3.
- Sloan, S (2006). Terrorism: The Present Threat in Context. Oxford: Berg Publishers.

- Stepanova, E. (2008). Terrorism in Asymmetrical Conflict: Ideological and Structural aspects. Sipri Research Report NO. 23. Oxford University Press.
- Stoessinge, J. (2007). “Përse kombet shkojnë në luftë” Tiranë: AIIS.
- Stojarova, V. (2012). Organized Crime in the Western Balkan. HUMSEC Journal, Issue 1. Graz.
- Svendsen, A. (2012). Understanding the Globalization of intelligence. Palgrave Macmillan, 30 August.
- Taureck, R. (2006). Securitization theory and securitization studies. Journal of International Relations and Development, (9). Palgrave macmillan.
- The Meir Amit Intelligence and Terrorism Information Center.(2014). ISIS: Potrait of a Jihadi Terrorist Organization.
- Ullman, R. (1983). “International Security”, Vol.8/NR.1, Summer.
- Vickers, M. (1998). “Shqipëria nga anarkia tek një identitet ballkanik”. Tirane: Shtëpia Botuese Toena.
- Wall, David: “Crime and the internet”, Routledge Londër& New- York 2002.
- Walt, S. (1991). “The renaissance of Security Studies”. International Studies Quarterly, Vol. 35. No. 2
- Wolfers, A. (1952). “National Security:As an ambiguous symbol”. Political Science Quartely, Vol 67.No. 4.
- Wolfers, A. (1962). “National Security as an Ambiguous Symbol”, Discord and Collaboration 7. Baltimore: John Hopkins University.

- Yakov, Gilinskiy and Kostjukosvki. (2004). “The history of Organized Crime in Russia”, bot. Organized Crime in Europe”, Concepts, Patterns and Control Policies in European Union and Beyond.
- Zhilla. F., & Lamallari, B. (2015). “ Krimi i Organizuar, Vlerësimi i rriskut në Shqipëri. Tiranë: Fondacioni shoqëria e hapur për Shqipërinë.

Burime Parësore

- Balkan web (2014). Harta e drogës, 6 pikat kufitare, ja rrugët e trafikut, nga Aurora Koromani më 28 Nëntor.
- Council of Europe. (2001). Preventive Legal Measures Againsts Organized Crime. Strasbourg.
- Council of Europe & European Commission (2006). Projekti Rajonal Carpo “ Raporti mbi gjendjen e Krimin të Organizuar dhe Krimin Ekonomik në Europën Juglindore”. Strasbourg.
- Council of the European Union. (2005). The European Union Counter-Terrorism Strategy.
- Definitions of Terrorism in the U.S. Code. Retrieved September 1, 2014:
- European Security Strategy. (2003). A Secure Europe in a better world. Brussels.
- Europol. (2004). European Union Organized Crime Report. Luxembourg: Office for Publication of the European Communities.
- Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë. Strategjia ndërsektoriale në luftën kundër Terrorizmit, 2011-2015. Botim i Qendrës për Publikime Zyrtare.

- Gazeta 55. (2010). “Të respektohen të drejtat e pakicës shqiptare në Serbinë jugore”, Deklarata për shtyp e ministrit të Jashtëm, Ilir Meta pas takimit me homologun e tij serb, Vuk Jeremiç, 12 Mars.
- Gazeta Dita. (2014). Raport i Komisionit për Këshillin dhe Parlamentin European për Progresin e Shqipërisë në Luftën kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe në Reformën në Gjyqësor, tetor 2014.
- Gazeta Tema. (2011). Lidhjet e krimit në Shqipëri shkojnë deri tek politika, Artan Hoxha, më 2 Prill.
- Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, 1946: Neni 94. Marrënga:http://shtetiweb.org/wpcontent/uploads/2014/05/strategjia_ndersektori_ale_e_luftes_kunder_krimin_te_organizuar_trafikeve_dhe_terrorizmit_vkm_178.pdf. Marrë nga: <http://licodu.cois.it/?p=385&lang=en>
- Ministria e Mbrojtjes, Akademia e Mbrojtjes. (1996). “Politika e Sigurimit Kombëtar në Shoqërinë Demokratike”. Tiranë: Shtëpia Botuese e Ushtrisë.
- Ministria e Mbrojtjes. (2002), “Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë”. Tiranë” Qendra e Shtypit, Botimeve dhe Përkthimeve Ushtarake.
- Ministria e Punëve të Brëndshme (2015). Konferenca e ministrave Tahiri dhe Hyseni për mediat me 29 Janar. Për më shumë shiko videon e konferencës për shtyp: <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/newsroom/fjalime/shqiperia-e-kosova-bashke-ne-luften-kunder-krimin-te-organizuar-dhe-terrorizmit-video&page=3>.

- National Commission on Terrorist Attacks upon the United States., Kean, T. H., & Hamilton, L. (2004). The 9/11 Commission report: Final report of the National Commission on Terrorist Attacks upon the United States. Washington, D.C.: National Commission on Terrorist Attacks upon the United States.
- NATO. (2010). Lisbon Summit Declaration. Issued by the Heads of State and the Government participating in the meeting of the NATO.
- NATO. Wales Summit Declaration. 5 September 2014. (obtaining from: <https://www.gov.uk/government/publications/nato-summit-2014-wales-summit-declaration>). seen on 20 January 2015.
- Paul Nesbitt, Head of Organized Crime Group, cit. in Bresler 1993, 319)
- Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave. (2002). Plan i veprimit Kombëtar në luftën kundër terrorizmit. Miratuar më 28 Janar.
- Republika e Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes. (2005). “Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë”. Tiranë: Qendra e Shtypit, Botimeve dhe Përkthimeve Ushtarake.
- Republika e Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes. (2008). “Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë”. Tiranë: Qendra e Shtypit, Botimeve, Përkthimeve Ushtarake.
- Republika e Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes. “ Strategjia e Sigurisë Kombëtare, 2014“.
- Republika e Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes. “Strategjia e Sigurisë Ushtarake, 2015“. Miratuar më 9 Korrik 2015.

- Republika e Shqipërisë, Ministria e Punëve të Brendshme. (2013). “Strategjia Ndërsektoriale në luftën kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të paligjshme dhe Terrorizmit, 2013-2020“.
- Republika e Shqipërisë. (2008). Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve dhe Terrorizmit.
- Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë .(1985). “Arti Ushtarak i Luftës Popullore”. Tiranë.
- Senator Alberto Maritati. Report: Organized crime in the Balkans with reference to Albania. Rome, November 16, 2002.
- The Eu response to Organized Crime. Taken from: C: / Documents and Settings/ new user/ Destop/ org. Crime_files/ The EU’s Response to Organized Crime,mht, 2007.
- Top Channel. (2014). “Top Story”: Intervista me Prokurorin e Përgjithshëm, Adriatik Llalla, 11 Qeshor. Marrw nga: <http://www.top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=287400>.
- U.S. (2003). National Strategy for Combating Terrorism.
- U.S. Department of state. Country Reports on Terrorism, 2013.
- U.S. Department of State. Country Reports on Terrorism, 2004.
- U.S. Department of state. County Reports on Terrorism, 2014.
- United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC). World Drug Report 2013. United Nations publication, Sales No. E.13.XI.6.
- United States (2011). Strategy to combat Transnational Organized Crime.

- United States Army Training and Doctrine Command TRADOC G2. (2007). A Military Guide to Terrorism in the Twenty-First Century. Handbook No. 1.
- United States Department of Defense. (2005). Dictionary of Military and Associated Terms.
- Zëri i amerikës. (2015). Intervista e Ministrit të Jashtëm të Shqipërisë. Z. Ditmir Bushatit më 20 Prill. Për më shumë shiko intervistën e plotë në <http://www.zeriamerikes.com/content/article/2726949.html>.